



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Auditim i Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare”



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE
VLORE”

<u>Nr .Përmbajtja</u>	<u>Faqe</u>
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-8
HYRJA	9-12
Objektivat dhe qëllimi	9-10
Identifikimi i çështjes	10-10
Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10-11
Përgjegjësitë e audituesve	11-11
Kriteret e vlerësimit	11-11
Standardet e auditimit	11-12
II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12-14
III. GJETJET DHE REKOMANDIMET	15-169
Pika 1 e Programit të Auditimit	14-27
<i>Auditimi i Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm</i>	
Pika 2 e Programit të Auditimit.	27-35
<i>Auditimi i programimit dhe realizimit të të ardhurave doganore për periudhën e auditimit</i>	
Pika 3 e Programit të Auditimit	37-96
<i>Auditimi i sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave</i>	
Pika 4 e Programit të Auditimit	96-115
<i>Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori regjimeve doganore ekonomike.</i>	
Pika 5 e Programit të Auditimit	115-128
<i>Auditimi i borxhit doganor dhe masat e marra për zbatimin e tij.</i>	
Pika 6 e Programit të Auditimit	128-144
<i>Auditimi i procedurave mbi vendimet administrative të nxjerra nga Autoriteti DoganorKompetent</i>	
Pika 7 e Programit të Auditimit	144-153
<i>Auditimi i veprimtarisë të subjekteve të Akcizës.</i>	
Pika 8 e Programit të Auditimit	153-158
<i>Të tjera gjatë auditimit</i>	
IV. REKOMANDIMET	158-169
ANEKSE	169-212
Komente dhe shpjegime nga subjekti i audituar	
DOKUMENTE SHOQËRUESE	212-213



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Degën Doganore Vlorë në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr.1148/1 datë 15.11.2017, nga data 15.11.2017 deri në datën 19.01.2018, për periudhën e juridiksionit të auditimit nga data 01.01.2015 deri në datë 01.10.2017 me lloj auditimi “*Auditim i Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare*” duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me realizimin e të ardhurave dhe zbatimin e legjislacionit doganor në Degën Doganore Vlorë .

Qëllimi i auditimit ishte vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Vlorë gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Drejtimet e auditimit u përqëndruan në 8 pika auditimi të detajuara më konkretisht në pjesën e 3 (katërt) të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi dhe që u përqëndruan në sektorët dhe problematikat e konstatuara më parë në fazën paraprake planifikuese. Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nga periudha 2011 deri në momentin e kryerjes së këtij auditimi janë kryer 2 (dy) auditime ligjshmërie dhe rregullshmërie financiare të cilët përkojnë me periudhën 2011 deri në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014.

Në këtë auditim u angazhuan 4 (katër) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjatë periudhës 01.01.2015-01.10.2017 është konstatuar se veprimtaria e Degës Doganore Vlorë në drejtim të realizimit të të ardhurave doganore ka ardhur me një vijueshmëri në ulje të të ardhurave doganore për shkak të uljes së kapaciteteve deklaruese dhe importuese nga subjektet tregëtarë, por interesi i burimeve njerëzore të administratës doganore të këtij subjekti është përqëndruar në realizimin maksimal të këtyre objektivave.

Objektivat kryesorë të veprimtarisë së subjektit që u auditua konsistuan në rritjen e të ardhurave doganore, përmirësimin e shërbimeve kundrejt subjekteve të biznesit dhe individëve, ruajtjen e parimeve të barazisë gjatë procesit të vlerësimit doganor të mallrave, rritjen e transparencës me operatorët tregëtarë, konstatimi dhe sanksionimi i veprimeve që krijojnë shkelje doganore me shmangie dhe mospagim të detyrimeve doganore.

Në përfundim të Raportit Përfundimtar të Auditimit u konstatuan të ardhura doganore të pallogaritura si dhe janë rekomanduar rilogaritje detyrimesh doganore për të cilat nuk janë kryer dhe nuk është kërkuar procedura e verifikimit doganor të vlerave të transaktuara për periudhën nën juridiksion auditimi **në Buxhetin e Shtetit në shumën 82,679 mijë lekë**, nga të cilat **shuma prej 74,194 mijë lekë** të ardhura doganore të pallogaritura gjatë procesit të auditimit të procedurave të vlerësimit dhe klasifikimit doganor, **shuma prej 6,150 mijë lekë** sanksione dhe detyrime doganore gjatë procedurave të veprimtarisë së subjekteve që operojnë në regjimin e përpunimit aktiv dhe të lejimit të përkohshëm, **shuma prej 2,335 mijë lekë** gjatë procedurave doganore të nxjerrjes së vendimeve administrative si dhe është kërkuar ndjekja e arkëtimit të pagesës së rentës minerare dhe garantimit të borxhit doganor për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe në **shumën prej 2,240,931 mijë lekë** për deklarime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017 të kryera nga dy subjekte deri në përfundim të hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare .

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes së zërave të aktivitetit dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit ushtron veprimtarinë Dega e Doganës Vlorë

Në përfundim të procedurës audituese për përmirësimin e situatës të konstatuar u rekomanduan **14 Masa Organizative** për ndjekje dhe zbatim nga Dega Doganore Vlore. Në këtë raport përfundimtar auditimi janë rekomanduar 3 Masa Shpërblim Dëmi në **shumën 82,679 mijë lekë**, dhe **2 Masa Organizative** për arkëtim detyrimi doganor për ndjekje sipas verifikimeve doganore në proces me garantim në shumën **2,240,931 mijë lekë**. Në përfundim të fazës së Raportit Përfundimtar të Auditimit u konstatuan problematika të ndryshme të cilat u përmblohdën në gjetje dhe rekomandime të klasifikuara sa më poshtë :

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	<p>Zbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave, klasifikimin tarifor dhe përfitimin e kushtit të trajtimit preferencial MSABE (reduktimit nga pagesa e tarifës doganore).</p> <p>Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë rrillogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor që lidhen vlerësimin doganor të shpenzimeve të transportit, të vlerës së mallrave për qëllime doganore, të përmbushjessë kushtit preferencial MSABE, përputhshmërisë së klasifikimit tarifor të mallrave, duke krijuar të ardhura doganore të munguara të rrillogaritura nga grupi auditues dhe të rekomanduara në shumën 74,194 mijë lekë në këtë Raport Përfundimtar Auditimi për periudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2015 deri në datën 01.10.2017.</p>	<p>Pika nr.3 “<i>Auditimi i procedurave doganore të sistemit të vlerësimit doganor dhe procedura te tjera doganore</i>”. (trajtuar në faqet nr.35-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	E lartë	<p>Dega Doganore Vlorë të ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën 74,194 mijë lekë për periudhën nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2015 deri në datën 01.10.2017 që lidhen me rrillogaritje pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje dhe mbështetje të shpjegimeve të nenit 34 deri 37 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “<i>Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë</i>” i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjit nr.102/2014 datë 31.7.2014 “<i>Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë</i>” i ndryshuar, VKM nr.205, datë 13.04.1999 “<i>Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor</i>” i ndryshuar, Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD “<i>Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore</i>”, shkresës nr.779 prot DPD datë 16.01.2013 “<i>Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE</i>”, shpjegimeve të Udhërrëfyesit të MSABE “<i>Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lire</i>” dalë sipas ligjit nr.9590, datë 27.07.2006 për “<i>Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit</i>” nga personeli përpunues doganor.</p> <p style="text-align: right;">Menjëherë</p>



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

2	<p>Mosrealizim i të ardhurave doganore dhe masa të rekomanduara për përmirësimin e të ardhurave doganore. Nga auditimi i ushtruar mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore gjatë periudhës së audituar të viteve 2015, 2016 dhe 9-mujori i parë i vitit 2017, u konstatua se nga Dega e Doganës Vlorë nuk janë realizuar të ardhurat doganore në krahasim me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar një diferencë të përgjithshme në vlerën 7,349,041 mijë lekë të rezultuar gjatë viteve 2015-2016 e cila përbën rreth 95,5% të diferencës totale të mosrealizuar, nga personeli përpunues doganor gjatë periudhës 2015 dhe 2016 në lidhje me përmbushjen e misionit që i janë ngarkuar sipas ligjit nr.8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH”,</p>	<p>Pika nr.2 “Auditimi i të ardhurave doganore”(<i>trajtuar në faqet nr 27-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>)</p>	Lartë	<p>Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë të marrë masa të plota ligjore e administrative me plane konkrete për të analizuar në mënyrë të përditësuar zbatimin e masave që janë marrë dhe që do të merren për realizimin e të ardhurave doganore sipas të gjithë zërave respektivë në përputhje të plotë me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për përmbushjen e misionit që i është ngarkuar sipas ligjit nr.8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar dhe ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse të stafit të doganor në përputhje me funksionet që ata kryejnë.</p> <p>Menjëherë dhe në vijimësi</p>
3	<p>Zbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje me diferencat e konstatuara gjatë pagesës së rentës minerare në sektorin Petrolifera Nga auditimi u konstatua se rezultoni diferencat e pagesës së rentës minerare që lidhen me vlerën e mallit “naftë bruto” deklaruar në kodin tarifor *27090090* në deklaratat e eksportit nga subjekti “Bankers Petroleum” dhe “Transantik Oil” krahasuar kjo me çmimin e publikuar të Bursës së Reuters (platts) për artikullin “Naftë Bruto” sipas kushtit të lëvrimit FOB në shumën prej 2,240,931,479 lekë. Gjithashtu nga Komisioni AD-HOC pranë Ministrisë së Financave nuk janë nxjerrë të dhëna referuese ose krahasuese për artikullin “Naftë Bruto” të deklaruar për eksport me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të lëvrimit FOB. Nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive pritëse ose importuese për praktikat doganore nën juridiksion auditimi për periudhën 01.01.2015 deri në periudhën 01.09.2017 për eksportet e kryer nga subjektet “Bankers Petroleum” dhe kompania “Transantik Oil”, si dhe nuk është kryer garantimi për pjesën e detyrimit doganor të munguar që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe pas kryerjes së verifikimeve doganore nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi trajtuar si problematikë edhe më parë me shkresën nr.835/1 Prot të Kontrollit të Lartë të Shtetit, datë 20.09.2016 me lëndë “Kthim</p>	<p>Pika nr.3 “Auditimi i procedurave doganore të sistemit të vlerësimit doganor dhe procedura të tjera doganore”.(<i>trajtuar në faqet nr 35-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>)</p>	E lartë	<p>Autoriteti Doganor Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të kërkojë vjeljen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore të pagesës së rentës minerare në vazhdimësi dhe të kërkojë garantimin e menjëhershëm të borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë “Bankers Petroleum”, dhe “Transantik Oil” dhe kompanive pritëse ose importuese të mallrave të natyrës “naftë bruto” të eksportuara nga këto kompani nga territori doganor shqiptar, për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, në shumën prej 2,240,931,479 lekë për deklarime doganore të evidentuara deri në përfundim të Hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport</p>

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT****Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”**

	<i>përgjigje kërkesës së Degës Doganore Vlorë”.</i>			Përfundimtar Auditimi. Menjëherë dhe në vijimësi
4	Zbatimin e legjislacionit doganor në përputhje me Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë. Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore për periudhën nën auditim rezultuan vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e nenit 107-112, 136-149, 256, 261, 275, 276 dhe 281/1 të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, dhe pikave 234-239, 272-325 dhe 463-472 të VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, në shumën totale 2,335 mijë lekë për raste vendimesh administrative të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2015 dhe 2016	Pika nr. 7 “ Auditimi i procedurave doganore të indjekura gjatë marrjes së vendimeve administrative ”. (trajtuar në faqet nr134-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)		Dega Doganore Vlorë të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendime administrative në shumën totale 2,335 mijë lekë për raste vendimesh administrative të vitit 2015 dhe 2016 duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore bazuar në ligjin nr.8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, sipas aneksit nr.63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit Menjëherë dhe në vijimësi
5	Mbi gjetjet që lidhen me veprimtarinë e subjekteve që operojnë sipas autorizimeve të regjimeve doganore ekonomike Nga auditimi i procedurave doganore gjatë mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike rezultuan veprime që kanë sjelle pasoja në mosrespektim të afateve dhe sasive autorizuese që lidhen me veprimtarinë e operatorëve ekonomike që janë autorizuar të operojnë në fushën e regjimeve doganore ekonomike të përpunimit aktiv dhe pasiv si dhe regjimeve doganore ekonomike të lejimit të përkohshëm, për periudhën e juridiksionit të auditimit në shumën totale 6,150 mijë lekë nga të cilat shuma prej 3,275 mijë lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RLP dhe shuma prej 2,833 mijë lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RLA	Pika nr.4 “ Auditimi i veprimtarisë e subjekteve që operojnë sipas autorizimeve të regjimeve doganore ekonomike periudhës nën auditim ” (trajtuar në faqet nr 88-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)	E Mesme	Dega Doganore Vlorë të ndjekë dhënien e destinacionit të mallrave të hyra sipas autorizimeve të tipit RLP dhe RPA të trajtuara në Raport Përfundimtarin e Auditimit me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore në shumën totale prej 6,150 mijë lekë nga të cilat shuma prej 3,275 mijë lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RLP dhe shuma prej 2,833 mijë lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA për shkelje doganore ndryshme të kryera nga operatorë tregtarë në kundërshtim dhe tejkalim të afateve administrative autorizuese, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve dhe sanksioneve doganore sipas anekseve nr.65-83 të Raport Përfundimtarit të Auditimit sipas përcaktimeve të ligjit nr.8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar, ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, të trajtuar specifikisht në faqet 10-11 të Raport Përfundimtarit të Auditimit. Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

6	<p>Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm: Nga auditimi u konstatua se nuk rezultojnë të zbatuara masa për shpërblim dëmi të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 222/19 Prot, datë 30.06.2014, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr.1534/3 Prot, datë 03.07.2014 në shumën 72,479,395 lekë. Gjithashtu nuk është zbatuar një masë administrative dhe një masë disiplinore si dhe nuk është njoftuar Kontrolli i Lartë i Shtetit brenda afatit 20 ditor sipas përcaktimeve të shkresës nr.222/19 Prot, datë 30.06.2014. Gjithashtu u konstatua se rezultojnë të pazbatuaramasa për shpërblim dëmi të rekomanduara më parë në shumën prej 3,312,447,182 lekë të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr.1101/17, datë 06.05.2015 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për auditimin e kryer për Taksën e Rentës Minerare dhe dërguar me shkresën nr. 11213/1 datë 11.05.2015 Degës Doganore Vlorë për 3 subjekte eksportues me aktivitet në fushën e hidrokarbureve që operojnë me eksportin e artikullit “naftë bruto</p>	<p>Pikant.1 “Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm” <i>(trajtuar në faqet nr 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</i></p>	<p>i E Lartë</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në cilësinë e organit epror dhe Dega Doganore Vlorë në cilësinë e organit administrativ juridiksional të analizojnë në bashkëpunim të plotë rekomandimet e pa realizuara, deleguar për kompetencë për vendimmarrje Degës Doganore Vlorë duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto dy institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për kontabilizimin e shumës prej 72,479 mijë lekë rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 222/19 Prot, datë 30.06.2014, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr.1534/3 Prot, datë 03.07.2014 dhe kontabilizimin e shumës prej 3,312,447 mijë lekë rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr.1101/17, datë 06.05.2015 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që lidhet me auditimin e pagesës së rentës minerare</p> <p>Menjëherë dhe në vijimësi</p>
7	<p>Mbi gjetjet dhe rekomandimet që lidhen me veprimtarinë e Degës Doganore Vlorë gjatë mbledhjes dhe arkëtimit të borxhit doganor Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganor gjendje deri më datë 01.10.2017, i krijuar gjatë viteve deri në periudhën 30.09.2017, u konstatua se nga autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë nuk janë arritur të zbatohen plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për rikuperimin e borxhit doganor, duke reflektuar një gjendje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 819,296 mijë lekë nga të cilat shuma prej 571,630 mijë lekë në proces gjyqësor falimentimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shuma prej 247,666 mijë e parikuperuar. Konstatohet një pakësim i dukshëm i borxhit doganor në periudhën gusht-tetor 2017 në vlerën 38,025 mijë lekë.</p>	<p>Pikant.5 “Auditimi i borxhit doganor, niveli i borxhit dhe analiza e tij dhe masat e marra për zbatimin e tij” <i>(trajtuar në faqet nr 117-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</i></p>		<p>Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë të marrë masa të plota ligjore e administrative, për rikuperimin ose shuarjen e borxhit doganor të krijuar gjatë viteve 2009 deri në periudhën 01.10.2017 në vlerën 819,296 mijë lekë, si dhe të hartojë një program konkret me persona përgjegjës me afate kohore konkrete rikuperimi duke bashkëpunuar intensivisht me të gjitha institucionet e ngarkuara sipas ligjit për rikuperimin e borxhit si mësipërm bazuar në ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës</p> <p>Menjëherë dhe në vijimësi</p>



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

8	<p>Zbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje me procedurat e verifikimit dhe vlerësimit doganor të transaksioneve të mallrave nga auditimi u konstatua se për subjekte tregëtarë për të cilët janë rekomanduar rivlerësime të detyrimeve doganore nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për deklarime doganore të konstatuara nën vlerën e të Dhënave të Disponueshme në RSH dhe jo në përmbushje të përcaktimeve të Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD, ”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, kryesisht për mallrat të natyrës “ tuba plastikë, materiale plastikë, letër tualeti, artikuj ushqimore, kafe, elektrosh, detergjente etj” të importuara nga Italia vend i Komunitetit Europian bazuar në Ligjin nr.8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” sipas nenit 1 deri 23 të këtij ligji, u vendosen në dispozicion pas fazës së dërgimit të Projekt Raportit të Auditimit, nga Dega Doganore Vlorë përgjigje të verifikimeve doganore të ardhura respektivisht gjatë viteve 2013, 2014, 2015, 2016 nga vende si Italia dhe të tjera vende që ka Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi dhe Asistence Doganore. Nga administrimi i këtij dokumentacioni konstatohet se nga këta subjekte nuk ka fshehje ose ulje të vlerës së mallrave të deklaruar pranë autoriteteve doganore homologe dhe se verifikimi doganor i proceduar nuk është kryer pranë selive dhe kontabiliteteve financiare të kompanive eksportuese ose lëvruese të shteteve homologe. Gjithashtu në vijim për praktikat doganore nën juridiksion auditimi nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese ose eksportuese për importe të operatorëve tregëtarë të trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, për të cilët rezultojnë verifikime doganore të mëparshme por që nuk lidhen në kohë dhe hapësirë me deklaratimet dhe numrat konkretë të praktikave dhe importeve të konstatuara në këtë material, si dhe nuk është kryer garantimi për pjesën e detyrimit doganor të munguar që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe pas kryerjes së verifikimeve doganor.</p>	<p>Pika nr.3 “<i>Auditimi i procedurave doganore të sistemit të vlerësimit doganor dhe procedura të tjera doganore</i>”.(trajtuar në faqet nr 35-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p>	<p>Dega Doganore Vlorë për subjektet për të cilët rezultojnë verifikime doganore të mëparshme në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Doganave të rikërkojë ndjekjen e arkëtimit të detyrimeve doganore dhe kryerjen e procedurave doganore verifikuese të rekomanduara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi për transaksione të kryera nga nga Italia si vend i Komunitetit Europian, bazuar nën nenin 1-23 të Ligjit nr.8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” dhe nga vende të tjera të Komunitetit Evropian me të cilët administrata doganore shqiptare ka Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi dhe Asistence Doganore, si dhe në vijim të rikërkojë garantimin e menjëhershëm të borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanive lëvruese ose eksportuese dhe kompanive importuese shqiptare për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, për deklarime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017 deri në përfundim të hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive eksportuese të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Menjëherë</p>
9	<p>Nxjerrja e të dhënave referuese nga Komisioni Ad-Hoc pranë Ministrisë së Financave për artikullin naftë bruto të</p>	<p>Pika nr.3 “<i>Auditimi i procedurave doganore të sistemit të vlerësimit doganor</i>”</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ti drejtohet menjëherë Kryetarit të Komisionit AD-</p>



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

<p>prodhimit vendas. Nga auditimi u konstatua se rezultonin diferenca te pagesës së rentës minerare që lidhen me vlerën e mallit “naftë bruto” të deklaruar në kodin tarifor *27090090* në deklaratat e eksportit nga subjekti “Bankers Petroleum” dhe “Transantlik Oil” krahasuar kjo me çmimin e publikuar të Bursës së Reuters (platts) për artikullin “Naftë Bruto” sipas kushtit të lëvrimit FOB, në shumën totale prej 2,240,931,479 lekë për periudhën nën auditim. Gjithashtu nga Komisioni AD-HOC pranë Ministrisë së Financave nuk janë nxjerrë të dhëna referuese ose krahasuese për artikullin “Naftë Bruto” të deklaruar për eksport me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të lëvrimit FOB në zbatim të pikës 3 të VKM nr.201, datë 21.03.2012, e ndryshuar përcaktohet se lista me vlerat referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale, hartohet dhe miratohet nga një komision AD-HOC i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Drejtorive të Përgjithshme të Doganave e Tatimeve, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), Fakultetit të Gjeologji-Minierave, dhe “brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ua përcjell zyrtarisht listën e miratuar autoriteteve doganore e tatimore, për t’u përdorur si burim i të dhënave të disponueshme. Ky komision mblidhet dhe përditëson listën sa herë është e nevojshme” Trajuar në faqet nr.28-74 të Raport Përfundimtarit të Auditimit:</p>	<p>dhe procedura te tjera doganore”.(trajuar në faqet nr 35-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</p>	<p>HOC pranë Ministrisë së Financave në cilësinë e përfaqësuesit të ngarkuar me ligj pranë këtij Komisioni, me qëllim përcaktimin e menjëhershëm të vlerave referuese, të artikullit naftë bruto nxjerrë sipas prodhimit vendas sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale, bazuar në zbatim të pikës 3 të VKM nr.201, datë 21.03.2012, e ndryshuar dhe “brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, t’ja përcjell zyrtarisht listën e miratuar autoriteteve doganore e tatimore, për t’u përdorur si burim i të dhënave të disponueshme dhe të kryejë përditësimet e listës sa herë të gjykohet se është e nevojshme” Menjëherë dhe në vijimësi</p>
---	---	---

IV.KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërisë financiare (ISSAI 4100¹). Nga auditimi i përputhshmërinë², për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet buxheti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Degën Doganore Vlorë, gjatë auditimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore të importit që lidhen me moszbatimin e kushtit preferencial sipas marrëveshjeve në fuqi që lidhen me tarifën doganore të reduktuar, mosaplikimin e saktë të

¹ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

²Mbeshtetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

³ISSAI 4000 - 4200 - Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

elementëve të vlerës së mallit dhe shpenzimeve të transportit për qëllime të vlerësimit doganor, klasifikime tarifore jo në përputhje me nomenklaturën e mallrave në RSH, diferenca në pagesën e rentës minerare dhe moskryerja e procedurave doganore të verifikimit të vlerës së rentës minerare të deklaruar për eksport jashtë territorit doganor në RSH, procedura jo të sakta gjatë veprimtarisë autorizuese të regjimeve doganore ekonomike të tipit të përpunimit aktiv dhe të regjimit të lejimit të përkohshëm, veprimtarisë së subjekteve që operojnë në fushën e akcizës, mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi gjatë procedurave administrative të vendimmarrjes nga ana e autoritetit doganor, mangësi në procedurat e ndjekura për vjeljen e borxhit doganor dhe raste praktikash doganore të përzgjedhura nga profile të ndryshme risku për dyshime të keqklasifikimeve tarifore për të cilat nuk janë marrë mostra, si dhe moskryerja e procedurave doganore verifikuese pranë autoriteteve doganore homologe italiane bazuar ligjin nr.8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkrimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” dhe nga vende të tjera të Komunitetit Evropian me të cilët administrata doganore shqiptare ka Marrëveshje Reciproke Bashkëpunimi dhe Asistence Doganore për praktikat e audituara nën juridiksion auditimi.

Si konkluzion, nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Dega Doganore Vlorë, rezultuan mospërputhje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë***³.

Në Opinionin tonë, Dega Doganore Vlorë përveç mangësive të identifikuara më sipër dhe të trajtuara në këtë P/Raport (të cilat janë materiale por jo të përhapura), ka një sistem të kontrollit të brendshëm efektiv për të garantuar përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e institucionit.

HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Degën Doganore Vlorë në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr.1148/1 prot, datë 15.11.2017, nga data 15.11.2017 deri në date 19.01.2017, për periudhën nga 01.01.2015 deri në 01.10.2017 me lloj auditimi “Auditim i Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare” i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1-Altin Dinaj
- 2-Livan Hoxha
- 3-Aqif Klosi
- 4-Agron Opari

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes së zërave të aktivitetit dhe pasiviteteve të tjera shoqëruese të bilancit, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Dega e Doganës Vlorë.

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Vlorë gjatë procesit të realizimit të objektivave



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me liritë dhe kufizimet në sistemin doganor, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike si dhe dhënien e rekomandimeve me qëllim dhënien e një sigurie objektive kësaj Dege Doganore gjatë veprimtarisë së saj nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë kryer në përputhje dhe rregullshmëri sipas legjislacionit në fuqi.

Objektivat e auditimit:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Dega Doganore Vlorë gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi janë

-Vlerësimi i realizimit të treguesve të të ardhurave, shpenzimeve, mënyrës dhe saktësisë në pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare dhe rakordimit me thesarin.

-Opinion në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator për periudhën objekt i auditimit, sipas kriterëve të vlerësimit

Identifikimi i çështjes :

Veprimtaria përpunuese e personelit doganor të Degës Doganore Vlorë është realizuar në mbështetje të Ligjit nr.8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.8474 datë 14.04.1999 “Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore”, i ndryshuar dhe VKM-se nr.205 datë”Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” dhe Ligjit nr.61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Veprimtaria e Degës Doganore Vlorë realizon kontrollin dhe përputhshmërinë e deklarimeve dhe procedurave të kryera nga operatorë ekonomikë sipas legjislacionit të fushës. Gjithashtu përgatitja dhe miratimi i pasqyrave financiare në Degën Doganore Vlorë , është realizuar në mbështetje të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituarasi edhe shoqërohen me relacion shpjegues (si lista e debitorëve, akt-rakordimet me sistemin e Thesarit, si edhe shpjegime të tjera sa i takon evidentimit të transaksioneve në llogaritë respektive)

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe Pasqyrat Financiare:

-Kryetari i Degës Doganore (Nëpunësi autorizues) është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale e rregulluar kjo me përshkrimin e dhënë në “Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore”, miratuar me shkresën nr.19095/2 prot, date 12.11.2012 në zbatim Ligjit nr.8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.8474 datë 14.04.1999 “Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore”, i ndryshuar dhe VKM-se nr.205 datë”Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” dhe Ligjit nr.61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në mbështetje të legjislacionit doganor,

-Specialist i Financës (Nëpunësi zbatues) është personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

-Personeli përpunues doganor i sektorit operacional (*nënpunës zbatues*), i kontrollit të mjeteve nëpikën e hyrjes (*nënpunës zbatues*), i regjimeve dhe akcizës (*nënpunës zbatues*) dhe specialisti i sektorit të kontrollit pas zhdoganimit /juristi/specialisti i borxhit (*nënpunës zbatues/kontrollues*) janë përgjegjës për veprimet e kryera gjatë veprimtarisë funksionale e rregulluar kjo me përshkrimin e dhënë në “*Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore*”, miratuar me shkresën nr.19095/2 prot, date 12.11.2012 në zbatim Ligjit nr.8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Ligji nr.8474 datë 14.04.1999 “Për Nomenklaturën dhe Tarifën Doganore”, indryshuar dhe VKM-se nr.205, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” dhe Ligjit nr.61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe urdhërave, udhëzimeve dhe shkresave të dala në mbështetje të legjislacionit doganor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar

-Të vlerësojë nëse informacioni mbi çështjen në të gjitha aspektet materiale është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi dhe në ç’masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100*), të krijohen bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne si auditues t’i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimeve të ndjekura nga subjekti i audituar, për faktin nëse pasqyrat financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojnë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500, ISA 300*).

-Të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raport Përfundimtar i Auditimit.

Kriteret e vlerësimit:

-Ligji nr.8449 datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

- Ligji nr.8474 datë 14.04.1999 “Për miratimin e Nomenklaturës dhe të Tarifës Doganore”, i ndryshuar;
 - Ligji nr.8485 datë 12.05.1999,Ligji nr.44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
 - Ligji nr.61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore në funksion të tyre.
 - Ligjin Nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
 - Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar nga Ministri i Financave (2010);
 - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.
- Marrëveshjet e Republikës së Shqipërisë me vendet e tjera të EU apo NEU lidhur me trajtimin preferencial të mallrave etj.

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

- Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISAI) të IFAC

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimitMbështetur në ISSAI 1315,

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit konkluduan në metodologjinë e aplikuar gjatë planifikimit në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi nënvlerësimin e kontrolleve të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

1.1.Kontrolli aritmetik që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

1. 2 Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përpunimin ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

- 1.3. Kontrolli i vlerësimit për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- 2-Verifikimi i transaksioneve duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese
- 3-Intervistimi i personelit që ka pasur role specifike në subjektin që u auditua.
- 4-Raporte dhe informacione nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit.
- 5-Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm lidhje me informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit
- 6-Pyetësorët sipas teknikës së grumbullimit të të dhënave në rastet kur veprime të caktuara kanë karakteristikat e ngjashme dhe janë të përsëritura në struktura të ndryshme të organizatës.
- 7-Modelimet statistikore në formën e serive kohore mbi shpenzimet e pagesave dhe treguesit përkatës

PERSHKRIMI I AUDITIMIT.

Dega Doganore Vlorë është një njësi funksionale që varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e cila është nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave në Republikën e Shqipërisë. Vlorë është e vendosur në portin detar Vlorë si dhe kryen veprimtari mbikëqyrëse doganore në zonën e lirë PIA (Petrolifera) si dhe në zonën doganore Himarë. Dega Doganore Vlorë ka në përbërjen e saj një administratë të vogël prej 37 të punësuar. Dega Doganore Vlorë e ushtron veprimtarinë e vet sipas sektorit operacional shesh port Vlorë, personelit përpunues të regjim/akcizë/preferencë/përjashtime, të cilët kryejnë përbushjen e operacioneve përpunuese, sektorit operacional të zonës së lirë PIA, sektorit operacional në zyrën doganore Himarë si nëpërmjet strukturave të tjera funksionale si specialist/jurist që mbulon veprimtarinë e ndjekjes së borxhit, veprimtarinë juridike dhe kryen njëkohësisht, specialisti i Kontrollit Pas Zhdoganimit. Administrata e Degës Doganore Vlorë funksionon sipas rregullores së Brendshme të Degëve Doganore me nr. 19052 prot, DPD date 11.02.2011. Dega Doganore gjatë veprimtarisë së aktivitetit të saj përbush vizionin e shërbimit doganor të afruar nga Administrata Doganore Shqiptare në gjithë territorin doganor shqiptar **me qëllim:** “sigurimin mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, që kanë të bëjnë me importet, eksportet dhe transitet e mallrave, pavarësisht nga mënyra e transportit, lidhur me dërgesat ndërkombëtare, me kalimin në pikat kufitare dhe me qarkullimin e lire të mallrave, të personave dhe të bagazheve të tyre kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në Kodin Doganor për mallrat në hyrje dhe në dalje të territorit doganor shqiptar, verifikimin dhe vjeljen e detyrimeve doganore që duhen paguar, parandalimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabande, shkeljeve dhe trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara, konstatimin dhe verifikimin e shkeljeve të dispozitave të këtij Kodi, të parashikuara në pjesën VIII, mbikëqyrjen në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore”.

Dega Doganore Vlorë kryen funksionet zbatuese, përpunuese dhe autorizuese të deleguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe legjislacioni doganor në fuqi si më poshtë:

Përpunon, ndjekë, mbikëqyrë dhe autorizon deri në çlirimin e mallrave dhe përfundimin e procedurave deklarimet e subjekteve operatorë ekonomike dhe personave fizikë gjatë procedurave deklaruese që kryhen me qëllim pagesa të detyrimeve doganore dhe procedura të tjera autorizuese që kryhen në veprimtarinë e saj të përditshme. Harton dhe nxjerr akte administrative me fuqi ligjore të cilat kanë pasoja juridike mbi operatorët ekonomikë dhe palë të tjera të përfshira të cilët konstatohen në shkelje të parashikuara në pjesën VIII të Kodit Doganor në RSH, për vepra dhe mallra që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore”.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Kontrolli i Lartë iShtetitme shkresënr. 1101/17,datë 06.05.2015 i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Raportin Përfundimtar të Auditimit për auditimin e kryer për Taksën e Rentës Minerare dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 11213/1 datë 11.05.2015 këtë material ia ka dërguar D.D.Vlorë me porosinë *“të meren masa për zbatimin e rekomandimeve ,të njoftohet me shkrim Kontrolli i Lartë i Shtetit”*.

Nga Dega Doganore Vlorë janë zbatuar pjesërisht rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresën nr. 1101/17,datë 06.05.2015, protokolluar ne Degën e Doganës, Vlorë me shkresën nr. 1459/1,datë 16.05.12.2015 sipas përcaktimeve ligjore të bëra në Ligjin nr. 154/2014,datë 27.11.2024 *“Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit “ neni 15 germa c “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”*

Nga auditimi rezultoi se zbatimi i masave për shpërblim dëmi paraqitet si më poshtë

Masa Për Shpërblim Dëmi

Rekomandimi i dhënë. Dega e Doganës Vlorë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore,duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit prej 3,312,447,182 lekë nga 3 subjekte eksportues :*“Bankers Petroleum Albania LTD”* meNIPT K43128401L për shumën 2,940,174,914 lekë, subjekti *“Stream Oil&Gas LTD”* meNIPT K72205016P për shumën 290,932,489 lekë, dhe subjekti *“Albpetrol SHA”* meNIPT J82916500U për shumën 80,339,779 lekë.

Zbatimi.Nga Dega Doganore Vlorë nuk është zbatuar rekomandimi i dhënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit por janë kryer veprime verifikuese pranë Autoriteteve Doganore Homologe.

Rekomandimi i dhënë: Dega e Doganës Vlorë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore,duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit prej 815,706 lekë nga 9 subjektet sipas anekseve nr. 6-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Zbatimi. Nga Dega e Doganës Vlorë ky rekomandim është zbatuar plotësisht. Dega Doganore Vlorë ka dalë me vendime administrative për kontabilizimin e borxhit doganor për shumën 815,706 lekë.

Për sa më sipër mbajtur dhe trajtuar nga ana e audituesit është mbajtur Akt-Konstatimi nr .6 datë 16.01.2018 dhe nga subjekti i audituar nuk ka komente dhe shpjegime:

Gjetje dhe Rekomandime për këtë pikë auditimi

Drejtimi nr.1 *“Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet emëparshme”*

Titulli i Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm
Gjetjes 1

Situata: Nga auditimi u konstatua se nuk rezultojnë të zbatuara masa për shpërblim dëmi të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 222/19 Prot,datë 30.06.2014, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr.1534/3 Prot, datë 03.07.2014 në shumën **72,479,395 lekë**. Gjithashtu nuk është zbatuar një masë administrative dhe një masë disiplinore si dhe nuk është njoftuar Kontrolli i Lartë i Shtetit brenda afatit 20 ditor sipas përcaktimeve të shkresës nr.222/19 Prot,datë 30.06.2014. Gjithashtu u konstatua se rezultojnë të pazbatuaramasa për shpërblim dëmi të rekomanduara më parë në shumën prej **3,312,447,182 lekë** të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr.1101/17,datë 06.05.2015 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për auditimin e kryer për Taksën e Rentës Minerare dhe dërguar me shkresën nr. 11213/1 datë 11.05.2015 Degës Doganore Vlorë për 3 subjekte eksportues me



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

aktivitet në fushën e hidrokarbureve që operojnë me eksportin e artikullit “*naftë bruto*”.

Kriteri : Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Ndikimi/Efekti Konstatohet moszbatim i rekomandimeve të lëna më parë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në shumën totale 3,384,926,577 lekë

Rëndësia E lartë

Rekomandimi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në cilësinë e organit epror dhe Dega Doganore Vlorë në cilësinë e organit administrativ juridiksional të analizojnë në bashkëpunim të plotë rekomandimet e pa realizuara, deleguar për kompetencë për vendimmarrje Degës Doganore Vlorë duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto dy institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për kontabilizimin e shumës prej **72,479 mijë lekë** rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 222/19 Prot, datë 30.06.2014, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr.1534/3 Prot, datë 03.07.2014 dhe kontabilizimin e shumës prej **3,312,447 mijë lekë** rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr.1101/17, datë 06.05.2015 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që lidhet me auditimin e pagesës së rentës minerare
Menjëherë dhe në vijimësi

Drejtimi i II “*Auditim mbi të Ardhurat Doganore*”.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit nr.1148/1, datë 15.11.2017, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Programimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i të ardhurave vjetore detajuar sipas muajve dërguar në Degën e Doganës Vlorë , për periudhën në auditim, vitet 2015, 2016 dhe periudha deri më 01.10.2017.

2. Evidencat me të dhënat e programimit dhe realizimit të të ardhurat doganoretë përgatitura dhe të administruara nga Drejtoria e Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si mësipër u konstatua se:

Nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë nuk janë zbatuar dispozitat ligjit nr.147/2015, datë 24.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, nenet 1, 2 dhe 8, mbështetur në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 30, Aktin Normativë nr.1, datë 29.07.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.147/2015, datë 24.12.2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, nenet 1 dhe 2, dispozitën e ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, neni 11 pikat 3-9, “Formalitetet, kontrollet, mbikëqyrja dhe kompetencat e autoriteteve doganore”, kërkesat e udhëzimit nr.25, datë 30.11.2007 i Ministrisë së Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, pika 2, si dhe planin e të ardhurave doganore dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për vitin 2016.

Për sa mësipër referuar dispozitave të ligjit nr.147/2015, datë 24.12.2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, mbështetur në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 30, ndryshuar me Aktin Normativë nr.1, datë 29.07.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.147/2015, datë 24.12.2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr.32, datë 02.04. 2015, të VKM-së nr.205, datë 13.04.1999, “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, kërkesat e udhëzimit nr.25, datë 30.11.2007 i Ministrisë së Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre” pika 2, përcaktohet se:

Neni 1, “Buxheti për vitin 2016”,

Neni 2, “Buxheti i Shtetit për vitin 2016”,

Neni 8, “Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore.

Neni 11, pikat 3-9, “Formalitetet, kontrollat, mbikëqyrja dhe kompetencat e autoriteteve doganore”,

3. Autoritetet doganore janë përgjegjëse për :

a) kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në këtë Kod për mallrat në hyrje dhe në dalje të territorit doganor shqiptar, sipas rregullave të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi;

b) verifikimin dhe vjeljen e detyrimeve doganore që duhen paguar;

c) parandalimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabande, shkeljeve dhe trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara;

d) konstatimin dhe verifikimin e shkeljeve të dispozitave të këtij Kodi, të parashikuara në pjesën VIII;

g) mbikëqyrjen në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore;

4. Për të siguruar respektimin e dispozitave të përcaktuara nga ky Kod dhe nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore, zbatimi i të cilave u është ngarkuar autoriteteve doganore, punonjësit e doganave ushtrojnë kontroll mbi të gjitha mallrat, mbi mjetet e transportit dhe udhëtarët që kalojnë vijën doganore në zonat doganore e përgjatë vijës kufitare tokësore e ujore, në ujërat e brendshme dhe në hapësirën ajrore, që janë nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore. Me qëllim që të rritet efikasiteti i kontrolleve, autoritetet doganore mund të lidhin edhe marrëveshje për shkëmbim informacioni me organizma publike ose private, shqiptare ose të huaja, të këtij sektori.

5. Në pikat e kalimit të kufirit tokësor, ujor e në aeroporte, si edhe në dalje nga doganat e brendshme, organizohet kontrolli i mallrave dhe i mjeteve të transportit që dalin nga zonat doganore, për të verifikuar nëse cilësia dhe sasia e mallrave të transportuara janë në përputhje me dokumentet doganore shoqëruese. Nëse nuk rezultojnë mospërputhje, punonjësit e doganës që kryejnë këtë shërbim vendosin mbi dokumentet doganore vulën që tregon se janë në rregull. Në rast të kundërt, ata përpilojnë proces-verbalin përkatës, të cilin ia kalojnë Kryetarit të zyrës doganore për të kryer formalitetet e mëtejshme.

6. Kur është e nevojshme, një shërbim i tillë kryhet nga autoritetet doganore edhe nëpërmjet kontrollit të mjeteve të transportit përgjatë rrugëve të lëvizjes së këtyre mjeteve. Në këtë rast, punonjësit e doganës që janë ngarkuar për të ndaluar mjetet e transportit, përdorin tabelën e ndalim-qarkullimit, me të cilën janë pajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe i tregojnë drejtuesit të mjetit kartën e tyre identifikuese. Në rast se nga kontrolli i bere rezultojnë parregullsi, punonjësit e doganës e shoqërojnë automjetin pranë zyrës doganore me të afërt, ku përpilojnë proces-verbalin përkatës, i cili i dorëzohet Kryetarit të zyrës doganore për të kryer formalitetet e mëtejshme.

7. Me qëllim që të sigurohet zbatimi i legjislacionit doganor dhe i akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, zbatimi i të cilave i është ngarkuar doganës, autoritetet doganore mund të kryejnë të gjitha



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

kontrollet e nevojshme pranë ambienteve të deklaruesit ose të çdo personi tjetër që është përfshirë, në mënyrë direkte ose të tërthortë, në çlirimin e mallrave, sipas akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

8. Në rastet kur autoritetet e tjera që veprojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë kanë dyshime ose vihen në dijeni për shkelje të normave të këtij Kodi, të akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të ligjeve të tjera, zbatimi i të cilave është detyrë e autoriteteve doganore, ato njoftojnë menjëherë zyrën doganore që mbulon territorin në fjalë. Kjo e fundit kryen të gjitha verifikimet e formalitetet e rastit, përfshirë këtu edhe njoftimin e organeve gjyqësore, sipas procedurave të parashikuara në Pjesën VIII të këtij Kodi.

9. Kur ka dyshime të bazuara për trafik droge, armesh ose për krime të tjera me karakter ekonomik e financiar, autoritetet kompetente të policisë mund të ndalojnë automjetet që u nënshtrohen formaliteteve doganore dhe që janë të vulosura me plumbç prej autoriteteve doganore. Në këto raste, mjetet e transportit shoqërohen në zyrën doganore më të afërt që është kompetente territorialisht, ku hiqet vula dhe autoritetet e mësipërme policore, në prani të autoriteteve doganore, kryejnë të gjithë kontrollet që ato i konsiderojnë të nevojshme. Këto autoritete, në bashkëpunim me autoritetet doganore, përgatisin një raport me shkrim, i cili, nëse është rasti, u dërgohet autoriteteve gjyqësore në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentet e paraqitura nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë, lidhur me programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore për vitet 2015, 2016 dhe 9-mujori i vitit 2017, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 11 “formalitetet, kontrollet, mbikëqyrja dhe kompetencat e autoriteteve doganore”, pikat 3-9, i ndryshuar me ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.32, datë 02.04. 2015, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, kërkesat e udhëzimit nr.25, datë 30.11.2007, i Ministrisë së Financave, pika 2”, u konstatua se :

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bazuar në kërkesën e paraqitur nga Dega e Doganës Vlorë dërgoi në doganë evidencat vjetore të programimit dhe realizimit të të ardhurave për çdo vit të periudhës në auditim së bashku me ndryshimet përkatëse, mbasi autoriteti doganor kompetentë gjatë kësaj periudhe nuk ka patur akses në sistemin Assxcuda Eörd për të përgatitur raporte lidhur me analizat mujore apo vjetore për realizimin e të ardhurave.

Të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lidhur me programin, realizimin dhe ndryshimet e bëra në të ardhurat doganore sipas muajve dhe viteve u konfirmuan me e-mail datë 13.12.2017 dërguar në Degën e Doganës Vlorë nga z. Dritan Cekani me detyrë Drejtor i Monitorimit, Planifikimit Strategjik dhe Analizës së të Ardhurave, pranë DPDoganave, e konkretisht :

Për vitin 2015:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr.2448 prot, datë 03.02.2015, ka dërguar programin e të ardhurave doganore për muajin shkurt 2015 në vlerë 800,000 mijë lekë, bashkëlidhur është programi për muajin janar 2015, në vlerë 816,000 mijë lekë në total 1,616,000 mijë lekë të programuara në zbatim të shkresës nr.1532 prot datë 30.01.2015 të Ministrisë së Financës, por ky programim më vonë është shtuar në vlerë 549,178 mijë lekë, duke arritur në vlerë 2,165,178 mijë lekë, me shkresën nr.5626 prot, datë 04.03.2015 ka dërguar programin e të ardhurave për muajin mars 2015, në vlerë 1,300,000 mijë lekë, i cili më vonë është ulur në vlerë 256,409 mijë lekë, duke mbetur në vlerë 1,043,591 mijë lekë, me shkresën nr.9011 prot, datë 14.04.2015 ka dërguar programin e të ardhurave për muajin prill 2015 në vlerë 950,000 mijë lekë, i cilimë pas është rritur në vlerë 122,043 mijë lekë duke arritur në vlerë 1,072,043 mijë lekë, me shkresën nr.10977 prot, datë 06.05.2015 ka dërguar programin e të ardhurave për muajin maji 2015 në vlerë 1,599,806 mijë lekë, i cili më pas është ulur në vlerë 335,860 mijë lekë duke arritur në vlerë 1,263,946 mijë lekë, me shkresën nr.13779 prot, datë 05.06.2015 ka dërguar programin e të ardhurave për muajin qershor 2015



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

në vlerë 1,310,000 mijë lekë, i cili më pas është rritur në vlerë 67,078 mijë lekë duke arritur në vlerë 1,377,078 mijë lekë, me shkresën nr.16584 prot, datë 06.07.2015 ka dërguar programin e të ardhurave për muajin korrik 2015 në vlerë 2,192,984 mijë lekë, i cili më pas është ulur në vlerë 325,958 mijë lekë duke arritur në vlerë 1,867,026 mijë lekë, me shkresën nr.19948 prot, datë 09.08.2015 ka dërguar programin e të ardhurave për muajin gusht 2015 në vlerë 1,522,203 mijë lekë, i cili më pas është ulur në vlerë 40,296 mijë lekë duke arritur në vlerë 1,562,499 mijë lekë, me shkresën nr.21573 prot, datë 04.09.2015 ka dërguar programin e të ardhurave shkresën nr.24651 prot, datë 08.10.2015 ka dërguar programin e të ardhurave për muajin tetor 2015 në vlerë 1,280,000 mijë lekë, i cilika mbetur i pa ndryshuar, me shkresën nr.27523 prot, datë 09.11.2015 ka dërguar programin e të ardhurave për muajin nëntor 2015 në vlerë 1,200,000 mijë lekë, i cilika mbetur i pa ndryshuar, me shkresën nr.30016 prot, datë 03.12.2015 ka dërguar programin e të ardhurave për muajin dhjetor 2015 në vlerë 1,200,000 mijë lekë, i cilika mbetur i pa ndryshuar. Nga një analizë e shkurtër e të ardhuravedoganore të programuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe të dërguara nëpërmjet shkresave përcjellëse në Degën e Doganës Vlorë arrijnë në vlerë **14,521,943 mijë lekë**, ndërsa të ardhurat doganore mbas ndryshimeve të bëra arrijnë në vlerë **15,331,360 mijë lekë**, me një shtesë vjetore në vlerë **809,417 mijë lekë**, shtesë e cila ka sjellë rritjen e të ardhurave të programuara në masën **5,5 %**.

Në këto kushte rezulton sepër vitin 2015 janë programuar për tu realizuar **15,331,360 mijë lekë** të ardhura doganore, e konkretisht;

Pasqyra nr.1. Të ardhurat doganore të programuara dhe të realizuara sipas muajve, në strukturë; Në000/ lekë

Nr	Muajt	TE ARDHURA NGA:								TOTALI		
		TAKSA DOG		AKCIZE		TVSH		RMN		P	F	%
		P	F	P	F	P	F	P	F			
1	Janar	6439	6547	473714	344156	404506	302438	182916	159560	1067574	812721	76
2	Shkurt	6156	7193	522400	289054	397103	297419	171944	151854	1097604	745520	68
3	Mars	10937	8721	429975	279144	396079	318458	206600	178414	1043591	784739	75
4	Prill	6433	7877	439995	388386	364653	388929	260962	208685	1072043	993877	93
5	Maj	7819	7265	425091	266911	452262	318331	378775	375458	1263946	967966	77
6	Qershor	8730	9115	458935	447457	499904	495253	409509	395567	1377078	1347391	98
7	Korrik	10017	9872	739907	433813	761228	432646	355874	375225	1867026	1251556	67
8	Gusht	5434	7010	617458	448213	602692	421510	336915	246095	1562499	1222829	72
9	Shtator	6200	7882	509287	297521	477695	366734	306817	327810	1300000	999947	77
10	Tetor	7624	10311	546972	273584	391619	313068	333786	253655	1280000	850618	66
11	Nentor	8469	10121	550179	306157	333424	303651	307918	208916	1200000	828845	69
12	Dhjetor	10065	17428	400000	351467	492536	369050	297439	254748	1200000	992693	83
	TOTAL	94,323	109,341	6,113,913	4,125,863	5,573,760	4,327,488	3,549,364	3,135,988	15,331,360	11,698,680	76

Nga auditimi i të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të paraqitura sa më sipër nga Specialistja e Financës u konstatua se; gjatë vitit 2015 të ardhurat doganore nga **15,331,360 mijë lekë** të programuara janë realizuar në vlerë **11,698,680 mijë lekë**, ose në masën **76 %**.

Të ardhurat doganore të programuara nuk janë realizuar në asnjë muaj gjatë vitit 2015, duke krijuar një diferencë në vlerë **3,632,680 mijë lekë**, por për shkaqet e kësaj difference autoriteti doganor kompetent, D.D.Vlorë nuk paraqiti asnjë raport-analizë të përgatitur me shkrim për periudhën e audituar, veprim i cili tregon se ai nuk ka kryer analiza të thella e të domosdoshme për të zbuluar shkaqet e vërteta që kanë influencuar në mos realizimin e të ardhurave doganore si një prej misionëve më të rëndësishme që i ka ngarkuar ligja këtij autoritetit. Nga auditimi dhe analiza e realizimit të të ardhurave doganore në strukturë



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

rezulton se; të ardhurat nga Taksa doganore nga 94,123 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 109,341 mijë lekë, ose në masën 116 %, të ardhurat nga Akciza nga 6,113,913 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 4,125,863 mijë, ose në masën 67 %, të ardhurat nga TVSH-ja nga 5,573,760 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 4,327,488 mijë lekë, ose në masën 78 % dhe të ardhurat nga Renta minerare nga 3,549,364 mijë lekë të programuar janë realizuar në vlerë 3,135,988 mijë lekë, ose në masën 88 %.

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të paraqitura në pasqyrën nr.1, sipas zërave në strukturë konstatohet lehtësisht se me përjashtim të zërit të ardhura nga Taksa doganore nuk është realizuar asnjë zë tjetër në zbatim të programit të të ardhurave të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Për vitin 2016;

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr.2655 prot datë 01.02.2016 ka dërguar programin e të ardhurave doganore për muajin janar 2016, me shkresën nr.4316 prot datë 16.02.2016, ka dërguar programin për muajin shkurt 2016, me shkresën nr.9408 prot, datë 11.04.2016, ka dërguar programin për muajët mars-prill 2016, me shkresën nr.11661 prot, datë 06.05.2016, ka dërguar programin e muajit maji 2016, me shkresën nr.14547 prot, datë 07.06.2016, ka dërguar programin e muajit qershor 2016, me shkresën nr.17141 prot, datë 08.07.2016, ka dërguar programin e muajit korrik 2016, me shkresën nr.19124 prot, datë 02.08.2016, ka dërguar programin e muajit gusht 2016, me shkresën nr.22177 prot, datë 21.09.2016, ka dërguar programin e muajit shtator 2016, me shkresën nr.23832 prot, datë 12.10.2016, ka dërguar programin e muajit tetor 2016, me shkresën nr.26288 prot, datë 09.11.2016, ka dërguar programin e muajit nëntor 2016 dhe me shkresën nr.28606 prot, datë 07.12.2016, ka dërguar programin e muajit dhjetor 2016, në përfundim programi vjetor rezulton **në vlerë 10,134,000 mijë lekë**, e konkretisht;

Pasqyra nr.2: Të ardhurat doganore të programuara dhe të realizuara sipas muajve, në strukturë

(në 000/lekë)

Nr	Muajit	TE ARDHURA NGA:								TOTALI		
		TAKSA DOG		AKCIZE		TVSH		RMN		P	F	%
		P	F	P	F	P	F	P	F			
1	Janar	33607	7714	191345	243571	541720	226642	23328	113269	790000	591396	75
2	Shkurt	7000	11914	230360	202364	162690	217055	199950	135367	600000	566699	94
3	Mars	17000	9285	240000	157967	228300	230161	274700	172298	760000	569710	75
4	Prill	13000	8895	258000	123684	316000	196684	283000	161826	870000	491090	56
5	Maj	17500	8952	238000	104933	351500	193105	343000	96072	950000	403062	42
6	Qershor	24000	9749	340000	152332	520000	233958	316000	238121	1200000	634160	53
7	Korrik	15000	14959	280000	141183	537000	239786	268000	203760	1100000	599688	55
8	Gusht	20000	9092	254000	176932	385000	227730	296000	187372	955000	601126	63
9	Shtator	14000	9328	269000	130682	378000	237351	299000	193607	960000	570970	59
10	Tetor	10000	14130	148000	111373	229000	259390	243000	105287	630000	490180	78
11	Nëntor	14500	9773	130000	169015	182500	243573	211000	157844	538000	580206	108
12	Dhjetor	12000	15464	272000	172267	321000	314902	176000	144046	781000	646679	83
	TOTALI	197,607	129,255	2,850,705	1,886,303	4,152,710	2,820,537	2,932,978	1,908,868	10,134,000	6,744,963	67

Ngauditimi i të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të paraqitura sa më sipër nga Specialistja e Financës u konstatua se; gjatë vitit 2016 të ardhurat doganore **nga 10,134,000 mijë lekë** të programuara janë realizuar **në vlerë 6,744,963 mijë lekë**, ose në masën **67 %**.

Të ardhurat doganore të programuara janë realizuar vetëm në muajin nëntor, ndërsa në gjatë gjithë muajve të tjerë të vitit 2016 ato nuk janë realizuar, duke krijuar një diferencë **në vlerë**



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

3,389,037 mijë lekë, por për shkaqet e kësaj difference autoriteti doganor kompetent, D.D.Vlorë nuk paraqiti asnjë raport-analizë të përgatitur me shkrim për periudhën e audituar, veprim i cili tregon se ai nuk ka kryer analiza të thella e të domosdoshme për zbulimin e shkaqeve të vërteta që kanë influencuar në mos realizimin e të ardhurave doganore.

Nga auditimi dhe analiza e realizimit të të ardhurave doganore në strukturë rezulton se; të ardhurat nga Taksa doganore nga 197,607 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 129,255 mijë lekë, ose në masën 65 %, të ardhurat nga Akciza nga 2,850,705 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 1,956,300 mijë lekë, ose në masën 68 %, të ardhurat nga TVSH-ja nga 4,152,710 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 2,820,537 mijë lekë, ose në masën 68 % dhe të ardhurat nga Renta minerare nga 2,932,978 mijë lekë të programuar janë realizuar në vlerë 1,908,868 mijë lekë, ose në masën 65 %.

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të paraqitura në pasqyrën nr.2, sipas zërave në strukturë konstatohet lehtësisht se të ardhurat doganore nuk janë realizuar në asnjë zë krahasuar me programimin e të ardhurave të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Dega e Doganës Vlorë nuk e ka analizuar realizimin e të ardhurave doganore muaj pas muaji, ai nuk ka përcaktuar dhe analizuar shkaqet e mos realizimit të të ardhurave, për të nxjerr më pas përgjegjësit individuale të secilit anëtar të stafit në përputhje me funksionet që ata kryejnë, ku realizimi mujor ka arritur në nivel 42 %, (muaj maji i vitit 2016.)

Për 9-mujorin e I të vitit 2017.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr.3053 prot, datë 06.02.2017, protokolluar në doganë me nr.706 prot, datë 20.02.2017 ka dërguar planin e të ardhurave doganore për muajt janar-qershor 2017, në vlerë 2,876,644 mijë lekë, i detajuar në muaj, por jo në strukturë.

Nga krahasimi i të ardhurave doganore të programuara dhe të dërguara në doganë nëpërmjet shkresave përcjellëse në vlerë 2,876,644 mijë lekë, me ndryshimet e bëra më pas kemi një ulje të të ardhurave doganore në vlerë 12,375 mijë lekë.

Me shkresën nr. 16202 prot, datë 10.07.2017, është dërguar plani i të ardhurave doganore për muajin korrik 2017 në vlerë 310,718 mijë lekë, ndërsa me shkresën nr.17931 prot, datë 02.08.2017 është dërguar plani i të ardhurave doganore për muajin gusht dhe shtator 2017 në vlerë 370,000 dhe 286,325 mijë lekë, të cilët janë të detajuara në strukturë. Programimi i të ardhurave doganore në muajin korrik është ulur në vlerë për 29,427 mijë lekë, ndërsa plani i muajit gusht është rritur në vlerë për **31,779 mijë lekë**. Në total të ardhurat doganore të programuara për 9-mujorin e vitit 2017, arrijnë në vlerë **3,803,061 mijë lekë**, e konkretisht,

Pasqyra nr.3: Të ardhurat doganore të programuara dhe të realizuara sipas muajve dhe në strukturë;

(në 000/ lekë)

Nr	Muajit	TE ARDHURA NGA:								TOTALI		
		TAKSA DOG		AKCIZE		TVSH		RMN		P	F	%
		P	F	P	F	P	F	P	F			
1	Janar	13416	9580	150008	145811	259578	203964	91163	183788	514165	543144	106
2	Shkurt	12001	6439	114042	100842	259872	200507	97735	99278	483650	407066	84
3	Mars	10115	8157	98395	116578	220540	219356	79978	58272	409028	402363	98
4	Prill	10938	8837	124920	117046	231418	237110	108000	186253	475282	549245	116
5	Maj	12776	9246	123047	39438	256208	160130	128284	88860	520315	297675	57
6	Qershor	9485	10324	124558	26994	229060	171774	98726	96848	461829	305940	66
7	Korrik	9189	10560	55132	26147	126441	173184	90529	106717	281291	316608	113
8	Gusht	8288	5298	97724	30448	193219	150605	71945	103996	371176	290347	78
9	Shtator	6986	9229	71964	26001	152358	153506	55016	109110	286325	297846	104
	TOTAL I	93,194	77,670	959,790	629,305	1,928,694	1,673,136	821,376	1,026,122	3,803,061	3,406,233	90

Nga auditimi i të dhënave të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të paraqitura sa më sipër nga Specialistja e Financës u konstatua se;



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Gjatë 9 mujorit të vitit 2017 të ardhurat doganore nga 3,803,061 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 3,406,233 mijë lekë, ose në masën 90 %.

Të ardhurat doganore të programuara janë realizuar në muajt janar, prill, korrik dhe shtator respektivisht 106, 116, 113 dhe 104 %, ndërsa në pesë muajt e tjerë të kësaj periudhe ato nuk janë realizuar duke krijuar një diferencë **në vlerë 396,828 mijë lekë**, veprim i cili tregon se autoriteti doganor kompetent edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer analiza të plota për të zbuluar shkaqet që kanë influencuar në mos realizimin e të ardhurave, kjo vërtetohet me mos paraqitjen e ndonjëraport-analizë të përgatitur për këtë qëllim.

Nga auditimi dhe analiza e realizimit të të ardhurave doganore në strukturë rezulton se; të ardhurat nga Taksa doganore nga 93,194 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 77,670 mijë lekë, ose në masën 83 %, të ardhurat nga Akciza nga 959,790 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 629,305 mijë, ose në masën 66 %, të ardhurat nga TVSH-ja nga 1,928,694 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 1,673,136 mijë lekë, ose në masën 87 % dhe të ardhurat nga Renta minerare nga 821,376 mijë lekë të programuar janë realizuar në vlerë 1,026,122 mijë lekë, ose në masën 125 %.

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të paraqitura në pasqyrën nr.3, sipas zërave në strukturë konstatohet lehtësisht se të ardhurat doganore janë realizuar vetëm në zërin Renta minerare, menjë tejkallim në vlerë 204,746 mijë lekë krahasuar me programin e të ardhurave të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por edhe në këtë rast nuk kemi një raport anaizë për shkaqet që kanë ndikuar në rritjen e nivelit të të ardhurave.

Në përfundim të auditimit të të ardhurave doganore për gjithë periudhën e audituar vitet 2015-2016 dhe 9-mujori 2017 rezulton se.

Pasqyra nr.4, të ardhurat doganore të programuara dhe të realizuara sipas muajve dhe në strukturë, për gjithë periudhën e audituar.

në 000/lekë

Nr	Vitet	TE ARDHURA NGA:								TOTALI		
		TAKSA DOG		AKCIZE		TVSH		RMN		P	F	%
		P	F	P	F	P	F	P	F			
1	2015	94,323	109,341	6,113,913	4,125,863	5,573,760	4,327,488	3,549,364	3,135,988	15,331,360	11,698,680	76
2	2016	197,607	129,255	2,850,705	1,956,300	4,152,710	2,820,537	2,932,978	1,908,868	10,134,000	6,814,960	67
3	9-2017	93,194	77,670	959,790	629,305	1,928,694	1,673,136	821,376	1,026,122	3,803,054	3,406,233	90
	TOTAL	385,124	316,266	9,924,408	6,711,468	11,655,164	8,821,161	7,303,718	6,070,978	29,268,414	21,919,873	76

Nga auditimi dhe analiza e realizimit e të ardhurave doganore për të gjithë periudhën e audituar bazuar në të dhënat e paraqitura në pasqyrën nr.4 konstatohet se; të ardhurat doganore në total nga **29,268,414 mijë lekë** të programuara janë realizuar **në vlerë 21,919,873 mijë lekë**, ose **në masën 76 %**, duke krijuar një diferencë **në vlerë 7,349,041 mijë lekë**, ndërsa në strukturë ato paraqiten si më poshtë; të ardhurat nga taksa doganore nga 385,124 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 316,266 mijë lekë, ose në masën 82 %, të ardhurat nga Akciza nga 9,924,408 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 6,711,468 mijë lekë, ose në masën 68,6 %, të ardhurat nga TVSH-ja nga 11,655,164 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 8,821,161 mijë lekë, ose në masën 75,7 % dhe të ardhurat nga taksa e Rentës minerare nga 7,303,718 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 6,070,978 mijë lekë, ose në masën 83 %.

Në përfundim

Të dhënat e paraqitura simësipër tregojnë se gjatë periudhës së audituar vitet 2015, 2016 dhe 9-mujori i vitit 2017, autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë nuk i ka realizuar të ardhurat doganore në total dhe në strukturë në zbatim të programeve të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar **një diferencë në të ardhurat doganore**



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

vlerë 7,349,041 mijë lekë, por mosrealizimi mëi madh është krijuar gjatë viteve 2015-2016 në vlerë 7,021,717 mijë lekë, osenë masën 95,5 %, veprim i cili tregon për punën e pamjaftueshme që ka kryer autoritet doganor kompetent, lidhur me përmbushjen e njërit prej misionëve më të rëndësishme që i ka ngarkuar atij “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Për sa më sipër mbajtur dhe trajtuar nga ana e audituesit është mbajtur Akt-Konstatimi nr . 14 datë 19.01.2018 dhe nga subjekti i audituar nuk ka komente dhe shpjegime :

Gjetje dhe Rekomandime

Drejtimi nr.2 “Auditimi i realizimit të të ardhurave doganore”

Titulli i Gjetjes 1 Mosrealizim i të ardhurave doganore dhe masa të rekomanduara për përmirësimin e të ardhurave doganore

Situata

Situata: Nga auditimi i ushtruar mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore gjatë periudhës së audituar të viteve 2015, 2016 dhe 9-mujori i parë i vitit 2017, u konstatua se nga Dega e Doganës Vlorë nuk janë realizuar të ardhurat doganore në krahasim me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar një diferencë të përgjithshme në vlerën 7,349,041 mijë lekë të rezultuar gjatë viteve 2015-2016 e cila përbën rreth 95,5% të diferencës totale të mosrealizuar, nga personeli përpunues doganor gjatë periudhës 2015 dhe 2016 në lidhje me përmbushjen e misionit që i janë ngarkuar sipas ligjit nr.8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH”,

Kriteri : Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Ndikimi/Efekti Konstatohet mosrealizim i të ardhurave doganore në shumën 7,349,041 lekë në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit midis planit të programuar dhe realizimit faktik

Rëndësia E lartë

Rekomandimi Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë të marrë masa të plota ligjore e administrative me plane konkrete për të analizuar në mënyrë të përditësuar zbatimin e masave që janë marrë dhe që do të merren për realizimin e të ardhurave doganore sipas të gjithë zërave respektive në përputhje të plotë me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për përmbushjen e misionit që i është ngarkuar sipas ligjit nr.8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar dhe ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse të stafit të doganor në përputhje me funksionet që ata kryejnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Drejtimi nr. 3 i Auditimit “Auditimi i sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave gjatë procedurave të zhdoganimit për periudhën nën auditim”



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me Drejtimin e 3 të auditimit “*Auditimi i sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave gjatë procedurave të zhdoganimit për periudhën nën auditim*”, në lidhje me procedurat e kryera nga personeli përpunues doganor gjatë procesit të vlerësimit të sistemit të vlerësimit doganor, klasifikimit tarifor të mallrave dhe kushteve të përfitimit të trajtimit tarifor preferencial favorizues të kryera nga Autoriteti Doganor Vlorë për periudhën 01 Janar 2015 deri më 01.10 2017 u audituan me përzgjedhje procedurat dhe dokumentacioni ligjor respektiv :

1. Dokumentacioni tregtar me përzgjedhje i praktikave doganore të importit për periudhën nën auditim të administruara nga Dega Doganore

2. Të dhënat elektronike të zhdoganimeve të kryera të siguruara nga sistemi elektronik.

Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me procedurat e kryera nga personeli përpunues doganor gjatë procesit të vlerësimit të sistemit të vlerësimit doganor, klasifikimit tarifor të mallrave të kryera nga Autoriteti Doganor Vlorë për periudhën 01 Janar 2015 deri më 01 Tetor 2017.

3. Dosjet e subjekteve të cilët operojnë me transaksion pranë kësaj Dege Doganore dhe për të cilët janë kryer ose kërkuar veprime verifikuese pranë Autoriteteve Doganore Homologe respektive nga Departamenti Operativ-Hetimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

4. Çmimet referuese të publikuara në “*Dosjen me të Dhënat e Disponueshme në Republikën e Shqipërisë*” sipas azhurnimit aktual në fuqi.

5. Tarifat e publikuara në transportin rrugor dhe detar, të cilat marrin pjesë në vlerën statistikore të mallrave, mbi të cilën llogariten detyrimet e importit bazuar në shpjegimet e nenit 37 të Kodit Doganor.

6. Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr.24, datë 11.9.2015 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.25, datë 30.11.2007 “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre*”.

7. Çmimet referuese të publikuara në “*Dosjen me të Dhënat e Disponueshme në Republikën e Shqipërisë*” sipas azhurnimit të të dhënave të siguruara nga buletini “*Quattroruote*” të muajve Janar dhe Korrik 2017.

Konkretisht

Nga auditimi u konstatua se në lidhje me vlerësimin e mallrave sipas “**Indikatorëve shtesë të nxjerrë për këtë qëllim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave**”.

♦. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës veshje të deklaruara në kapitullin 61 dhe 62 të Nomenklaturës së Mallrave në RSH konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shkresa nr.779 prot DPD datë 16.01.2013 “*Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE*”, përcaktohet se niveli i vlerësimit doganor për mallrat e klasifikuara në kreun *61* dhe *62* nuk duhet të jetë më i ulët se 1350 lekë/kg. Për mallrat të deklaruar në kreun *61* dhe *62* nuk është ndërhyrë nga personeli përpunues doganor për të vjelë detyrimet doganore bazuar në vlerën e mallit prej 1350 lek/kg sipas kushtit CIF si dhe nuk është marrë në konsideratë fakti i indikatorëve shtesë gjatëdeklarimit të këtyre mallrave në dogane përfshirë kontrollin e detajuar fizik me qëllim që të shmangen anomalitë e mundshme në vlerësimin doganor të mallrave dhe sidomos të vlerës se mallrave me peshën e tyre. Gjithashtu dokumentacioni tregëtar bashkangjitur praktikave doganore të mëposhtme nuk përmbush edhe kushtet për trajtim vlerësimi sipas metodës së transaksionit sipas nenit 34 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, dhe nenit 65 deri 70 të ligjit nr.102/2014 datë 31.7.2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Shkresa nr. 779 prot DPD, datë 16.01.2013 “*Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE*”

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
2. Ligjinr.102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”.
3. VKM nr.205, datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar
4. Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*”,
- 5.Shkresa nr. 779 prot DPD, datë 16.01.2013 “*Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE*”

Vlera prej 529,122 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.1 bashkangjitur këtij Raport PërfundimtarAuditimi

◆.Nga auditimi u konstatua se në lidhje me *vlerësimin e shpenzimeve të transportit sipas shpjegimeve të nenit 37 të Kodit Doganor* dalë sipas Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar u konstatua se:Në lidhje me vlerësimin doganor shpenzimeve të transportit të mallrave të natyrës “*Ushqim Peshku*” deklaruar në kodin doganor *2309* me vend lëvrimi Gjermaninë pranë kompanisë “*Emsland Alleraquagmbh15938 Gollben Gjermani*”.Konstatohet nga auditimi i praktikave doganore të mëposhtme se dokumentacioni tregtar bashkangjitur praktikave doganore nuk përmbush kushtet dhe përcaktimet ligjore tëSesionit 1 “*Mbi Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore*” pika 2 dhe nën pikat 2.21 deri në 2.25 tëUdhëzimit nr.25 datë 30.11.2007 “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*”. *Konstatohet se nuk ka një kontratë lëvrimi malli të përcaktuar midis lëvruesit të mallit shoqërive importuese dhe shoqërive transportuese të mallit të cilat janë shoqëri transportuese të huaja dhe jo tëregjistruara me aktivitet në Territorin Doganor Shqiptar. Referuar INCOTERMAVE 2000 “Rregullat Ndërkombëtare të Tregtisë së Jashtme” konstatohet se “Nocioni “transportues”në këtë rast nënkupton çfarëdopersoni i cili është obliguar me kontratë të transportit hekur rrugor, ajror, detar ose lumenjsh ose në kombinim të llojeve të përmendura të transportit”.Dega Doganore Vlorë duhej të kishte marrë në konsideratë shpjegimet dhe përcaktimet ligjore të nenit 36 dhe 37 të Ligjitnr.8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar specifikisht 37 pika 1 ku trajtohet se ”*Për përcaktimin e vlerës doganore në bazë të nenit 34, çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat e importuara*” i duhen shtuar pika 1) i “*shpenzimet e transportit e të sigurimit për mallrat e importuara*” dhe ii) “*shpenzimet e ngarkimit e të trajtimit që lidhen me transportin e mallrave të importuara, deri në vendin e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë*”. Pika 2 e nenit 37 të Kodit Doganor përcakton se “*Shtesat në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar, sipas këtij neni, bëhen vetëm në bazë të të dhënave objektive e të llogaritshme*”. Në zbatim të nenit 102, “*Shqyrtimi i deklaratës pas çlirimit të mallrave*”, nenit 36 pika 1, ”*Metoda e zgjedhjes më të mirë dhe kufizimet*” të KD të rillogariten detyrime doganore të munguara duke marrë si bazë vlerësimi doganor te të Dhënat e Disponueshme për Tarifat e Transportit Rrugor me vend referimi vendet eksportuese të shprehura për shënimet cilësuar në dosjen e të dhënave referuese sipas Rregullit 3 të Shënimit të shprehur të Tarifat e Transportit Rrugor sipas “*Kur kapaciteti mbajtës i automjetit është i barabartë ose më i madh se 20Ton, tarifa të llogaritet proporcionalisht me kapacitetin e mjetit*”. të detajuar sa më poshtë ne tabelën e*



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

mëposhtme. Tabela e rasteve të detajuara për vitin 2015 dhe 2016 trajtuar nga ana e grupit të auditimit të cilat do të rekomandohen për arkëtim detyrimi doganor në Buxhetin e Shtetit

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
 2. Ligjinr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.
 3. VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar
 4. Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,
- Vlera prej 2,703,302 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit***

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.2 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave ndryshme që janë përpunuar pranë Degës Doganore Vlorë për vitin 2015, 2016 dhe 2017 (periudha nën juridiksion auditimi) konstatohet se dokumentacioni tregtar bashkangjitur praktikave doganore të mëposhtme nuk përmbush kushtet dhe përcaktimet ligjore të Sesionit 1 “Mbi Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore” pika 2 dhe nën pikat 2.21 deri në 2.25 të Udhëzimit nr.25 datë 30.11.2007 “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”. Vlera e mallrave të deklaruara nga ky subjekt është nën kufijtë minimalë të çmimit të publikuar të Dosjes së të Dhënave referuese. Konstatohet se nuk ka një kontratë lëvrimi malli të përcaktuar midis lëvruarit të mallit shoqërive importuese dhe shoqërive por dokumentimi i shpenzimeve të transportit është kryer nga shoqëri shqiptare me seli në Territorin Doganor Shqiptar dhe me Fatura Tatimore Shitje të njohura nga legjislacioni tatimor në fuqi në RSH. Dega Doganore Vlorë duhej të kishte marrë në konsideratë shpjegimet dhe përcaktimet ligjore të nenit 67 pika 2 e ligjit nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” ose nenit 36 të Kodit Doganor të shfuqizuar, nenit 37 pika 2 e nenit 37 të Kodit Doganor përcakton se “***Shtesat në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar, sipas këtij neni, bëhen vetëm në bazë të të dhënave objektive e të llogaritshme***”. Në vijim të problematikës së mësipërme konstatohet se këto **transporte malli janë kryer kryesisht me destinacion Italinë, Greqinë, Maqedoninë dhe Kosovën** dhe janë kryer nga kompani shqiptare me seli të regjistruara në territorin doganor shqiptar dhe si dokument transporti kanë shërbyer fatura tatimore shqiptare për transport ndërkombëtar të lëshuar nga këto kompani. Nga personeli përpunues doganor është administruar vetëm dokumentacioni tregëtar që lidhet me ***itinerarin mbërritës*** dhe nuk është kërkuar dokumentacion shtesë për të justifikuar edhe pjesën e ***itinerarit nisës***. Do të lihet rekomandim që në vijim nga **Dega Doganore Vlorë** për praktikën që do të vijojë në të ardhmen gjatë procesit të vlerësimit doganor të shpenzimeve të transportit të mallrave që importohen për rastet kur vlera e këtyre shpenzimeve është **nën kufijtë e lejuar** sipas të Dosjes së të Dhënave të Disponueshme si dhe në praktikën doganore rezultojnë të dokumentuara vetëm shpenzimet e transportit të mbërritjes nga vendet lëvruar, nga personeli përpunues doganor të kërkohej **dokumentacion shtesë** për shpenzimet e transportit të kryera në nisje nga shoqëritë transportuese si dhe të kryhen dhe të kërkohej verifikime periodike pranë Drejtorive Rajonale Tatimore Respektive në lidhje me vlerat dhe vërtetësitë e dokumenteve të transportit të shprehura si shërbime të kryera nga shoqëritë e transportit sipas faturave tatimore respektive të administruara pranë këtyre deklarimeve. Praktikën e evidentuar në ProjektRaportin e Auditimit dhe të cituara edhe në këtë Raport Përfundimtar Auditimi sipas tabelave të rasteve të detajuara nga ana e grupit të auditimit për vitin 2015, 2016 dhe 2017 do të rekomandohen për verifikim të mëtejshëm në bazë të nenit 102 të Kodit



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Dogonor sipas ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neni 47,48 dhe 49 të ligjit nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Neni 49 i Kodit Doganor në RSH sipas ligjit nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” përcakton se :

Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën e rieksporit ose në njoftimin rieksporit, si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqërues” si dhe paragrafi nr.2

Ato mund të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat në fjalë ose për veprimet tregtare paraprake ose veprimet në vijim që përfshijnë këto mallra.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar
3. Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,
4. Ligji nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.3 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës “**skela të papërfunduara**” të deklaruara në kapitullin *7308* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH. Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, pasi nuk konstatohet që malli të jëtë “**i amortizuar ose i përdorur**” dhe nga personeli përpunues doganor nuk është ndërhyrë për vlerësimin e mallit me Komision Vlerësimi Doganor bazuar në shpjegimet e Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”. Gjithashtu dokumentacioni tregtar bashkëngjitur praktikave doganore të mëposhtme nuk përmbush edhe kushtet për trajtim vlerësimi sipas metodës së transaksionit sipas nenit 34 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga personeli përpunues doganor nuk është vlerësuar kushti i përcaktuar në **Kontratën Furnizuese** të mallit i shprehur dhe dokumentuar në kontratën bashkëlidhur praktikave doganore **për një ulje në masën 50% mbi çmimin dhe vlerën reale të këtij malli** sipas përkrahimit të bërë nga kompania shitëse “CONDOR” me seli në ITALI ,si dhe nuk është marrë në konsideratë niveli prej 1000 euro/toni i shprehur në Dosjen e Të Dhënave të Disponueshme për mallra të klasifikuar në kodin *73084000*.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar
3. Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,

Vlera prej 9,032,762 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.4 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës “**lule të prera të freskëta**” të subjektit “NECO” të deklaruara në kapitullin *06* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD „Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, si dhe shpjegimet e nenit 35 të ligjit nr.8449, datë. 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" nenit 54, titulli VI “Vlera Doganore” pika c, e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Neni 64 pika 1,b e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Pikës 4 e Sesioni I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore”.që trajtohen me legjislacionin e vjetër doganor dhe sipas nenit 70 pika 1 dhe 2 Ligjinr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” që lidhet me “**Metodën dytësore për vlerësimin doganor**”. Dega Doganore Vlorë mbi bazën e transaksioneve alternative të pranuarra për vitin 2015, 2016 për artikullin “**lule të freskëta**”të nxjerrë dhe kontabilizojë detyrimet doganore të munguara të pasqyruara sa më poshtë:

Pika 4 e Sesioni I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore” përcakton se “Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit e deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). Kjo e bazuar në të dhënat e transaksioneve të pranuarra. Këto të dhëna janë të disponueshme edhe në formë elektronike, përmes moduleve të veçanta të ndërthuara për këtë qëllim në nivel qendror

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar
3. Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD „Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,
4. Ligji nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”

Vlera prej 1,079,152 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.5 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtari Auditimi

◆. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës “**lule të prera të freskëta**” të deklaruarra ngasubjekti “**Anton Angoni**”në kapitullin *06* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH. Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD „Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, si dhe shpjegimet e nenit 35 të ligjit nr.8449, datë. 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" nenit 54, titulli VI “Vlera Doganore” pika c, e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Neni 64 pika 1,b e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Pikës 4 e Sesioni I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore”.që trajtohen me legjislacionin e vjetër doganor dhe sipas nenit 70 pika 1 dhe 2 Ligji nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” që lidhet me “**Metodën dytësore për vlerësimin doganor**”. Dega Doganore Vlorë mbi bazën e transaksioneve alternative të pranuarra për vitin 2015, 2016 dhe 2017 për artikullin “**lule të freskëta**”të nxjerrë dhe kontabilizojë detyrimet doganore të munguara të pasqyruara sa më poshtë:

Pika 4 e Sesioni I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore” përcakton se “Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit e deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). Kjo e bazuar në të dhënat e transaksioneve të pranuar. Këto të dhëna janë të disponueshme edhe në formë elektronike, përmes moduleve të veçanta të ndërtuara për këtë qëllim në nivel qendror

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar
3. Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,
4. Ligji nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”

Vlera prej 321.935 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.6 bashkangjitur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi

◆. Në lidhje me procedurat e vlerësimit doganor të mallrave të subjektit “Aza Elektroshtepiake” meNIPT K17217201E për mallra të deklaruar kryesisht në kapitullin *84* dhe *85* të Nomenclaturës së Mallrave në RSH. Konstatohet se nga personeli përpunues doganor janë pranuar dhe përpunuar vlera të mallrave të deklaruar në vlera më të ulëta se vlerat e publikuara si të Dhëna të Disponueshme në RSH dalë në mbështetje të Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, dhe përcaktimeve të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pikës 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 2.11.2005. Në Udhëzim përcaktohet se në zbatim të neneve 34-39 të Kodit Doganor procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore fillojnë me pranimin ose jo të vlerës së transaksionit të deklaruar, **sipas indikatorëve të përcaktuar në pikën 2 të këtij Udhëzimi**. Nga shqyrtimi i dokumentacionit tregëtar të praktikave doganore të deklaruar nga ky operatorsipas metodës me përzgjedhje për periudhën nën juridiksion auditimi të përzgjedhura sipas periudhave të ndryshme për artikujt (**televizorë, grirëse ushqimi, hekura hekurosje, larëse rrobash**) u konstatua se nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për subjektin “AZA Elektroshtepiake” për të cilët rezultojnë verifikime doganore të mëparshme **por që nuk lidhen në kohe dhe hapësirë me numrat e deklarimeve doganore konkrete të praktikave dhe importeve të konstatuara nën juridiksion auditimi (2015-2017)** nuk është të kërkuar ndjekja e arkëtimit të detyrimeve doganore të rekomanduara në këtë raport përfundimtar auditimit si dhe nuk është kërkuar garantimi i menjëhershëm i borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanive importuese dhe kompanive lëvruese ose eksportuese për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999,“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë,sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, për deklarime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017 deri në përfundim të hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Gjithashtu nga personeli përpunues doganor nuk janë marrë në konsideratë hapat e duhur për analizën e indikatorëve mbi të cilët duhet të ishte mbështetur analiza për pranimin ose jo të vlerës së transaksionit. Gjatë shqyrtimit të praktikave doganore të deklaruar për mallrat të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

natyrës (*televizorë, grirëse ushqimi, hekura hekuosje, larëse rrobash*) me origjinë jokomunitare pra të deklaruar jo sipas kushtit MSABE në *Aktet e Kontrollit* të përpiluar nga personeli përpunues doganor të këqyrura pranë sistemit Asicuda Ëord bashkangjitur pas çdo praktike doganore nuk dokumentohet *veprimtaria e analizës së kryer nga personeli vlerësues doganor për përcaktimin e indikatorëve të riskut mbi vlerësimin e mallrave në fjalë.*

Nga personeli përpunues doganor nuk janë kryer veprime procedurale dhe verifikuese për praktikën doganore të shqyrtuar nën juridiksionin auditimi (*viti 2015, 2016 dhe 2017*) për pikat e indikatorëve të cituara dhe të renditura sa më poshtë:

2. Indikatorët mbi të cilat do të mbështetet kjo analizë janë.

2.1 vlerat e mallrave identike apo të ngjashme të pranuar me transaksionin në sistemin doganor brenda 3 muajve të fundit. (*procedurë e pakryer nga personeli përpunues doganor*)

2.2 vlera të konfirmuara nga verifikimi i faturave që kanë rezultuar me diferenca (*procedurë e pakryer nga personeli përpunues doganor*)

2.3 vlera e mallrave të dërguara zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si të dhëna të disponueshme etj; (*procedurë e pakryer nga personeli përpunues doganor*)

2.6 në vendin e deklaruar si origjinë malli i deklaruar nuk prodhohet (*procedurë e pakërkuar dhe pakryer nga personeli përpunues doganor*)

2.8 fatura nuk është lëshuar nga prodhuesi (*procedurë e pakërkuar dhe pakryer nga personeli përpunues doganor*)

2.9 vendi i origjinës ndryshon nga vendi nga ku transportohet malli (*procedurë e pakërkuar dhe pakryer nga personeli përpunues doganor*)

2.11 vendi i ngarkimit nuk korrespondon me vendin e adresën e eksportuesit (PO)

2.12 mallrat janë të grupuara (PO)

2.15 eksporti i mallit bëhet nga kompani transportuese (Po)

2.22 kontratë me firmën shitëse (*procedurë e pakërkuar dhe pakryer nga personeli përpunues doganor*)

2.24 fatura të sigurimit të mallit (*procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor si dhe nuk rezulton e deklaruar nga operatori ekonomik*)

3. Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm justifikohet plotësisht vlera e deklaruar pranohet vlera e transaksionit. Në rastet, kur vlera e deklaruar krahasuar me të “*Dhënat e Disponueshme*” të përmendura më sipër është dukshëm më e ulët praktika e plotë i dërgohet për verifikim Departamentit Operativ Hetimor Drejtorisë së Inteligjencies dhe një kopje njësisë së kontrolleve aposteriori, që janë përgjegjës për verifikimin e plotë brenda dhe jashtë vendit. (*Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor*)

4. Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit e deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues dhe në *zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme).* (*Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor*)

5. Vetëm në rastet, kur nuk është e mundur që çmimi i mallit të përcaktohet sipas procedurave të përcaktuara më sipër bazuar në nenet 34, 35 të Kodit Doganor, si bazë vlerësimi mund të përdoret “*Dosja e Të Dhënave të Disponueshme*” (*Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor*)

6. Përcaktimi i vlerës së mallit bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

indikatorët e kontrolluar me shenjë “X” (*Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor*)

Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës “televizorë” të deklaruar jashtë kushtit preferencial MSABE (*origjinë NEU*) në praktikat doganore nën juridiksion auditimi (2015-2017). Nuk është kërkuar verifikimi i saktë i transaksioneve *pranë selive të kompanive lëvruese ose eksportuese të këtyre mallrave* si dhe garantimi në përputhje me legjislacionin doganor për pjesën e borxhit që mund të lindte nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” në shumën prej 15,644,304 lekë për praktika doganore të cituara sa më poshtë.

Tabela e kompanive eksportuese të mallrave televizorë.

1	"DISTANTE ELETRODOMEESTICI SRL72023 MESAGNE BR/ITALI"
2	"GO.VAR SRL22100 COMOITALI"
3	"HISENSE ITALIA SRL201256 MILANO ITALI"
4	"S.I.E.L SRL13012 PRAROLA VCITALI"
5	"SGM DISTRIBUZIONE SPA VIA SCHIPARELLI NR 3147122 FORLI ITALI"
6	"TREVI SPA 47924 RIMINI RNITALI"
7	"TVlorë ENTY SRL20126 MILANO ITALI"
8	"UNIEURO SPA47122 FORLIITALI"
9	"CONSUMER ELETRONICS SPA PIAZZA G.FERRE 1020025 LEGNAMO MILANO ITALI"

Sa më poshtë edhe tabela e rasteve të praktikave doganore të artikullit televizorë të konstatuara sa më poshtë ku vlera doganore e deklaruar krahasuar me të “*Dhënat e Disponueshme*” të përmendura më sipër “*është dukshëm më e ulët*” për të cilat do të rekomandohen nga grupi auditues ndjekja dhe kërkimi i arkëtimit të detyrimit doganor në shumën 15,644,304 lekë.

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.7 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës “shtrydhëse/grirëse” të deklaruar jashtë kushtit preferencial MSABE (*origjinë NEU*) në praktikat doganore nën juridiksion auditimi (2015-2017). Nuk është kërkuar verifikimi i saktë i transaksioneve të *kryera pranë selive të kompanive lëvruese ose eksportuese të këtyre mallrave* si dhe garantimi në përputhje me legjislacionin doganor për pjesën e borxhit që mund të lindte nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” në shumën prej 853,997 lekë për praktika doganore të cituara sa më sipër.

Tabela e kompanive eksportuese të mallrave “shtrydhëse/grirëse”.

1	"DCG SRL20861 BRUGHERIO MBITALI"
2	"TREVI IDEA SRL47924 RIMINI RNITALI"
3	"ELETRONIC SRL210861 BRUGHERIO MBITALI"
4	"TEENTY SRL 20126 MILANO P.ZA DEL TRICOLORE ITALI"
5	"DISTANTE ELETRODOMEESTICI SRL72023 MESAGNE BR/ITALI"
6	"SGM DISTRIBUZIONE SPA VIA SCHIPARELLI NR 3147122 FORLI ITALI"
7	"UNIEURO SPA47122 FORLIITALI"

Sa më poshtë edhe tabela e rasteve të praktikave doganore të artikullit “shtrydhëse/grirëse” të konstatuara sa më poshtë ku vlera doganore e deklaruar krahasuar me të “*Dhënat e Disponueshme*” të përmendura më sipër “*është dukshëm më e ulët*” për të cilat do të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

rekomandohen nga grupi auditues kërkimi i arkëtimit të detyrimit doganor në *shumën 853,997 lekë*.

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.8 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës “*hekur hekurosje*” të deklaruar jashtë kushtit preferencial MSABE (*origjinë NEU*) në praktikat doganore nën juridiksion auditimi (2015-2017). Nuk është kërkuar verifikimi i saktë i transaksioneve të kryera *pranë selive të kompanive lëvruese* ose eksportuese të këtyre mallrave si dhe garantimi në përputhje me legjislacionin doganor për pjesën e borxhit që mund të lindte nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “*Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara*” në shumën prej 853,997 lekë për praktika doganore të cituara sa më sipër.

Tabela e kompanive eksportuese të mallrave “hekur hekurosje”

"ALEAMA SRL74122 TALSANO TAITALI"
"DCGSRL20861 BRUGHERIO MBITALI"
"TREVIDEA SRL47924 RIMINI RNITALI"
"ELETRONIC SRL210861 BRUGHERIO MBITALI"
"TVlorë ENTY SRL 20126 MILANO P.ZA DEL TRICOLORE ITALI"

Sa më poshtë edhe tabela e rasteve të praktikave doganore të artikullit “*hekur-hekurosje*” të konstatuara sa më poshtë ku vlera doganore e deklaruar krahasuar me të “*Dhënat e Disponueshme*” të përmendura më sipër “*është dukshëm më e ulët*” për të cilat do të rekomandohen nga grupi auditues kërkimi i arkëtimit të detyrimit doganor në *shumën 819,924 lekë*.

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.9 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës “*larëse rrobash*” të deklaruar jashtë kushtit preferencial MSABE (*origjinë NEU*) në praktikat doganore nën juridiksion auditimi (2015-2017). Nuk është kërkuar verifikimi i saktë i transaksioneve të kryera *pranë selive të kompanive lëvruese* ose eksportuese të këtyre mallrave si dhe garantimi në përputhje me legjislacionin doganor për pjesën e borxhit që mund të lindte nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “*Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara*” në shumën prej 2,131,218 lekë për praktika doganore të cituara sa më poshtë.

Tabela e kompanive eksportuese të mallrave “larëse rrobash”

"TECHNOMARKETBULGARIAEAD 361 TSARIGRADSKO CHAUSSEESOFIE BULLGARI"
"S.I.ELSRL13012 PRAROLA VCITALI"
"TVlorë ENTY SRL 20126 MILANO P.ZA DEL TRICOLORE ITALI"
"DISTANTEELETRODOMEESTICI SRL72023 MESAGNE BR/ITALI",

Sa më poshtë edhe tabela e rasteve të praktikave doganore të artikullit “*larëse rrobash*” të konstatuara sa më poshtë ku vlera doganore e deklaruar krahasuar me të “*Dhënat e Disponueshme*” të përmendura më sipër “*është dukshëm më e ulët*” për të cilat do të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

rekomandohen nga grupi auditues kërkimi i arkëtimit të detyrimit doganor në *shumën 19,560,454 lekë*.

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.10 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

Në lidhje me artikullin “Telefona Celularë” konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të deklaruar jashtë kushtit preferencial MSABE (*origjinë NEU*) në praktikën doganore nën juridiksion auditimi (2015-2017). Nuk është kërkuar verifikimi i saktë i transaksioneve të kryera *pranë selive të kompanive lëvruese* ose eksportuese të këtyre mallrave si dhe garantimi në përputhje me legjislacionin doganor për pjesën e borxhit që mund të lindte nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “*Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara*” për praktika doganore të cituara sa më sipër. Gjithashtu nuk janë kryer veprime verifikuese nga burime:

www.trovaprezzi.com

www.pixmania.com

www.aliexpress.com

www.ideal.de

sipas përcaktimeve të *Shkresës nr. 18125/2 prot datë 07.10.2014 “Për vlerësimin e celularëve”* për krahasimin e çmimeve të deklaruara me ato të burimeve të mësipërme duke pranuar një tolerancë deri në -10% të çmimit të publikuar. Tabela e rasteve të deklarimeve për vitin 2015-2016-2017.

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.10.1 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

Në pëfundim

Administrohen nga Dega Doganore Vlorë edhe përgjigjet e verifikimit të faturave nga Bullgaria dhe Italia për subjektin “Aza Elektrosht” sipas *shkresave nr. 363 prot datë 27.01.2017 për 2 fatura të vitit 2013 për televizorë “Hair 22” ardhur nga Italia, shkresa nr. 1764 prot datë 29.04.2016 për 18 fatura malli që i përkasin 6 praktikave doganore të vitit 2013 dhe 2014 për mallra “Frigoriferë”, ardhur nga Bullgaria, shkresa nr. 3032 datë 19.07.2016 për 1 faturë malli për mallra “fshesa me korent” ardhur nga Italia, shkresa nr. 1765 prot datë 29.04.2016 për mallra frigoriferë për fatura të vitit 2013 ardhur nga Italia të konfirmuara nga protokollin e Degës Doganore Vlorë për të cilat ka rezultuar se faturat janë të rregullta dhe autentike*

Në analizë të fakteve dhe hapave të ndjekura nga personeli përpunues doganor vërehet se nuk është kërkuar verifikimi i faturave të mallit për praktikën e mësipërme nën juridiksion auditimi dhe të konstatuara në Projekt Raportin e Auditimit ku vërehet dukshëm se “*çmimi i deklaruar dhe i pranuar është më i ulët se çmimi i publikuar i të dhënave të disponueshme*” për artikujt që janë prekur gjatë fazës së auditimit. Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të importuara nga kompanitë e cituara të natyrës “*elektroshtepiake*” për praktika deklaruese nën juridiksion auditimi (2015-2017) të cituara sa më sipër. Rezultojnë verifikime doganore të mëparshme “*por që nuk lidhen në kohe dhe hapësirë me deklaratimet dhe numrat konkretë të praktikave dhe importeve të konstatuara nën juridiksion auditimi për vitin 2017*”. Në vijim të kërkohet ndjekja e arkëtimit të detyrimeve doganore të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

rekomanduara në shumën 19,560,600 lekë në këtë raport përfundimtar auditimi si dhe në vijim të procedurave verifikuese që mund të kryhen për verifikimin e të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë importuese dhe kompanive lëvruese të garantohet borxhi doganor për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane bazuar në përcaktimet e Titullit “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, për deklarime doganore të periudhës të cituara sa më sipër bazuar në Ligjin nr. 8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” sipas nenit 1 deri 23 të këtij ligji.

Dega Doganore Vlorë të kërkojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave edhe “**verifikimin e plotë dhe të garantuar të klasifikimit tarifor të këtyre mallrave dhe vlerave të transaktuara sipas deklarimeve nga prodhuesi direkt dhe eksportuesi ose lëvruesi i mallit**” për praktika të konstatuara sa më sipër në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” ku përcaktohet se “informacioni do të jetë veçanërisht i tillë që të lehtësojë përcaktimin e vlerës së taksueshme, klasifikimin tarifor dhe origjinën e mallrave”

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar
- 3.Shkresës nr18125/2 prot datë 07.10.2014 “Për Vlerësimin e Celularëve”
4. Ligji nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”
5. Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Fatmir Ferati në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë ,
2. Artan Bedini në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë
3. Avni Hysi në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë
- 4.Renato Bega në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë aktualisht në sektorin PIA
- 5.Andet Hoxha në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë

I. Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me trajtimin preferencial të mallrave. Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1. Nga ana e z. Shkëlqim Rama, me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve; z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim dhe z. Renato Bega me detyrë përgjegjës zyre te Petrolifera Italo Albanese, në cilësinë e ish doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në legjisllacionin doganor dhe protokollin e origjinës gjatë kryerjes së detyrave funksionale.

Referuar Titullit I, neni 1 “Përkufizimet”, germa “I” të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, në të përcaktohet qartë që:

“dërgesa” do të thotë produkte që janë dërguar në mënyrë të njëkohshme nga një eksportues



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

te një marres ose te shoqëruara me një dokument te vetëm transporti qe mbulon transportimin e tyre nga një eksportues te një marres ose, ne mungese te një dokumenti te tille, nga një fature e vetme

Referuar Titullit V, neni 22 “Kushtet përbërjen e një Deklarate Fature”, pika 1, germa “a” dhe “b” të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, në të përcaktohet qartë që:

1. Një deklaratë faturë, siç referohet ne Nenin 16(1)(b), mund te behet:

a) nga një eksportues i miratuar në kuptimin e Nenit 23,

ose b) nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, **vlera totale e të cilave nuk i kalon 6000€**

Referuar nenit 256, pika 2, të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

Çdo veprim ose mosveprim që bie ndesh me dispozitat e parashikuara në këtë Kod, me aktet nënligjore të tij dhe me dispozita të tjera në fuqi, me përjashtim të rasteve të fuqisë madhore, quhet kundërvajtje administrative doganore dhe dënohet si e tillë.

Referuar nenit 261, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një **origjine** të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë.

2. Në rastet kur pas rishikimit të deklaratës rezulton që detyrimet doganore që duhen paguar janë më të larta se ato të llogaritura në bazë të deklaratës dhe diferenca e këtyre është më e madhe sesa 5%, në vend të gjobës së mësipërme, zbatohet një gjobë e barabartë me trefishin e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara.

♦ Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 të artikujve të ndryshëm në kodet përkatëse tarifore të NKM të mallrave me origjinë preferenciale rezultoi se, bazuar në faturat (invoice), apo dokumentin e transportit (CMR), artikujt janë trajtuar me MSABE bazuar në deklaratat faturë pjesë e praktikave doganore. Faturat bashkëlidhur praktikave doganore kanë të cilësuar notën shpërndarëse për produkte origjinuese por vlera totale e tyre i kalon 6000 euro. Për të përfituar trajtim preferencial, artikujt e mbuluar nga këto fatura duhet të kishin certifikatë origjine EUR.1 ose dërguesi duhej të ishte eksportues i miratuar. Nga agjensitë doganore, por dhe sektori operacional, artikujt e mbuluar nga këto fatura janë deklaruar dhe trajtuar me origjinë preferenciale në shkelje të nenit 256.1/a, 256.2, 256.4, 261.1 dhe 261.2 të KD, pasi:

- **së pari**, referuar Titullit I, neni 1 “Përkufizimet” të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë” i cili citon: **“Përqëllime te këtij protokolli:**

.....(I) “dërgesa” do te thotë produkte qe janëdërguar ne mënyre te njëkohshme nga një eksportues te një marres ose te shoqëruara me një dokument te vetëm transporti qe mbulon transportimin e tyre nga një eksportues te një marres ose, ne mungese te një dokumenti te tille, nga një fature e vetme...”;

- **së dyti**, referuar Titullit V, neni 22, të MSABE, kushtet për lëshimin e një deklarate faturë citon: “...Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22 ose nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, **vlera e të cilave nuk i kalon 6000€...**”. Nga mosveprimi referuar neneve 256.4, 261.1, 261.3 të KD. Konstatimi i mësipërm, evidentohet më konkretisht në tabelat bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

◆ Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 të artikujve të ndryshëm në kodet përkatëse tarifore të NKM të mallrave me origjinë preferenciale rezultoi se, bazuar në faturat (invoice), rezultojnë artikuj pa shenjën (*), të trajtuar me MSABE edhe pse janë cilësuar në faturë që nuk përfitojnë origjinë preferenciale. Nga agjensitë doganore, por dhe sektori operacional, këta artikujt të mbuluar nga këto fatura janë deklaruar dhe trajtuar me origjinë preferenciale me pasojë shmangie të detyrimit doganor në shkelje të nenit 256.1/a, 256.2, 256.4, 261.1 dhe 261.2 të KD. Konstatimi i mësipërm, evidentohet më konkretisht në tabelën e mëposhtme: Konstatimi i mësipërm, evidentohet më konkretisht në tabelat bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Trajtuar më hollësisht në aneksin 3.11 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësit z. Shkëlqim Rama, me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.12 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për veprimet jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me trajtimin preferencial të mallrave;

2. Nga ana e nëpunësve z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim dhe z. Renato Bega me detyrë përgjegjës zyre të Petrolifera Italo Albanese, në cilësinë e ish doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për veprimet jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me trajtimin preferencial të mallrave.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 28, pika 1 dhe 3, gërma “a”, në të cilin përcaktohet qartë që:

1. Detyrimet doganore ligjore që duhen shlyer kur lind një borxh doganor, bazohen në Tarifën doganore të Republikës së Shqipërisë.

3. Tarifa doganore e Republikës së Shqipërisë përfshin:

a) nomenklaturën e mallrave të bazuar në sistemin e harmonizuar;

Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 261, pika 1, 2 dhe 3, në të cilin përcaktohet qartë që:

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një **origjine** të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë.

2. Në rastet kur pas rishikimit të deklaratës rezulton që detyrimet doganore që duhen paguar janë më të larta se ato të llogaritura në bazë të deklaratës dhe diferenca e këtyre është më e madhe sesa 5%, në vend të gjobës së mësipërme, zbatohet një gjobë e barabartë me trefishin e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara.

3. Megjithatë, në rast se kjo diferencë është pasojë e një gabimi të kryer në mirëbesim gjatë hartimit të deklaratës doganore dhe deklaruesi i ka paraqitur të gjithë dokumentet dhe informacionin e nevojshëm për verifikim doganor, zbatohet një gjobë që shkon nga një e dhjeta deri në tërë shumën e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara.

Vlera prej 3,435,009 lekë, e cila përfaqëson 1,605,127 lekë detyrim doganor dhe shuma prej 1,784,882 penalitet do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Shkëlqim Rama me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve;



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

2. Z. Renato Bega, me detyrë përgjegjës zyre te Petrolifera Italo Albanese, në cilësinë e ish doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim;

3. Z. Avni Hysi, Z. Artan Bedini dhe Z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim.

Konstatimi i mësipërm dhe rastetetraktuara nga grupi i auditimit trajtuar më hollësisht në aneksin 3.11 dhe 3.12 bashkangjitur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi për detyrime doganore të rekomanduara në shumën totale 3,435,009 lekë.

II. Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave. Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1. Nga ana e z. Renato Bega me detyrë përgjegjës zyre te Petrolifera Italo Albanese, në cilësinë e ish doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim; z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim; z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime dhe zj. Jeta Manaj me detyrë dhe në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra legjislacionin doganor si dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..”, nxjerrë për këtë qëllim.

Referuar nenit 35, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

Vlera doganore e përcaktuar sipas këtij neni do të jetë: a) vlera e transaktuar e mallrave identike të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

Referuar nenit 70, pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

vlera e transaksionit e mallrave identike, të shitura për eksport për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në kohën ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave doganore IM4, deklaruar nga operatorët ekonomik pranë D.D. V, rezultoi:

1.- artikulli “Paleta” (europaleta), klasifikuar në kodin tarifor me kre *4415* të NKM, te disa subjekte rezultoi i padeklaruar duke krijuar një efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit. Nga sektori i vlerës është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 35 dhe 36 të KD, pasi rivlerësimi i tyre duhej bërë me 8 €/copë nga EU;

2.- artikulli “Veshje druri për tavane”, klasifikuar në kodin tarifor *44091018* të NKM, i deklaruar nga i njëjti subjekt eksportues për të njëjtin importues, paraqitet me çmime shumë të ulëta dhe të ndryshme. Nga sektori i vlerës është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 35 dhe 36 të KD, pasi rivlerësimi i artikullit duhej bërë me 4.5 €/m² nga EU në kushtet e lëvrimit FOB;

3.- artikujt “Tubo dhe rekorderi plastike për instalime hidraulike; tub fleksibël për instalime elektrike si dhe artikujt e tjerë të deklaruar në copë”, klasifikuar në kodin tarifor me kre *3917* dhe artikujt e tjerë plastik të deklaruar në copë, të deklaruar nga i njëjti subjekt eksportues për të njëjtin importues, paraqiten me çmime shumë të ulëta dhe të ndryshme, madje në shumë raste edhe nën çmimin e lëndës së parë. Nga sektori i vlerës është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 35 dhe 36 të KD, pasi rivlerësimi i artikullit duhej bërë përkatësisht me 1.8/2.3/1.73 €/kg nga EU në kushtet e lëvrimit FOB;



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

4.- artikulli “Lastra graniti” i deklaruar nga i njëjti subjekt eksportues, klasifikuar në kodin tarifor *68029310* të NKM, me importues subjektin “AFVlorë RDITA/V”, paraqitet me çmime më të ulëta nga operatorët e tjerë për të cilët nga sektori i vlerës është bërë ndërhyrje sipas metodës 6 të vlerësimit;

5.- artikulli “Kafe në tableta” i deklaruar në kodin tarifor *09012100* të NKM, është rivlerësuar me 0.08 euro/tableta, por referuar dokumentacionit bashkëlidhur (kodit të artikullit në fatura) dhe imazheve të internetit, artikulli rezulton me ambalazhin kapsul, ndaj rivlerësimi i artikullit duhej bërë minimalisht me 0.1 €/tableta nga EU në kushtet e lëvrimin FOB;

6.- për gjithë artikujt e tjerë, nga sektori i vlerës nuk është bërë ndërhyrje sipas metodës së vlerësimit të ndjekura për praktikat e tjera doganore për të njëjtët artikuj.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësve, z. Renato Bega me detyrë përgjegjës zyre te Petrolifera Italo Albanese, në cilësinë e ish doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim, z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim; z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime dhe zj. Jeta Manaj me detyrë dhe në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për veprimet jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me shqyrtimin e vlerës së mallrave.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 35, pika 2, gërma “a”;

Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 70, pika 2, gërma “a”;

Udhëzimin 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..”, Sesioni I, pikës 2.

Vlera prej 26,665,261 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Renato Bega me detyrë përgjegjës zyre te Petrolifera Italo Albanese, në cilësinë e ish doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim;

2. Z. Avni Hysi, Z. Artan Bedini dhe Z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim;

3. Zj. Jeta Manaj, me detyrë dhe në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime;

4. Z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime

Konstatimi i mësipërm dhe rastet trajtuara nga grupi i auditimit trajtuar më hollësisht në aneksin 3.13 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

III. Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me klasifikimin tarifor të mallrave si dhe taksës së ambalazhit (TAM).

Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

1. Nga ana e z. Shkëlqim Rama, me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve; z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim dhe z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra legjislacionin doganor lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave të deklaruar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore.

Referuar nenit 256, pika 2, të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

Çdo veprim ose mosveprim që bie ndesh me dispozitat e parashikuara në këtë Kod, me aktet nënligjore të tij dhe me dispozita të tjera në fuqi, me përjashtim të rasteve të fuqisë madhore, quhet kundërvajtje administrative doganore dhe dënohet si e tillë.

Referuar nenit 261, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një cilësie... të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë.

2. Në rastet kur pas rishikimit të deklaratës rezultojnë detyrimet doganore që duhen paguar janë më të larta se ato të llogaritura në bazë të deklaratës dhe diferenca e këtyre është më e madhe sesa 5%, në vend të gjobës së mësipërme, zbatohet një gjobë e barabartë me trefishin e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4, rezultojnë referuar: notave shpjeguese të NKM: importeve të kryera nga subjekte të tjerë në këtë degë doganore por edhe në degë të tjera doganore si dhe në shumë raste deklaratave të eksportit që mbulojnë këto artikuj, artikujt janë keqklasifikuar në kodet tarifore në të cilat janë deklaruar në shkelje të nenit 256.1/a, 256.2 dhe 261.1 të KD. Nga këto keqklasifikime tarifore sinë kuadratin 33 të DAV, por edhe në kuadratin 31 (në rastet e importit të artikujve plastik), rezultojnë detyrime shtesë për tu paguar.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësit z. Shkëlqim Rama, me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.12 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për veprimet jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave të deklaruar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore;

2. Nga ana e nëpunësve z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim dhe z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për veprimet jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave të deklaruar me pasojë shmangien e detyrimeve doganore.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 256, pika 2 dhe 4;

Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 261, pika 1 dhe 2.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Vlera prej 3,238,858 lekë, e cila përfaqëson 809,714 lekë detyrim doganor dhe 2,429,143 lekë penalitet do të konsiderohet e ardhur e munguar doganore shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Shkëlqim Rama me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve;
2. Z. Avni Hysi, Z. Artan Bedini dhe Z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim;
3. Z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime

Konstatimi i mësipërm dhe rastet e trajtuara nga grupi i auditimit trajtuar më hollësisht në aneksin 3.14 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

IV. Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të përdorur.

Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1. Nga ana e z. Shkëlqim Rama, me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve; z. Fesim Kapaj me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i zyrës regjime/preferencë përjashtime; z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim; z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime dhe zj. Jeta Manaj me detyrë dhe në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra legjislacionin doganor si dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..”, nxjerrë për këtë qëllim.

Referuar nenit 35, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

Vlera doganore e përcaktuar sipas këtij neni do të jetë: a) vlera e transaktuar e mallrave identike të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

Referuar nenit 70, pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

vlera e transaksionit e mallrave identike, të shitura për eksport për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në kohën ose afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen

Referuar Sesionit I, pikës 5.4, të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..”, në të përcaktohet qartë që:

Ne rastet e importit të mallrave të përdorura nga Dega Doganore të ngrihet Komision përvlerësimin e tyre që duhet të përcaktojë shkallen e amortizimit të mallrave për të cilat baze llogaritjes duhet të jene vlera referuese, viti i prodhimit, dhe vlera e llogaritur nuk mund të jete me e vogël se 30% e vlerës së mallit të ri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 të zhdoganimit të artikujve të përdorur, rezulton se nga sektori i vlerës nuk është ngritur komision vlere për rivlerësimin e artikujve të deklaruar, veprim ky, jo në përputhje të kërkesave të pikës 5.4 të Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” dhe nuk është bërë ndërhyrje në elementët e vlerës pasi artikulli duhej vlerësuar me minimumi 30 % të çmimit minimal sipas të dhënave të disponueshme. Artikulli (ekskavator), është zhdoganuar me 0.04 €/kg, pra shumë me ulët se



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

çmimi i deklaruar (bursa) e lëndës së parë (skrap). Ky artikull në gjithë sistemin doganor, rezulton të jetë zhdoganuar me 0.5 €/kg. Konstatimi i mësipërm, evidentohet më konkretisht në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.5

NR	DAVR	DATA	SUBJEKT	NIPT	ARTIKULLI	KODIT.	COPVlorë /KG	EF. FIN./L
12	4828	14/04/15	D.K.S GROUP	K665302020	EKSKAVATOR	84295210	60000 KG	774,676
3	9558	04/08/17	ANA 2013	L37009201B	EKSKAVATOR	84295210	62100 KG	160,434
4	14137	02/10/15	G.M - SHPK	K67105202R	E. KAFEJE	84198120	10 COPVlorë	16,767
5	767	21/10/15	G.M - SHPK	K67105202R	E. KAFEJE	84198120	5 COPVlorë	8,363
6	9778	30/07/16	DERLIN	K37213202L	M. KAFEJE	85094000	60 COPVlorë	52,765
7	4244	10/04/17	DERLIN	K37213202L	LAVATRICE TVlorë PVlorë RD. 400 / 500/ 600/ 1000 XHIRO	84501111	156 COPE (87/32/30/7)	63,654
8	963	25/01/15	EUROFRIGO	L36713201R	LAVATRICE TVlorë PVlorë RD. 400/ 600/ 800/ 1000/ >1000 XHIRO	84501111	40/10/14/ 18/8 COPVlorë	34,290
9	2120	16/02/15	EUROFRIGO	L36713201R	LAVATRICE TVlorë PVlorë RD. 400/ 600/ 800/ 1000/ >1000 XHIRO	84501111	104/21/10/ 10/10 COPVlorë	103,068
10	12288	16/10/17	XHELIL C.	G90517084T	PIRUN	84272011	1 COPVlorë	40,110
11	2707	05/03/16	T. A. S. Vlorë	L57031219A	BID. PLASTIK	39249000	1206 KG	35,974
SHUMA LEK								1,290,101

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësve z. Shkëlqim Rama, me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve dhe z. Fesim Kapaj me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i zyrës regjime/preferencë/përrjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.12 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për veprimet jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me shqyrtimin e vlerës së mallrave të përdorur;

2. Nga ana e nëpunësve z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim; z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime dhe zj. Jeta Manaj me detyrë dhe në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për veprimet jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me shqyrtimin e vlerës së mallrave të përdorur.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

Udhëzimin 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..”, Sesioni I, pikës 5.4.

Vlera prej 1,290,101 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Shkëlqim Rama me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve;
2. Z. Festim Kapaj me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjës i zyrës regjime/preferencë përjashtime;
3. Z. Avni Hysi, Z. Artan Bedini dhe Z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim;
4. Zj. Jeta Manaj, me detyrë dhe në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime;
5. Z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim në cilësinë e doganier i zyrës regjime/preferencë përjashtime

Konstatimi i mësipërm dhe rastet e trajtuara nga grupi i auditimit trajtuar më hollësisht në aneksin 3.16 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

V. Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me vlerësimin doganor të automjeteve.

Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1. Nga ana e z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në Udhëzimin e Ministrisë së Financave për vlerësimin doganor të automjeteve.

Referuar pikës 17.1 dhe 17.2, të Udhëzimit nr.24, datë 11.09.2015 të Ministrit të Financave “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.25, datë 30.11.2007 ‘Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, ...si dhe zhdoganimit të automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre’”, në të përcaktohet qartë që:

17. Në vlerësimin e automjeteve me vit prodhimi, para vitit të fundit të publikuar në buletin, vlera nuk mund të llogaritet me pak se:

17.1 Per autoveturat:

- a) Deri 1400 cc jo me pak se 130.000 leke
- b) Mbi 1400-1900 cc jo me pak se 200.000 leke
- c) Mbi 1900-2500 cc jo me pak se 325.000 leke
- d) Mbi 2500-3000 cc jo me pak se 400.000 leke
- e) Mbi 3000-4500 cc jo me pak se 500.000 leke
- f) Mbi 4500 cc jo me pak se 800.000 leke

17.2 Kamioncina, furgona dhe kamione:

- a) Deri në 1.5 ton jo me pak se 400.000 leke
- b) Nga 1.5 ton deri në 3.5 ton jo me pak se 600.000 leke
- c) Nga 3.5 ton deri në 10 ton jo me pak se 850.000 leke
- d) Nga 10 ton deri në 15 ton jo me pak se 1.000.000 leke
- e) Mbi 15 ton jo me pak se 1.200.000 leke

Referuar shkresës nr.12090/4 prot., datë 21.10.2015 të Ministrisë së Financave, në të përcaktohet qartë që:

Udhëziminr.24.....ka parashikuar hyrjen në fuqi menjëherë. Hyrja në fuqi është shprehur në mënyrë të qartë në përmbajtjen e aktit, e për rrjedhojë nuk ka vend për interpretim përsa i përket fillimit të efekteve juridike të udhëzimit...”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 të zhdoganimit të automjeteve, me vit prodhimi, para vitit të fundit të publikuar në buletin, vlera e automjeteve është përllogaritur më pak se vlera e vendosur nga komisioni *Ad-Hoc*, dhe i miratuar nga Ministria e Financave. Nga sektori operacional, këto automjete janë llogaritur më pak se vlera e vendosur nga Ministria e Financave, veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 34-37 të Kodit Doganor.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësve z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.13 të “Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot”, datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për veprimet jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me shqyrtimin e vlerës së mallrave.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

Udhëzimin nr.24, datë 11.09.2015 të Ministrit të Financave “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.25, datë 30.11.2007 ‘Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, ...si dhe zhdoganimit të automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre’”, pikës 17.1 dhe 17.2.

Vlera prej 811,032 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

1. Z. Avni Hysi, Z. Artan Bedini dhe Z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim.

Konstatimi i mësipërm dhe rastet e trajtuara nga grupi i auditimit trajtuar më hollësisht në aneksin 3.17 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

VI. Auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 në lidhje me skonton në faturë. Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1. Nga ana e z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në legjislacionin doganor për vlerësimin doganor të vlerës realisht që duhej paguar për mallrat për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Referuar nenit 34, pika 1, të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaktuar, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.....

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur praktikave doganore IM4 të artikujve të ndryshëm rezultoi se vlera reale e faturave bashkëlidhur e cila mbulon artikujt e deklaruar është më e lartë se vlera e artikujve të deklaruar në DAV. Nga sektori operacional, artikujt e mbuluar nga këto fatura janë deklaruar dhe trajtuar në DAV me skonto (sipas faturës), veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 34 të Kodit Doganor.

Konstatimi i mësipërm, evidentohet më konkretisht në tabelën e mëposhtme:

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësve z. Avni Hysi, z. Artan Bedini, z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale për veprimet jo në përputhje të kërkesave të legjislacionit doganor lidhur me shqyrtimin e vlerës së mallrave.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 34, pika 1.

Vlera prej 113,685 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Shkëlqim Rama me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve;

2. Z. Avni Hysi, Z. Artan Bedini dhe Z. Fatmir Ferati me detyrë dhe në cilësinë e doganier kontrollit dokumentar klasifikim/vlerësim.

Konstatimi i mësipërm dhe rastet e trajtuara nga grupi i auditimit trajtuar më hollësisht në aneksin 3.18 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

Për vitin 2017

♦.- Artikulli “***Lule të Freskëta***”, klasifikuar në kodin tarifor dhe kreun *0603* të NKM, për mallra të njëjtë edhe nga i njëjti subjekt dhe nga subjekte të ndryshëm rezultojn të jenë deklaruar me çmime të ndryshëm nga 0.05 E/copë deri 0.32 E/copë dhe dukshëm më ulët se vlera e të dhënave të disponueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të natyrës “***lule të prera të freskëta***” të deklaruar në kapitullin *06* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH. Konstatohet se nga personeli



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD, ”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, si dhe shpjegimet e nenit 35 të ligjit nr.8449, datë. 27.01.1999, ”Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” nenit 54, titulli VI “Vlera Doganore” pika c, e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Neni 64 pika 1,b e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Pikës 4 e Sesioni I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore”.që trajtohen me legjislacionin e vjetër doganor dhe sipas nenit 70 pika 1 dhe 2 Ligji nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” që lidhet me “Metodën dytësore për vlerësimin doganor”. Dega Doganore Vlorë mbi bazën e transaksioneve alternative të pranuar për vitin 2015, 2016 për artikullin “**lule të freskëta**” të nxjerrë dhe kontabilizojë detyrimet doganore të munguara të pasqyruara sa më poshtë:

Pika 4 e Sesioni I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore” përcakton se “Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit e deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). Kjo e bazuar në të dhënat e transaksioneve të pranuar. Këto të dhëna janë të disponueshme edhe në formë elektronike, përmes moduleve të veçanta të ndërtuara për këtë qëllim në nivel qendror

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar
3. Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD, ”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,
4. Ligji nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”

Vlera prej 816,200 lekë, e cila përfaqëson detyrim doganor të munguar do të konsiderohet e ardhur doganore e munguar në Buxhetin e Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Fatmir Ferati në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë ,
2. Artan Bedini në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë
3. Avni Hysi në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë
- 5.Andet Hoxha në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë

Konstatimi i mësipërm dhe rastet e trajtuara nga grupi i auditimit trajtuar më hollësisht në aneksin 3.29 bashkangjitur këtij ProjektAuditimi

◆.Në lidhje me vlerësimin e artikullit “Autovetura” konstatohet se:

Nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë në disa raste nuk janë zbatuar dispozitat e ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 32, datë 02.04. 2015, të VKM-së nr. 205, datë 13.04.1999, “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe kërkesat e udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 i Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”,ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 24, datë 11.9.2015 .

Sipas Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 24, datë 11.9.2015 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre” në pikën 17 përcaktohet: Në



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

vlerësimin e automjeteve me vit prodhimi para vitit të fundit të publikuar në buletin, vlera nuk mund të llogaritet më pak se:

17.1 Për autoveturat:

- a) Deri 1400 cc, jo më pak se 130.000 lekë;*
- b) Mbi 1400-1900 cc, jo më pak se 200.000 lekë;*
- c) Mbi 1900-2500 cc, jo më pak se 325.000 lekë;*
- d) Mbi 2500-3000 cc, jo më pak se 400.000 lekë;*
- e) Mbi 3000-4500 cc, jo më pak se 500.000 lekë;*
- f) Mbi 4500 cc, jo më pak se 800.000 lekë.*

Me shkresën nr. 15448 Prot, datë 30.06.2017, protokolluar në Degën Doganore Vlorë me nr. 2603, datë 04.07.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë dërguar çmimet e shitjes së autoveturave sipas buletinit “Quattroruote”, ku janë përcaktuar çmimet përkatëse sipas tipeve të autoveturave .

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentet e paraqitura nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë , për periudhën 9-mujori 2017, lidhur me vlerësimin doganor të automjeteve ***u konstatua se :***

◆ *Me DAV me R-11531, datë 27.09.2017, subjekti “ ALFONS AGO”, me NIPT I10402086U, ka deklaruar në import nga Italia Autoveturë AUDI A3 prodhim i vitit 2004 me cilindrata 1896 cc me çmim 500 euro, me shpenzime transporti 26,700 lekë. Nga shqyrtimi i praktikës doganore rezulton se nga doganieri **Andet Hoxhaj** është bërë ndërhyrje për vlerësimin e artikullit dhe vlera për qëllime doganore është llogaritur për shumën 156,709 lekë me T.V.SH. për shumën 31,342 lekë. Sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 11.9.2015 për autoveturat me cilindrata mbi 1400-1900 cc, vlera nuk mund të llogaritet më pak se më pak se 200.000 lekë, kështu që vlera duhet të ishte llogaritur për shumën 226,700 lekë (200,000 + 26,700) dhe T.V.SH. duhet të ishte llogaritur për shumën 45,340 lekë. Efekti financiar me **të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit për TVSh për shumën 13,998 lekë (45,340 - 31,342)**.*

◆ *Me DAV me R-9068, datë 26.07.2017, subjekti “ AUREL SALATI”, me NIPT I01006085V, ka deklaruar në import nga Gjermania Autoveturë MERCEDEC Tipi E 200 prodhim i vitit 2011 me çmim 6000 euro, me shpenzime transporti 39,777 lekë. Nga shqyrtimi i praktikës doganore rezulton se nga doganieri **Artan Bedinaj** është bërë ndërhyrje për vlerësimin e artikullit dhe vlera për qëllime doganore është llogaritur për shumën 1,308,942 lekë me T.V.SH. për shumën 261,787 lekë.*

Sipas të dhënave të buletinit “QUATTRORUOTE”, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 15448 Prot, datë 30.06.2017 çmimi për këtë tip autoveture është 17,100 euro, kështu që vlera duhet të ishte llogaritur :

$17,100 \text{ euro} \times 80\% = 13,680 \text{ euro} \times 132,59 \text{ lekë/euro} = 1,813,831 \text{ lekë} + 39,777 \text{ lekë} = 1,853,608 \text{ lekë}$ dhe detyrimet për T.V.SH. duhet të llogariteshin për shumën 370,721 lekë. Efekti financiar me **të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit për TVSh për shumën 108,934 lekë (370,721 - 261,787)**.

◆ *Me DAV me R-9894, datë 14.08.2017, subjekti “NELVIS JONUZAJ”, me NIPT I61005091U, ka deklaruar në import nga Spanja Autoveturë tip VOLKSVAGEN Golf cilindrata 1598 cc, prodhim i vitit 2011 me çmim 200,000 lekë, me shpenzime transporti 39,894 lekë. Nga shqyrtimi i praktikës doganore rezulton se nga doganieri **Avni Hysi** është bërë ndërhyrje për vlerësimin e artikullit dhe vlera për qëllime doganore është llogaritur për shumën 720,642 lekë me T.V.SH për shumën 144,127 lekë.*



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Sipas të dhënave të buletinit “QUATTRORUOTE”,dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 15448 Prot. datë 30.06.2017 çmimi për këtë tip autoveture është 6,900 euro,kështu që vlera duhet të ishte llogaritur :

$6,900 \text{ euro} \times 80\% = 5,520 \text{ euro} \times 132,98 \text{ lekë/euro} = 734,050 \text{ lekë} + 39,894 \text{ lekë} = 773,944 \text{ lekë}$ dhe detyrimet për T.V.SH. duhet të llogaritëshin për shumën 154,788 lekë. Efekti financiar me **të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit për TVSh për shumën 10,661 lekë**(154,788 – 144,127).

♦ Me DAV me R-9938, datë 16.08.2017, subjekti “DHIMITRAQ DHIMA”, me NIPT J31227072N, ka deklaruar në importnga Italia Autoveturë tip AUDI A4cilindrat 2698 cc, prodhim i vitit 2008 me çmim 400,000 lekë, me shpenzime transporti 26,596 lekë. Nga shqyrtimi i praktikës doganore rezulton se nga doganieri **Andet Hoxhaj** është bërë ndërhyrje për vlerësimin e artikullit dhe vlera për qëllime doganore është llogaritur për shumën 824,603 lekë me T.V.SH. për shumën 164,921 lekë.

Sipas të dhënave të buletinit “Quattroruote”,dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 15448 Prot. datë 30.06.2017 çmimi për këtë tip autoveture është 8,800 euro,kështu që vlera duhet të ishte llogaritur :

$8,800 \text{ euro} \times 80\% = 7,040 \text{ euro} \times 132,98 \text{ lekë/euro} = 936,179 \text{ lekë} + 26,596 \text{ lekë} = 962,775 \text{ lekë}$ dhe detyrimet për T.V.SH duhet të llogaritëshin për shumën 192,555 lekë. Efekti financiar me **të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit për TVSh për shumën 27,634 lekë**(192,555–164,92).

Nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë për rastet e trajtuara në këtë Akt Konstatim nuk janë zbatuar dispozitat e ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 32, datë 02.04. 2015, të VKM-së nr. 205, datë 13.04.1999, “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe kërkesat e udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 i Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”,ndryshuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 24, datë 11.9.2015 dhe shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 15448 Prot. datë 30.06.2017 për çmimet e shitjes së autoveturave sipas buletinit “Quattroruote”.

Efekt i Financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit për TVSh për rastet e mësipërme rezulton shumën 175,238 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi sipas DAV-ve përkatës të vlerësuar;

- 1 .z. Shkëlqim Rama me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së operacioneve;
- 2 .z. Fatmir Ferati, me detyrë Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik.
3. z. Avni Hysi, me detyrë Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik.
4. z. Andet Hoxhaj, me detyrë Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik .
5. z. Artan Bedinaj, me detyrë Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik

♦- Artikulli “**Bajame të Qëruara**“, klasifikuar në kodin tarifor me kre *0802* të NKM, për mallra të njëjtë edhe nga i njëjti subjekt rezulton të jenë deklaruar me çmime të ndryshëm nga 3.9 E/kg deri 4.2 E/kg dhe më ulët se vlera e të dhënave të disponueshme në territorin e Republikës së Shqipërisëku përcaktohet se për artikullin bajame pa guaskë nga EU çmimi FOB është 4.5-4.6 E/kg duke krijuar një efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit. Nga sektori i vlerës është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 70, pika 3, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.Duke i vlerësuar edhe me një çmim prej 4.5 E/kg, rezulton: vit 2017

Davi		Subjekti		Artikulli	Sasia	Dif.VI
R	Dt	Emri	Nipt			

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT****Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”**

5952	5/20	Benard 2002	K27223201G	Bajame Te Qeruara	3061.8	33075
6784	6/9	Benard 2002	K27223201G	Bajame Te Qeruara	6032.88	97146
11568	9/28	Benard 2002	K27223201G	Bajame Te Qeruara	2608.2	34819
Shuma						165041

Në analizë të fakteve dhe hapave të ndjekura nga personeli përpunues doganor vërehet se nuk është kërkuar verifikimi i faturave të mallit për praktikën e mësipërme në juridiksionin auditimi dhe të konstatuara në ProjektRaportin e Auditimit ku vërehet dukshëm se **“çmimi i deklaruar dhe i pranuar është më i ulët se çmimi i publikuar i të dhënave të disponueshme”** për artikujt që janë prekur gjatë fazës së auditimit. Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës **“bajame të qëruara”**. Në vijim të kërkohet ndjekja e arkëtimit të detyrimeve doganore të rekomanduara në shumën **165,041 lekë** në këtë raport përfundimtar auditimi menjëherë si dhe në vijim të procedurave verifikuese që mund të kryhen për verifikimin e të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë importuese dhe kompanive livruese, të garantohet borxhi doganor për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe për deklarime doganore të periudhës të cituara sa më sipërbazuar në Ligjin nr.8555, datë 22.12.1999 **“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë”** sipas nenit 1 deri 23 të këtij ligji

◆- Artikulli **“Çokollatë për bare”**, klasifikuar në kodin tarifor me kre *1806* të NKM, për mallra të njëjtë edhe nga i njëjti subjekt dhe nga subjekte të ndryshëm rezultojnë të jenë deklaruar me çmime të ndryshëm nga 2.6 E/kg deri 3.3 E/kg dhe dukshëm më ulët se vlera e të dhënave të disponueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet artikulli Përgatitje ushqimore në formë pluhuri, çmimi është 4 Euro/kg duke krijuar një efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit. Nga sektori i vlerës është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 70, pika 3, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 **“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”**. Duke i vlerësuar edhe me një çmim prej 4 E/kg, rezultojnë:

Viti 2017

Dav		Subjekti		Artikulli	Sasi	Dif.VI
R	Dt	Emri	Nipti			
85	1/6	Indrit	J97201203k	Cokollate Bari	1230	45535
1104	2/1	Indrit	J97201203k	Cokollate Bari	2160	39141
3840	4/1	Indrit	J97201203k	Cokollate Bari	3708	78753
Shuma						163428

Artikulli **“Kapucino në Bustino”**, klasifikuar në kodin tarifor me kre *2101* të NKM, për mallra të njëjtë edhe nga i njëjti subjekt rezultojnë të jenë deklaruar me çmime të ndryshëm nga 5E/kg deri 8.5 E/kg dhe dukshëm më ulët se vlera e të dhënave të disponueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se për artikullin kapuçino me origjinë EU çmimi është 10–10.5 Euro/kg duke krijuar një efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit. Nga sektori i vlerës është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit 70, pika 3, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 **“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”**. Duke i vlerësuar edhe me një çmim prej 10 E/kg, rezultojnë:

Viti 2017

Dav		Subjekt		Artikulli	Sasi	Dif.VI
R	Dt	Emri	Nipti			
85	1/6	Indrit	J97201203K	Kapucino Ne Bustina	1206	141072
1104	2/1	Indrit	J97201203K	Kapucino Ne Bustina	60	7075
2780	3/9	Indrit	J97201203K	Kapucino Ne Bustina	415.8	32095
2780	3/9	Indrit	J97201203K	Kapucino Ne Bustina	180	24314
3840	4/1	Indrit	J97201203K	Kapucino Ne Bustina	294	22693
6557	6/6	Indrit	J97201203K	Kapucino Ne Bustina	1129	86569
7203	6/17	Indrit	J97201203K	Kapucino Ne Bustina	240	23134
Shuma						336953

Në analizë të fakteve dhe hapave të ndjekura nga personeli përpunues doganor vërehet gjithashtu se nuk është kërkuar verifikimi i faturave të mallit për praktikën e mësipërme në



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

juridiksion auditimi dhe të konstatuara në ProjektRaportin e Auditimit ku vërehet dukshëm se **çmimi i deklaruar dhe i pranuar është më i ulët se çmimi i publikuar i të dhënave të disponueshme** për artikujt që janë prekur gjatë fazës së auditimit. Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës **“Cokollate për Bare” dhe “Kapucino në Bustina”**. Në vijim të kërkohet ndjekja e arkëtimit të detyrimeve doganore të rekomanduara **në shumën 500,381 lekë** në këtë raport përfundimtar auditimi menjëherë si dhe në vijim të procedurave verifikuese që mund të kryhen për verifikimin e të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë importuese dhe kompanive lëvruese të garantohej borxhi doganor për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane për deklarime doganore të periudhës të cituara sa më sipërbazuar në Ligjin nr.8555, datë 22.12.1999 **“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë”** sipas nenit 1 deri 23 të këtij ligjiduke kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave edhe **“verifikimin e plotë dhe të garantuar të klasifikimit tarifor të këtyre mallrave dhe vlerave të transaktuara sipas deklarimeve nga prodhuesi direkt dhe eksportuesi ose lëvruesi i mallit”** për praktika të konstatuara sa më sipër në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 8555, datë 22.12.1999 **“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë** ku përcaktohet se **“informacioni do të jetë veçanërisht i tillë që të lehtësojë përcaktimin e vlerës së taksueshme, klasifikimin tarifor dhe origjinën e mallrave”**

◆-Artikulli **“Letër tualeti,Shami letre,Letër gazhine“**, klasifikuar në kodin tarifor me kreun***4818*** të NKM, për mallra të njëjtë edhe nga i njëjti subjekt dhe nga subjekte të ndryshëm rezulton të jenë deklaruar me çmime të ndryshëm si : Letër tualeti nga 1.2-1.5 E/kg, Shami letre nga 1.4-1.6 E/kg, Letër guzhine nga 1-1.5 E/kgdhe dukshëm më ulët se vlera e të dhënave të disponueshme në territorin e Republikës së Shqipërisëku përcaktohetse për artikujt me origjinë EU çmimi është :Letër tualeti nga 1.7-1.72E/kg, Shami letre nga 1.9-1.92 E/kg, Letër guzhine nga 1.75-1.76 E/kg duke krijuar një efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit. Nga sektori i vlerës është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit nenit 70, pika 3, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 **“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë**.Duke i vlerësuar çmimin minimal sipas llojit, rezulton:

Viii 2017

Dav		Subjekt		Artikulli	Sasi	Dif.VI
R	Dt	Emri	NIPT			
315	1/14	Rosiva	J97426224C	Leter Kuzhine	1149	11539
452	1/18	Rosiva	J97426224C	Shami Letre	800	4968
1385	2/7	Rosiva	J97426224C	Shami Letre	520	4168
2249	2/26	Rosiva	J97426224C	Shami Letre	1310	18118
3398	3/24	Rosiva	J97426224C	Leter Kuzhine	649	6107
4029	4/6	Rosiva	J97426224C	Leter Tualeti	1950	21645
4029	4/6	Rosiva	J97426224C	Leter Kuzhine	384	7350
6270	5/30	Rosiva	J97426224C	Leter Kuzhine	1208	9777
6320	5/31	Rosiva	J97426224C	Leter Kuzhine	615	5570
7092	6/16	Rosiva	J97426224C	Leter Kuzhine	1121	10502
7782	6/30	Rosiva	J97426224C	Leter Tualeti	2620	20987
8083	7/7	Rosiva	J97426224C	Leter Tualeti	1420	12463
8343	7/12	Rosiva	J97426224C	Leter Kuzhine	620	7430
8799	7/21	Rosiva	J97426224C	Shami Letre	680	6767
6642	6/8	Juri	K06705213T	Shami Letre	358	4899
8671	7/19	Agim Osmani	K77217203U	Leter Kuzhine	1102	8579
11047	9/16	Kallarati	L16703201L	Shami Letre	478.2	5927
1312	2/5	Marsel Gjeka	L56328203G	Leter Tualeti	1340	8787
89	1/6	Vlora Ipercash	L57024202R	Leter Tualeti	1238	13364
89	1/6	Vlora Ipercash	L57024202R	Leter Kuzhine	1613	21341
3857	4/1	Vlora Ipercash	L57024202R	Leter Kuzhine	1307	16335

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT****Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”**

6840	6/10	Vlora Ipercash	L57024202R	Leter Tualeti	2630	30279
10776	9/11	Vlora Ipercash	L57024202R	Leter Tualeti	1020	12507
10776	9/11	Vlora Ipercash	L57024202R	Leter Kuzhine	420	5087
Shuma						422,581

Në analizë të fakteve dhe hapave të ndjekura nga personeli përpunues doganor vërehet se nuk është kërkuar verifikimi i faturave të mallit për praktikën e mësipërme në juridiksionin auditimi dhe të konstatuara në ProjektRaportin e Auditimit ku vërehet dukshëm se **“çmimi i deklaruar dhe i pranuar është më i ulët se çmimi i publikuar i të dhënave të disponueshme”** për artikujt që janë prekur gjatë fazës së auditimit. Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të importuara nga kompanitë e cituara të natyrës **“letër guzhine, shami letre”** për praktika deklaruese nën juridiksionin auditimi (2015-2017). Rezultojnë verifikime doganore të mëparshme **“por që nuk lidhen në kohe dhe hapësirë me deklaratimet dhe numrat konkretë të praktikave dhe importeve të konstatuara nën juridiksionin auditimi për vitin 2017”**. Në vijim të kërkohet ndjekja e arkëtimit të detyrimeve doganore të rekomanduara **në shumën 422,581 lekë** në këtë raport përfundimtar auditimi menjëherë si dhe në vijim të procedurave verifikuese që mund të kryhen për verifikimin e të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë importuese dhe kompanive lëvruese të garantohet borxhi doganor për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane për deklarime doganore të periudhës të cituara sa më sipërbazuar në Ligjin nr.8555, datë 22.12.1999 **“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë”** sipas nenit 1 deri 23 të këtij ligji. Dega Doganore Vlorë të kërkojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave edhe **“verifikimin e plotë dhe të garantuar të klasifikimit tarifor të këtyre mallrave dhe vlerave të transaktuara sipas deklaratimeve nga prodhuesi direkt dhe eksportuesi ose lëvruesi i mallit”** për praktika të konstatuara sa më sipër në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 8555, datë 22.12.1999 **“Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë”** ku përcaktohet se **“informacioni do të jetë veçanërisht i tillë që të lehtësojë përcaktimin e vlerës së taksueshme, klasifikimit tarifor dhe origjinën e mallrave”**

◆- Artikulli **“Rakorderi plastike ,tubo për ujë të pijshëm e shkarkime”**, klasifikuar në kodin tarifor me kre *3917* të NKM të cilët i përkasin subjektit **“Kanina 2000”** për mallra të njëjtë edhe nga i njëjti subjekt rezultojnë të jenë deklaruar me çmime të ndryshme ;për rakorderi plastike nga 1.4 E/kg deri 2.1 E/kg dhe për tubot plastike nga 0.7 E/kg deri 1.4 E/kg ,dukshëm më ulët se vlera e të dhënave të disponueshme në territorin e Republikës së Shqipërisëku përcaktohet se për mallrat me origjinë EU se çmimi është për rakorderitë plastike 2.3 Euro/kg , për tubot për ujë të pijshëm 1.8 E/kg dhe për tubot e shkarkimit 1.75 E/kg, duke krijuar një efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit. Nga sektori i vlerës është vepruar jo në përputhje me kërkesat e nenit nenit 70, pika 3, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 **“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.Duke i vlerësuar me çmimet sipas të dhënave të disponueshme, rezultojnë: Viti 2017**

DAV	Subjekt		Artikull	SASI	DIF.VL	
9392	8/2	Kanina 2000	K07303202H	Rakorderi Plastike	5310	20060
6261	5/29	Kanina 2000	K07303202H	Rakorderi Plastike	3520	49567
8858	7/22	Kanina 2000	K07303202H	Rakorderi Plastike	4260	103929
7093	6/16	Kanina 2000	K07303202H	Rakorderi Plastike	5830	143948
6262	5/29	Kanina 2000	K07303202H	Rakorderi Plastike	6130	152303
2769	3/9	Kanina 2000	K07303202H	Rakorderi Plastike	6680	166030
11484	9/26	Kanina 2000	K07303202H	Rakorderi Plastike	7780	184852
8857	7/22	Kanina 2000	K07303202H	Tubo Për Ujë Të Pijsh.	3344	3890
8081	7/7	Kanina 2000	K07303202H	Tubo Per Shkark.Hidr.	7955	78018
4025	4/6	Kanina 2000	K07303202H	Tubo Per Ujë Të Pijsh.	9150	104623
9392	8/2	Kanina 2000	K07303202H	Tubo Per Shkark.Hidr.	14850	244228
1135	2/2	Kanina 2000	K07303202H	Tubo Për Ujë Të Pijsh.	15100	436506
6261	5/29	Kanina 2000	K07303202H	Tubo Per Ujë Të Pijsh.	9700	136748



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

11483	9/26	Kanina 2000	K07303202H	Tabo Për Shkark.Hidr.	11730	249114
7091	6/16	Kanina 2000	K07303202H	Tabo Për Ujë Të Pjish.	12720	337547
8080	7/7	Kanina 2000	K07303202H	Tabo Për Shkark.Hidr.	12725	374056
2768	3/9	Kanina 2000	K07303202H	Tabo Për Ujë Të Pjish.	13000	316195
4023	4/6	Kanina 2000	K07303202H	Tabo Për Ujë Të Pjish.	15000	453857
						3,555,472

Në analizë të fakteve dhe hapave të ndjekura nga personeli përpunues doganor vërehet se nuk është kërkuar verifikimi i faturave të mallit për praktikatat e mësipërme në juridiksion auditimi dhe të konstatuara në ProjektRaportin e Auditimit ku vërehet dukshëm se “çmimi i deklaruar dhe i pranuar është më i ulët se çmimi i publikuar i të dhënave të disponueshme” për artikujt që janë prekur gjatë fazës së auditimit. Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të importuara nga kompanitë e cituara të natyrës “*tuba uji, rekorderi plastike*” për praktika deklaruese nën juridiksion auditimi (2015-2017). Rezultojnë verifikime doganore të mëparshme “por që nuk lidhen në kohë dhe hapësirë me deklaratimet dhe numrat konkretë të praktikave dhe importeve të konstatuara nën juridiksion auditimi për vitin 2017”. Në vijim të kërkohet ndjekja e arkëtimit të detyrimeve doganore të rekomanduara në shumën 422,581 lekë në këtë raport përfundimtar auditimi menjëherë si dhe në vijim të procedurave verifikuese që mund të kryhen për verifikimin e të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë importuese dhe kompanive lëvruese të garantohet borxhi doganor për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane për deklarime doganore të periudhës të cituara sa më sipërbazuar në Ligjin nr.8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” sipas nenit 1 deri 23 të këtij ligji

Efekt i Financiar me të ardhura doganore të rekomanduara të munguara në Buxhetin e Shtetit për TVSh për rastet e mësipërme rezulton shumën 4,682,333 lekë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Fatmir Ferati në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë ,
2. Artan Bedini në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë
3. Avni Hysi në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë
5. Andet Hoxha në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë

◆ Në lidhje me rastet ku për kompaninë “Kml” grup shpk me nipt K7160665040 janë konstatuar rivlerësime doganore për artikullin “*tubo plastike per instalime elektrike*” për vitet 2015, 2016 dhe 2017 sipas trajtimeve dhe anekseve pasqyruar në Projektin Raportin e Auditimit nr.1148/8 Prot datë 07.02.2018 dhe protokolluar në Degën Doganore Vlorë me shkresën nr.640 prot D.D.Vlorë datë 09.02.2018 ka ardhë observacioni nr. 1148/52 prot datë 26.03.2018 tonën. Në ankesë nga subjekti nuk pranohet ndërhyrja në vlerën e mallit dhe kërkohet nga Dega doganore Vlorë verifikimi i transaksioneve të kryera nga Italia pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në Projektin Raportin e Auditimit nr.1148/8 Prot datë 07.02.2018 bazuar në ligjin nr. 8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” sipas nenit 1 deri 23 të këtij ligji sipas rasteve të trajtuara. Konstatohet se subjekti KML grup edhe ne procedura eksporti për vitet 2016 dhe 2017 ka nxjerrë nga territori doganor shqiptar të njëjtat vlera të faturuara për mallin “tubo plastike për instalime elektrike” në vlerat 0,8 EU/kg deri 0,95 Eu/kg të deklaruar në praktikatat doganore nr. 10949 datë 30/08/2016 dhe nr. 1493 datë 02.09.2017 si ato të konstatuara në procedura importi gjatë periudhës nën juridiksion auditimi. Gjithashtu aktiviteti tregëtar i këtij subjekti në procedura importi është tërësisht i trajtuar sipas kushtit tarifor preferencial MSABE të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit sipas ligjit nr. 9950 të nënshkruar nga vendet anëtare të këtij pakti dhe



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

provohet tërësisht se malli i importuar është me Origjinë Preferenciale Europiane, pra mall i prodhuar në Itali/Europë. Konstatohet se nga Dega Doganore Vlorë janë përcjellë rezultate të verifikimeve doganore të kryera më parë sipas shkresës nr. 23512/2 prot DPD datë 16.10.2015 dhe nr. 4986 prot DDVlorë datë 30.10.2015 ku ka rezultuar se nga investigimi 10 fatura sipas numrave respektive të cituara në këtë shkresë për vitet 2014 dhe 2015 janë të rregullta. Merret në konsideratë kërkesa e subjektit shprehur në observacion për verifikim doganor dhe vendosjen në dispozicion të cdo deklaratë ose garancie për verifikime doganore që mund të nevojiten për këto raste të cilat janë konstatuar nga Kontrolli i Larte i Shtetit në Projektraportin e Auditimit, për verifikime doganore pranë kompanive lëvruese ose eksportuese si dhe garantimin për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane Titulli I “*Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara*” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “*Kodi i Ri Doganor në RSH*” i ndryshuar, për deklaratime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017.

◆ Në lidhje me rastet ku kompania “*Food Trading*” me nipt L57222209A ku konstatohen detyrime doganore për tu paguar për deklaratime doganore jashtë kushtit preferencial MSABE nga observacioni i subjektit ardhur me shkresën nr. 1148/50 datë 26.03.2018 prot tonën KLSH ku kërkohet domosdoshmërisht verifikimi i këtij fakti pranë Doganave Italiane në përmbushje të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit sipas ligjit nr. 9950 të nënshkruar nga vendet anëtare të këtij pakti. Nuk pranohen detyrime doganore të rivlerësuar dhe penalitete doganore duke kërkuar nga Dega Doganore Vlorë verifikimin real të vlerave të transaktuara nga furnitori në Itali, si dhe nuk pranohet ndërhyrja mbi cmimin realisht të paguar. Gjithashtu vendosin në dispozicion cdo deklaratë ose garanci për verifikime doganore që mund të nevojiten për këto raste të cilat janë konstatuar nga Kontrolli i Larte i Shtetit. Merret në konsideratë observacioni i bërë në lidhje me metodikën e verifikimit doganor që kërkohet dhe konstatohet se janë nxjerrë me detyrime doganore të rillogaritura për deklaratime jashtë kushtit preferencial MSABE për të cilat ankuesi kërkon domosdoshmërisht verifikimin e këtij fakti pranë Doganave Italiane në përmbushje të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit sipas ligjit 9950 të nënshkruar nga vendet anëtare të këtij pakti. Legjislacioni doganor sipas Pikës 2 e nenit 32 të Marrëveshjes Stabilizim Asocimit “*Bashkëpunimi i ndërsjelltë*”, Komuniteti dhe Shqipëria duhet të ndihmojnë, në kontrollin e origjinalitetit të certifikatave EUR. 1 ose të deklaratave faturë si dhe korrektësinë e informacionit të dhenë dhe pikave 1, 2, 3, 4 5 dhe 6 të nenit 33 “*Verifikimi i Dëshimve të Origjinës*” të dëshimve të origjinës “*Deklarata Faturë*” nga autoritetet e vendit eksportues me qëllim provimin e vërtetësisë së origjinës së mallrave të lëvruara. Gjithashtu nga Dega Doganore Vlorë të kryhet dhe garantimi i menjëhershëm i borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të Deklaratave Faturë të kryera midis kompanive importuese dhe kompanive lëvruese ose eksportuese për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “*Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara*” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “*Kodi i Ri Doganor në RSH*” i ndryshuar, për deklaratime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017 deri në përfundim të hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare për detyrime doganore për praktikën e rekomanduara për këtë subjekt për detyrime doganore në shumën 251,899 dhe në shumën totale 503,798 lekë (gjobë dhe detyrim) trajtuar në ProjektRaportin e Auditimit nr. 1148/8 datë 07.02.2018 dhe protokolluar me shkresën nr. 640 prot DDVlore datë 09.02.2018 dhe më pas gjykimin përfundimtar për aplikimin e



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

sanksioneve administrative si dhe të informohet Kontrolli i Lartë i Shtetit për rezultatet e verifikimit të kryer. Tabela e rasteve për verifikim Doganor dhe ndjekje arkëtimi detyrimi doganor nga Dega Doganore Vlore për kushtin MSABE trajtuar sa më lart dhe sipas trajtimit dhe rekomandimit në pjesën rekomanduese të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi në masën nr. 12

◆ Në lidhje me rastet ku kompania “Euro-Italba” me nipt K97209202U dhe “Adriatik/V” me nipt J874162484 U nga këto dy subjekte ka ardhë observacioni nr. 1148/49 prot datë 26.03.2018 tonën Klsh janë rivlerësuar me detyrime doganore për tu paguar për deklarime doganore jashtë kushtit preferencial MSABE nga observacioni i subjektit verifikimi pranë Doganave Italiane në përmbushje të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit sipas ligjit 9950 të nënshkruar nga vendet anëtare të këtij pakti. Nga subjekti “Euro-Italba” me nipt K97209202U dhe “Adriatik/V” me nipt J874162484 U ka ardhë observacioni nr. 1148/49 prot datë 26.03.2018 tonën Klsh dhe në observacion nuk pranohen detyrime doganore të rivlersuara dhe konstatohen penalitete doganore të cilat kalojnë kufirin proporcional të sanksioneve dhe gjobave doganore nga 3(fish) sipas legjislacionit doganor, deri në 10 fish në raste specifike. Merret në konsideratë kërkesa e subjektit shprehur në observacion për verifikim doganor dhe ndjekje të mëtejshme nga Dega Doganore Vlorë. *Kërkohet nga Dega Doganore Vlorë aplikimin e këtij standardi ligjor deri në provimin e fajësisë duke rikërkuar verifikimin real të vlerave të transaktuara nga furnitori në Itali, si dhe nuk pranohet ndërhyrja mbi cmimin realisht të paguar. Gjithashtu vendosin në dispozicion cdo deklaratë ose garanci për verifikime doganore që mund të nevojiten për këto raste të cilat janë konstatuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.* Konstatohet se janë nxjerrë me detyrime doganore të rilogaritura për deklarime jashtë kushtit preferencial MSABE për të cilat ankuesi kërkon domosdoshmërisht verifikimin e këtij fakti pranë Doganave Italiane në përmbushje të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit sipas ligjit 9950 të nënshkruar nga vendet anëtare të këtij pakti sipas Pikës 2 e nenit 32 të Marrëveshjes Stabilizim Asocimit “*Bashkëpunimi i ndërsjellët*” ku përcaktohet se me qëllim “*aplikimin e duhur të këtij protokollit, Komuniteti dhe Shqipëria duhet të ndihmojnë njëra tjetrën, nëpërmjet administratave doganore kompetente, në kontrollin e origjinalitetit të certifikatave EUR. 1 ose të deklaratave faturë si dhe korrektësinë e informacionit të dhenë dhe pikave 1, 2, 3, 4 5 dhe 6 të nenit 33 “Verifikimi i Dëshimve të Origjinës” të kryhen verifikimet e dëshimve të origjinës “Deklarata Faturë” nga autoritetet e vendit eksportues me qëllim provimin e vërtetësisë së origjinës së mallrave të lëvruara për praktikën e cituara për këtë subjekt në ProjektRaportin e Auditimit nr. 1148/8 datë 07.02.2018 dhe shkresës nr. 640 prot DDVlore datë 09.02.2018*

◆ Në lidhje me detyrimet doganore të llogaritura për artikullin “Letër Guzhine” për të cilin janë kryer verifikime doganore nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe artikullin “letër tualeti guzhine” për të cilin nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është kryer verifikim doganor sipas shkresës nr. 13326/2 prot DPD datë 09.06.2016 ku ka rezultuar se faturat e dërguara për verifikim janë të sakta dhe konform deklaramit. Gjithashtu referuar observacionit artikulli “Paleta” nuk është një mall tregëtar dhe shërben si mjet ndihmës gjatë procesit të ngarkimit të mallit nga furnitori dhe nuk ka vlerë tregëtare, gjithashtu ato janë të përdorura dhe aspak të reja dhe riverësimi i tyre më një vlerë prej 8 Euro/copa është i padrejtë. Këto mallra thjesht shërbejnë për transportin nga Italia drejt Shqipërisë. Dega Doganore Vlorë për subjektin “Euro-Italba” me Nipt K97209292U, në vijim të procedurës rekomanduese të kryejë veprime verifikuese pranë kompanisë së sipërcituar ku ushtrohet ky aktivitet. Merret në konsideratë kërkesa e subjektit shprehur në observacion për verifikim doganor dhe ndjekje të mëtejshme nga Dega Doganore Vlorë të transaksioneve të kryera në zbatim të pikës 2 të Udhëzimit të MF për këtë artikull. Dega Doganore Vlorë të kryejë veprime verifikuese pranë



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

autoriteteve doganore homologe si dhe verifikime nga sektori i kontrollit pas zhdoganimit bazuar në nenin 47, 48 dhe 49 të ligjit nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Neni 49 i Kodit Doganor në RSH sipas ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” përcakton se :”Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën e rieksportit ose në njoftimin rieksportit, si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqërues” si dhe paragrafi nr. 2 “Ato mund të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat në fjalë ose për veprimet tregtare paraprake ose veprimet në vijim që përfshijnë këto mallra. Autoritetet doganore gjithashtu mund të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë”. për praktikën e rekomanduar për këtë subjekt në shumën prej 300,174 lekë në ProjektRaportin e Auditimit nr. 1148/8 datë 07.02.2018,

Në lidhje me detyrimet doganore të llogaritura për artikullin “ace kandexhine dhe doreza plastike” për të cilin janë konstatuar keqklasifikime tarifore të këtyre mallrave në fazën e Projektraportit të Auditimit, sipas kërkesës të shprehur në observacion për verifikim të plotë dhe të garantuar të klasifikimit tarifor të këtyre mallrave sipas deklarimeve nga prodhuesi dhe lëvruesi i mallit në zbatim të Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të Ministrisë të Financave,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”. Merret në konsideratë kërkesa e subjektit shprehur në observacion dhe nga Dega Doganore Vlorë në vijim të procedurës rekomanduese të kryhen veprime verifikuese pranë kompanisë së sipërcituar ku ushtrohet ky aktivitet si dhe të kërkohet ndjekja e kërkimit të arkëtimit të detyrimeve doganore që do të rezultojnë pas procesit të verifikimit doganor që do të gjykohej nga Dega Doganore Vlorë nga sektori i kontrollit pas zhdoganimit në DDVlorë bazuar në nenin 47, 48 dhe 49 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Neni 49 i Kodit Doganor në RSH sipas ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” përcakton se :”Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën e rieksportit ose në njoftimin rieksportit, si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqërues” si dhe paragrafi nr. 2 “Ato mund të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat në fjalë ose për veprimet tregtare paraprake ose veprimet në vijim që përfshijnë këto mallra. Autoritetet doganore gjithashtu mund të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë” për praktikën e rekomanduar për këtë subjekt në shumën 382,416 lekë në ProjektRaportin e Auditimit nr. 1148/8 datë 07.02.2018 dhe shkresës nr. 640 prot DDVlore. Në vijimësi të kërkohet verifikimi i klasifikimit tarifor dalë dhe eksportuar nga prodhuesi i mallit, vlerës realisht të paguar nga Dega Doganore Vlore, për deklarime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017

Në përfundim :

Të Auditimit të pikës 3 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi konstatohet se :

Në analizë të fakteve dhe hapave të ndjekura nga personeli përpunues doganor vërehet se nuk është kërkuar verifikimi i faturave të mallit për praktikën e mësipërme nën juridiksionin auditimi dhe të konstatuara në Projekt Raportin e Auditimit ku vërehet dukshëm se “**çmimi i deklaruar dhe i pranuar është më i ulët se çmimi i publikuar i të dhënave të disponueshme**” për artikujt që janë prekur gjatë fazës së auditimit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Në zbatim të Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të Ministrit të Financave, “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore” konstatohet se :

- Nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk janë kryer veprime në zbatim të pikës 3 të shpjegimeve të Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të Ministrit të Financave, “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore” edhe pas konstatimit të vlerave të deklaruara më të ulëta se ato të krahasuara me të “Dhënat e Disponueshme” të përmendura më sipër, sipër të dukshëm më e ulët praktika e plotë i dërgohet për verifikim Departamentit Operativ Hetimor Drejtorisë së Inteligjencës dhe një kopje njësisë së kontrolleve a posteriori, që janë përgjegjës për verifikimin e plotë brenda dhe jashtë vendit.

(Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor)

- Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit të deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues dhe në zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme) sipas pikës 4 të këtij Udhëzimi

(Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor)

- Vetëm në rastet, kur nuk është e mundur që çmimi i mallit të përcaktohet sipas procedurave të përcaktuara më sipër bazuar në nenet 34, 35 të Kodit Doganor, si bazë vlerësimi mund të përdoret “Dosja e Të Dhënave të Disponueshme” sipas pikës 5 të këtij Udhëzimi

(Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor)

Nuk rezultojnë verifikime doganore pranë selive të kompanive levruese për mallra të importuara nga kompanitë e cituara për praktika deklaruese nën juridiksion auditimi (2015-2017) të cituara sa më sipër dhe metoda alternative vlerësimi, bazuar në nenin 35 dhe 36 të Kodit Doganor të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 69-70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH”

- Rezultojnë verifikime doganore të mëparshme “por që nuk lidhen në kohe dhe hapësirë me deklarimet dhe numrat konkretë të praktikave dhe importeve të konstatuara nën juridiksion auditimi”
- Në vijim të kërkohet ndjekja e arkëtimit të detyrimeve doganore të rekomanduara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi bazuar në shpjegimet dhe përcaktimet e pikës 3, 4 dhe 5 të shpjegimeve të Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të Ministrit të Financave, “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore” si dhe në vijim të procedurave verifikuese që mund të kryhen për verifikimin e të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë importuese dhe kompanive levruese të garantohet borxhi doganor për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane bazuar në përcaktimet e Titullit “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar,
- Për deklarime doganore të periudhës të cituara sa më sipër bazuar në Ligjin nr. 8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë” sipas nenit 1 deri 23 të këtij ligji. Dega Doganore Vlorë të kërkojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

edhe “*verifikimin e plotë dhe të garantuar të klasifikimit tarifor të këtyre mallrave dhe vlerave të transaktuara sipas deklarimeve nga prodhuesi direkt dhe eksportuesi ose lëvruesi i mallit*” për praktika të konstatuara sa më sipër në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 8555, datë 22.12.1999 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë ku përcaktohet se “informacioni do të jetë veçanërisht i tillë që të lehtësojë përcaktimin e vlerës së taksueshme, klasifikimin tarifor dhe origjinën e mallrave”

Sqarime Observacione

Për sa më sipër është mbajtur Projekt Raporti i Auditimit nr.1148/8 Prot datë 07.02.2018 dhe protokolluar në Degën Doganore Vlorë me shkresën nr.640 prot D.D.Vlorë datë 09.02.2018 dhe për këtë rast subjekti i audituar Dega Doganore Vlorë me shkresën nr.1138/32 prot datë 09.03.2018 dhe shkresën nr.1116 prot D.D.Vlorë datë 08.03.2018 ka bërë komente dhe shpjegime nisur specifikisht edhe nga observacionet e subjekteve të prekura si palë e interesuar si më poshtë vijon,

Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH

Konkretisht u shqyrtuan obserbacionet e subjekteve :Subjekti “Myftari shpk” meNIPT K06429228Q, sipas shkresës nr.1016 prot DD Vlorë datë 05.03.2018 dhe shkresës nr.1148/23 prot datë 06.03.2018, të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .Subjekti “Neë Alba Trade” shpk meNIPT L36303202J sipas shkresës nr.1024 prot DPD datë 05.03.2018 dhe shkresës nr.1148/27 prot datë 07.03.2018 të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .Subjekti “Kola B” meNIPT K61517029Usipas shkresës nr.1148/28 prot tonën KLSH datë 07.03.2018 të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .

Subjekti “Andi Gjoka” meNIPT K94203201A sipas shkresës nr.1148/34 prot datë 09.03.2018 tonën KLSH të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .Subjekti “ChipStar” shpk meNIPT K06605218K sipas shkresës nr.1148/33 prot tonën KLSH datë 09.03.2018 dhe shkresës nr.1097 prot DD VLORE datë 07.03.2018 të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .

Subjekti “Ilijarjan Mucaj” meNIPT L63412402U sipas shkresës nr.1073 prot DD Vlorë datë 07.03.2018 të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë . Subjekti “Mazniku Frut 15” shpk meNIPT L52310007U sipas shkresës nr.1074 datë 07.03.2018 të Degës Doganore Vlorë të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Subjekti “Geri” shpk meNIPT K113100001L sipas shkresës nr.1075 datë 07.03.2018 të Degës Doganore Vlorë të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .Subjekti “Blu Star” shpk meNIPT K36309201H sipas shkresës nr.1056 datë 06.03.2018 të Degës Doganore Vlorë të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .Subjekti “Serma” meNIPT J66703222N, sipas shkresës nr.1017 prot DD Vlorë datë 05.03.2018 dhe shkresës nr.1148/9 prot datë 20.02.2018 dhe u arrit në konkluzionin që për këtë subjekt të merret në konsideratë dhe të reflektohet në raportin përfundimtar të audirtimit në vijim të veprimeve procedurale të kryera nga Dega Doganore Vlorë sipas shkresës nr.699 date 13.12.2019. Subjekti “Kem Color” meNIPT K86322201I, sipas shkresës nr.932 prot DD Vlorë datë 26.02.2018 dhe shkresës nr.1148/10 prot datë 22.02.2018 dhe u arrit në konkluzionin që për këtë subjekt të merret në konsideratë dhe të reflektohet në raportin përfundimtar të audirtimit

Subjekti “Alfred Shaska” meNIPT K 86723204D, sipas shkresës nr.1148/19 prot DD Vlorë datë 05.03.2018 të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .

Subjektit “Vlora Iper Cash Shpk” me NIPT L5702402R sipas shkresës nr.1148/45 prot tonën KLSH dhe shkresës nr.1226 prot D.D.Vlorë datë 13.03.2018 të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë Subjektit “Reald” meNIPT J97426208U sipas shkresës përcjellëse nr.1148/43 prot tonën KLSH dhe shkresës nr.58 prot D.D.Vlorë datë 12.03.2018 të përmendura në këtë material sqarojmë se kjo problematikë merret në konsideratë dhe do të lihet si masë rekomanduese organizative me qëllime verifikimi nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë .

Në vijim të problematikës së mësipërme konstatohet se këto transporte malli janë kryer kryesisht me destinacion Italinë dhe Greqinë dhe janë kryer kryesisht nga kompani shqiptare me seli të rregjistruara në territorin doganor shqiptar dhe si dokument transporti kanë shërbyer fatura tatimore shqiptare për transport ndërkombëtar të lëshuar nga këto kompani. Nga personeli përpunues doganor është administruar vetëm dokumentacioni tregëtar që lidhet me itinerarin mbërritës dhe nuk është kërkuar dokumentacion shtesë për të justifikuar edhe pjesën e itinerarit nisës do të lihet rekomandim që në vijim nga Dega Doganore Vlorë gjatë procesit të vlerësimit doganorëshpenzimeve të transportit të mallrave që importohen, të marrë në konsideratë të plotë përcaktimet e nenit 67 të ligjitnr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” ku përcaktohet seçmimit realisht të paguari duhen shtuar pika (i) “shpenzimet e transportit e të sigurimit për mallrat e importuara” dhe (ii) “shpenzimet e ngarkimit e të trajtimit që lidhen me transportin e mallrave të importuara, deri në vendin e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe pika 2 e nenit 67 të Kodit Doganor përcakton se “Shtesat në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar, sipas këtij neni, bëhen vetëm në bazë të të dhënave objektive e të llogaritshme”. Për rastet kur vlera e këtyre shpenzimeve është nën kufijtë e lejuar sipas të Dosjes së të Dhënave të Disponueshme kur në praktikën doganore rezultojnë të dokumentuara vetëm shpenzimet e transportit të mbërritjes nga vendet lëvruese, nga personeli përpunues doganor të kërkohet



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

dokumentacion shtesë për shpenzimet e transportit të kryera në nisje nga shoqëritë transportuese si dhe të kryhen dhe të kërkohen verifikime periodike pranë Drejtorive Rajonale Tatimore në lidhje me vlerat dhe vërtetësitë e dokumenteve të transportit të shprehura si shërbime të kryera nga shoqëritë e transportit sipas faturave tatimore respektive -Subjektit “Bello Tris Shpk” meNIPT K67220202D sipas shkresës nr.1072 prot D.D.Vlorë datë 07.03.2018 dhe shkresës nr.1148/35 prot tonën KLSH datë 12.03.2018 subjekti “Alb-Adriatico” meNIPT L36618201Q sipas shkresës nr.1077 prot D.D.VLORË , subjekti “Vangjeli 2002” meNIPT K36716202Q dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura të mos merren në konsideratë dhe mostë reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit. Gjithashtu nga Dega Doganore Vlorë të kryhen verifikime për këtë rast në lidhje me pagesat bankare të kryera pranë kompanive transportuese që lidhen me praktikat objekt konstatimi nga grupi auditues

*Subjektit “L. Haxhijosifi” me NIPT L47201206I me adresë rruga Gjergj Kastrioti/Vlorë sipas shkresës nr.1071 prot D.D.Vlorë datë 07.03.2018 dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura të merren tërësisht në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit pasi referuar deklaratës doganore të Exportit të Doganës Italiane kodi deklarues është *85182995*, dhe nuk provohet që malli i deklaruar është altoparlant i gatshëm dhe i përfunduar, ose boks muzikor dhe klasifikimi në kreun 6 shifror *851829* është një deklarim i referuar edhe nga kompania shitëse ose lëvruese me seli në Itali në zonën e Komunitetit European me një sitëeb dhe seli të verifikueshme edhe në rrjetet ëeb. Subjektit “Kml” grup shpk me nipt K716066504O ka ardhë observacioni nr. 1148/52 prot datë 26.03.2018 tonën Klsh, ku u trajtuan faktet dhe kërkesat e paraqitur si dhe verifikimet doganore të kryera më parë të cilat u pranuan dhe u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit. Subjektit “Euro-Italba” me nipt K97209202U dhe “Adriatik/V” me nipt J874162484 U nga këto dy subjekte ka ardhë observacioni nr. 1148/49 prot datë 26.03.2018 tonën Klsh 4, ku u trajtuan faktet dhe kërkesat e paraqitur si dhe verifikimet doganore të kryera më parë të cilat u pranuan dhe u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit. Subjektit “Food Trading” me nipt L57222209A ardhur me shkresën nr. 1148/50 datë 26.03.2018 prot tonën KLSH, ku u trajtuan faktet dhe kërkesat e paraqitur si dhe verifikimet doganore pranë autoriteteve doganore për verifikimin e kushtit preferencial MSABE dhe u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit.*

Subjektit “K. Sinanaj” meNIPT J66903222T me adresë rruga Lagjia 24 Maji/Vlorë sipas shkresës nr.1121 prot D.D.Vlorë datë 09.03.2018 pas verifikimeve dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura të merren tërësisht në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit. Subjektit “Paper Orvi” meNIPT K97005201J sipas shkresës nr.1148/2 prot tonën KLSH datë 15.03.2018 ku pas verifikimeve në sistemin Asycuda Ëord u rikonstatua se nga personeli përpunues doganor është ndërhyrë në vlerën e mallit duke e rivlerësuar me një koeficient prej 1,533 herë më tepër se vlera e deklaruar nga subjekti, bazuar në metodat alternative sipas nenit 35 të Kodit Doganor shoqëruar kjo edhe me shënimin në “Aktin e Kontrollit” bashkangjitur praktikës doganore nga doganieri përpunues. Në përfundim merret në konsideratë kërkesa e subjektit dhe u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit

Subjektit “Juri SHPK” meNIPT K06705213T me adresë rruga Lagjia Rilindja Rr/Transballkanike Vlorë sipas shkresës nr.1148/37 prot D.D.Vlorë datë 12.03.2018 pas shqyrtimit të fakteve dhe riverifikimit në të dhënat e marra nga sistemi Asicuda Ëord për periudhën 2015-2017 për këtë subjekt si dhe shqyrtimit të dokumentacionit shoqëruar konstatohet se importet janë kryer nga kompania “Ingross Levante Spa 70066 Molfeta Bari/Itali” dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura të merren në



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

konsideratë pasi konstatimi i rivlerësimit doganor në shumën 48,000 lekë për artikujt konserva peshku dhe letër higjienike nuk është i plotë dhe i bazuar në metodologjinë e vlerësimit doganor të ndjekur nga Dega Doganore Vlorë dhe njëkohësisht nga administrata doganore për të gjitha artikujt e deklaruar në deklaratat e përmendura në ankesë është pranuar metoda e transaksionit për të gjitha mallrat e përfshira në deklaratimet e subjektit.

Subjektit “Harillaq Neco” me NIPT K36330207E sipas shkresës nr.1148/26 prot D.D.Vlorë datë 07.03.2018 dhe shkresës nr.1011 prot D.D.Vlorë datë 05.03.2018 dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura nuk përbëjnë prova të reja për tu rimarë në konsideratë dhe nuk u reflektuan në raportin përfundimtar të auditimit.

Në lidhje me observacionin e ardhur me shkresën nr.1110 prot D.D.Vlorë datë 08.03.2018 në ngarkim të subjektit “Liljana Saliq” person fizik për vjeljen e detyrimit doganor në shumën 14,000 lekë grupi i auditimit pasi rishqyrtoi dokumentacionin arriti në konkluzionin që të merret në konsideratë dhe të reflektohet në raportin përfundimtar të auditimit

Në lidhje me observacionin e ardhur nga subjekti i audituar Dega Doganore Vlorë me shkresën nr.1138/32 prot datë 09.03.2018 dhe shkresën nr.1116 prot datë 08.03.2018 u analizua pjesa e observacionit të kryer nga Zyra Operacionale Doganore dhe konkretisht -Për artikujt “Veshje Trupi” që lidhen me indikatorin e vlerësimit prej 1350 lekë/kg sipas kushtit të lëvrimit CIF grupi i auditimit pasi shqyrtoi materialin observues arriti në konkluzionin që nuk ka prova dhe fakte të reja për tu marrë në konsideratë.

*-Në lidhje me subjektin ubjektit “Neco” meNIPT K36330207E i cili ka observuar për artikullin “lule të freskëta“, klasifikuar në kodin tarifor dhe kreun *0603* të NKM, konstatohet se për mallra të njëjtë edhe nga i njejti subjekt dhe nga subjekte të ndryshëm rezulton të jenë deklaruar me çmime të ndryshëm nga 0.05 E/copë deri 0.32 E/copë dhe dukshëm më ulët se vlera e të dhënave të disponueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shpjegimi i Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”, si dhe shpjegimet e nenit 35 të ligjit nr.8449, datë. 27.01.1999,“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” nenit 54, titulli VI “Vlera Doganore” pika c, e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar,. Neni 64 pika 1,b e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Pikës 4 e Sioni I të Udhëzimit nr.25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore”.që trajtohen me legjislacionin e vjetër doganor dhe sipas nenit 70 pika 1 dhe 2 Ligji nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” që lidhet me “Metodën dytësore për vlerësimin doganor”. Dega Doganore Vlorë mbi bazën e transaksioneve alternative të pranuar për vitin 2015, 2016 për artikullin “lule të freskëta” të nxjerrë dhe kontabilizojë detyrimet doganore të munguara të pasqyruara sa më poshtë:Pika 4 e Sioni I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore” përcakton se “Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit e deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). Kjo e bazuar në të dhënat e transaksioneve të pranuar. Këto të dhëna janë të disponueshme edhe në formë elektronike, përmes moduleve të veçanta të ndërtuara për këtë qëllim në nivel qendror”.*

-Në lidhje me subjektin “Aza Elektroshtëpiake” me NIPT K17217201E i cili ka dërguar ankesën sipas shkresës nr.1148/18 prot tonën KLSH datë 05.03.2018, dhe shkresës nr.972 prot D.D.Vlorë datë 28.02.2018 si dhe shqyrtimit të observacionit të bere nga personeli përpunues doganor ku deklarohet se vlerësimi doganor i artikujve elektroshtëpiakë është një



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

proces i vështirë, i diskutueshëm për shkak të natyrës së mallit, rolit që luan marka e mallit, cilësia e mallit, kostot shtesë, zhvlerësimi i shpejtë që ndodh, publiciteti ose reputacioni i markës. Në lidhje me problematikën e azhurnimit të çmimit të të dhënave referuese për artikujt elektroshtëpiakë sqarojmë se ky është një problem ekskluziv i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Komisionit AD-HOC pranë Ministrisë së Financave.

Gjithashtu Udhëzimi i cituar për vlerësimin doganor të mallrave elektroshtëpiake i dalë në nëntor 2017 është jashtë afateve juridiksionalë të periudhës së audituar e cila përfshin periudhën nga data 01.01.2015-01.10.2017.

Merret në konsideratë fakti i publikimit të çmimeve publike nga kjo kompani por varieteti i artijve është tepër i madh dhe juridiksioni lëndor i programi të auditimit janë procedurat e vlerësimit doganor të ndjekura nga Degës Doganore Vlorë ,

Nga shqyrtimi i importeve të kryera nga subjekti Aza elektroshtëpiake me NIPT K17217201E në sistemin “Asicudaëord” konstatohet se ka diferencë të dukshme në vlera më të larta në lidhje me subjektet e tjerë tregëtarë që operojnë në këtë fushë dhe gjithashtu administrohen nga Dega Doganore Vlorë edhe përgjigjet e verifikimit të faturave nga Bullgaria dhe Italia sipas shkresave nr.363 prot datë 27.01.2017 për 2 fatura të vitit 2013 për televizorë “Hair 22” ardhur nga Italia, shkresa nr.1764 prot datë 29.04.2016 për 18 fatura malli që i përkasin 6 praktikave doganore të vitit 2013 dhe 2014 për mallra “Frigoriferë”, ardhur nga Bullgaria, shkresa nr.3032 datë 19.07.2016 për 1 faturë malli për mallra “fshesa me korent” ardhur nga Italia, shkresa nr.1765 prot datë 29.04.2016 për mallra frigoriferë për fatura të vitit 2013 ardhur nga Italia të konfirmuara nga protokollin e Degës Doganore Vlorë për të cilat ka rezultuar se faturat janë të rregullta dhe autentike. Në vijim të argumenteve të mësipërm sipas konstatimeve të shprehura sa më sipër edhe në Projekt Raportin e Auditimit është konstatuar moszbatimi i hapave proceduralë në zbatim të Udhëzimit nr.25 për praktikën doganore të shqyrtuara nën juridiksionin e auditimit (viti 2015, 2016 dhe 2017) për pikat e indikatorëve të cituara dhe të renditura sipas pikave 2.1, 2.2, 2.3, 2.6, 2.8, 2.9, 2.11, 2.12, 2.15, 2.22, 2.24 të Pikës së 2 Të Udhëzimit të Ministrisë së Financave.

Pikë 3. Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm kur vlera e deklaruar krahasuar me të “Dhënat e Disponueshme” të përmendura më sipër është dukshëm më e ulët praktika e plotë i dërgohet për verifikim Departamentit Operativ Hetimor, Drejtorisë së Inteligjencies (Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor)

4. Nëse nga analiza e indikatorëve të mësipërm, nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit të deklaruar, pra është e dyshuar, njoftohet me shkrim deklaruesi (agjencia doganore ose përfaqësuesi) në rast se kërkohet nga subjekti deklarues dhe në zbatim të nenit 35 të Kodit Doganor, mund të përdoren metoda alternative të vlerësimit të mallrave (mallra identike/të ngjashme). (Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor)

5. Vetëm në rastet, kur nuk është e mundur që çmimi i mallit të përcaktohet sipas procedurave të përcaktuara më sipër bazuar në nenet 34, 35 të Kodit Doganor, si bazë vlerësimi mund të përdoret “Dosja e Të Dhënave të Disponueshme”(Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor)

6. Përcaktimi i vlerës së mallit bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar me shenjë “X” (Procedurë e pakërkuar dhe e pakryer nga personeli përpunues doganor). Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës “elektroshtëpiake” të deklaruar jashtë kushtit preferencial MSABE (origjinë NEU) për kompanitë eksportuese sa më poshtë vijon: "DistanteEletrrodomeestici Srl72023 Mesagne



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Br/Itali", "Go.Var Srl22100 Comoitali" "Hisense Italia Srl201256 Milano Itali" "S.I.El Srl13012 Prarola Vcitali" "Sgm Distribuzione Spa Via Schiparelli Nr 3147122 Forli Itali" "Trevi Spa 47924 Rimini Rnitali", "Tëenty Srl20126 Milano Itali", "Unieuro Spa47122 Forlitali", "Consumer Eletronics Spa Piazza G.Ferre 1020025 Legnamo Milano Itali" në praktikat doganore nën juridiksion auditimi (2015-2017) si dhe njëkohësisht garantimi në përputhje me legjislacionin doganor për pjesën e borxhit që mund të lindë nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” për praktika të cituara në Projekt Raportin e Auditimit. Në këto kushte nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për subjektin “Aza Elektroshtepiake” dhe për subjekte të tjerë për të cilët rezultojnë verifikime doganore të mëparshme por që nuk lidhen në kohe dhe hapësirë me deklaratimet dhe numrat konkretë të praktikave dhe importeve të konstatuara nën juridiksion auditimi (2015-2017) të kërkohet ndjekja e arkëtimit të detyrimeve doganore të rekomanduara në këtë raport përfundimtar auditimit në vazhdimësi si dhe të kërkohet garantimi i menjëhershëm i borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanive importuese dhe kompanive lëvruese ose eksportuese për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, për deklarime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017 deri në përfundim të hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Në Lidhje Me Observacionin e Ardhur nga Dega Doganore Vlorë sipas Shkresës Nr.1148/22 Prot Datë 05.03.2018 dhe shkresës Nr.1116 Prot D.D.Vlorë Datë 08.03.2018 grupi i auditimit mori në shqyrtim materialet e parqitura që u përkasin verifikimeve doganore të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe të rezultuara të rregullta që u përkasin praktikave doganore të vitit 2013, 2014 dhe 2015 dhe 2016 të dokumentuara me shkresat bashkangjitur këtij materiali. Në analizë të fakteve dhe hapave të ndjekura nga personeli përpunues doganor vërehet se nuk është kërkuar verifikimi i faturave të mallit për praktikat në juridiksion auditimi dhe të konstatuara në ProjektRaportin e Auditimit ku vërehet dukshëm se cmimi i deklaruar dhe i pranuar është më i ulët se cmimi i publikuar i të dhenave të diponueshme për artikujt që janë prekur gjatë fazës së auditimit. Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës “materiale plastike, mallra ushqimorë, elektroshtepiake, shampoo, letër tualeti, material elektrikë plastikë, lastra graniti, rakorderi plastike, detergjentë” për praktikat doganore nën juridiksion auditimi (2015-2017) si dhe garantimi në përputhje me legjislacionin doganor për pjesën e borxhit që mund të lindë nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe Italisë bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

doganor me detyrime të importit të pezulluara” për praktika të cituara në Projektraportin e Auditimit.

Për sa më sipër në lidhje me faktet e paraqitura në Akt Konstatimin nr.3, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, dhe konkretisht me shkresën nr.1148/44 prot., datë 15.03.2018 (KLSH), me dokumentacionin bashkëlidhur, nr.1225 prot., datë 13.03.2018, ku citohet se: “...Blerjet janë të faturuara të pavarura nga njëra tjetra...dhe se...bashkëlidhur keni dokumentacioni që vërtetojnë provat e mallrave më origjinë preferenciale”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Osmëni, (dhe shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur), sqarojmë se pretendimet e mësipërme merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa më sipër në lidhje me faktet e paraqitura nr. 3, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, dhe konkretisht me shkresën nr.1148/40 prot., datë 12.03.2018 (KLSH), me dokumentacionin bashkëlidhur, nr.8 prot., datë 12.03.2018, ku citohet se: “...Baza Kryesore për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave është vlera e transaksionit, që është çmimi i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të RSH...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Haskaj, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi për artikullin “Caj kamomili dhe Caj jeshil në bustina”, referuar deklaramëve në degët e tjera doganore të subjekteve të tjerë por edhe i Juaji në degën ku Ju operoni me deklaramet e artikullit, (citojmë DAV me R-5483, datë 24.04.2015, R-6315, datë 09.05.2015 etj.), nga sektori i vlerës, artikulli është rivlerësuar me 18 euro/kg, ndërsa lidhur me artikullin kafe në konfeksione tabletë nga ana jonë është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në materialet e auditimit;

Për sa më sipër në lidhje me faktet e paraqitura nr.3, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, dhe konkretisht me shkresën nr.1148/38 prot., datë 12.03.2018 (KLSH), me dokumentacionin bashkëlidhur, nr.1030 prot., datë 08.03.2018, ku citohet se: “...Në Projekt Raport për këtë deklaratë doganore është shënuar se nuk është paguar taksa e ambalazhit”, që unë nuk kam lidhje fare me ambalazhin plastik...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

*Në lidhje me komentet e bëra nga z. Miftaraj, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë për DAV me R-246, datë 12.01.2017 dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi nga auditimi është konstatuar se artikulli 8 “Televizor LCD” është deklaruar në kodin tarifor *85285291* me nivel të taksës doganore 2 %, ndërkohë që duhej klasifikuar në kodin tarifor *85287240* të NKM me nivel të taksës doganore 10 % me pasojë shmangien e detyrimeve doganore në vlerën 29,856 lekë.*

Për sa më sipër në lidhje me faktet e paraqitura nr.3, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, dhe konkretisht me shkresën nr.1148/36 prot., datë 12.03.2018 (KLSH), me dokumentacionin bashkëlidhur, nr.1082 prot., datë 07.03.2018, ku citohet se: “...Bazuar në Kodin Doganor, metoda bazike e vlerësimit doganor është çmimi i transaksionit të mallit...”;



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Kanani, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë për DAV me R-5471, datë 08.05.2017 dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi nga auditimi është konstatuar se nga sektori i vlerës është bërë ndërhyrje për rivlerësimin e artikullit por jo në masën e duhur dhe se pretendimet Tuaja lidhur me vlerësimin doganor të mallrave bien ndesh me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..”.

Për sa më sipër në lidhje me faktet e paraqitura nr. 3, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, dhe konkretisht me shkresën nr.1148/29 prot., datë 07.03.2018 (KLSH), me dokumentacionin bashkëlidhur, ku citohet se: “...janë konstatuar diferenca në vlerësimin e disa faturave të subjektit që ne përfaqësojmë...R4154, R4153 dhe R4155, datë 27/03/2015; R8872, R8873, R8874 dhe R8875, datë 24/06/2015 si dhe R13, datë 05/10/2015...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Sinanaj, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi:

- së pari, Ju keni deklaruar mallra me origjinë preferenciale pa dokumentacionin e detyrueshëm të origjinës preferenciale për dërgesa ku vlera totale e të cilave i kalon 6000 euro, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Titullit I “Dispozita të përgjithshme”, neni 1 “Përkufizimet”, germa “l”, të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, ku përcaktohet qartë që: ““dërgesa” do të thotë produkte që janë dërguar në mënyrë të njëkohshme nga një eksportues te një marrësosetë shoqëruara me një dokument të vetëm transporti që mbulon transportimin e tyre nga një eksportues te një marrës ...”, dhe kërkesat e Titullit V, neni 22 “Kushtet përbërjen e një Deklarate Fature”, pika 1, germa “b” të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, në të përcaktohet qartë që: “Një deklaratë faturë, siç referohet ne Nenin 16(1)(b), mund të behet:... nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera totale e të cilave nuk i kalon 6000€”;

- së dyti, pretendimet Tuaja lidhur me DAV me R-13, datë 05/10/2015, referuar notave shpjeguese të NKM por edhe deklarimeve në D.D.V si dhe në degët e tjera doganore, artikulli “Letër për depilim” është keqklasifikuar në kodin tarifor *48189090* me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej klasifikuar në kodin tarifor *33079000* me nivel të taksës doganore 6 %.

Për sa më sipër në lidhje me faktet e paraqitura Akt Konstatimi nr.3, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, dhe konkretisht me shkresën nr.1148/32 prot., datë 09.03.2018 (KLSH), nr.1116 prot., datë 08.03.2018 (D.D.V), me dokumentacionin bashkëlidhur, sa më poshtë:

Në lidhje me importet e kryera nga subjekti “Sirol-2008”, ku citohet se “...Duke analizuar në tërësinë e tyre të gjithë elementët për një vlerësim doganor sa më objektiv, u pranua transaksioni si metodë e parë e vlerësimit doganor...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi çmimi i artikullit të deklaruar paraqitet nën 50 % të cmimeve të miratuara nga komisioni add-hoc pranë MF si dhe krahasuar me subjektet e tjerë për të cilët nga ana Juaj është rivlerësuar artikulli si dhe referuar DAV me R-8133, datë 12.06.2015 nga ana Juaj është bërë ndërhyrje për rivlerësimin e artikullit sipas nenit 36 të KD sipas të dhënave të disponueshme.

Në lidhje me “Deklaratat faturë”, ku citohet se “...Subjektet nuk kanë patur qëllim për të shmangur apo për të fshehur diçka në këto fatura pasi pavarësisht ndarjes në dy fatura malli është tërësisht me origjinë italiane...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi mallrat janë trajtuar me origjinë preferenciale pa dokumentacionin e detyrueshëm të origjinës preferenciale, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Titullit I “Dispozita të përgjithshme”, neni 1 “Përkufizimet”, germa “l”, të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, ku përcaktohet qartë që: ““dërgesa” do të thotë produkte që janë dërguar në mënyrë të njëkohshme nga një eksportues te një marrësosetë shoqëruara me një dokument të vetëm transporti që mbulon transportimin e tyre nga një eksportues te një marrës ...”, dhe kërkesat e Titullit V, neni 22 “Kushtet përbërjen e një Deklarate Fature”, pika 1, germa “b” të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, në të përcaktohet qartë që: “Një deklaratë faturë, siç referohet në Nenin 16(1)(b), mund të behet... nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera totale e të cilave nuk i kalon 6000€”;

Në lidhje me importet e kryera nga subjekti “Afërdita/V”, ku citohet se “...Çmimet në sistemin e raporteve të ASYCUDA janë të ndryshme në varësi të sasisë dhe cilësisë së importuar nga subjekte të ndryshëm...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi çmimi i artikullit të deklaruar paraqitet shumë ulët, krahasuar me çmimet e miratuara nga komisioni add-hoc pranë MF si dhe krahasuar me subjektet e tjerë për të cilët nga ana Juaj është rivlerësuar artikulli si dhe referuar DAV me R-8133, datë 12.06.2015 nga ana Juaj është bërë ndërhyrje për rivlerësimin e artikullit sipas nenit 36 të KD sipas të dhënave të disponueshme.

Në lidhje me taksën e ambalazhit (TAM), ku citohet se “...për tu quajtur set këto produkte duhet të jenë së bashku, kafja, sheqeri, trazuesi etj, të përdoren specifikisht në shërbim të kafes...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi artikulli është importuar së bashku me kafën në bustina apo



KONTROLLI I LARTE I SHETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

kapsula, sheqerin dhe trazuesit brenda një dite dhe shërben për ambalazhimin e saj, (pavarësisht se është ndarë në DAV tjetër), ndajnë kuadratin 31 të DAV duhej deklaruar kodi 74 për të gjeneruar taksën e ambalazhit, ashtu si dhe te praktikat e tjera doganore.

5. Në lidhje me artikullin “Ace kandexhina”,

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Konstatohet se nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive lëvruese për mallra të natyrës “naftë brutto” për praktikën doganore nën juridiksion auditimi (2015-2017) bazuar në shpjegimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave **nr.7 datë 4.1.2012 “Mbi pagesën e Rentës Minerare”**. Nuk është kërkuar verifikimi i saktë i transaksioneve të kryera pranë selive të kompanive lëvruese ose eksportuese të këtyre mallrave për eksportet e kryer nga subjektet “**Bankers Petroleum**” dhe kompania “**Transantlik Oil**”, në vijim të metodikës së ndjekur nga Dega Doganore Vlorë të përmendur sa më lart ku është kërkuar verifikimi i **114 praktikave doganore**, si dhe nuk është kryer garantimi në përputhje me legjislacionin doganor për pjesën e borxhit që mund të lindë nga rezultatet e verifikimit doganor në përputhje me garantimin e pjesës së detyrimit doganor të munguar dhe që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe bazuar në nenin 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213 dhe 214 të Kodit Doganor sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “*Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara*” në shumën **prej 2,240,931,479 lekë** për praktika doganore të cituara sa më sipër deri në deri në përfundim të hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar sa më sipër.

Në kushtet kur nga Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr.835/1 Prot të Kontrollit të Lartë të Shtetit, date 20/09/2016 me lëndë “**Kthim përgjigje kërkesës së Degës Doganore Vlorë nr.3159 date 28.07.2016**” përcaktohet qartë se “*Për sa kohë nuk ka një përgjigje nga nga Autoritetet Doganore Homologe Italiane për hetimin dhe monitorimin e transaksioneve të kryera midis “Bankers Petroleum” dhe “Eni Trading” për rregullshmërinë e transaksioneve konstatohet se nuk ekzistojnë baza për rishqyrtim të vendimit nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Vendim ky i rekomanduar më parë nga **Kontrolli i Lartë i Shtetit** me shkresën nr.1101/17, datë 06.05.2015 nga grupi auditues do të kërkohej ndjekja e



KONTROLLI I LARTE I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

vjeljes së detyrimeve doganore të pagesës së rentës minerare, si dhe garantimi i borxhit që mund të lindë deri në **përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë Bankers Petroleum, dhe “Transantlik Oil”** për periudhën nën auditim

Për sa më sipër është mbajtur Projekt Raporti i Auditimit nr.1148/8 Prot datë 07.02.2018 dhe protokolluar në Degën Doganore Vlorë me shkresën nr.640 prot D.D.Vlorë datë 09.02.2018 dhe për këtë rast subjekti i audituar Dega Doganore Vlorë me shkresën nr.1138/32 prot datë 09.03.2018, ka bërë komente dhe shpjegime nisur specifikisht edhe nga observacionet e subjekteve të prekura si palë e interesuar si më poshtë vijon,

.Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH

Konkretisht u shqyrtuan observacioni i sektorit doganor PIA Vlorë nënshkruar nga doganieri z. Renato Bega. Konstatohet në observacion se nga Dega Doganore Vlorë me shkresat nr.718 prot D.D.Vlorë datë 14.02.2018, me nr.670 prot D.D.Vlorë datë 12.02.2018 dhe shkresa nr.632 prot D.D.Vlorë datë 08.02.2018 janë dërguar për konfirmim doganor 121 praktika doganore të njehsuara pranë Departamentit Operativ-Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me qëllim verifikimin e transaksioneve të kryera midis kompanisë Bankers Petroleum dhe kompanive pritëse ose blerëse të mallit të cituara në këtë shkresë që lidhen me juridiksionin e auditimit për vitet 2015-2017.

Gjithashtu nëpërmjet këtij observacioni na janë vendosë në dispozicion edhe shkresat nr. 3552 prot D.D.Vlorë datë 07.09.2017 me lende “Përgjigje për verifikimin e faturave” ardhur me shkresën nr.18505/1 prot DPD datë 23.08.2017 ku ka ardhë dokumentacioni shkresor për verifikimin e 2 faturave të mallit të cituara në shkresë përkatësisht me blerës malli kompaninë IPLOM sipas faturës nr.23/2013 datë 07.05.2013 dhe faturës nr.31/2013 datë 12.06.2013 dhe shkresa nr.3532 datë 07.09.2017 prot D.D.Vlorë dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr.18055/1 prot datë 13.08.2017 kërkuar 27 fatura për verifikim ku janë dokumentuar edhe përgjigjet për këto fatura “**por pa specifikuar rezultatin konkret të përputhshmërisë së tyre me faturat e dërguara për verifikim doganor**” Gjithashtu në shënimet e Kryetarit të Degës Doganore Vlorë i është lënë detyrë juristit dhe specialistit të Degës Doganore Vlorë për të dyja shkresat “**Përgatitja e një Informacioni të detajuar për këtë rast**”. Në këto kushte në zbatim të shpjegimeve dhe përcaktimeve të Udhezimit nr.VKM nr.201 datë 21.03.2012 i ndryshuar dhe VKM nr.7 datë 04.01.2012 i ndryshuar deri në ardhjen e një përgjigjeje përfundimtare nga Dega Doganore Vlorë mbi rezultatet e verifikimeve doganore të kërkuara do të rikërkohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit vjelja dhe arkëtimin e detyrimeve doganore të pagesës së rentës minerare në vazhdimësi si dhe garantimi i menjëhershëm të borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë “**Bankers Petroleum**”, dhe “**Transantlik Oil**” dhe kompanive pritëse ose importuese të mallrave të natyrës “**nafte brutto**” të eksportuara nga këto kompani nga territori doganor shqiptar, për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, në shumën prej 2,240,931,479 lekë për deklarime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017 deri në përfundim të Hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. **trajtuar si problematikë edhe më parë me shkresën**



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

nr.835/1 Prot të Kontrollit të Lartë të Shtetit, datë 20.09.2016 me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës së Degës Doganore Vlorë”.

Në lidhje me observacionin e bërë nga z. Renato Bega në lidhje me rezultatet e lëna, sqarohet se pretendimet e shprehura në këtë material nuk përbëjnë prova dhe fakte ligjore të provueshme dhe të dokumentuara me prova shkresore. Në lidhje me referimin ligjor të munguar të audituesve të KLSH-së për VKM nr.201 datë 21.03.2012 sqarohet se ky akt normative nuk ka shfuqizuar VKM nr.7 datë 04.01.2012 por ka prekur disa ndryshime të VKM nr.7 dhe konkretisht në pikën 3, 4, 9 dhe është shtuar PIKA 7.1. Pra të gjitha përcaktimet ligjore të sanksionuara më parë në VKM nr.7 kanë fuqi ligjore

U shqyrtua observacioni i ardhur me shkresën nr.780 prot DPD datë 19.02.2017 i ardhur nga subjekti La Petrolifera Italo-Albanese në lidhje me sasinë prej 180 ton diesel dhe nuk dokumentohet qartë origjina e pronësisë së sasisë prej 180 ton diesel të gjetur në tepricë. Konstatohet se më datën 17.05.2017 subjekti “Netsaviale Franscini,306900 Lugano Zvicra Petrolifera It-Alb, Kod MI-04NIPT K71906007” ka kryer eksport malli në sasinë prej 3,847,060 kg në vlerën 3,847,060 USD për artikullin naftë në kodin tarifor 2710943 ku dokumentohet edhe sasia prej 180 Ton naftë e hyrë në magazinë sipas deklaratës IMP 7 me nr R 2403 datë 28.02.2017. Sipas faturës nr. 23639556 datë 07.03.2017 dokumentohet kalimi i një sasi prej 2,171,270 kg me një cmim prej 424 euro/toni në vlerën totale prej 1,109,916 Euro me shitës malli kompaninë ENI SPA dhe blerës NET SA (adresë Lugano) Zvicër. Nuk dokumentohet në akte ose process-verbale sasia gjëndje e mallit të magazinës doganore në zotërim nga ENI SPA për artikullin naftë në moëmentin e kryerjes së eksportit të kësaj sasi prej 3,847,060 kg naftë diesel. Merret në konsideratë observacioni i bërë nga sektori Pia me shkresën nr.780 prot datë 19.02.2017 në lidhje me destiancionin e lirë që mund të marrë malli joshqiptar i magazinuar në një zonë të lirë por nuk arrihet të provohet nga ana dokumentare gjëndja e magazinës më datën e kryerjes së eksportimit të këtij malli me qëllim provimin e sasi prej 180 ton të rieksportur jashtë zonës së lirë PIA.

Gjithashtu nga Komisioni AD-HOC pranë Ministrisë së Financave nuk janë nxjerrë të dhëna referuese ose krahasuese për artikullin “Naftë Bruto” të deklaruar për eksport me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të levrimit Fob në zbatim të pikës 3 të VKM nr.201, datë 21.03.2012, e ndryshuar përcaktohet se lista me vlerat referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale, hartohet dhe miratohet nga një komision AD-HOC i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Drejtorive të Përgjithshme të Doganave e Tatimeve, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), Fakultetit të Gjeologji-Minierave, dhe “brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ua përcjell zyrtarisht listën e miratuar autoriteteve doganore e tatimore, për t’u përdorur si burim i të dhënave të disponueshme. Ky komision mbledhet dhe përditëson listën sa herë është e nevojshme”

Gjetjet kryesore

Drejtimi nr.3 “Auditimi i sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor të mallrave gjatë periudhës nën auditim”

Titulli i Gjetjes 1

Zbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave, klasifikimin tarifor dhe përfitimin e kushtit tëtrajtimin tarifor preferencial MSABE(reduktimit nga pagesa e tarifës doganore)



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

- Situata:** Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues doganor nuk janë rrillogaritur të sakta elementët e vlerës doganore për efekt taksimi doganor që lidhen vlerësimin doganor të shpenzimeve të transportit, të vlerës së mallrave për qëllime doganore, të përmbushjessë kushtit preferencial MSABE, përputhshmërisë së klasifikimit tarifor të mallrave, duke krijuar të ardhura doganore të munguara të rrillogaritura nga grupi auditues dhe të rekomanduara në **shumën 74,194 mijë lekë** në këtë Raport Përfundimtar Auditimipër periudhen nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2015 deri në datën 01.10.2017.
- Kriteri :** Neni 34 deri 37 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjitnr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,shkresës nr.779 prot DPD datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”, shpjegimeve të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë” dalë sipas ligjit nr.9590, datë 27.07.2006 për “Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit”
- Ndikimi/Efekti** Konstatohet efekt financiar i munguar nga të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në formën e detyrimit doganor dhe gjobës doganore në shumën të ardhuradoganore të rrillogaritura në **shumën 74,194 mijë lekë**për periudhen nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2015 deri në datën 01.10.2017.
- Rëndësia** i larte
- Rekomandimi** Dega Doganore Vlorë të ndjekë të gjitha rrugët ligjore me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e vendimeve administrative për kontabilizimin dhe më pas arkëtimin e detyrimeve doganore në **shumën 74,194 mijë lekë**per periudhen nën juridiksion auditimi nga data 01.01.2015 deri në datën 01.10.2017që lidhen me rrillogaritje pagesash detyrime doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje dhe mbështetje të shpjegimeve të nenit 34 deri 37 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neneve 65-70 të ligjitnr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, Udhëzimit nr.25 datë 16.05.2006 të DPD ,”Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”,shkresës nr.779 prot DPD datë 16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”, shpjegimeve të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë” dalë sipas ligjit nr.9590, datë 27.07.2006 për “Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit” nga personeli përpunues doganor.

Menjëherë

Titulli i Gjetjes 2
Situata:

Zbatimi i procedurave të sakta doganore në lidhje me diferencat e konstatuara gjatë pagesës së rentës minerare në sektorin Petrolifera

Nga auditimi u konstatua se rezultoni diferenca të pagesës së rentës minerare që lidhen me vlerën e mallit “naftë brutto” deklaruar në kodin tarifor *27090090* në deklaratat e eksportit nga subjekti “Bankers Petroleum” dhe “Transantlik Oil” krahasuar kjo me cmimin e publikuar të Bursës së Reuters (platts) për artikullin “Naftë Bruto” sipas kushtit të levrimit FOB në shumën prej 2,240,931,479 lekë. Gjithashtu nga Komisioni AD-HOC pranë Ministrisë së Financave nuk janë nxjerrë të dhëna referuese ose krahasuese për artikullin “Naftë Bruto” të deklaruar për eksport me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të levrimit FOB. Nga Autoriteti Doganor Vlorë nuk është kërkuar verifikim doganor pranë selive të kompanive pritëse ose importuese për praktikat doganore nën juridiksion auditimi për periudhën 01.01.2015 deri në periudhën 01.09.2017 për eksportet e kryer nga subjektet “Bankers Petroleum” dhe kompania “Transantlik Oil”, si dhe nuk është kryer garantimi për pjesën e detyrimit doganor të munguar që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe pas kryerjes së verifikimeve doganore nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi trajtuar si problematikë edhe më parë me shkresën nr.835/1 Prot të Kontrollit të Lartë të Shtetit, datë 20.09.2016 me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës së Degës Doganore Vlorë”.

Kriteri :

Vendimi i Këshillit të Ministrave “nr.7 datë 4.1.2012 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti

Konstatohen diferenca të pagesës së rentës minerare që lidhen me vlerën e mallit “naftë brutto” deklaruar në kodin tarifor *27090090* në deklaratat e eksportit nga subjekti “Bankers Petroleum” dhe “Transantlik Oil” krahasuar kjo me cmimin e publikuar të Bursës së Reuters (platts) për artikullin “Naftë Bruto” sipas kushtit të levrimit FOB nga data 01.01.2015 deri në datën 01.10.2017.

Rëndësia

i larte

Rekomandimi

Autoriteti Doganor Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të kërkojë vjeljen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore të pagesës së rentës minerare në vazhdimësi dhe të kërkojë garantimin e menjëhershëm të borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë “Bankers Petroleum”, dhe “Transantlik Oil” dhe kompanive pritëse ose importuese të mallrave të natyrës “naftë brutto” të eksportuara nga këto kompani nga territori doganor shqiptar, për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, në shumën prej 2,240,931,479 lekë për deklarime doganore të evidentuara deri në përfundim të Hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Menjëherë

🚩 Drejtimi nr. 4 i Auditimit “Auditimi i procedurave doganore të ndjekura nga sektori rregjime/përrjashtime gjatë mbikëqyrjes së rregjimeve ekonomike”.

Në zbatim të pikës 4(Për auditimin e procedurave doganore të ndjekura nga sektori rregjime/akcizë përrjashtime gjatë mbikëqyrjes së rregjimeve doganore ekonomike) gjatë periudhës 2015-2017 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Deklaratat doganore Import 4 për mallrat e zhdoganuara me procedurën 4051(importpër konsum pas RPA me pezullim) gjatë periudhës 01/01/2017 deri 30/09/2017, lidhur me procedurat doganore të zbatuara nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë , për zhdoganimin e tyre.
2. Dokumentacioni elektronik i praktikave doganore lidhur me importet dhe eksportet e operatorëve ekonomik që operojnë nën regjimet e përpunimit aktiv;
3. Dokumentacioni shkresor (dosjet e operatorëve ekonomik), lidhur me autorizimet për regjimin e përpunimit aktiv;
4. Dokumentacioni tregtar i praktikave doganore si dhe autorizimeve që kanë rezultuar me shkelje të legjislacionit doganor mbi bazën e të cilave autoriteti doganor ka dalë me vendim administrativ.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua se:

◆***Në lidhje me autorizimet e subjektit “Lolida Grup” meNIPT K87116202F***konstatohet se është pajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me AutoriziminNr. 3032/1,datë 06/02/2015 për zhvillimin e aktivitetit të përpunimit aktiv me pezullim. Sipas DAV me R.5876,datë 18/05/2017 me Faturë Proform nr. 13,datë 17/05/2017 me procedurën5100 subjekti ka importuar nga Italia artikullin lëkurë me kodin tarifor 41079190 për sasinë 802,16mq me peshë neto 898,42 kg , me vlerë 20,054 euro me çmimin 25 euro/ mq. Sipas DAV me R.6398,datë 02/06/2017 me Faturë Profarm nr. 16,datë 29/05/2017 me procedurën5100 subjekti ka importuar nga Italia artikullin lëkurë me kodin tarifor 41079190 për sasinë 921,13 mq me peshë neto 1031,67 kg , me vlerë 23,028,25 euro me çmimin 25 euro/ mq,.

Nga sa më sipër rezulton se çmimi i lëkurës së importuar me kodin tarifor 41079190 është 25 euro/mq. Për mbylljen e Autorizimit Nr. 3032/1,datë 06/02/2015 subjekti ka kërkuar dhënien e destinacionit të mallrave të importuara dhe të papërdorura. Për këtë ka kaluar në procedurën 4051(importpër konsum pas RPA me pezullim) artikullin lëkurë me R.8410,datë



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

13/07/2017 dhe R.8588, datë 17/07/2017. *Nga auditimi rezulton se detyrimet doganore për këtë artikull nuk janë llogaritur saktë;* megjithëse çmimi i lëkurës së importuar është 25 euro/mq gjatë zhdoganimit dhe llogaritjes së detyrimeve doganore me procedurën 4051 (import për konsum pas RPA me pezullim) është aplikuar çmimi i lëkurës për 3 euro/mq e konkretisht: Me DAV me R.8410, datë 13/07/2017 artikullin lëkurë me kodin tarifor 41079190 për sasinë 1015,91 mq me peshë neto 1105 kg, me vlerë 3,045 euro me çmim 3 euro/mq dhe me vlerë për qëllime doganore për shumën 403,737 lekë me TVSH për shumën 80,746 lekë.

Vlera për qëllime doganore duhet të ishte llogaritur:

$1015,91 \text{ mq} \times 19,29 \text{ euro/mq} = 19,579 \text{ euro} \times 132,59 = 2,596,026 \text{ lekë.}$

Detyrimet për TVSH duhet të ishin llogaritur : $2,596,026 \times 20\% = 519,205 \text{ lekë.}$

Detyrimet janë llogaritur më pak për shumën 438,459 lekë (673,497 - 80,746).

(Detyrimet doganore janë llogaritur ngadoganieri i regjimeve ekonomike Gjergji Braka).

=Me DAV me R.8588, datë 17/07/2017 artikullin lëkurë me kodin tarifor 41079190 për sasinë 2465 mq me peshë neto 2698.1 kg, me vlerë 7423 euro me çmim 3 euro/mq dhe me vlerë për qëllime doganore për shumën 984,177 lekë me TVSH për shumën 196,835 lekë.

Vlera për qëllime doganore duhet të ishte llogaritur:

$2465 \text{ mq} \times 19,29 \text{ euro/mq} = 47,500 \text{ euro} \times 132,59 = 6,209,852 \text{ lekë.}$

Detyrimet për TVSH duhet të ishin llogaritur : $6,209,852 \text{ lekë} \times 20\% = 1,241,970 \text{ lekë.}$

Detyrimet janë llogaritur më pak për shumën 1,045,135 lekë (1,634,171 - 196,835).

(Detyrimet doganore janë llogaritur ngadoganieri e regjimeve ekonomike Jeta Manaj).

Për të dy DAV-ët e mësipërme detyrimet për TVSH janë llogaritur më pak për shumën 1,483,594 lekë

Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin që;

Nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë për rastet e trajtuara në këtë Akt Konstatim nuk janë zbatuar dispozitat e ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 32, datë 02.04.2015, të VKM-së nr.205, datë 13.04.1999, “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe kërkesat e udhëzimit nr.25, datë 30.11.2007 i Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhënat e disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.24, datë 11.9.2015 dhe të Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave Nr. 1 datë 06.09.2012 .

Të ardhurat e munguara në Buxhetin e Shtetit rezultojnë për shumën 2,030,087 lekë.

♦ ***Në lidhje me Autorizimin nr. 20140321/7073/2 të subjektit “Tomaificio Maro” me NIPT L364101201R konstatohet se kontratat e porosisë janë kryer kryesisht me furnitorin “Imac Spa Via Menochia 27 63010 Montefiore Del Asolo Askoli Piceno Itali”.*** Konstatohet se vlerat dhe sasi të këtij rregjimi doganor ekonomik janë të larta ndërkohë që taksa TTP e trajtimit tarifor preferencial janë shumë të ulët. Konstatohet se kompania furnizuese operon me statusin e eksportuesit të miratuar dhe artikujt kryesorë furnizues janë “Lëkura” dhe “Pëlhura” të cilat hyjnë të trajtuara me kushtin MSABE dhe ***pa kushtin MSABE***. Për mallrat e hyra për përpunim sipas kushtit jo preferencial nga personeli përpunues doganor nuk janë kryer veprime verifikuese bazuar në përcaktimet e Udhëzimit nr.2077 prot datë 06.08.2010 “Mbi rregullat e Origjinës”, dokumentit të Udhërfyësit sipas ligjit nr 9590 datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizimit asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare”, pjesa V, Titulli “Vërtetimi i Origjinës”, neni 22 “Kushtet për bërjen e një deklarate fature” dhe neni 33 “Verifikimi i Dëshimve të Origjinës” për kryerjen e verifikimeve të dëshimve të origjinës “Deklarata



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Faturë” nga autoritetet e vendit eksportues me qëllim provimin e vërtetësisë së origjinës së mallrave të lëvruara në praktikat doganore të poshtëcituar në procedurat e importit. Gjithashtu nuk janë kryer mostrime mallrash të krerëve *4107* dhe *5903* të deklaruara në kode tarifore më tarifë bazë 0%. Tabela e rasteve të praktikave doganore të deklaruara në këto krere më importe pa trajtim MSABEdhe me tarifë doganore 0% dhe të trajtuara gjatë procesit të prodhimit dhe të rieksporuara në kreun tarifor *6406* me trajtim tarifor preferencial MSABE,

(Trajtuar në aneksin 4.4 bashkangjitur Raport Përfundimtarit të Auditimit)

Sa më poshtë tabela e eksporteve të kryera brenda Autorizimit nr.20140321/7073/2 të subjektit “Tomaificio Maro” meNIPT L364101201Rkonstatohet se kontratat e porosisë janë kryer kryesisht me furnitorin “*Imac Spa Via Menochia 27 63010 Montefiore Del Aso Askoli Piceno Itali*”. Konstatohet se për një vlerë malli në hyrje prej 41,112,036 lekë më një peshë prej 49,639 kg nga subjekti “Tomaificio Maro” meNIPT L364101201R brenda Autorizimit nr.20140321/7073/2 konstatohet se për kontratat e porosisë me furnitorin “*Imac Spa Via Menochia 27 63010 Montefiore Del Aso Askoli Piceno Itali*” janë paguar vetëm një vlerë prej 350,433 lekë si tarifë e TTP (trajtimit tarifor preferencial). Gjithashtu konstatohet se artikulli “*Lekurë*” i deklaruar në kreun *4107*importohet në disa raste sipas trajtimit tarifor MSABE dhe në disa raste sipas trajtimit tarifor pa MSABEImporte me MSABE

Gjithashtu konstatohet se subjekti ka kryer Procedura Doganore IMP9 për mallrat e deklaruara në kodet tariforë *4107* dhe *5903* të detajuara sa më poshtë

Dav	Viti	Subjekt	Marresi	Kodi	Procedura zgjeruar	Pershkrimi	Pesha
17128	2014	Tomaificio"MARO"	Tomaificio"MARO"	41071291	9351	MBETJE	7849
1203	2015	Tomaificio"MARO"	Tomaificio"MARO"	41071291	9351	MBETJE	22023
3264	2015	Tomaificio"MARO"	Tomaificio"MARO"	41071291	9351	MBETJE	2060
13523	2015	Tomaificio"MARO"	Tomaificio"MARO"	41071291	9351	MBETJE	2157
17128	2014	Tomaificio"MARO"	Tomaificio"MARO"	59039099	9351	MBETJE	7190
1203	2015	Tomaificio"MARO"	Tomaificio"MARO"	59039099	9351	MBETJE	22062
3264	2015	Tomaificio"MARO"	Tomaificio"MARO"	59039099	9351	MBETJE	2062
13523	2015	Tomaificio"MARO"	Tomaificio"MARO"	59039099	9351	MBETJE	2157
Totali							67561

Gjithashtu konstatohet se subjekti ka kryer Procedura Doganore EXP për mallrat e deklaruara në kodet tariforë *4107* dhe *5903* të detajuara sa më poshtë:

DAV	Viti	NIPT	Eksp	Marres	Kodi	Proc	Pershk	Pesha
8020	2014	L36401201R	Tomaificio MARO	IMAC SPA	41071990	3151	Lekure	30
10274	2014	L36401201R	Tomaificio MARO	IMAC SPA	41071990	3151	Lekure	46
11029	2014	L36401201R	Tomaificio MARO	IMAC SPA	41071990	3151	Lekure	21
11612	2014	L36401201R	Tomaificio MARO	IMAC SPA	41071990	3151	Lekure	159
13906	2014	L36401201R	Tomaificio MARO	IMAC SPA	59031090	3151	Pelhure	70
1075	2015	L36401201R	Tomaificio MARO	IMAC SPA	59031090	3151	Pelhure	12
Totali								338

Për mallrat e hyra për përpunim sipas kushtit jo preferencial nga personeli përpunues doganor të kryhen veprime verifikuese bazuar në përcaktimet e Udhëzimit nr.2077 prot datë 06.08.2010 “*Mbi rregullat e Origjinës*”, dokumentit të Udhërfyësit sipas ligjit nr 9590 datë 27.07.2006, “*Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare*”, pjesa V, Titulli “*Vërtetimi i Origjinës*”, neni 22 “*Kushtet për bërjen e një deklarate faturë*” dhe neni 33 “*Verifikimi i Dëshimve të Origjinës*” për kryerjen e verifikimeve të dëshimve të origjinës “*Deklarata Faturë*” nga autoritetet e vendit eksportues me qëllim provimin e vërtetësisë së origjinës së mallrave të lëvruara në praktikat doganore të poshtëcituar në procedurat e importit. Gjithashtu të kryhen mostrime të detyrueshme mallrash të krerëve *4107* dhe *5903* të deklaruara në kode tarifore më tarifë bazë 0%.

♦ **Në lidhje me Autorizimin nr. 20150320/6658/2 të subjektit “Tomaificio Maro” meNIPT L364101201Rkonstatohet se kontratat e porosisë janë kryer kryesisht me furnitorin “Imac Spa Via Menochia 27 63010 Montefiore Del Aso Askoli Piceno Itali”. Konstatohet se**



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

vlerat dhe sasi të këtij rregjimi doganor ekonomik janë të larta ndërkohë që taksa TTP e paguar e trajtimit tarifor preferencial është shumë e ulët. Konstatohet se kompania furnizuese operon me statusin e eksportuesit të miratuar dhe artikujt kryesorë furnizues janë “Lëkura” dhe “Pëlhuara” të cilat hyjnë të trajtuara me kushtin *MSABE* dhe *pa kushtin MSABE*. Për mallrat e hyra për përpunim sipas kushtit jo preferencial nga personeli përpunues doganor nuk janë kryer veprime verifikuese bazuar në përcaktimet e Udhëzimit nr.2077 prot datë 06.08.2010 “*Mbi rregullat e Origjinës*”, dokumentit të Udhërfyësit sipas ligjit nr 9590 datë 27.07.2006, “*Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare*”, pjesa V, Titulli “*Vërtetimi i Origjinës*”, neni 22 “*Kushtet për bërjen e një deklarate faturë*” dhe neni 33 “*Verifikimi i Dëshmimeve të Origjinës*” për kryerjen e verifikimeve të dëshmimeve të origjinës “*Deklarata Faturë*” nga autoritetet e vendit eksportues me qëllim provimin e vërtetësisë së origjinës së mallrave të lëvruara në praktikën doganore të poshtëcituar në procedurat e importit. Gjithashtu nuk janë kryer mostrime mallrash të krerëve *4107* dhe *5903* të deklaruara në kode tarifore më tarifë bazë 0%. Sa më poshtë edhe tabela e rasteve të praktikave doganore të deklaruara në këto krere më tarifë doganore 0% dhe të trajtuara gjatë procesit të prodhimit dhe të riekportuara në kreun tarifor *6406* me trajtim tarifor preferencial *MSABE* Importe *pa trajtim MSABE* Sa më poshtë tabela e eksporteve të kryera brenda Autorizimit nr.20140321/7073/2 të subjektit “*Tomaificio Maro*” me NIPT L364101201R konstatohet se kontratat e porosisë janë kryer kryesisht me furnitorin “*Imac Spa Via Menochia 27 63010 Montefiore Del Aso Askoli Piceno Itali*” *Procedura ne eksport te trajtuara pa MSABE*

Dav	Viti	NIPT	Eksportues	Marres	Kodi	Proced	Prefe	Persh	Pesha	Vlera
6044	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	4107	3151	NEU	Lekure	21	100869
6923	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	4	20031
7675	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	3,81	15983
8022	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	58,5	280417
8420	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	11,25	61364
8854	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	240,6	949954
10526	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	80	391670
1193	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	60	180592
2161	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	24	123784
2805	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	9,8	47375
244	2016	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	5,2	14568
1888	2016	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	109	535052
1892	2016	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	5	26078
3161	2016	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	9,7	42696
3496	2016	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	41071990	3151	NEU	Lekure	9	45597
13698	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	59031090	3151	NEU	Pelhuare	140	139440
9244	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	64061090	3151	NEU	Faqe	262,2	1325912
2508	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	64061090	3151	NEU	Faqe	170	1152281
1464	2015	L36401201R	Tomaificio	Imac SPA	64069090	3151	NEU	Faqe	0,9	142547
Totali									1224	5596210

Konstatohet se sasia prej 22,338 kg me vlerë 37,724,824 lekë e hyrë si mall për përpunim në rregjimin doganor është trupëzuar në mallra të riekportuara sipa kushtit *MSABE* dhe vetëm në një sasi prej 1224 kg është trupëzuar ky mall. Për mallrat e hyra për përpunim sipas kushtit jo preferencial nga personeli përpunues doganor të kryhen veprime verifikuese bazuar në përcaktimet e Udhëzimit nr.2077 prot datë 06.08.2010 “*Mbi rregullat e Origjinës*”, dokumentit të Udhërfyësit sipas ligjit nr 9590 datë 27.07.2006, “*Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare*”, pjesa V, Titulli “*Vërtetimi i Origjinës*”, neni 22 “*Kushtet për bërjen e një deklarate faturë*” dhe neni 33 “*Verifikimi i Dëshmimeve të Origjinës*” për kryerjen e verifikimeve të dëshmimeve të origjinës “*Deklarata Faturë*” nga autoritetet e vendit eksportues me qëllim provimin e vërtetësisë së origjinës së mallrave të lëvruara në praktikën doganore të poshtëcituar në procedurat e importit. Gjithashtu të kryhen



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

mostrime të detyrueshme mallrash të krerëve *4107* dhe *5903* të deklaruara në kode tarifore më tarifë bazë 0%.

◆ *Në lidhje me Autorizimin nr. 20150807/19426/1 të subjektit “MANIFATTURA ROLEGA”* meNIPT L3652503S konstatohet se sipas kontratave të porosisë janë kryer furnizime në sasinë prej 65,140 kg brenda afateve autorizuese. Konstatohet se subjekti brenda kushteve në Autorizimi nr. 20150807/19426/1 të subjektit “*Manifattura Rolega*” meNIPT L3652503S ka eksportuar sasinë prej 60,444 kg drejt kompanive furnitore. Subjekti nuk ka kryer “*rieksportim*” të sasisë së mallrave me statusin e produkteve lëndë e parë dhe materiale ndihmëse të vendosur në regjimin e lejimit të përkohshëm RPA, nuk është deklaruar për mallra “*gjendje*” në ambientet e mbajtësit të autorizimit (produkte kompensuese dhe mallra të importuara përkohësisht në gjendjen e tyre të pandryshuar) si dhe për zhdoganim të mallrave gjendje “*në deklaratën për qarkullim të lirë*”. Mbajtësi i Autorizimit është në kalim të afateve për paraqitjen e dokumentit të shkarkimit por nuk ka dhënë një “*Deklaratë*” për vendosjen e mallrave të përfshirë në këtë autorizim të Rregjimit të Perpunitimit Aktiv. Bazuar në nenin 256/2, nenit 271, të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor në RSH*”, i ndryshuar, VKM-së nr.205 datë 13.04.1999 “*Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, të Udhëzimit nr.1 datë 06.09.2012, “*Për Zbatimin Praktik të Regjimit të Perpunitimit Aktiv*” të rekomandohet kërkimi i detyrimit doganor për subjektin “*ROLEGA*” shpk meNIPT K49719206B në shumën **325,000 lekë** për sasinë prej 4700 kg mall lëndë e parë (llogaritur sipas çmimit mesatar hyrës).

Trajtuar në tabelat nr.4.5 bashkëgjatë Raport Përfundimtarit të Auditimit

◆ *Në lidhje me Autorizimin nr. 20150626/15180/2 të subjektit “GBD METAL”* meNIPT K56809202J konstatohet se sipas kontratave të porosisë janë kryer furnizime në sasinë prej 625,766 kg dhe dalje në eksport malli në sasinë prej 623,101 kg dhe procedurë transferuese 5151 në sasinë 2600kg.

Dav	Viti	Subjekt	NIPT	Kodi	Proc	Artikull	Pesha	Vlera	Detyrim
3265	2015	GBD	K56809202J	7306	4051	Mbetje	5792	257280	44.4
6006	2015	GBD	K56809202J	7306	4051	Mbetje	5345	240037	44.9
2107	2015	GBD	K56809202J	7306	4051	Mbetje	3161	55973	17.7

Konstatohet se janë kryer deklarime mallrash për nxjerrje në qarkullim të lirë brenda procedurës së regjimeve ekonomike të evidentuara sa më sipër për mallra të natyrës “*mbetje*” të klasifikuara në kapitullin *73* të Nomenklaturës së Mallrave. Gjatë auditimit të praktikave doganore të vitit 2015 ku janë konstatuar deklarime mallrash me procedurë hedhje në qarkullim të lirë “*për mallra të nxjerrë nga regjimi doganor ekonomik*” me një vlerë tregtare më të ulët se ato transaktuar brenda sistemit doganor në vlerën doganore të pranuar në nivelin **44 lek/kg** bazuar në shpjegimet dhe përcaktimet Pikës 4 të Sesioni i të Udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 “*Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore*”, Neni 64 pika 1, b e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, Neni 54, titulli VI “*Vlera Doganore*” pika c, e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar dhe nenit 35 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar. Veprimet ose mosveprimet e kryera kanë sjellë pasojë mosarkëtimin e detyrimeve doganore si pasojë e mosvlerësimit doganor të kryer në kundërshtim me shpjegimet dhe përcaktimet e nenit 54, titulli VI “*Vlera Doganore*” pika c, e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, Pika 4 e Sesioni I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007, neni 35 i ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar për të cilat nuk është vepruar nga personeli përpunues doganor i Degës Doganore Vlorë të cilat kanë sjellë pasojë detyrime doganore të munguara në shumën **totale prej 13,626 lekë**.

Vlera prej 338,626 lekë, e cila përfaqëson detyrim dhe penalitet për shkelje në fushën doganore, do të konsiderohet e ardhur e munguarshkaktuar Buxhetit të Shtetit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Festim Kapaj me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së regjime/preference/përrjashtime;
2. Zj. Jeta Manaj, me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/preferenca/përrjashtime;
3. Z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrolli dokumentar klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, në cilësinë e doganier regjime/preferenca/përrjashtime;

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të operatorëve ekonomik, lidhur me autorizimet për regjimin e përpunimit aktiv u konstatua se:

1. Nga ana e z. Festim Kapaj, me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së regjime/preferencë/përrjashtime; zj. Jeta Manaj, me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/preferenca/përrjashtime; z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrolli dokumentar klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, në cilësinë e doganier regjime/preferenca/përrjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në legjislacionin doganor gjatë kryerjes së detyrave funksionale.

Referuar nenit 6, pika 3, të të Udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 të D.P.D “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, në të përcaktohet qartë që:

*Pasi përfundon periudha e vlefshmërisë së autorizimit, përfshi këtu edhe kohën e përpunimit të cilësuar në pikën 8 të autorizimit, shoqëria është e detyruar të dorëzojë pranë degës së doganës mbikëqyrëse materialin e mbylljes së autorizimit sipas modelit 3 të këtij udhëzimi. Megjithatë kjo kohë do të jetë më e shpejtë në rastet kur i jepet destinacion doganor produkteve kompesuese. **Koha e dorëzimit nuk mund të kalojë 30 ditë** nga rastet e sipër përmendura, në të kundërt shoqëria penalizohet sipas nenit 272 të Kodit Doganor.*

Referuar nenit 256, pika 2, të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

Çdo veprim ose mosveprim që bie ndesh me dispozitat e parashikuara në këtë Kod, me aktet nënligjore të tij dhe me dispozita të tjera në fuqi, me përrjashtim të rasteve të fuqisë madhore, quhet kundërvajtje administrative doganore dhe dënohet si e tillë.

Referuar nenit 272, pika 1, të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

Pa rënë ndesh me dispozitat për kontrabandën, quhet se përbën kundërvajtje administrative doganore mosparaqitja në kohën e përcaktuar e dokumentit të mbylljes së regjimit për mallrat e vendosura në lejim të përkohshëm, nën regjimin e përpunimit aktiv ose nën regjimin e përpunimit pasiv.

Referuar nenit 275, pika 1, të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në të përcaktohet qartë që:

Për shkeljet, të cilave u referohet neni 256, paragrafi 2 dhe të paparashikuara shprehimisht në këtë Kre, zbatohet një gjobë që shkon nga 50 000 lekë deri në 200 000 lekë.

Referuar nenit 251, pika 2, gërma “i”, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje me përgjegjësi objektive: mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të përpunimit aktiv i detyrimit për mbylljen e regjimit doganor brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230

Referuar nenit 251, pika 2, gërma “i”, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, në të përcaktohet qartë që:

Pa cenuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje me përgjegjësi objektive: mosrespektimi nga mbajtësi i regjimit të përpunimit aktiv i detyrimit për mbylljen e regjimit doganor brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 230



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit sipas dosjeve bashkëlidhur autorizimeve për regjimin e përpunimit aktiv të lëshuar për operatorë të ndryshëm ekonomik,

Rezultoi se

◆ Në lidhje me mbylljen e regjimit (sipas mod.3), nga ana e operatorëve sipas pasqyrës së mëposhtme, u konstatua tejkalim i afatit 30 ditor (afat ky i përllogaritur nga data e fundit e eksportit të produkteve kompensuese), në shkelje të nenit 265.2, 272.1, ndryshuar me nenin 250.1/a dhe 251.2/i të KD, për të cilët nga sektori i regjimeve nuk është mbajtur procesverbal konstatimi;

◆ Në lidhje me kushtet e përcaktuara në formularin e autorizimit, nga një subjekt u konstatua tejkalim i vlerës së vlerësuar në pikën 3.d (autorizimi nr.17947/1, datë 17.01.2014), pasi importi i lëndës së parë është në vlerën 32568.68 euro dhe rieksperti i produkteve kompensuese parësore në vlerën 60508.98 euro (pa vlerën e shtuar 34370.31 euro), pra me një diferencë në vlerën 27940.3 euro më tepër ndërkohë kur nuk ka lëndë të parë nga prodhimi vendas, veprime këto në shkelje të nenit 256.2 dhe 275.1 të KD;

◆ Në lidhje me kushtet e përcaktuara në formularin e autorizimit, lidhur me periudhën kohore të vlefshmërisë (12 muaj), u konstatua një subjekt i cili ka importuar produkte parësore (IM5) me anë të DAV me R-2899, datë 12.03.2017, jashtë afateve të vlefshmërisë së autorizimit nr.2229/1, datë 03.02.2016, veprime këto në shkelje të nenit 256.2 dhe 275.1 të KD. Konstatimet e mësipërme, evidentohet më konkretisht në tabelën e mëposhtme:

NR	SUBJEKTI	NIPTI	AUT. RPA. NR.	DATA	DAV EXP. R	DATA	NR.PROT MOD.3	DATA	EF. FIN./LEKVlorë
1	M. WORK	L26326201A	17947/1	17.01.14	Prod. Komp. Me vlerë më të madhe				50,000
2	M. WORK	L26326201A	24393/1	09.10.15	Mb. me vonesë e regjimit		5063	13.12.17	50,000
3	DELTA alpetra	K768252100	6271/1	10.03.14	10187	16.07.15	3887/1	06.11.15	50,000
4	DELTA	K768252100	5916/1	10.03.15	10819	26.08.16	4379	02.11.16	50,000
5	DELTA	K768252100	6513/1	11.03.16	7325	20.06.17	3582	08.09.17	50,000
6	T. MARO	L36401201R	7336/2	25.03.16	5998	22.05.17	3809	25.09.17	20,000
7	2 T. GROUP	L46806203C	14781/1	10.06.16	2916	13.03.17	5097	14.12.17	20,000
8	3 T. GROUP	L46806203C	14588/1	20.06.14	9476	04.07.15	3701/1	08.09.15	50,000
9	4 T. GROUP	L46806203C	15106/1	26.06.15	5529	06.05.16	2366/1	17.06.16	50,000
10	ROMAR	L46806203C	12181/1	21.05.14	8637	21.06.15	4169	17.09.15	50,000
11	ROMAR	L46806203C	12098/1	22.05.15	7229	13.06.16	3072/1	02.11.16	50,000
12	ROMAR	L46806203C	12702/1	23.05.16	7628	27.06.17	4666	17.11.17	20,000
13	PIERILIA	J66703248G	2813/1	03.02.16	8983	15.07.16	854	01.03.17	50,000
14	PIERILIA	J66703248G	2552/1	04.02.15	3084	14.03.16	1453/1	19.08.16	50,000
15	PIERILIA	J66703248G	2316/1	30.01.14	3306	12.03.15	1722	29.04.15	50,000
16	NEVADA	L16408205N	5691/1	04.03.14	14452	20.09.14	718	19.02.15	50,000
17	NEVADA	L16408205N	294/1	25.01.14	3752	19.03.15	1738/1	27.05.15	50,000
18	NEVADA	L16408205N	2229/1	03.02.16	IM5,jashtë afateve të vlefshmërisë				50,000
19	NEVADA	L16408205N	2229/1	03.02.16	1783	15.02.17	2561	03.07.17	50,000
20	HELIOS	J66703212G	11889/1	21.05.14	8920	25.06.15	4595/1	14.10.15	50,000
21	HELIOS	J66703212G	12138/1	25.05.15	9860	01.08.16	4093/1	21.11.16	50,000
22	N. I. GOM	K37327202P	1638/1	22.01.16	3249	21.03.17	3412/3	30.08.17	50,000
SHUMA LEKVlorë									1,010,000

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësit z. Festim Kapaj, me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së regjime/ preferencë/përrjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.14 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale lidhur me shkeljet doganore të konstatuara nuk është mbajtur procesverbal konstatimi;

2. Nga ana e nëpunësve: zj. Jeta Manaj, me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/preferenca/ përrjashtime; z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrolli dokumentar klasifikim/vlerësim/ kontroll fizik, në cilësinë e doganier regjime/preferenca/përrjashtime dhe z. Skerdi Lamçellari me detyrë dhe në cilësinë e doganier akcizë, regjime/preferenca/ përrjashtime, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 15.14 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale lidhur me shkeljet doganore të konstatuara nuk është mbajtur



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

procesverbal konstatimi. Nga sektori regjime/ preferencë /përrjashtime, është vepruar jo në përputhje të kërkesave të nenit 285, pika 3, të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë që, **citojmë:** “Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve të tij nënligjore mbahet një procesverbal me shkrim.”, si dhe nenit 273, pika 3, ku përcaktohet qartë që, **citojmë:** “Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore, nga ana e strukturave doganore që kanë konstatuar shkeljen mbahet një procesverbal me shkrim, i cili duhet të nënshkruhet nga punonjësit doganorë që kryejnë verifikimin e kontrollin, si dhe shkelësi, kur shkelja është evidentuar në prani të tij.”

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 275, pika 1, ku përcaktohet qartë që:

Për shkeljet, të cilave u referohet neni 256, paragrafi 2 dhe të paparashikuara shprehimisht në këtë Kre, zbatohet një gjobë që shkon nga 50 000 lekë deri në 200 000 lekë

2. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 272, pika 2, ku përcaktohet qartë që:

Për kryerjen e kësaj kundërvajtjeje, mbajtësi i autorizimit ndëshkohet me një gjobë që shkon nga 50 000 lekë deri në 200 000 lekë.

3. Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 256, pika 1, gërma “b”, ku përcaktohet qartë që:

kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë

4. Pika 4. Neni 271 i ligjit nr.8449, dt. 27/01/1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

** Veprime jo në përputhje me nenin 271/2/a të Kodit Doganor ku përcaktohet se "për mallrat që mungojnë dhe që gjenden në ambientet e mbajtësit të autorizimit një gjobë që shkon nga një deri në trefishin e shumës së detyrimeve që duhen paguar për këto mallra " dhe 271/2/b "në rast se mallrat nuk gjenden në ambientet e mbajtësit të autorizimit pagesën e një gjobë shtesë të asaj që parashikohet në pikën (a) e barabartë me gjithë shumën e detyrimeve doganore që duhen paguar për këto mallra (produkte kompensuese dhe mallra të importuara për kohësisht në gjendjen e tyre të pandryshuar" të ligjit nr.8449, dt. 27/01/1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.*

Dalja e mallrave nga rregjimi i përpunimit aktiv.

Pikës 4 të Sesionit I të Udhëzimit nr 25 datë 30.11.2007 “Për Procedurat e Shqyrtimit të Vlerës Doganore”, neni 64 pika 1,b e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, neni 54, titulli VI “Vlera Doganore” pika c, e VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar dhe neni 35 të ligjit nr.8449, datë. 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar

Vlera prej 1,010,000 lekë, e cila përfaqëson penalitet për shkelje në fushën doganore, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Festim Kapaj me detyrë dhe në cilësinë përgjegjës i zyrës së regjime/preference/përrjashtime;
2. Znj. Jeta Manaj, me detyrë dhe në cilësinë e doganier regjime/preferenca/përrjashtime;
3. Z. Andet Hoxhaj me detyrë doganier kontrolli dokumentar klasifikim/vlerësim/kontroll fizik, në cilësinë e doganier regjime/preferenca/përrjashtime;



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Situata: Nga auditimi i procedurave doganore gjatë mbikëqyrjes së regjimeve doganore ekonomike rezultuan veprime që kanë sjelle pasoja në mosrespektim të afateve dhe sasive autorizuese që lidhen me veprimtarinë e operatorëve ekonomike që janë autorizuar të operojnë në fushën e regjimeve doganore ekonomike të përpunimit aktiv dhe pasiv si dhe regjimeve doganore ekonomike të lejimit të përkohshëm, për periudhën e juridiksionit të auditimit në **shumën totale 6,150 mijë lekë** nga të cilat shuma prej 3,275 mijë lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RLP dhe shuma prej 2,833 mijë lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA

Kriteri : Ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, VKM nr.205 datë 13.04.1999 “*Për Dispozitat e*



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Kodit Doganor”, Udhëzimit nr.1 datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

Ndikimi/Efekti Konstatohet efekt financiar i munguar me të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në formën e gjobave doganore në **shumën 6,150 mijë lekë**

Rëndësia i lartë

Rekomandimi Dega Doganore Vlorë të ndjekë dhënien e destinacionit të mallrave të hyra sipas autorizimeve të tipit RLP dhe RPA të trajtuara në Raport Përfundimtarin e Auditimit me qëllim arkëtimin e detyrimeve doganoresipas deklarimeve statistikore të kryera në procedura doganore IMP 5 dhe sanksioneve respektive në shumën totale prej **6,150 mijë lekë**nga të cilat shuma prej 4,359 mijë lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RLP dhe shuma prej 2,833 mijë lekë e konstatuar gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike RPA për shkelje doganore ndryshme të kryera nga operatorë tregtarë në kundërshtim dhe tejkallim të afateve administrative autorizuese, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve dhe sanksioneve doganore sipas anekseve nr. 65-83 të Raport Përfundimtarit të Auditimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar, ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 “*Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv*”, VKM nr.205 datë 13.04.1999 “*Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*” i ndryshuar, të trajtuar specifikisht në faqet 10-11 të Raport Përfundimtarit të Auditimit.

5. Drejtimi nr. 5 i Auditimit “*Auditimi i borxhit doganor, niveli i borxhit dhe analiza e tij dhe masat e marra për zbatimin e tij*”

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit nr.1148/1, datë 15.11.2017, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Informacionet e paraqitur nga Zyra e Borxhit doganor, lidhur me administrimin dhe masat e marra për rikuperimin e tij, gjendja në fund të periudhës së auditimit.
2. Gjendja e borxhit doganor sipas viteve në auditim (2015-9-mujori 2017)
3. Lista e subjekteve debitore gjendje më 31.12 të vitit 2014, 2015 dhe 2016, sa nga të cilat janë pajisur me Urdhëra Ekzekutimi nga Autoriteti Gjyqësorë kompetente.
4. Lista e subjekteve debitore gjendje në fund të periudhës së auditimit më 01.10.2017, sa nga të cilat janë pajisur me Urdhëra Ekzekutimi nga Autoriteti Gjyqësorë kompetente
5. Masat e marra nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë , për zbatimin e procedurave ligjore për rikuperimin në kohë të borxhit doganor.
6. Subjektet që kanë përfituar nga ligji nr. 33/2017, datë 30.03.2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

procedure e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit, pas shuarjes së detyrimeve tatimore”, si dhe procedurat e përcaktuara në udhëzimin e MF, nr. 14, datë 05.03.2017.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatuase:

Autoritetit doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë gjatë periudhës në auditim nuk kamundur të sigurojë zbatimin e poltë të legjislacionit doganor e në veçanti disa nga dispozitat e ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nenet 237, 242,243 dhe 245,kërkesat e vendimit të KM nr.205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar, si dhe kërkesat e udhëzimeve nr.6, datë 23.07.2013 dhe nr.4, datë 07.04.2016të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës.”

Për simësipër referuar nenit 237, pika 1, shkronjat a,b dhe pika 2, nenet 242-243, pikat 1, neni 245, pika 1, shkronja a, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr.32, datë 02.04. 2015, të VKM-së nr.205, datë 13.04.1999, “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar si dhe udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nr.6, datë 23.07.2013dhe nr.4, datë 07.04. 2016, “mbi zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”, përcaktohet:

Neni 237I. Shumat e detyrimeve të njoftuara sipas nenit 236 paguhen nga debitorët brenda afateve të mëposhtme:a)nëse personi nuk gëzon ndonjë prej lehtësive të pagesës të parashikuara nga aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, pagesa bëhet brenda afatit të parashikuar.

Zgjatja jepet automatikisht kur vërtetohet se personi i interesuar e mori njoftimin tepër vonë dhe se kryerja e pagesës brenda afatit të parashikuar ishte e pamundur.

Gjithashtu autoritetet doganore mund të japin zgjatje të afatit, me kërkesë të debitorit, kur shuma e detyrimeve që duhet paguar është pasojë e një vjeljeje pas zhdoganimit. Kjo zgjatje e kufirit kohor nuk duhet të kalojë 10 ditët;

b)nëse personi gëzon ndonjërin nga lehtësitë e pagesës së parashikuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, pagesa bëhet jo më vonë se përfundimi i afatit ose i afateve të përcaktuara në lidhje me këto lehtësira.

2. Kur, një kërkesë për shuarjen e detyrimeve, bëhet sipas neneve 250, 251 ose 252 ose kur mallrat janë sekuestruar, me synim konfiskimin e mëvonshëm të tyre sipas nenit 246 (b), (c) (ii), ose (d), detyrimi i debitorit për pagimin e detyrimeve do të përmbushet me vonë, sipas kushteve të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 242

1. Afati i shtyrjes së pagesës është 30 ditë

Neni 243.

1. Autoritetet doganore mund t'i japin debitorit edhe lehtësi të tjera pagese, përveç shtyrjes së afatit të pagesës.

Neni 245

1. Kur shuma e detyrimeve që duhen paguar nuk është shlyer brenda afatit të caktuar:

a)autoritetet doganore përdorin të gjitha mjetet ligjore për të siguruar pagesën e shumës së borxhit doganor. Dispozita të posaçme për dorëzantinë brenda kuadrit të regjimit të transitit do të parashikohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

3. Autoritetet doganore mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente edhe pezullimin e aktivitetit ekonomik të debitorit në lidhje me importimin, eksportimin, dhe tranzitimin e mallrave ose të aktiviteteve të tjera prodhuese për ushtrimin e të cilave debitori është regjistruar pranë autoriteteve të taksave.

4. Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, bëhen tituj ekzekutive menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit. Ekzekutimi i vendimeve të sipërpërmendura bëhet në bazë të dispozitave të parashikuara



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

nga nenet 511 dhe në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile.

Titujt ekzekutive të nxjerre nga administrata doganore, menjëherë sapo mbështeten me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejte nga organet e administratës doganore.

-Zbatimi i udhëzimeve nr.6, datë 23.07.2013 dhe nr.4, datë 07.04. 2016, të Drejtorisë së Përgjithshme së Doganave “mbi zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentet e paraqitura nga Zyra eBorxhit doganor dhe Zyra e Financës pranë D.D.Vlorë për periudhën në auditim vitet 2015, 2016 dhe 9-mujori 2017, për zbatimin procedurave ligjore-administrative, lidhur me masat e marra për rikuperimin e borxhit doganor u konstatua se:

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 216-255, të kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar si dhe udhëzimevetë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nr.6, datë 23.07.2013 dhe nr.4, datë 07.04. 2016, “mbi zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës” u konstatua se;

I-Gjendja e borxhit doganor gjatë periudhës në auditim, vitet 2015, 2016 deri më 01.10.2017, paraqitet si më poshtë:

VITI 2015:

Pasqyra nr.1:Gjendja, shtesat dhe paksimet e borxhit doganor gjatë vitit 2015.

Gjendja më 01.01.15		Shtuar		Pakësuar		Gjendja më 31.12.15	
Debitorë	Vlera	Debitorë	Vlera	Debitorë	Vlera	Debitorë	Vlera
221	711,692,054	26	215,638,588	21	124,515,987	226	802,814,655
TOTALI	711,692,054	26	215,638,588	21	124,515,987	226	802,814,655

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të paraqitura si mësipër rezulton se gjendja e borxhit doganorë në fillimin të periudhës së auditimit ka qenë në vlerë 711,692,054 lekë, është shtuar në vlerë 215,638,588 lekë, është pakësuar në vlerë 124,515,987 lekë, gjendja në fund të periudhës së audituar arrin në vlerë 802,814,655 lekë, me rritje në vlerë absolute **prej 91,122,601 lekë**, ose në masën **12,8 %**. Nga auditimi i të dhënave të mësipërme u konstatua se autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë , për rikuperimin (arkëtimin) e borxhit doganor ka punuar në vazhdimësi gjatë gjithë muajve të vitit, por rezultatetmë të mira janë arritur gjatë muajit mars ku janë arkëtuar 7,412,772 lekë, gjatë muajit maji janë arkëtuar 8,681,772 lekë, gjatë muajit korrik janë arkëtuar 9,300,556 lekë, gjatë muajit shtator janë arkëtuar 53,831,011 lekë dhe gjatë muajit tetor janë arkëtuar 24,671,589 lekë,ose vetëm gjatë këtyre muajve është rikuperuar një borxh doganor në vlerë **103,897,700 lekë**, ose sa 83,4 %, e borxhit doganor të arkëtuar gjatë vitit 2015 gjithsej.

VITI 2016:

Pasqyra nr.2: Gjendja, shtesat dhe pakësimi borxhit doganor gjatë vitit 2016.

Gjendja më 01.01.16		Shtuar		Pakësuar		Gjendja më 31.12.16	
Debitorë	Vlera	Debitorë	Vlera	Debitorë	Vlera	Debitorë	Vlera
226	802,814,655	131	58,970,089	161	21,970,104	196	839,814,640
TOTALI	802,814,655	131	58,970,089	161	21,970,104	196	839,814,640

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të paraqitura si mësipër rezulton se gjendja e borxhit doganorë në fillimin të periudhës së auditimit ka qenë në vlerë **802, 814, 655 lekë**është shtuar gjatë vitit në vlerë **58,970,089 lekë**, është pakësuar në vlerë **21,970,104 lekë**,gjendja në fund të periudhës së audituar ka arritur në vlerë **839,814,640 lekë**, me rritje në vlerë **36,999,985 lekë**, ose në masën **4,6 %**. Nga auditimi i të dhënave të mësipërme u konstatua se



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë , ka punuar për rikuperimin (arkëtimin) e borxhit doganor por rezultatet e masave të marra nuk kanë arritur të rikuperojnë më shumë se sa 37 % të vlerës së shtuar gjatë periudhës në auditim.

9-mujori i vitit 2017.

Pasqyra nr.3:Gjendja, shtesat dhe pakësimet e borxhit doganor gjatë 9-mujorit 2017.

Gjendja më 01.01.17		Shtuar		Pakësuar		Gjendja më 30.09.17	
Debitorë	Vlera	Debitorë	Vlera	Debitorë	Vlera	Debitorë	Vlera
196	839,814,640	60	17,507,299	52	38,025,139	204	819,296,800
TOTALI	839,814,640	60	17,507,299	52	38,025,139	204	819,296,800

Gjendja e borxhit doganor në fillim të vitit 2017 kaqenë në vlerën 839,814,640 lekë, është shtuar gjatë periudhës së audituar në vlerë 17,507,299 lekë, është pakësuar në vlerë 38,025,139 lekë dhe gjendja në fund të 9-mujorit të vitit 2017 arrin **në vlerë 819,296,800 lekë**. Në përfundim të auditimit të masave të marra për rikuperimin e borxhit doganor gjatë periudhës së audituar u konstatua se:

Pasqyra nr.4: Gjendja dhe lëvizjet e borxhit doganor gjatë periudhës janar 2015 deri më 30.09.2017.

VITET	Gjendja në fillim		Shtuar		Pakësuar		Gjendja në fund	
	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë	Debitorë	Vlerë
2015	221	711,692,054	26	215,638,588	21	124,515,987	226	802,814,655
2016	226	802,814,655	131	58,970,089	161	21,970,104	196	839,814,640
2017	196	839,814,640	60	17,507,299	50	38,025,139	206	819,296,800
Totali	-	-	-	292,115,975	-	184,511,230	206	819,296,800

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se borxhi doganor për të gjithë periudhën e audituar është shtuar në vlerë 292,115,975 lekë dhe është pakësuar në vlerë 184,511,230 lekë, me një rritje në vlerë 107,604,945 lekë. Rritjen më të madhe gjatë viteve në auditim borxhi doganor e ka pësuar gjatë vitit 2015 në vlerë 215,638,588 lekë, po kështu është arritur dhe arkëtimi më i madh për të gjithë periudhën e audituar në vlerë 124,515,987 lekë.

Gjendja e borxhit doganor më 30.09.2017, mbas verifikimit dhe krahasimit të të dhënave megjendjen e kontabilitetit që administron Zyra e Financës pranë Degës së Doganës Vlorë , u konstatua se ato janë të përputhura dhe pa diferenca.

Në listën e subjekteve që rezultojnë me borxhe doganorë të papaguar më 30.09.2017 **në vlerë 819,296,800 lekë** janë përfshirë **206 debitorë** gjithsej, nga të cilët dy prej tyre në vlerë të përgjithshme **571,630,468 lekë**, (551,436,587 lekë+20,193,881 lekë), gjenden në proces falimentimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

Në këto kushte gjendja e borxhit doganor e pa rikuperuar më 30.09.2017 përbëhet nga 204 subjekte **në vlerë 247,666,332 lekë**, (819,296,800-571,630,468)

Struktura e borxhit doganor sipas viteve të krijimit, paraqitet;

Pasqyra nr.5:Gjendja e borxhit doganorë më 30.09.2017.

Vitet	Subjekte	Shuma (leke)
2009	1	1,213,579
2010	12	19,502,452
2011	57	155,880,162
2012	19	23,830,793
2013	10	32,026,719
2014	23	479,258,252
2015	52	89,828,033
2016	11	9,422,828
2017	19	8,333,982
Totali	204	819,296,800

Nga analiza e të dhënave të paraqitura si më sipër rezulton se gjendja e borxhit doganor më 30.09.2017, përbëhet nga 204 subjekte të cilët e kanë fillimin e tyre që nga viti 2009 e deri në vitin 2017, me një shtrirje prej 9 vitesh ku borxhi i krijuar është mbartur vit pas viti.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Nga të dhënat e paraqitura konstatohet se nga 204 subjekte të konstatuara me borxhë doganor, 122 subjekte në vlerë **711,711, 957 lekë** i përkasin periudhës para viteve në auditimi.

Nga auditimi dhe analiza e gjendjes së borxhit doganor të krijuar nga viti 2009 e deri më 30.09.2017, u konstatua se masat e marra nga autoriteti doganor kompetent, D.D.Vlorë gjatë viteve nuk kanë qenë të plota sepse rikuperimi i borxhit doganorë nuk është mbështetur me programe pune vjetore dhe të përditësuara, por rikuperimi i tij është bërë vetëm nëpërmjet një pune rutinë dhe në vartësi të trysnive të ushtruara nga Ministria e Financave dhe në raste të veçantadhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të cilat për hirë të së vërtetës e kanë patur më të thjeshtë që borxhet të falen se sa të rikuperohen. Nga auditimi dhe analiza e gjendjes së borxhit doganorë më 30.09.2017 u konstatua se **204 subjekte** zënë një vlerë **247,666,332 lekë**, nga të cilat vetëm 46 subjekte zenë një vlerë prej **223,077,212 lekë**, ose sa **90 %** të borxhit gjendje.

Pasqyra nr.6, janë renditur subjektet debitore në strukturë, me borxh doganorë mbi 1 milionë lekë, gjendje më 30.09.2017.

Trajtuar me hollësisht ne aneksin nr.5 bashkangjitur këtij Raport Përfundimtar Auditimi

II. Disa nga shkaqet më kryesore që kanë ndikuar në krijimin e borxhit doganor gjatë periudhës në auditim.

- mos zbatimi nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë i dispozitave të ligjit nr.8449, datë 27.01.1997, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”,
- mos përcaktimi i saktë i vlerës së mallrave për qëllime doganore,
- mos përcaktimi i saktë origjinës së mallrave dhe origjinës preferenciale,
- mos zbatimi i dispozitave të Kodit Doganor lidhur me regjimet ekonomike,
- mos zbatimi i Kodit Tarifor të Nomenklaturës së Kombinuar lidhur me Klasifikimin Tarifor të Mallrave,
- mos zbatimi i kërkesave të ligjit nr.61/2012, datë 19.05.2012 “Për Akcizat në RSH”, i ndryshuar,
- mos zbatimi i procedurave ligjore, gjatë aplikimit të Skemës së Shtyrjes së Pagesës së TVSH-së, etj.

III-Masat e marra për rikuperimin e borxhit doganor, gjatë periudhës në auditim.

Zyra e Borxhit; në vazhdimësi e në mënyrë sistematike ka informuar Kryetarin e Degës së Doganës Vlorë dhe Sektorin e Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor pranë Departamentit Operativ Hetimor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për shkaqet dhe arsyet e shtimit apo të mos arkëtimit të borxhit doganor nga subjekte të ndryshme e deri tek marrja e masave për nxjerrjen e vendimeve për rikuperimin me forcë të këtij borxhi duke zbatuar të gjitha hapat ligjore të përcaktuar nga legjislacioni doganor në fuqi.

Zyra e Borxhit Doganor, pranë D.D.Vlorë, ka marrë masa të plota administrative-ligjore për rikuperimin e borxhit doganorë nëpërmjet zbatimit të dispozitave të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenet 216-255.

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë rikuperimin e borxhit doganor e ka kërkuar nëpërmjet vënies në ekzekutim të detyrueshëm të Urdhërave të Ekzekutimit të nxjerra nga Autoriteti Gjyqësorë kompetent në të gjitha rastet që ajo ka paraqitur kërkesë.

Mbas mbështetjes së titujt ekzekutiv të nxjerra nga D.D.Vlorë nga Autoriteti Gjyqësorë kompetent Vlorë me Urdhëra Ekzekutimi, ajo ka kërkuar menjëherë bashkëpunim ndër institucional me të gjitha strukturat shtetërore që janë ngarkuar nga ligja për rikuperimin e borxhit, ku mund të përmendim

-Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugorë Vlorë ,



KONTROLLI I LARTE I SHETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

-Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugorë Vlorë ,

-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë ,

-Zyrën Qëndore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë,

-Qendrën Kombëtar të Biznesit (QKB) Tiranë,

-Drejtorinë e Përgjithshme Detare Durrës,

-Policinë së Shtetit,

-Pushetin Lokal,

-Zyrëne Përmbarimit Gjyqësorë Shtetërorë Vlorë ,

-Autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë , për të siguruar rikuperimin e plotë të borxhit doganorë ka proceduar edhe me referimin e kallëzimeve penale për të gjitha regjimet doganore të pambyllura mbi 55 subjekte për veprën penale kontrabandë me mallra me regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal dhe për veprën penale mos pagimi i detyrimeve pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Vlorë , nga e cila janë arkëtuar 3,479,778 lekë. Procedurat penale të ndjekura nga D.D.Vlorë s, janë pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Vlorë , e cila ka penalizuar një numër të konsiderueshëm subjektësh, të cilët në zbatim të nenit 4 të ligjit të faljes nuk përfitojnë nga amnistia.

-ajo ka krijuar një bashkëpunim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve,

-ajo ka kërkuar pranë D.P.Doganave bllokimin eNIPT-ve të subjekteve debitore në Sistem, si dhe bashkëpunimin me Drejtorinë Rajonale Tatimore për pezullimin e aktivitetit ekonomik të këtyre subjekteve,

-Të gjitha subjektet me të cilët ka bashkëpunuar Zyra e Borxhit doganor nëpërmjet praktikave shkresore kanë reaguar në mënyrë ligjore dhe kanë treguar interes për bashkëpunimin e krijuar duke marrë pjesë aktive lidhur me rikuperimin e borxhit doganor.

-Veprimet e kryera nga Zyra e Borxhit janë të dokumentuara me njoftime dhe lajmërimet marrje njoftimi nga subjektet debitorë, me shpallje publike pranë Degës së Doganës Vlorë , si dhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe pranë ambienteve të Bashkive të Qarkut Vlorë .

IV. Gjendja e Borxhit Doganor,

Gjendja e regjistrit kontabël të administruar nga Dega e Doganës Vlorë më 30.09.2017, përbëhet nga 206 subjekte në vlerë 819,296,800 lekë , e cila në strukturë përbëhet nga 204,479,713 lekë detyrime të papaguara, 513,559,141 lekë gjoba të zbatuara dhe 101,257,946 lekë kamat vonesa të llogaritura, të cilat janë kontabilizuara.

Nga auditimi dhe analiza mbi gjendjen në strukturë të borxhit doganor të disa subjekteve doganore të përzgjedhura në bazë të vlerës më të madhe, gjendje më 30.09.2017 u konstatua se; nisur nga detyrimi ligjor për auditimin e rikuperimit të borxhit doganor dhe të akcizës, mbështetur në ligjin nr. 8449, datë 27.11.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, V.K.M-në nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr.4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, si dhe në zbatim të Planit të Veprimit “Së bashku kundër informalitetit” të miratuar nga Ministria e Financave, Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 40, datë 30.09.2017 “Për zbatimin e planit të veprimit kundër informalitetit”, autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë ka marrë të plota ligjore e administrative për rikuperimin e borxhit doganor dhe të akcizës, ku mund të cilësojmë subjektet si më poshtë :

1-Subjekti “*Italian Sofa By Galli*” meNIPT K87224201R rezulton me gjendje debitorë në vlerë 1,026,0622 lekë që nga vitit 2010, i cila përbëhet nga 578,150 lekë detyrime doganore,



KONTROLLI I LARTE I SHETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE
VLORE”

50,000 lekë penalitete janë llogaritur 397,912 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 0,4 % të borxhit.

2-Subjekti “*Con Noi*” meNIPT K67401204Vlorë rezulton me gjendje debitore në vlerë 3,616,670 lekë, që nga viti 2010 e cila përbëhet nga 769,795 lekë detyrime doganore janë zbatuar 1,539,590 lekë penalitete, janë llogaritur 1,307,285 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 1,46 % të borxhit.

3-Subjekti “*Romalba End Alb*” meNIPT K91425010E rezulton me gjendje debitore në vlerë 8,261,642 lekë, që nga viti 2010 e cila përbëhet nga 3,164,161 lekë detyrime doganore janë zbatuar 2,236,546 lekë penalitete, janë llogarit 2,860,935 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 3,3 % të borxhit.

4-“*Gelis Accesori*” meNIPT K96903204C rezulton me gjendje debitore në vlerë 1,813,759 lekë, që nga viti 2010 e cila përbëhet nga 616,557 lekë detyrime doganore janë zbatuar 616,577 lekë penalitete, janë llogarit 580,605 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 0,7 % të borxhit.

5-“*Hanxhari*” meNIPT J66915252I rezulton me gjendje debitore në vlerë 7,401,356 lekë, që nga viti 2011 e cila përbëhet nga 7,089,212 lekë detyrime doganore janë zbatuar 100,000 lekë penalitete, janë llogarit 212,144 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 3 % të borxhit.

6-“*Kalaja*” meNIPT J76705217 L rezulton me gjendje debitore në vlerë 1,292,408 lekë, që nga viti 2010 e cila përbëhet nga 1,292,408 lekë kamat vonesa të llogaritura. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 0,5 % të borxhit.

7-“*Preza 1x1*” meNIPT K51918008 O rezulton me gjendje debitore në vlerë 6,913,813 lekë, që nga viti 2011 e cila përbëhet nga 1,245,356 lekë detyrime doganore janë zbatuar 3,736,068 lekë penalitete, janë llogarit 1,932,489 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 2,8 % të borxhit.

8-“*Europa Cnstruksion*” meNIPT K34107808K rezulton me gjendje debitore në vlerë 8,590,158 lekë, që nga viti 2010 e cila përbëhet nga 4,152,472 lekë detyrime doganore janë zbatuar 2,076,237 lekë penalitete, janë llogarit 2,361,450 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 3,5 % të borxhit.

9-“*Premiero-S-92*” meNIPT K83116202U rezulton me gjendje debitore në vlerë 32,115,698 lekë, që nga viti 2011 e cila përbëhet nga 3,757,920 lekë detyrime doganore janë zbatuar 18,789,600 lekë penalitete, janë llogarit 9,568,178 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 13 % të borxhit.

10-“*GFA-Asfalt*” meNIPT K8723201J rezulton me gjendje debitore në vlerë 3,978,209 lekë, që nga viti 2011 e cila përbëhet nga 2,456,531 lekë detyrime doganore janë zbatuar 100,000 lekë penalitete, janë llogarit 1,421,678 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 1,6 % të borxhit.

11-“*Dova Fat*” meNIPT J66703204P rezulton me gjendje debitore në vlerë 1,224,103 lekë, që nga viti 2011 e cila përbëhet nga 921,245 lekë detyrime doganore, janë llogarit 302,858 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 0,5 % të borxhit.

12-“*Aladin Union*” meNIPT L16328001U rezulton me gjendje debitore në vlerë 4,110,940 lekë, që nga viti 2011 e cila përbëhet nga 3,077,044 lekë detyrime doganore janë zbatuar 50,000 lekë penalitete, janë llogarit 983,896 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 1,66 % të borxhit.

13-“*Hema Metal*” meNIPT J16314204J rezulton me gjendje debitore në vlerë 1,077,973 lekë, që nga viti 2011 e cila përbëhet nga 275,580 lekë detyrime doganore janë zbatuar 551,160 lekë penalitete, janë llogarit 251,233 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 0,45 % të borxhit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

14-“Gjikondi” meNIPT K06924215V rezulton me gjendje debitore në vlerë 1,077,935 lekë, që nga viti 2012 e cila përbëhet nga 833,940 lekë detyrime doganore janë zbatuar 50,000 lekë penalitete, janë llogarit 193,995 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 0,44 % të borxhit.

15-“Trans Beton” meNIPT L26603204K rezulton me gjendje debitore në vlerë 43,593,856 lekë, që nga viti 2013 e cila përbëhet nga 38,740,000 lekë penalitete, janë llogarit 4,853,859 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 17,6 % të borxhit.

16-“Sejmon Europa Konstruksion” meNIPT K96922205N rezulton me gjendje debitore në vlerë 7,761,103 lekë, që nga viti 2010 e cila përbëhet nga 5,320,959 lekë detyrime doganore janë zbatuar 1,393,463 lekë penalitete, janë llogarit 1,001,681 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 3,3 % të borxhit.

17-“Vlora Konfeksion” meNIPT J668,28202M rezulton me gjendje debitore në vlerë 23,766,260 lekë, që nga viti 2015 e cila përbëhet 7,219,032 lekë detyrime doganore, janë aplikuar 14,436,064 lekë penalitete, janë llogarit 2,109,164 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 9,9 % të borxhit.

18-“Maurizio Colombo” me Person Fizik pasaport 028431297 rezulton me gjendje debitore në vlerë 2,094,221 lekë, që nga viti 2015 e cila përbëhet nga 1,317,120 lekë detyrime doganore, janë aplikuar 658,560 lekë penalitete, janë llogarit 118,541 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 0,8 % të borxhit.

19-“Fatmir Krasniqi” me Person Fizik (Kosovar) rezulton me gjendje debitore në vlerë 10,072,205 lekë, që nga viti 2015 e cila përbëhet nga 6,334,720 lekë detyrime doganore, janë aplikuar 3,167,360 lekë penalitete, janë llogarit 570,125 lekë kamat vonesa. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 4 % të borxhit.

20-“Aza-Elektronik” meNIPT K17217201V rezulton me gjendje debitore në vlerë 1,780,212 lekë, që nga viti 2016 e cila përbëhet nga 1,780,212 lekë penalitete. Në totalin e borxhit gjendje ky subjekt zë 0,8 % të borxhit.

Nga Auditimi dhe Analiza e Vendimeve Administrative :

të nxjerra gjatë periudhës kohore 01.01.2015-01.10.2017, nga Dega e Doganës Vlorë , u konstatua se janë materializuar dhe kontabilizuar 89 (tetëdhjetë e nëntë) vendime, në vlerë 15,734,324 lekë nga të cilëve janë rikuperuar plotësisht 84 (tetëdhjetë e katër) vendime në vlerë 10,490,423 lekë dhe nuk janë rikuperuar 5 (pesë) vendime në vlerë 5,243,901 lekë, ku kemi nga grupi auditues janëanalizuar subjektet ;

1. Subjekti “Gema Accesori” shpk, meNIPT K87101208B, për të cilin është materializuar vendimi administrativ nr.39, protokolluar në doganë me nr.2079,/3, datë 24.07.2017, i cili duhet të paguante detyrimin doganor në shumën 1.346.789 lekë, në bazë të nenit 256/4 të Kodit Doganor, si dhe dënimi me gjobë në masën e njëfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 1.346.789 lekë, në bazë tënenit 271/2/a të Kodit Doganor. Vendim i është njoftuar subjektit me shkresën e D.D.Vlorë nr.2079/4 prot, datë 24/07/2017 me përmbajtje “Njoftim Vendimi”, i cili nuk mbërritur në destinacion bazuar kjo në konfirmimin e shërbimit postar (Lajmërim marrje me numër RR 216 953 226 AA), sepse zarfi i njoftimit është rikthyer në Degën e Doganës Vlorë me shënimin “I panjohur”. Në këto kushte D.D.Vlorë ka proceduar me shkresën nr. 3180 prot, datë 10.08.2017 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrative (Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore)”, drejtuar Prefekturës së Qarkut Vlorë , e cila ka konfirmuar njoftimin publik me shkresën e saj nr. 1725 prot., datë 30.08.2017 me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar me në doganë me numër 3180/1, datë 05.09.2017. Me qëllim zbatimin në mënyrë korrekte të procedurës së rikuperimit të borxhit dhe detyrimeve doganore, si dhe respektimin e kësaj procedure sipas përcaktimeve ligjore konkrete, bazuar në Kodin Doganor, si dhe në udhëzimin nr.6, datë 23.07.2013 të Drejtorisë



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”, me shkresën nr.3461 prot, datë 31.08.2017 me lëndë “Urdhër i brendshëm”, janë urdhëruar të gjithë sektorët në Degën e Doganës Vlorë , midis të tjerave në rast paraqitje në doganë të subjektit “Gema ACCESSORI“ shpk, meNIPT K87101208B, ti pezullohen menjëherë procedurat doganore. Në këto kushte në zbatim të Vendimit nr.39, me nr. 2079/3 prot., datë 24/07/2017, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që debitori-subjekti “Gema ACCESSORI“ shpk, meNIPT K87101208B, me seli në Vlorë ka ndaj Degës Doganore Vlorë , bazuar në nenin 245 pika 2,4 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe udhëzimin nr.4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë - “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, nga ana e D.D.Vlorë është materializuar vendimi nr.3768 prot., datë 21.09.2017 me lëndë “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor që debitori, subjekti “Gema ACCESSORI“ shpk, meNIPT K87101208B, me seli në Vlorë , ka ndaj Degës së Doganës Vlorë ”, i cili i është njoftuar këtij subjekti me shkresën nr.3768/1 prot., datë 21.09.2017 me lëndë “Njoftim vendimi” dhe rezulton nga shërbimi postar (Lajmërim marrje me numër RR 214 627 144 AA), se zarfi i njoftimit është rikthyer në Degën e Doganës Vlorë me shënimin “I panjohur”. Më tej është proceduar me shkresën nr.3796 prot., datë 25.09.2017 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrative (Vendimit të sekuestros)”, drejtuar Prefekturës së Qarkut Vlorë , si dhe me shkresën nr.4076 prot., datë 10.10.2017 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrative (Vendimit të sekuestros)”, drejtuar Bashkisë Vlorë . Pas ezaurimit të lajmërimit publik, është proceduar me shkresën nr.4309 Prot., datë 25.10.2017 me lëndë “Kërkesë–Për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit”, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë , e cila pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur, lëshuar urdhërin e ekzekutimit nr.255 vendimi datë 31.10.2017, I cili I është njoftuar subjektit debitor me shkresën nr.4309/1 prot., datë 06.11.2017, me lëndë “Njoftim-Për shlyerje vullnetare të detyrimeve doganore”. Rezulton se shkresa nr. 4309/1 Prot., datë 06.11.2017, është rikthyer në Degën e Doganës Vlorë me kod bar RR 090 907 900 AA, me shënimin “Larguar”. Më tej, nga ana e Degës së Doganës Vlorë , është proceduar me shkresën nr.4845 Prot., datë 24.11.2017 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit shkresor”, drejtuar Prefekturës së Qarkut Vlorë , me të cilën është kërkuar shpallja publike e shkresën nr. 4309/1 prot., datë 06.11.2017, me lëndë “Njoftim-Për shlyerje vullnetare të detyrimeve doganore”. Me shkresën nr.2521 prot., datë 11.12.2017 me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr. 4845/1, datë 14.12.2017, Prefektura e Qarkut Vlorë , ka konfirmuar njoftimin publik. Dega e Doganës Vlorë me shkresën nr. 4868 prot., datë 30.11.2017, me lëndë “Dërgim i Urdhërit të Ekzekutimit”, ka dërguar urdhërin e ekzekutimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, por detyrimidoganor në vlerë 2,693,578 lekë nuk është rikuperuar.

2. Subjekti “Aza Elektroshtëpiake” shpk, meNIPT K17217201V, në zbatim të vendimit nr.50, me nr.2710/3 prot, datë 10.08.2017, në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Kontrollit pas Zhdoganimit me nr.10682/4 prot, datë 04.07.2017 me lëndë “Raport Kontrolli Përfundimtar lidhur me Programin e Kontrollin nr. 10682 prot date 11..03.2017”, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr. 2710, datë 11.07.2017, si dhe mbas observacioneve të paraqitura nga subjekti D.D.Vlorë ka nxjerr vendimin administrative dhe vendimin e kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.50, prot në doganë me nr.2710/3 prot., datë 10.08.2017, në ngarkim të subjektit “AZA Elektroshtëpiake” me seli në Vlorë , me përfaqësues ligjor z. Alfred Bejkosala. Në bazë të këtij vendimi është vendosur që subjekti “AZA Elektroshtëpiake Vlorë ” shpk, meNIPT K17217201V, me aktivitetit në Vlorë , të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

kryejë menjëherë shlyerjen e detyrimit doganor të papaguar, në shumën 593,404 lekë në zbatim të nenit 256, pika 4 e Kodit Doganor, si dhe dënimi me gjobë në masën e trefishit të detyrimit doganor të papaguar, në shumën 1.780.212 lekë, në zbatim të nenit 261 pika 2 e Kodit Doganor. Vendim i është njoftuar subjektit dhe përfaqësuesit të tij agjencisë doganore “GAD UNIVERSI” me kod J 102 me shkresën e D.D.Vlorë nr. 2710/4 Prot., datë 14.08.2017 me lëndë “Njoftim Vendimi dhe rezulton nga shërbimi postar se subjekti ka marrë njoftim më datë 31.08.2017 (konfirmuar nga Lajmërim marrje me kod bar RR 214 359 023 AA), ndërsa përfaqësuesi i tij ka marrë njoftim më datë 31.08.2017 (konfirmuar nga Lajmërim marrje me kod bar RR 210 109 008 AA). D.D.Vlorë me qëllim zbatimin në mënyrë korrekte të procedurës së rikuperimit të borxhit dhe detyrimeve doganore, si dhe respektimin e kësaj procedure sipas përcaktimeve ligjore konkrete, bazuar në Kodin Doganor, si dhe në udhëzimin nr. 6, datë 23.07.2013 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”, me shkresën nr.3461 prot., datë 31.08.2017 me lëndë “Urdhër i brendshëm”, janë urdhëruar të gjithë sektorët në Degën e Doganës Vlorë , midis të tjerave në rast paraqitje në doganë të subjektit “Aza Elektroshtëpiake”shpk, meNIPT K17217201V, t’i pezullohen menjëherë procedurat doganore. Ndërsa me shkresën nr.3538 Prot., datë 07.09.2017 me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, i është kërkuar subjektit të likuidojë në mënyrë vullnetare të gjithë detyrimin doganorë të papaguara në shumën 2,373,616 lekë. Me shkresën nr. 3538/1 prot, datë 19.09.2017 me lëndë “Rikërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, i janë rikërkuar subjektit likuidimi vullnetare i detyrimeve doganorende të papaguara në shumën totale 2,373,616 lekë.

Nga ana e subjektit është likuiduar plotësisht detyrimi doganor (amendimi i dhjetë deklartave doganore është kryer nga Zyra e Kontrollit aposterior më datë 25.09.2017), në vlerë 593,404 lekë, ndërsa gjobën subjekti ka administruar në Degën e Doganës Vlorë me Garanci Bankare të lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare-Filiali Vlorë me numer reference 408GCCA172680001. Me shkresën nr.3831 prot., datë 26.09.2017 D.D.Vlorë ka dërguar informacion mbi amendimin e deklaratave doganore”, për të cilat është njoftuar subjekti për amendimin e dhjetë deklaratave doganore. Nga e subjektit është ushtruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - ankimi administrativ për vendimit nr.50, me nr. 2710/3 prot., datë 10.08.2017 dhe nr.21868 prot., datë 27/09/2017. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me shkresën nr.21868/10 prot., datë 01.12.2017 me lëndë “Mbi kërkesën ankimore”, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë nr.4952, datë 05.12.2017, ka vendosur “Lënien në fuqi të Vendimit nr. 50, datë 10.08.2017 të Degës së Doganës Vlorë dhe rrëzimin e ankimit nr.21868 prot., datë 27.09.2017, të subjektit “Aza Elektroshtëpiake” shpk.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financës pranë DPD-së ngarkohet me ndjekjen e proceduravepër kalimin e shumës së garancisë në llogarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Bashkëlidhur praktikave shkresore certifikata origjinalee garancisë nr. 815, datë 25.09.2017 e lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare. Dhe në fund kjo procedurë është mbyllur në favor të D.D.Vlorë në vlerë 2,693,578 lekë.

3. **Subjekti “KRIST-KONSTRUKSION” shpk, meNIPTK86923205R**, me përfaqësues ligjor z. Adriatik Selami, me seli në Vlorë në zbatim të vendimitnr.68, me nr. 2391/2 prot., datë 11.09.2017, të konstatuar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, me të cilin është vendosur qësubjekti të paguajë detyrimin doganor në shumën 1.700.215 lekë në zbatim tënenit 256/4 të Kodit Doganor, si dhe një gjobë në përputhje me rekomandimin në vlerë 850.108 lekë në zbatim tënenin 273/2 të Kodit Doganor. Vendim i është njoftuar subjektit me shkresën nr.2391/3 prot., datë 11.09.2017 me lëndë “Njoftim Vendimi”, i cili nuk konfirmohetnga shërbimi postar (Lajmërim Marrje me kod bar RR 171 306 485 AA), pasi zarfi i njoftimit



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

është rikthyer në Degën e Doganës Vlorë me shënimin “Larguar”. D.D.Vlorë me qëllim zbatimin në mënyrë korrekte të procedurës së rikuperimit të borxhit dhe detyrimeve doganore në përputhje me procedurën ligjore bazuar në Kodin Doganor, si dhe në udhëzimin nr.6, datë 23.07.2013 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”, me shkresën nr.3779 prot., datë 22.09.2017 me lëndë “Urdhër i brendshëm”, janë urdhëruar të gjithë sektorët në Degën e Doganës Vlorë , midis të tjerëve, në rast paraqitje në doganë të subjektit “KRISTI - KONSTRUKSION” shpk, meNIPTK86923205R, t'i pezullohen menjëherë procedurat doganore. Gjithashtu është proceduar dhe me shkresën nr.3849 prot., datë 28.09.2017 “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ (Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore)”, drejtuar Prefekturës së Qarkut Vlorë , dhe me shkresën nr. 4074 Prot., datë 10.10.2017 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të akteve administrativ (Vendimet të kontabilizimit të detyrimeve doganore)”, drejtuar Bashkisë Vlorë . Në këto kushte, në zbatim të Vendimit nr.68, me nr.2391/2 prot., datë 11.09.2017, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, subjekti “Kristi- Konstruksion” shpk, meNIPTK86923205R, me seli në Vlorë , ka ndaj Degës Doganore Vlorë , në zbatim të nenit 245 pikat 2,4 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe udhëzimin nr.4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, nga D.D.Vlorë është nxjerr vendimi nr.2391/4 prot., datë 24.10.2017 me lëndë “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor që debitori, subjekti “Kristi-Konstruksion” shpk, meNIPTK86923205R, me seli në Vlorë , ka ndaj Degës së Doganës Vlorë ”, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr.2391/5 prot., datë 25.10.2017 me lëndë “Njoftim vendimi” i cilinuk rezulton nga shërbimi postar (Lajmërim marrje me numer RR 211 503 809 AA) dhezafi i njoftimit është rikthyer në doganë me shënimin “Larguar”. Më pas D.D.Vlorë ka proceduar me shkresën nr. 4385 prot., datë 31.10.2017 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të akteve administrativ (Vendimet e Sekuestros të detyrimeve doganore)”, drejtuar Prefekturës së Qarkut Vlorë , dhe me shkresën nr. 4386 Prot., datë 31.10.2017 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të akteve administrativ (Vendimet Sekuestros të detyrimeve doganore)”, drejtuar Bashkisë Vlorë , të cilët kanëkonfirmuar njoftimin publik me qëllim vijimin e procedurave për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore. D.D.Vlorë me shkresën nr. 4840 prot., datë 30.11.2017 me lëndë “Kërkesë” për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, lidhur vendimin e sekuestros nr. 2391/4 prot., datë 24/10/2017”, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë , e cila pas shqyrtimit të kërkesës ka nxjerr urdhërin e ekzekutimit nr. 286, vendimi datë 05.12.2017. Detyrimet doganore të subjektit në vlerë 2,550,323 lekë deri në momentin e auditimit nuk janë rikuperuar.

V. Mbi Zbatimin e ligjit të faljes nr.33/2017.

Në zbatim të ligjit të faljes nr.33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”, autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë ka analizuar rast pas rasti gjendjene subjekteve debitorë që përfitojnë nga zbatimi i ligjit, e konkretisht

-Në zbatim të nenit 9/1 autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë me 13 vendime të nxjerra prej tij ka shuar një borxh doganor në vlerë 20.716.031 lekë.

-Në zbatim nenit 9/2, janëfshirë/shuar nga regjistrat detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, të papaguara ndaj administratës doganore dhe të



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

evidentuara për individët, lidhur me produktet e duhanit, nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate deri në datën 31 dhjetor 2016.

Dega e Doganës Vlorë i ka rikuperuar të gjitha rastet e produkteve të duhanit që janë konstatuar gjatë periudhës së audituar.

-Në zbatim të nenit 9/3, janë fshirë/shuar nga regjistrat detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, të evidentuara në administratën doganore, për TVSH-në e shtyrë dhe të papaguar për makineritë e pajisjet, importimi i të cilave është përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas listës përkatëse në fuqi, deri në datën 31.12.2016.

Ky nen është zbatuar plotësisht nga Dega e Doganës Vlorë, ku me 4 (katër) vendime të saj është shuar plotësisht borxhi. Shuma e borxhit doganor të falur sipas nenit 9.3 arrin në vlerë 14.363.012 lekë.

-Në zbatim të nenit 10/1, janë fshirë/shuar detyrimet e pagueshme në doganë të evidentuara nga vendimet e nxjerra nga kjo administratë nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2014, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë detyrimi i pagueshëm në doganë, pa përfshirë gjokat, kamatëvonesat dhe interesat kompensuese.

Ky nen është zbatuar plotësisht nga Dega e Doganës Vlorë, konkretisht borxhi është shuar me 33 vendime administrative. Shuma e borxhit doganor të falur sipas nenit 10/1 arrin në vlerë 55.016.510 lekë.

-Në zbatim të nenit 10/2, janë fshirë/shuar detyrimet e pagueshme në doganë të evidentuara për shkelje të regjimit të lejimit të përkohshëm për automjetet, nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate, nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2016, fshihen/shuhet, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet detyrimi (principiali).

Ky nen është zbatuar plotësisht nga Dega e Doganës Vlorë, duke nxjerr 9 vendime administrative për shuarjen e borxhit. Shuma e detyrimeve doganore (gjoka & kamatëvonesa) të falur sipas nenit 10.2 arrin në vlerë 1.815.746 lekë.

Në total detyrimet doganore të falura në Degën e Doganës Vlorë, në zbatim të ligjit nr.33/2017 Për faljet, arrijnë në vlerë 91,911,299 lekë.

Në përfundim gjatë auditimit të veprimtarisë personelit doganor në mbledhjen dhe rikuperimin me forcë të borxhit doganor u arrit në konkluzionin se:

Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganor gjendje më 01.10.2017, krijuar gjatë viteve 2009-30.09.2017, u konstatua se; për arsye të ndryshme të analizuara rast pas rasti sipas viteve të audituara sa më sipër u konstatua se; autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë nuk ka arritur të zbatojë afatet ligjore të përcaktuara për rikuperimin e borxhit doganorë, për këtë arsye gjendja e borxhit doganor në fund të periudhës së audituar ka arritur në vlerë 247,666,332 lekë..

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.3, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar nuk ka bërë komente dhe shpjegime.

Në listën e subjekteve që rezultojnë me borxhe doganorë të papaguar më 30.09.2017 në vlerë **819,296,800 lekë** janë përfshirë **206 debitorë** gjithsej, nga të cilët dy prej tyre në vlerë të përgjithshme **571,630,468 lekë**, (551,436,587 lekë+20,193,881 lekë), gjenden në proces falimentimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në këto kushte gjendja e borxhit doganor e pa rikuperuar më 30.09.2017 përbëhet nga 204 subjekte në vlerë **247,666,332 lekë**, (819,296,800-571,630,468)

Gjetje dhe Rekomandime

Pika 5 e Drejtimit të Auditimit: “Auditimi i borxhit doganor, niveli i borxhit dhe analiza e tij dhe masat e marra për zbatimin e tij”



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Titulli i Gjetjes 1 i Mbi gjetjet dhe rekomandimet që lidhen me veprimtarinë e Degës Doganore Vlorë gjatë mbledhjes dhe arkëtimit të borxhit doganor.

Situata: Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganor gjendje deri më datë 01.10.2017, i krijuar gjatë viteve deri në periudhën 30.09.2017, u konstatua se nga autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë nuk janë arritur të zbatohen plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për rikuperimin e borxhit doganor, duke reflektuar një gjendje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 819,296 mijë lekë nga të cilat shuma prej 571,630 mijë lekë në proces gjyqësor falimentimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shuma prej 247,666 mijë e parikuperuar. Konstatohet një pakësim i dukshëm i borxhit doganor në periudhën gusht-tetor 2017 në vlerën 38,025 mijë lekë

Kriteri : Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës

Ndikimi/Efekti Konstatohet një gjendje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 819,296 mijë lekë.

Rëndësia i lartë

♦ **Në lidhje me Vendimin Nr.46**, datë 26.05.2016 për subjektin “**METAL WORK**” meNIPT L26326201A për shkelje doganore u konstatua se më datën 26.05.2016 subjekti i sipërcituar me anë të DAV IM5 me R-6441 ka deklaruar pranë D. D. Vlorë 2 artikuj (tuba metalik të prerë dhe profile alumini të prera) në peshën totale 16362 kg, sasi e cila është deklaruar edhe në deklaratën e tranzitit T1#242, të hartuar në D. D. Durrës, ku pas deklarimit artikujt e deklaruar janë peshuar dhe nga peshimi, referuar fletë peshës me nr.0328660, datë 23.05.2016 ka rezultuar pesha 17470 kg për të cilën nga doganieri i peshore rezultojnë të jetë shënuar, citojmë: “*Të verifikohet pesha në destinacion*”. Nga peshimi i artikujve të deklaruar



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

në DAV-in e tranzitit edhe në D. D. Vlorë ka rezultuar një sasi e ndryshme nga ajo e deklaruar nga subjekti për të cilën është përpiluar DAV IM4 me R-6445, datë 26.05.2016 për artikullin “*Tuba metalik të prerë*”, në sasinë 1000 kg, klasifikuar në kodin tarifor *73066192*, me detyrime doganore të shmangura në vlerën 17,529 lekë. Nga kontrolli dokumentar dhe fizik i ushtruar nga sektori operacional, për DAV IM4 me R-6445, datë 26.05.2016, ka rezultuar sasi tepër për të cilën është mbajtur procesverbal konstatimi nr.2207 prot., datë 26.05.2016, (në të cilin citohet: “*Gjatë kontrollit të ushtruar në dokumentat e paraqitura nga subjekti...për praktikën doganore R-6445, dt. 26/05/2016 është deklaruar nga ana e subjektit një sasi tjetër nga ajo e deklaruar në transit. Argumentimi i subjektit ishte se kishte harruar shoferi një faturë pa marrë në Itali*”), për penalitet në shumën e detyrimit doganor të shmangur në vlerën 17,529 lekë, referuar nenit 263 të KD. Mbi bazën e procesverbalit të sipërcituar autoriteti doganor, referuar nenit 287 të KD, ka vijuar me nxjerrjen e vendimit administrative të sipërcituar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se si nga grupi i kontrollit po ashtu edhe nga autoriteti doganor nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 256.2, 261.1 dhe 261.2 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar (penalitet në shumën 3 fish). Nga mosveprimi sa më sipër, efekti financiar me të ardhura të munguara në **Buxhetin e Shtetit është 35,058 lekë** (është zbritur 17,529 lekë e kontabilizuar sipas vendimit të sipërcituar).

♦ **Në lidhje me Vendimin Nr.28**, datë 13.04.2017 për subjektin “*KenoShpkmeNIPT K76413202T*” për shkelje doganore u konstatua se nëpërmjet DAV IM4 me R-10084, datë 05.08.2016, subjekti i sipërcituar ka paraqitur pranë kësaj dege doganore për qarkullim të lirë artikullin “*Material tekstil stok*” në kodin tarifor *54076130* të NKM me nivel të taksës doganore 0 %, në sasinë neto 1890 kg dhe vlerë doganore 772,397 lekë. Detyrimet doganore të paguara janë 154,478 lekë. Praktika doganore është profilizuar me risk ku si kriter është përcaktuar marrja e mostrave të cilat janë dërguar në Laboratorin Kimik Doganor. Pas analizimit të mostrave me anë të “*Çertifikatës së verifikimit të mallit dhe klasifikimit tarifor*” nr.2429, datë 22.09.2016, LKD ka konkluduar se artikulli i sipërcituar rezulton në kodin tarifor *54082210* me nivel të taksës doganore 10 %. Nga ky keqklasifikim rezultojnë shmangie të detyrimeve doganore në shumën 92,688 lekë në shkelje të nenit 256.1/a; 256.2; 256.4 dhe 261.1 të KD. Shmangia nga detyrimet doganore është më e madhe se 5 % e detyrimeve doganore të paguara në shkelje të nenit 261.2 të KD. Nga grupi i kontrollit të pas zhdoganimit është mbajtur procesverbali i kundërvajtjes administrative nr.1460/1 prot., datë 13.04.2017, referuar nenit 256.4 (detyrim doganor 92,688 lekë) dhe nenit 261.2 të KD. Vendimi administrativ i nxjerrë nga Autoriteti Doganor ka dalë me detyrimin doganor të shmangur në vlerën 92,688 lekë referuar nenit 256.4 të KD dhe penalitet 92,688 lekë (1-fish), referuar nenit 261.3 të KD, veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 261 të Kodit Doganor. Nga mosveprimi në përputhje me kërkesat e nenit 256 dhe 261 të KD, Të rekomandohet **marrja e vendimit administrative në Buxhetin e Shtetit** nga Dega Doganore Vlorë në përputhje me kërkesat e **nenit 256 dhe 261** sipas pikës 1, 2 dhe 3 të këtij neni sipas rekomandimit të cituar në **shumën 185,376 lekë**.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1. Nga ana e nëpunësve z. Festim Kapaj, me detyrë përgjegjës i zyrës së regjime/preferencë/përrjashtime në cilësinë e ish Kryetar i Degës Doganore dhe z. Kasëm Cenaj me detyrë Kryetar i DD. Tre Urat, në cilësinë e ish Kryetarit të Degës Doganoreaktualisht jo në marëdhënie pune., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 13, pika 5, gërma “I” të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot, datë 12.11.2012 për sa i përket nxjerrjes së akteve administrative në lidhje me shkeljet e konstatuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

2. Nga ana e nëpunësit z. Emiliano Mustafallari, me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 14.5 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore nr.19095/2 prot., datë 12.11.2012 përsa i përket kryerjes së detyrave funksionale lidhur me përgatitjen dhe konceptimin e akteve administrative në përputhje me përcaktimet ligjore të legjislacionit doganor.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 261.2;

2. Ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 275.1.

Vlera prej 270,434 lekë, e cila përfaqëson penalitet do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Emiliano Mustafallari, me detyrë dhe në cilësinë e jurist/specialist borxhi;

2. Z. Festim Kapaj, me detyrë përgjegjës i zyrës së regjime/akcizë përjashtime, në cilësinë e ish Kryetarit të Degës Doganore.

3. Z. Kasëm Cenaj, me detyrë kryetar i D.D. Tre Urat, në cilësinë e ish Kryetarit të Degës Doganore aktualisht jo në marrëdhënie pune.

Për sa më sipër është mbajtur Projekt Raporti i Auditimit nr.1148/8 Prot datë 07.02.2018 protokolluar në Degën Doganore Vlorë me shkresën nr.640 prot D.D.Vlorë datë 09.02.2018 dhe për këtë rast subjekti i audituar Dega Doganore Vlorë me shkresën nr.1138/32 prot datë 09.03.2018, ka bërë komente dhe shpjegime nisur specifikisht edhe nga observacionet e subjekteve të prekura si palë e interesuar si më poshtë vijon,

Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH

Konkretisht u shqyrtuan observacionet e subjekteve :

Subjekti “Teknoplastik” meNIPT K47201207P sipas shkresave nr.938 prot D.D.Vlorë datë 26.02.2018, shkresa nr.992 prot datë 01.03.2016 D.D.Vlorë dhe shkresa nr.1148/21 prot datë 05.03.2018 tonën KLSH grupi i auditimit arriti në konkluzionin që të merret në konsideratë pasi nuk reflektohen detyrime doganore efektive.

Në lidhje me shkresën nr.1148/15 prot tonën KLSH datë 28.02.2018 dërguar nga z. E. Mustafaraj merret në konsideratë mospërgjegjësia funksionale e z. Mustafaraj për rastin e vendimit administrative në ngarkim të subjektit “Irene Lisette Cop” pasi çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë sipas vendimit unifikues të kolegjit administrative të Gjykatës së Lartë me nr. 3 datë 06.12.2013 dhe problematika e ngritur nga grupi auditues do të reflektohet përsëri në raportin përfundimtar të auditimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor ku Dega Doganore Vlorë do të jetë palë e interesuar dhe e paditur në gjykim.

Në lidhje me shkresën nr.1148/15 prot tonën KLSH datë 28.02.2018 dërguar nga z. E. Mustafaraj merret në konsideratë mospërgjegjësia funksionale e z. Mustafaraj për rastin e vendimeve administrative në ngarkim të subjektit “Maurizio Colombo” dhe subjektit “Fatmir Krasniqi” pasi çështja është për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe problematika e ngritur nga grupi auditues do të reflektohet përsëri në raportin përfundimtar të auditimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për borxhin e mbuluar me urdhër ekzekutimi ku Dega Doganore Vlorë do të jetë palë e interesuar dhe e paditur në gjykim



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Në lidhje me shkresën nr.1148/32 prot tonën KLSH datë 09.03.2018 dërguar nga z. E. CallmoriKryetar i Degës Doganore Vlorë me lëndë “Observacione mbi ProjektRaportin e Auditimit” dhe shkresës nr.1112 prot D.D.Vlorë datë 08.03.2018 nga shqyrtimi i dokumentacionit u arrit në konkluzionin se observacioni i bërë nga juristi i Degës Doganore Vlorë z. E. Mustafaraj për vendimet administrative të nxjerra në ngrakim të subjekteve “**Altin Haniaj**” “**Nevzat Shenaj**” “**Elona Spahiu**” dhe “**Mario&Adi**” nuk u pranua dhe nuk u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit.

Në lidhje me shkresën nr.1104 prot D.D.Vlorë datë 08.03.2018 dërguar në lidhje me observacionin e ardhura nga Dega Doganore Vlorë pretendohet që më shkresën nr.1277 prot datë 25.03.2016 të Degës Doganore Vlorë është dërguar pranë Departamentit të Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë por nuk provohet konkretisht shkresa specifike dërguar Organeve Tatimore përfshirë Drejtorinë Rajonale Vlorë , Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për konstatimin e referuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë shqyrtimit të Vendimit administrative nr.97 datë 10.03.2015 i mbajtur për subjektin “**Transatlantic Albania LTD-Dega Shqipëri meNIPT K72205016P**” ku është konstatuar se gjatë kontrollit të kryer sipas materialit shkresor nr.4482 prot datë 09.01.2014 me tematikë kontrolli “Verifikimin e gjendjes së stokut të produkteve me akcizë të përjashtuar” të pasqyruar edhe në proces-verbalin e verifikimit të kundërvajtjes administrative me nr.serial 000528 datë 17.11.2014 si dhe materialin me nr.398/1 prot datë 10.03.2015 është konstatuar se subjekti ka një sasi prej 210,834 kg naftë bruto në mungesë për të cilën është llogaritur një detyrim doganor prej 5,270,850 lekë gjatë kontrollit në magazinën fiskale me nr.AL03411202900 dhe për këtë fakt është rekomanduar Njoftimi i Organeve Tatimore për rezultatet e kontrollit në ngarkim të subjektit “**Transatlantic Albania LTD-Dega Shqipëri meNIPT K72205016P meNIPT L02010020K**” ku është kërkuar marrja në konsideratë e pagesës së detyrimit tatimor të përlllogaritur në **shumën 3,801,180 lekë për vlerën e TVSH** mbi vlerën e mallit dhe vlerën e akcizës së lindur dhe të papaguar në zbatim të Ligjit 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën” pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë . Ky observacion nuk u mor në konsideratë dhe nuk u reflektua në Raportin Përfundimtar të Auditimit

Gjithashtu

1. Në lidhje me Vendimin Administrativ nr.57, datë 30.06.2016 ku **citohet se: “...në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje doganore, por kemi të bëjmë me mosmbylljen në afat të skemes së TVSH së përfutur në doganë”;**

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. **Mustafallari**, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi nga ana e subjektit është vepruar jo në përputhje me afatet e përcaktuara në autorizimin për shtyrjen e TVSH, vprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.2 dhe 275.1 të KD.

2. Në lidhje me Vendimin Administrativ nr.46, datë 26.05.2016 ku **citohet se: “...Subjekti...është paraqitur në DDV dhe me deklaratën doganore IM4 me R-6445, datë 26.05.2016 i ka dhënë destinacion doganor mallit..”;**

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. **Mustafallari**, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi konstatimet janë bërë me hedhjen e mallit për qarkullim të lirë dhe jo në tranzit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

3. Në lidhje me Vendimin Administrativ nr.28, datë 13.04.2017 ku *citohet se: “...Kodi i Ri Doganor një penalitet të tillë e ka parashikuar me dënim një fish..”;*

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Mustafallari, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi Kodi i Ri Doganor lidhur me kapitullin e shkeljeve në fushën doganore ka hyrë në fuqi pas Qershorit 2017

Gjetje nga auditimi.

Drejtimi nr.6 “Auditimi i procedurave doganore të ndjekura gjatë marrjes së vendimeve administrative”.

Titulli i Gjetjes 1

Zbatimin e legjislacionit doganor në përputhje me Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, dhe pikave 234-239, 272-325 dhe 463-472 të VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor Situata

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore për periudhën nën auditim rezultuan vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e nenit 107-112, 136-149, 256, 261, 275, 276 dhe 281/1 të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, dhe pikave 234-239, 272-325 dhe 463-472 të VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, në shumën totale **2,335 mijë lekë** për raste vendimesh administrative të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2015 dhe 2016.

Kriteri : Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, dhe pikave 234-239, 272-325 dhe 463-472 të VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”

Ndikimi/Efekti Konstatohen vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me legjislacionin doganor në shumën **2,335 mijë lekë** për raste vendimesh administrative të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2015 dhe 2016.

Rëndësia E lartë

Rekomandimi Dega Doganore Vlorë të kërkojë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendime administrative në shumën totale **2,335 mijë lekë** për raste vendimesh administrative të vitit 2015 dhe 2016 duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim nxjerrjen dhe arkëtimin e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore bazuar në ligjin nr.8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar, sipas aneksit nr.63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

✚ Drejtimi nr.7 i Auditimit “Auditimi i veprimtarisë së operatorëve ekonomikë që kanë kryer veprimtari në zbatim të ligjit nr. 61, datë 24.05.2012, “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, gjatë, viteve 2015, 2016 deri 01.10.2017.

Në zbatim të pikës 7 të programit të auditimit nr. 1148/1, datë 15.11.2017 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Të dhënat dokumentare, evidencat dhe informacionet e paraqitura nga Përgjegjës i Zyrës së Regjim/Akcizës, lidhur me numrin e subjekteve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për administrimin e prodhimit vendas që trajtohet me akcizë sipas llojeve.
2. Dokumentet që gjenden në dosjet e subjekteve të autorizuar nga D.P.Doganave për të administruar Magazina Fiskale Prodhim-Stokimi, Magazina Fiskale Prodhimi dhe Magazina Fiskale, Pritësa të Regjistruar (Pjekës Kafe dhe Subjekte/peshkimi), për administrimin e prodhimit vendase që trajtohet me akcizë.
3. Raportet mujore të përgatitura për Pritësat e Regjistruar, pjekës kafe dhe subjekte/peshkimi në përputhje me kërkesat e aneksin nr.14 të ligjit nr.61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”.
4. Aktet administrative të mbajtura gjatë kontrolleve të ushtruaranga strukturat e ndryshme të kontrollit në ambientet e subjekteve, apo gjatë qarkullimit të produkteve që trajtohen me akcizë në territorin doganor të Qarkut Vlorë .

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si më sipër u konstatua se:

Ligji nr.61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

-Neni 85,klasifikimi i shkeljeve në fushën e akcizës:

a)kundërvajtjet administrative; b)veprat penale.

Pika2. Pagesa e gjobës, që zbatohet për shkeljen në fushën e akcizës, në asnjë rast nuk do të jetë shkak për të përjashtuar shkelësin nga pagimi i detyrimeve të akcizës që duhen paguar për mallrat, objekt i shkeljes.

Pika3.Vendosja e dënimit administrativ, sipas dispozitave të këtij ligji, nuk e ndalon administratën doganore të paraqesë kallëzim penal në prokurori për veprat penale, të parashikuara në Kodin Penal.

-Neni 87, Shmangia nga verifikimi ose pagimi i akcizës së produkteve energjetike

1. Pavarësisht nga ndjekja penale për këtë qëllim, dënohet

1.1. Për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto produkte të akcizës

1.2. Për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto produkte të akcizës

1.3. Për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto produkte të akcizës.

2. Gjoha për shkeljet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "d" të pikës 1 të këtij neni llogaritet jo vetëm për produktet tërësisht të përfunduara, por edhe për ato që mund të përftoheshin nga lëndët e para gjatë përpunimit ose në pritje për t'u përpunuar, apo që gjenden në fabrikë ose në ambientet ku është kryer shkelja. Gjoha për shkeljet e parashikuara në shkronjën "d" të pikës 1 të këtij neni llogaritet, gjithashtu, jo vetëm për produktet që janë duke u rigjeneruar ose tërësisht të rigjeneruara, por edhe për produktet e denaturuara, që gjenden në ambientet ku është kryer shkelja.

3. Shkelja e mbetur në tentativë ndëshkohet si shkelje e kryer.

-Neni 88, Prodhimi klandestin i alkoolit dhe pijeve alkoolike

1. Pa rënë ndesh me Kodin Penal, kushdo që prodhon në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine) alkool ose pije alkoolike dënohet me gjobë:

a) sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto mallra të akcizës, të prodhuara në mënyrë të padeklaruar dhe të paautorizuar (klandestine). Gjoha, përveç produkteve tërësisht të përfunduara, aplikohet edhe për produktet që mund të përftoheshin nga lëndët e para në përpunim ose në pritje për t'u përpunuar apo që gjenden në ambientet, në fabrikë a në lokalet ku është kryer shkelja;



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

b) përveç masës së gjobës, të parashikuar në shkronjën "a" të kësaj pike, edhe sekuestrim të makinerive, pajisjeve, mjeteve ndihmëse të prodhimit, lëndës së parë, çdo materiali të nevojshëm për prodhimin e këtyre produkteve, si dhe të gjitha mallrat e akcizës të gjetura në çdo kohë.

-Neni 89, Shmangia nga verifikimi dhe nga pagimi i akcizës për alkoolin dhe pijet alkoolike

1. Pavarësisht nga ndjekja penale për këtë qëllim, dënohet:

a) shmang me çfarëdo mënyre alkoolin ose pijet alkoolike nga verifikimi ose pagimi i akcizës;

2. Shkelja e mbetur në tentativë ndëshkohet si shkelje e kryer.

3. Përdoruesit të përjashtuar, kur është kryer shkelja e parashikuar në pikën 1 ndarja 1.3 shkronja "b" të këtij neni, i hiqet për dy vjet e drejta për të përfutur nga përjashtimet.

-Neni 90, Manipulimi i pajisjeve dhe shenjave

1. Pavarësisht nga ndjekja penale e parashikuar për këtë qëllim, dënohet:

1.1. Për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve fiskale të shmangura.

1.2. Për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve fiskale të shmangura.

1.3. Për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale të shmangura, kushdo që me qëllim, për të shmangur produktin nga verifikimi:

-Neni 91, Teprica ose mangësi në magazinën fiskale dhe në qarkullimin e produkteve që i nënshtrohen akcizës

1. Mangësitë mbi 2 për qind, përveç firove të lejuara, të konstatuara gjatë kontrollit të magazinave fiskale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në masën sa 3-fishi i detyrimeve fiskale të munguara që duheshin paguar.

-Neni 92, Shkelja e detyrimit për mbajtjen e regjistrave, të kontabilitetit dhe diferencat

Mosmbajtja apo mosruajtja e regjistrimeve/kontabilitetit për periudhën e caktuar, sipas përcaktimeve të këtij ligji, ose mosdhënia e regjistrimeve/kontabilitetit, sipas kërkesës së organeve doganore, dënohet me gjobë në masën 500 000 lekë.

-Neni 94, Mbajtja, transportimi ose shitja e mallrave të akcizës pa pullë fiskale

1. Mbajtja, transportimi ose shitja në çdo lloj mënyre e mallrave, për të cilat kërkohet pajisja me pulla fiskale, pa qenë i pajisur me pullë fiskale, përveç ndjekjes penale, sanksionohet si më poshtë:

a) Gjobë, për herën e parë të konstatuar, sa 2-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar, për herën e dytë të konstatuar, sa 3-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar, dhe për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar.

-Neni 95, Shkeljet për ndërhyrjet në pullat e akcizës/fiskale dhe vonesat në instalimin e pajisjeve që aplikojnë pullat fiskale nga prodhuesit e mëdhenj

1. Vendosja e pullave të falsifikuara ose të manipuluar në mallrat e akcizës, apo falsifikimi ose manipulimi i pullave, apo heqja e tyre për ripërdorim për të shmangur pagesën e akcizës, ose falsifikimi apo vjedhja e pullave, përveç ndjekjes penale, dënohen me gjobë, të barabartë me 5-fishin e detyrimit fiskal të shmangur.

2. Vonesat dhe tejkalimet e afateve, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave, në instalimin e pajisjeve që aplikojnë pullat fiskale nga prodhuesit në shkallë të madhe, dënohen me gjobë në vlerën 1 000 000 lekë, për çdo periudhë vonese prej 7 ditësh kalendarike.

-Neni 95/I, Mbajtja transportimi ose shitja e produkteve të akcizës, pa shënjuar, markues ose ngjyruar;

Eksportimi, hedhja për konsum, mbajtja tregtimi, transportimi i produkteve të Naftës, që nuk përmbajnë markuesin/shënjuar ose ngjyruar, apo që nuk e kanë markuesin/shënjuar apo ngjyruar në përqëndrimin /koncentrimin e duhur, sanksionohet si më poshtë;

a) Gjobë për herën e parë të konstatuar, sa dyfishi i detyrimeve fiskale që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të pashënjuar/të pangjyrosur, të gjendur në depozitë /mbajtës, por në çdo rast jo më pak se 200.000 lekë, për herën e dytë të konstatuar, sa trefishi i detyrimeve fiskale që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të pashënjuar/të pangjyrosur, të gjendur në depozitë /mbajtës, por në çdo rast jo më pak se 500.000 lekë dhe për herën e tretë të konstatuar, sa pesëfishi i detyrimeve fiskale që duhet të paguhet për të gjithë sasinë e produktit të pashënjuar/të pangjyrosur, të gjendur në depozitë /mbajtës, por në çdo rast jo më pak se 1,000.000 lekë.

b) përveç gjobës së parashikuar në shkronjën "a" të këtij neni, njëkohësisht konfiskohet e gjithë sasia e produktit të gjendur në depozitë/mbajtës.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Neni 95/2, Shkeljet për ndërhyerjet në shënjesve ose ngjyrues.

*Vendosja (injektimi) i markuesve/shënjesve ose ngjyruesve të falsifikuar ose të manipuluar në mallrat e akcizës ose falsifikimi apo vjedhja e shënjesve/ngjyruesëve , përveç ndjekjes penale, **dënohet me gjobë në masën 1.000.000 lekë.***

-Neni 96, Parregullsitë në qarkullim

Produktet, që i nënshtrohen akcizës, edhe nëse janë të destinuara për përdorim të përjashtuar nga detyrimi i akcizës ose me tarifë të reduktuar, që transportohen pa dokumentacionin përkatës të akcizës, me dokumentacion të falsifikuar ose të korrigjuar, apo që nuk lejon të identifikohet subjekti që kryen transportin, konsiderohen me prejardhje të paligjshme. Në këto raste, transportuesi dhe dërguesi solidarisht dënohen, për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar, për herën e dytë të konstatuar, me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar, dhe për herën e tretë të konstatuar dhe më pas, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar.

Në zbatim të VKM nr.29, datë 14.01.2015 dhe Udhëzimi nr.18, datë pika 13 përcaktohet “Pritësi regjistruar/subjekt peshkimit duhet të justifikojë pranë autoriteteve doganore sasinë e karburantit (gazoil), për peshkim të furnizuar nëpërmjet dokumenteve doganore, faturës së karburantit të blerë për peshkim, me faturat tatimore me TVSH të produktit të peshkuar të shitur dhe regjistrin të karburantit të anijeve të peshkimit ku janë shënuar sasinë e furnizuara, konsumi dhe lëvizjet e anijes së peshkimit”, ndërsa në pikën 14 theksohet se “Vlera totale e karburantit për peshkim të furnizuar dhe të konsumuar gjatë një 6 mujori, nuk mund të jetë më e madhe se 80 % e vlerës totale të produktit të peshkimit të shitur me faturë tatimore me TVSH, gjatë kësaj periudhe.”

Nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë nuk janë zbatuar plotësisht disa nga kërkesat e ligjit nr.61/2012, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, përcaktuar nga nenet 85, 85/2, 87,1/3, 88, 1/a, 89,1/2/b, 90/1,2,91/1, 92, 94/1/a, 95, 95/1/2, 96, 1dhe 96/1/a, kërkesat e VKM-së nr.612 datë 05.09.2012 “Për Dispozitave Zbatuese të Ligjit, Për Akcizat”, VKM nr.29, datë 14.01.2015 “Për përcaktimin procedurave të sasive kushteve dhe kritereve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga taksa e qarkullimit dhe e karbonit”, si dhe udhëzimi nr. 18, datë 15.06.2015, i nxjerr nga Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave “Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil) me përjashtim nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza” ndryshuar, ku përcaktohet:

Autoritetit doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë , për periudhën në auditim vitet 2015, 2016 deri më 30.09.2017, ka patur në mbikëqyrje 78 subjekte të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për administrimin e një Magazine Fiskale Prodhim-Stokimi, Magazinë Fiskale Prodhimi dhe Magazinat Fiskale (Pritësa të Regjistruar) 8 Pjekës Kafe dhe 50 Pritësa të Regjistruar/subjekte peshkimi, për administrimin e prodhimit vendas që trajtohet me akcizë në territorin doganor të Qarkut Vlorë , si më poshtë,

Pasqyra nr.1, lista emërore e subjekteve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave për administrimin e një magazine fiskale, për vitet 2015, 2016, deri më 30.09.2017.

Trajtuar me hollësiht ne aneksin nr.7.1 te Raport Përfundimtarit te Auditimit

Subjektet e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për administrimin e regjimit të akcizës janë ndarë në tre grupe, grupi **I** parë përbëhet nga 5 subjekte të autorizuar për të administruar Magazinat Fiskale Prodhimi dhe Stokimi (MFPS), nga të cilët katër subjekte në fushën e prodhimit të karburanteve dhe një prodhues birre, grupi **II** përbëhet nga 16 subjekte për të administruar Magazinat Fiskale Prodhimi (MFP), nga të cilët dy prodhues (importues) kafeje, dy prodhues birre, dhjetë prodhues vere dhe dy prodhues vere+raki, grupi **III** përbëhet nga 57 subjekte të autorizuar për administrim Magazine Fiskale (MF) Pritësa të Regjistruar, 7 subjekte për pjekje kafe dhe 50 subjekte/peshkimi.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Të gjitha dokumentet e përgatitura për administrimin e veprintarisë mujore apo vjetore të subjekteve që administrojnë prodhimin vendas objekt akcizejanë të protokolluara nga Zyra e Protokoll Arkivit pranë Degës së Doganës Vlorë dhe janë arkivuar në dosje të posaçme muaj pas muaji, ndërsa një kopje e tyre administrohet nga sektori i regjim/akcizës.

1. Magazina Fiskale Prodhimi

Gjatë periudhës në auditim subjektet e autorizuara për administrimin e magazinave fiskale të prodhimit të artikujve vendas që trajtohen me akcizë janë pasqyruar sipas viteve e konkretisht.

Pasqyra nr.2: Sasia e prodhimit të realizuar nga subjektet e autorizuar për administrimin e magazinave fiskale të prodhimit, sipas llojeve në vitet 2015, 2016, si dhe sasia e lëndës së parë hedhur në sistem, në muajin tetor 2017 në kg.

N/R	Subjekti	NIPT	2015			2016			2017	Gjendja Stokut 30.09.2017		Në % 16/15
			Verë	Raki	Pije	Verë	Raki	Pije	Sasia rrushithedhur në sistem	Verë	Raki	
1	Kantina shpk	K36528277V	1690	440	395	11700	0	205	0	7939	383	658
2	Alma Berberi	K36616211M	12900	0	0	10500	0	0	10000	45199	0	86
3	San Romeo	K76502202N	9000	700	0	0	0	0	7000	7906	150	0
4	Natasha Kapoj	K76603205V	5800	0	0	5900	0	0	9000	12669	0	116
5	Artan Balas	K77419201U	2610	0	0	4300	0	0	9200	9771	0	55
6	Lesko Vangjeli	K86319201Q	840	0	0	360	0	0	0	0	0	119
7	Majlinda Alliu	K96404204P	3000	0	0	4200	0	0	10000	2087	0	140
8	Xhelal Xhafaj	L17203202G	1200	0	0	1200	0	0	2000	2145	0	0
9	Arlinid shpk	K56915201L	0	1550	0	0	2030	0	13400	17262	3048	131
10	Zanaj shpk	K47123204G	3600	1500	0	4800	0	0	0	59664	5788	133
11	Xhevdet Rexhep	L57122211J	3000	150	0	1020	0	0	0	2520	150	0
12	Natalia Shytaj	K36518227 F	0	0	0	0	0	0	0	4963	0	0
TOTALI			43640	4340	395	43980	2030	205	60600	172125	9518	101

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të paraqitura si mësipër u konstatua se nga 12 subjekte të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për administrimin e magazinave fiskale të prodhimit vendas verë, raki dhe pije alkoolike, nga këta subjekte vetëm 6 kanë siguruar qëndrueshmëri prodhimi e konkretisht subjektet Alma Berberi meNIPT K36616211M, Natasha Kapoj meNIPTK76603205Vlorë , Artan Balaj meNIPT K77419201U, Majlinda Alliu meNIPT K96404204P, Arlindi shpk meNIPT K56915201L dhe Zanaj shpk meNIPT K47123204G.

Këta subjekte zotërojnë 146,652 litra të sasisë së verës stok, ose 85 % të këtij stoku respektivisht me 45199 litra, 12669 litra, 9771 litra, 2087 litra, 17262 litra dhe 59664 litra verë, ndërsa subjektetArlindishpk meNIPT K56915201L dhe Zanaj shpk meNIPT K47123204G zotërojnë dhe 8836 litra të rakisë stok, ose 93 % tëkëtij stoku.

Pasqyra nr.3, sasia e prodhimit të birrës dhe të ardhurat e sigurura nga zbatimi i taksës së akcizësrealizuar nga subjektet e autorizuar për administrimin e magazinave fiskale prodhim-stokim, për vitet 2015, 2016 deri më 30.09.2017

N/R	SUBJEKT	NIPT	Viti 2015		Viti 2016		2017		Gjithsej	
			Prodhimi litra	Të ardhura lekë	Prodhimi litra	Të ardhura lekë	Prodhimi litra	Të ardhura lekë	Prodhimi litra	Të ardhurat lekë
1	Enolfat	K36527289Q	0	0	0	0	0	0	0	0
2	A&B Grup	K67227203A	2,430,853	35,004,284	1,389,332	20,006,381	449,500	6,472,800	4,269,685	61,483,465
3	Alfred Shaska	K86723204D	109,920	1,369,864	114,780	1,458,624	109,950	1,397,245	559,350	4,225,773
Totali			2,540,773	36,374,148	1,504,112	21,465,005	559,450	7,870,045	4,604,335	65,709,198

Nga analiza e të dhënave të paraqitura sa mësipër u konstatua se 93 %e prodhimit të birrës dhe 94 % e të ardhurave nga zbatimi i taksës së akcizës në vlerë 61,483,465 lekë janë realizuar nga një subjekt.

Pasqyra nr.4: Sasia e të ardhurave të realizuar nga subjektet e autorizuar për administrimin e magazinave fiskale, sipas llojeve për vitet 2015, 2016 deri më 30.09.2017

N/R	SUBJEKT	NIPT	2015	2016	Në % 16/15	30.09.2017	Në % 17/15
-----	---------	------	------	------	------------	------------	------------



KONTROLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

1	Kantina shpk	K36528277V	246,978	227,982	92	79,400	32
2	Alma Berberi	K36616211M	27,000	124,965	463	86,872	322
3	San Romeo	K76502202N	178,970	206,035	115	0	0
4	Natasha Kapoj	K76603205V	192,623	118,538	62	153,000	79
5	Artan Balas	K77419201U	224,325	61,335	28	165,922	74
6	Lesko Vangjeli	K86319201Q	22,950	7,800	34	10,800	47
7	Majlinda Alliu	K96404204P	36,000	85,005	236	103,500	287
8	Xhelal Xhafaj	L17203202G	26,392	18,000	68	11,250	93
9	Arlinid shpk	K56915201L	115,326	121,089	105	104,580	91
10	Zanaj shpk	K47123204G	662,053	569,700	86	325,958	49
11	Xhevdet Rexhep	L57122211J	0	0	0	45,000	100
12	Natalia Shytaj	K36518227 F	0	9,000	100	9,000	100
TOTALI			1,732,617	1,549,449	89	1,095,282	63

Pasqyra nr.5: Sasia e prodhimit (importit) të kafes së papjekur, blerjet brenda vendit dhe sasi të shitura me DSHA-4 nga subjektet e autorizuar për administrimin e magazinave fiskale prodhim-stokimit, për vitet 2015, 2016 deri më 30.09.2017.

N / R	Subjekti	NIPT	Viti 2015		Viti 2016		Viti 2017		Gjithsej	
			Prodhimi (Imp.4) Kg	DSHA-4 Kg	Prodhimi (Imp.4) Kg	DSHA-4 Kg	Prodhimi (Imp.4) Kg	DSHA-4	Prodhimi bruto (Imp.4)	DSHA-4 Kg
1	KEJ 2010	L06511202G	75,432	4,440	76,450	17,280	62,232	5040	214,114	26,760
2	VANGJEL DOGA	L27212204A	5,890	5,890	7,819	7,819	5,970	5,970	19,679	19,679
Totali			81,322	10,330	84,269	25,099	68,202	11,010	233,793	46,439

Nga analiza e të dhënave të paraqitura sa më sipër u konstatua se 214,114 kg prodhim kafe të papjekur është realizuar nga subjekti Kej-2010 nëpërmjet importit ose 92 % të sasisë së prodhimit gjithsej, ndërsa subjekti Vangjel Doga ka blerë nga importues të ndryshëm brenda vendit 19,679 kg kafe të papjekur duke realizuar 8 % të prodhimit të kafes.

Pasqyra nr.6, sasia e prodhimit të kafes neto të importuar dhe të blerë brenda vendit, si dhe të ardhurat e realizuara nga zbatimi i taksës së akcizës prej subjekteve të autorizuar nga DPD-ja, për vitet 2015, 2016 deri më 30.09.2017

N/R	Subjekti	NIPT-i	Viti 2015		Viti 2016		Deri 30.09.2017		Gjithsej	
			Prodhimi neto kg	Tëardhura në lekë.	Prodhimi neto kg	Tëardhura në lekë.	Prodhimi neto kg	Tëardhura në lekë.	Prodhimi neto	Tëardhura në lekë.
1	KEJ 2010	L06511202G	67,472	4,048,320	75,234	4,514,040	44,921	2,695,260	187,627	11,257,620
2	Vangjel DOGA	L27212204A	4,771	286,260	6,333	380,004	4,836	290,142	15,940	956,400
Totali			72,243	4,406,823	81,567	4,894,044	49,757	2,985,402	203,567	12,214,020

Nga analiza e të dhënave të paraqitura sa më sipër u konstatua se gjatë periudhës në auditim janë realizuar **12,214,020 lekë të ardhura** gjithsej nga zbatimi i taksës së akcizës për prodhimin e kafes, nga të cilat 92 % të ardhurave në vlerë **11,257,620 lekë** janë siguruar nga subjekti Kej-2010, ndërsa 8 % e tyre në vlerë **956,400 lekë** është realizuar nga subjekti Vangjel Doga.

Firot e krijuar në procesin e prodhim-përpunimit janë sa 19 % e sasisë kafes së papjekur ose në përputhje me kërkesat e legjislacionit për akcizën.

Pasqyra nr. 7: Përmbledhëse e sasisë së prodhimit vendas të shitur dhe të ardhurat e realizuara nga taksa e akcizës, gjatë periudhës së audituar, vitet 2015, 2016 deri 30.09.2017.

N/r	Lloji prodhimit	2015		2016		30.09.2017		Gjithsej	
		Sasia	Të ardhurat	Sasi	Të ardhurat	Sasi	Të ardhurat	Sasi	Të ardhurat
1	Verë, raki, pije	48,375	1,732,617	46,215	1,549,449	36,509	1,095,282	131,099	4,377,348
2	Kafe	72,243	4,406,823	81,567	4,894,044	49,757	2,985,402	203,567	12,214,020
3	Birrë	2,540,773	36,374,148	1,504,112	21,465,005	559,450	7,870,045	4,604,335	65,709,198
Shuma		-	42,513,588	-	27,908,498	-	11,950,729	-	82,327,566

2. Magazina Fiskale Prodhim-Stokim (Naftë Bruto).

Pasqyra nr.8, sasia e naftës bruto prodhuar nga subjektet e autorizuar nga DPD-ja për administrimin e magazinave fiskale prodhim-stokim, për vitet 2015, 2016 deri më 30.09.2017.

N/R	Viti	Subjekt	NIPT	Kodi M Fiskale	Vend Burimi	Gjendjanë fillim	Sasia prodhimit	Transferuar DSHA-1	Gjendjanë fund (stoku)
1	2015	Phoenix Petroleum SHA	K92927401K	AL03411500012	Amonicë	41,864	5,900,517	5,767,342	175,039
2	2016	Phoenix Petroleum SHA	K92927401K	AL03411500012	Amonicë	175,039	4,887,214	4,579,253	483,000



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

2/1	2016	Transatlantik-Albania Ltd	K72205016P	AL03411201234	Gorisht	253,120	32,050,400	32,047,527	255,993
	2016	-	-	-	Shuma	-	36,937,614	36,555,938	738,993
3	30.09.2017	Phoenix Petroleum S.H.A	K92927401K	AL03411500012	Amonicë	483,000	204,402	357,402	330,000
3/1	30.09.2017	Transatlantik-Albania Ltd	K72205016P	AL03411201234	Gorisht	255,993	40,000	-	295,993
3/2	30.09.2017	Albpetrol S.H.A	J82916500U	AL03411700130	Gorisht	295,993	25,638,489	25,667,988	266,494
	30.09.2017	-	-	-	Shuma	778,993	25,882,891	26,025,390	636,494

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave dokumentare të paraqitura nga autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë , e cilika mbajtur në mbikëqyrje subjektet prodhues-stokues të naftës bruto të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave, u konstatua se **gjatë vitit 2015** ka operuar subjekti Phoenixs Petroleum SHA meNIPT **K92927401K** dhe Kod Magazine Fiskal **AL03411500012**, i cili ka prodhuar në vend burimin Amonicë-Vlorë **5,99,517 litra naftë bruto**, të cilën e ka bërëdalje me DSHA-1, pa detyrime fiskale drejt subjektit Kejsi 639,354 litra, Albpetrol 2,038,923 litra Porto Romano 1,835,442 litra, Trans Oil 383,910 litra, AEOT 185,360 litra, AM-OIL 142,288 litra dhe subjekti BP-2014 i janë bërë dalje 542,065 litra, ndërsa gjendja e stokut qenë 175,039 litra.

Gjatë vitit 2016, subjekti Phoenixs Petroleum SHA, meNIPT **K92927401K** dhe Kod Magazine Fiskal **AL03411500012**, i cilika prodhuar në vend burimin Amonicë-Vlorë **4,887,214 litra naftë bruto**, të cilën e ka bërëdalje me DSHA-1, pa detyrime fiskale drejt subjektit Kejsi 1,000,906 litra, subjektit Albpetrol 2,453,592 litra dhe subjektit BP-2014 me 1,124,755 litra dhe gjendje stoku prej 483,000 litra.

Gjatë vitit 2016, subjekti Transatlantik Albania LTD, meNIPT **K72205016P** dhe Kod Magazine Fiskal **AL03411201234**, ka prodhuar në vend burimin Gorishtë-Vlorë **32,303,520 litra naftë bruto**, të cilën e ka bërëdalje me DSHA-1, pa detyrime fiskale drejt subjektit TPD në sasi 11,103,411 litra, subjektit Albpetrol 11,853,352 litra, subjektit AEOT 1,472,232 litra, subjektit BP-2014 3,845,126 litra, subjekteve në Porto Romano 1,705,401 litra, subjektit IRTC-Ballësh 580, 596 litra dhe subjektit R.B.H SHA në sasi 1,487,409 litra. Gjendja stokut ka qenë 255,993 litra.

Gjatë vitit 2017, subjekti Phoenixs Petroleum SHA meNIPT **K92927401K** dhe Kod Magazine Fiskal **AL03411500012**, ka punuar vetëm një muaj duke prodhuar 204,402 litra naftë bruto e cila megjithë gjendjen e stokut (483,000 litra) arrin në 687,402 litra, nga e cila janë bërë dalje me DSHA-1, tek subjekti Kejsi një sasi 174,146 litra dhe Albpetrol në sasi 183,256 litra, në përfundim gjendja e stokut **ka mbetur në 330,000 litra**.

Gjendja e stokut prej 330,000 litra karburante gjendje, për të cilën autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë në bazë të kërkesës të subjektit për plumbosjen e saraçineskave të estakades në dalje për ngarkim me naftë bruto të mjeteve dhe plumbosjen e saraçineskave të kalimatsit të hyrjes dhe të daljes të magazinës fiskale me nr.reference 155/07/17, protokolluar në doganë me nr.2676, datë 10.07.2017ka përgatitur procesverbalin nr.2676/1, datë 10.07.2017. Plumbçet janë të përshkruara në PV sipas numrave përkatës, nënshkruar nga doganieri dhe përfaqësuesi i subjektit, bashkëlidhurgjendet formulari mbajtjes së kontabilitetit, protokoll 2221/1, datë 09.06. 2017, në sasi 330,000 litra

Gjatë vitit 2017, subjekti Transatlantik Albania LTD, meNIPT **K72205016P** dhe Kod Magazine Fiskal **AL03411201234** ka patur 255,993 litra stok më 31.12.2016, ka prodhuar 40,000 litra në muajin janar 2017 dhe gjendja e stokut ka arritur në 295,993 litra.

Në zbatim të shkresës nr.571, datë 27.01. 2017 dhe urdhërit të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr.431/1, datë 24.01.2017 protokolluar në D. D. Vlorë me nr.400, datë 30.01.2017 ...gjendja e sasisë së deklaruar në depozitat e magazinës fiskale të stokimit Gorishtë të kompanisë Transatlantik Petroleum Ltd ka qenë në sasi 295,993 litra, e cila është marrë në dorëzim nga subjekti Albpetrol S.H.A dhe është ngarkuar në sistemin doganor.

3. Magazina Fiskale (Pritës të Regjistruar)



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Për periudhën e audituar Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka autorizuar 7 subjekte Pritësa të Regjistruar për Pjekje Kafe, të cilat gjatë operimit janë mbikëqyrur dhe kontrolluar nga autoritetit doganor kompetent, veprimet e tyre kanë rezultuar në përputhje me ligjin.

3/1-Këtu janë të regjistruar 50 subjekte (anije) peshkimi(Pritësa të Regjistruar)

4. Kontrollat e Ushtruara

Nga auditimi i dokumenteve të vënë në dispozicion nga Zyra e Regjim/Akcizës u konstatua se gjatë periudhës në auditim vitet 2015, 2016 deri më 30.09.2017 janë ushtruar 35 kontrollegjithësej, nga të cilët 21 kontrolle janë ushtruar nga Departamenti i Akcizës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, 10 kontrolle janë ushtruar nga Departamenti i Akcizës në bashkëpunim me D.D.Vlorë , 3 kontrolle janë ushtruar nga D.D.Vlorë dhe 1 kontroll është ushtruar nga Drejtoria e Antikontrabandës pranë Departamentit Operativ Hetimor në bashkëpunim me D.D.Vlorë .

Nga kontrollet e ushtruara janë konstatuar **19,003,691 lekë detyrime doganore tëpapaguara** në shkelje të ligjit nr.61, datë 24.05.2012, Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë, nenet 85, 85/2, 88/1/a, 89/2/1/b, 91/1, 92, 94/1/a, 96/1/ dhe 96/1/a, janë aplikuar **59,118,981 lekë gjoba** (penalitet) dhe **1,548,671 lekë kamat vonesa**, në total arrijnë në vlerën **79,671,343 lekë** nga të cilat deri në momentin e auditimit janë arkëtuar **69,204,051 lekë**, ose në masën **87 %**.

Nga kontrollet e ushtruara në Sektorin e Hidrokarbureve janë konstatuar disa shkelje të procedurave për zbatimin e ligjit kryesisht në subjektin,

-Phoenix Petroleum SHA meNIPT **K92927401K**, ku janë konstatuar 1,973,425 lekë detyrime të papaguara, për të cilat subjekti është penalizuar me dyfishin detyrimeve në vlerë 3,946,850 lekë, ose gjithsej 5,920,275 lekë shumë e cila është arkëtuar.

-Transatlantik-AlbaniameNIPT **K72205016P**, ku janë konstatuar 5,270,850 lekë detyrime të papaguara, për të cilat ky subjekt është penalizuar me trefishin e detyrimeve në vlerë 15,,812,550 lekë, ose gjithsej 21,847,400 lekë, shumë e cila është arkëtuar.

-Bankers Petroleum-Abania meNIPT **K43128401L**, ku janë konstatuar 9,922,175 lekë detyrime të papaguara, për të cilat ky subjekt është penalizuar me trefishin e detyrimeve në vlerë 29,766,525 lekë, ose gjithsej 39,686,700 lekë, shumë e cila është arkëtuar.

Për sa më sipër Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka autorizuar për të operuar në regjimin e **Magazinës Fiskale (Pritës i Regjistruar)** dhe 50 Pritsa të Regjistruar/subjekte peshkimi, nga të cilët 33 subjekte në vitin 2015, 9 subjekte në vitin 2016 dhe 8 subjekte deri më 30.09.2017.

Në zbatim të vendimit nr.29, datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurave, të sasive, kushteve dhe kritereve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit*”, pika 1 “*Anijet e peshkimit përjashtohen nga pagesa e taksës së qarkullimit dhe taksës së karbonit në momentin e blerjes së karburantit*”.

Në zbatim të legjislacionit doganor dhe pikës 4, të vendimit nr.29, datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurave, të sasive, kushteve dhe kritereve të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit*”, Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë nxjerrë udhëzimin nr.18, datë 15.06.2015 “*Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil)me përjashtim ngataksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza.*”

Në këto kushte autoriteti doganor kompetent mbikëqyrës Dega e Doganës Vlorë në muajin korrik 2015 ka operuar me nxjerrjen e autorizimeve të para të përjashtimit të anijeve të peshkimit nga pagesa e taksës së qarkullimit, taksës së karbonit dhe të akcizës që në momentin e furnizimit. Nga auditimi dhe analiza e dokumenteve të vëna në dispozicion, për



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

këtë periudhë u konstatua se janë nxjerrë 71 autorizime përjashtimi në sasi 493,011 litra me vlerë të përjashtuar në shumën **33,037,829 lekë**.

Gjatë vitit 2016 janë nxjerrë 195 autorizime në sasi 1,198,224 litra me vlerë të përjashtuar **84,916,624 lekë**, nga të cilat 86 autorizime janë nxjerrë në 6-mujorin e parë 2016 në sasi 530,293 litra me vlerë të përjashtuar në shumën 35,527,579 lekë, ndërsa në 6-mujorin e dytë janë nxjerrë 109 autorizime përjashtimi në sasi 667,931 litra me vlerë të përjashtuar në shumën 49,389,045 lekë, ndërsa në periudhën janar-shtator 2017, janë nxjerrë 191 autorizime në sasi 1,242,018 litra me vlerë të përjashtuar **83,520,295 lekë**.

Pasqyra nr.8, sasia dhe vlera e naftës së përjashtuar nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza për furnizimin e anijeve të peshkimit të autorizuar nga DPD-ja, për 6-mujorin e dytë 2015, vitin 2016 deri më 30.09.2017.

N/R	Periudha	Numri Autorizimeve	Sasia në litra	Vlera në lekë	% viti, ndaj totalit në vlerë
1	6-mujori II-2015	71	493,011	33,037,829	16,4
2	2016	195	1,198,224	84,916,624	42,1
3	9-mujori 2017	191	1,242,018	83,520,295	41,5
	Totali	457	2,933,253	201,474,748	100

Nga zbatim i vendimit nr.29, datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimit nr.18, datë 15.06.2015 të nxjerr nga Ministri i Financave dhe Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave “Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil) me përjashtim ngataksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza”, konstatohet se pritësit e regjistruar subjekte peshkimi në Degën e Doganës Vlorë për gjithë periudhën në auditim janë furnizuar 2,933,253 litra karburante (gazoil) pa taksa duke përftuar një vlerë prej 201,474,748 lekë.

Pasqyra nr.9, zbatimi i koeficientit të përdorimit të karburantit për peshkim, për 6-mujorin e dytë 2015, vitin 2016 deri më 30.09.2017. Lista E Subjekteve/ Peshkimit Dhe Koeficientet e realizuar sipas Udhëzimit Nr. 18.

Trajtuar me hollësiht ne Aneksin nr.7.2 te Raport Përfundimtarit te Auditimit

Në pikën 13 të udhëzimit të mësipërm theksohet se “Pritësi i Regjistruar/subjekt i peshkimit duhet të justifikojë pranë autoriteteve doganore, sasinë e karburantit (gazoil), për peshkim të furnizuar nëpërmjet dokumenteve doganore, faturës së karburantit për peshkim të blerë, me faturat tatimore me TVSH të produktit të peshkimit të shitur, regjistrin të karburantit të anijeve të peshkimit ku janë shënuar sasinë e furnizuar, konsumi dhe lëvizjet e anijes së peshkimit.” Ndërsa në pikën 14, theksohet se “Vlera totale e karburantit (gazoil) për peshkim të furnizuar dhe konsumuar gjatë një 6 mujori, nuk mund të jetë më e madhe se 80% e vlerës totale të produktit të peshkimit të shitur me faturë tatimore, gjatë kësaj periudhe”.

Në këto kushte audituam dhe verifikuam regjistrat e shpenzimit të karburanteve në sasi dhe në vlerë për gjithë periudhën nga 01.07.2015 e deri më 30.09.2017, po kështu verifikuam vlerën e peshkut të shitur me TVSH nga subjektet e peshkimit ku rezultoi se autoriteti doganor kompetent D.D.Vlorë ka marra masa të plota për administrimin e karburantit të furnizuar për peshkim pa taksë qarkullimi, taksë karboni dhe akcizë veprim i kryer në përputhje kërkesat e VKM nr.29, datë 14.01.2015.

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave të pasqyruara si mësipër konstatohet se disa subjekte/peshkimi janë afër kufirit të fundit të shpenzimit të karburantit, por përsëri ata janë brenda limitit të përcaktuar nga udhëzimi i dy ministrive, disa qëndrojnë në kuota më të mira, ndërsa 4 subjekte/peshkimi e kanë shitur aktivitetin.

Konkluzion:



KONTROLLI I LARTE I SHETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Nga auditimi i sasisë së prodhimit dhe i të ardhurave të realizuara nga artikujt vendas të trajtuar me akcizë si verë, raki apo pije alkoolike u konstatua se; gjatë periudhës në auditim nga 12 subjekte të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për administrimin e magazinave fiskale të prodhimit vetëm 6 prej tyre kanë mundur të sigurojnë qëndrueshmëri të lehtë prodhimi e konkretisht subjektet Alma Berberi meNIPT K36616211M, Natasha Kapoj meNIPTK76603205Vlorë, Artan Balaj meNIPT K77419201U, Majlinda Alliu meNIPT K96404204P, Arlindi shpk meNIPT K56915201L dhe Zanaj shpk meNIPT K47123204G. Këta subjekte zotërojnë sëbashku 146,652 litra verë nga stoku i krijuarose 85 % të stokut gjithsej. Por për mungesë të doganierëve në Zyrën e Regjim-Akcizës gjatë viteve 2015, 2016 e deri më 30.09.2017 autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë nukka mundur të ushtrojë kontrole të programuara që nga momenti i grumbullimit të lëndës së parë (rrushit) e deri tek prodhimi dhe administrimi i produkteve të gatshme në depozita të kalibruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.10, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar nuk ka paraqitur pretendime.

Gjetje dhe rekomandime.

Drejtimi nr.7 *“Auditimi i procedurave doganore sipas ligjit nr.61 datë 25.09.2012 ”Për Akcizat në RSH” dhe VKM-nr.612 datë 25.09.2012 “Dispozitat Zbatuese të Ligjit të Akcizës*

Titulli i Gjetjes 7 *Zbatimin e legjislacionit doganor në përputhje me ligjin nr.61 datë 25.09.2012 ”Për Akcizat në RSH” dhe VKM-nr. 612 datë 25.09.2012 “Dispozitat Zbatuese të Ligjit të Akcizës*

Situata: Nga auditimi i veprimtarisë së subjekteve tregëtarë që operojnë në fushën e akcizës u konstatua se subjektet *”Alma Berberi”* meNIPT K36616211M, *”Natasha Kapaj”* meNIPT K76603205E, *”Artan Balaj”* meNIPT K77419201U, *”Majlinda Alliu”* meNIPT K96404204P, *”Arlindi”* shpk meNIPT K56915201L dhe *”Zanaj”* shpk meNIPT K47123204G të cilët. zotërojnë së bashku një sasi stoku prej 146,652 litra ose 85 % të stokut total të artikullit verë. Konstatohet se nga zyra e sektorit të akcizës gjatë viteve 2015, 2016 e deri më 01.10.2017 nuk janë ushtruar programe kontrole që nga momenti i grumbullimit të lëndës së parë (rrushit) e deri tek prodhimi, shitja dhe administrimi i produkteve të gatshme në magazinat fiskale respektive duke kryer veprime në kundërshtim me nenet 45-47 *”Kompetencat e Autoriteteve Doganore”* sipas përcaktimeve të ligjit nr.61 datë 25.09.2012 *”Për Akcizat në RSH”*

Kriteri : Ligji nr.61 datë 25.09.2012 *”Për Akcizat në RSH”* dhe VKM-nr. 612 datë 25.09.2012 *“Dispozitat Zbatuese të Ligjit të Akcizës*

Ndikimi/Efekti Konstatohen mosveprime doganore nga personeli përpunues doganor jo në përputhje me ligjin nr.61 datë 25.09.2012 *”Për Akcizat në RSH”* dhe VKM-nr. 612 datë 25.09.2012 *“Dispozitat Zbatuese të Ligjit të Akcizës gjatë vitit ushtrimor 2015, 2016 dhe 2017.*



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Rëndësia E lartë.

Rekomandimi Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë të marrë masa të menjëhershme ligjore për nxjerrjen e përgjegjësiëve për mosveprimet e kryera nga ana e personelit përpunues doganor të sektorit të akcizës të cilët nuk kanë kryer kontrole pranë operatorëve me status depozitues të miratuar gjatë periudhës 2015, 2016 dhe 2017 duke kryer veprime në kundërshtim me nenet 45-47 ”Kompetencat e Autoriteteve Doganore”, si dhe të ndjekë në mënyrë të menjëhershme analizimin e faktorëve që kanë sjellë pasojë akumulimin e sasisë së stokut prej 146,652 litra vere nga operatorët e mësipërm në përmbushje të përcaktimeve të ligjit nr.61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH” dhe VKM-nr. 612 datë 25.09.2012 “Dispozitat Zbatuese të Ligjit të Akcizës”

Menjêherë

8. Drejtimi nr.8 e Auditimit “Të tjera gjatë Auditimit”

Në zbatim të pikës nr.8 të Programit të Auditimit “1148/1 prot, datë 15.11.2017”, u konsiderua si e nevojshme zhvillimi, në ambientet e Degës Doganore Vlorë , i një verifikimi nga audituesit e KLSH-së, z. Altin Dinaj, z. Agron Opari, z. Aqif Klosi dhe z. Livan Hoxha. Objekti i këtij akt verifikimi është: Auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Vlorë gjatë veprimtarisë së zyrës doganore sektorit operacional gjatë veprimtarisë së personelit doganor në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr.8909/1 prot datë 10.04.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “*Mbi procedurat e Mostrimit, Transportit , Ruajtjes së Mostrave, Administrimit të rezultateve të analizave laboratorike*”
Nga verifikimi rezultoi se:

♦.Nga sektori i zyrës operacionale për artikujt “*paste domate, pelati domate, salce domate, domate të qëruara*” të përzgjedhura nga Profili i Riskut 20P1 për keqklasifikim tarifor pasi mund të jenë lëngje frutash ose zrazavate kreu 2009 ose kreu 21030320 salca të tjera. Konstatohet se nuk janë marrë mostra nga doganierët z. Albert Bani, z. Avni Hysi, z. Artan Bedini dhe z. Fatmir Ferhati.

Subjekti	NIPT	DAV	Viti	artikulli	artikulli	artikulli
Juri	K06705213T	14546	2016	10		
Juri	K06705213T	6463	2016	7		
Juri	K06705213T	8603	2017	4		
Juri	K06705213T	76	2017	7		
F&Trading	L57222209A	8882	2016	11	12	
F&Trading	L57222209A	7412	2016	4	5	
F&Trading	L57222209A	10439	2016	33	34	
F&Trading	L57222209A	7009	2016	4	5	
F&Trading	L57222209A	15985	2016	9	18	19
F&Trading	L57222209A	3048	2017	4	5	
F&Trading	L57222209A	6105	2017	1	2	
F&Trading	L57222209A	7074	2017	4	5	
F&Trading	L57222209A	13678	2016	5		
F&Trading	L57222209A	12565	2016	2		
Emiliano	K16619201S	12587	2016	5		
Emiliano	K16619201S	12567	2016	6	14	
Emiliano	K16619201S	10814	2016	6		
Emiliano	K16619201S	9459	2016	33		
Emiliano	K16619201S	7303	2016	18	19	
Emiliano	K16619201S	8899	2017	6		
Sokol Mehmetaj	L76305209K	955	2017	1		
Euro Italba	K97209202U	4288	2016	2		

♦.Nga verifikimi rezultoi që: nga sektori i zyrës operacionale për artikujt “*lëndë e parë për prodhim akullore*” të përzgjedhura nga Profili i Riskut 21P1 për keqklasifikim tarifor. Dyshohet se mallrat e deklaruara në kreun 2106 mund të jenë mallra të kërreëve 1901, 0401-



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

0406 me tarifë doganore bazë 2% dhe 10%. Konstatohet se nuk janë marrë mostra nga doganierët Albert Bani.

Subjekti	NIPT	DAV	Viti	artikulli	artikulli	artikulli
Artjoli	K76318201K	7490	2017	1		

◆.Nga verifikimi rezultoi që: nga sektori i zyrës operationale për artikujt “**atlete me suprinë tekstili për djem**” të përzgjedhura nga Profili i Riskut **6P1-2-4** për keqklasifikim tarifor për efekt vlerësimi doganor dyshohet për mallra të kreut 6204 ose 6404 me nivel vlerësimi nga 600lek/kg në 1000lek/kg. Konstatohet se nuk është marrë mostra nga doganierët Albert Bani.

Subjekti	NIPT	DAV	Viti	artikulli	artikulli	artikulli
Panajot Rjepaj	K76318201K	14486	2016	1		

◆.Nga verifikimi rezultoi që: nga sektori i zyrës operationale për artikujt “**material tekstil stock**” të përzgjedhura nga Profili i Riskut **54P1** për keqklasifikim tarifor për efekt vlerësimi doganor dyshohet për mallra të kreut 52 ose 54 me tarifë doganore 10% dhe me nivel vlerësimi nga 600lek/kg. Konstatohet se nuk është marrë mostra nga doganieri Albert Bani.

Subjekti	NIPT	DAV	Viti	artikulli	artikulli	artikulli
Këno 2014	K76318201K	5101	2017	1		

◆.Nga verifikimi rezultoi që: nga sektori i zyrës operationale për artikujt “**doreza**” të përzgjedhura nga Profili i Riskut **K3902** për dyshim keqklasifikimi tarifor të artikullit doreza për të cilat duhet të ishin marrë mostra për të verifikuar nëse janë “**doreza plastike apo doreza tulip**”Konstatohet se nuk është marrë mostra nga doganieri Albert Bani dhe Avni Hysi.

Subjekti	NIPT	DAV	Viti	artikulli	artikulli	artikulli
Adriatik	K76318201K	6256	2017	37		
Food Trading		6105	2017	22		

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që: Nga ana e personelit përpunues doganor nuk është kryer marrja e të gjitha veprimeve ligjore për të proceduar me marrje mostrash në të gjitha rastet e përzgjedhur në kanal të kuq dhe të goditura nga profili risku për marrje mostre duke lënë edhe gjurmë në aktin e inspektimit në rastin e deklarimeve të vogla duke informuar Drejtorinë e Analizës së Riskut

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
1- Udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi procedurat e Mostrimit, Transportit , Ruajtjes së Mostrave, Administrimit të rezultateve të analizave laboratorike” dalë më shkresën nr.8909/1 prot datë 10.04.2014.

2- Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore,miraturar me nr. 19095/2 prot, datë 12.11.2012 në zbatim të Ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr.205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i shfuqizuar, dhe ligjit nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi ;

1. Fatmir Ferati në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë ,
2. Artan Bedini në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë
3. Avni Hysi në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë
4. Albert Bani në cilësinë e doganierit të sek/operacional pranë D.D.Vlorë

◆. Në lidhje me përgjigjet e ardhura nga Drejtoria e Laboratorit Doganor u konstatua sa më poshtë

◆. Në lidhje me shkresën nr.18595/1 prot DPD datë 08.09.2017 që lidhet me “**Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor**” me nr.51 nxjerrë më datë 05.09.2017 që lidhet më praktikën doganore nr R 9459 datë 03.08.2017 për mallin e deklaruar si “Material Tekstil” në kodin tarifor *54076130* është konkluduar në përfundim në klasifikimin tarifor në kreun tarifor *54082210*.Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë përcaktimi i indikatorit të dhënë në shkresën nr.779 prot DPD datë



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

16.01.2013 “Mbi rishikimin e disa Indikatorëve shtesë në vlerësimin doganor të mallrave me origjinë nga vendet jashtë BE”, përcaktohet se niveli i vlerësimit doganor për mallrat e klasifikuara në kreun *5408* nuk duhet të jetë më i ulët se 600 lekë/kg. Për mallrat të deklaruar në kreun *5407* si mallrat ë natyrës “stock” të përfshira në këtë deklaram dhe të konkluduar në “Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor” me nr. 51 nuk është nxjerrë Vendim nga Autoriteti Doganor Vlore për këtë rast.

◆. Në lidhje me shkresën nr.15062/2 prot DPD datë 14.10.2015 që lidhet me “**Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor**” me NR. 112 nxjerrë më datë 05.10.2015 që lidhet më praktikën doganore nr R 8225 datë 15.06.2015 të subjektit “SIROL 2008” për mallin e deklaruar si “Etanol Denatyrëd” në kodin tarifor *22072000* është konkluduar në përfundim në klasifikimin tarifor në kreun tarifor *22071000* “Alkol etilik jo i denatyruar i një forcë ndaj volumit prej 80% vol. apo më shumë”. Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë përcaktimi i dhënë ligjor i dhënë sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 61 “Për Akcizat në RSH” sipas shkallës së detyrimit të akcizës prej 45 000 lekë për HL alkool anhidër e llogaritur në detyrimin e akcizës prej 2580 litra alkool anhidër *45.000 lekë Hektoliter. Nga Autoriteti Doganor nuk është dalë me vendimarrje për këtë rast dhe detyrimisht duhet të vijohet me nxjerrjen nga Autoriteti Doganor Vlorë të Vendimit Administrativ dhe të informohet Departamenti i Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave **dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit bazuar në ligjin specifik organik.**

◆. Në lidhje me shkresën nr.11986/1 prot DPD datë 13.06.2017 që lidhet me “**Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor**” me NR. 1227 nxjerrë më datë 08.06.2017 që lidhet më praktikën doganore nr R 5323 datë 05.05.2017 për mallin e deklaruar si “Atlete për të rritur” në kodin tarifor *64029910* është konkluduar në përfundim në klasifikimin tarifor në kreun tarifor *64041990* “Veshje këmbë me shuallin e jashtëm prej gome ose plastike, suprina prej materiali tekstili”. Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shkelja doganore e konsumuar që lidhet me keqklasifikim tarifor të kryer nga subjekti “BESMIR SPAHO” meNIPT L02718204J. Nga Autoriteti Doganor nuk është dalë me vendimarrje për këtë rast dhe detyrimisht duhet të vijohet me nxjerrjen nga Autoriteti Doganor Vlorë të Vendimit Administrativ dhe të informohet **Kontrolli i Lartë i Shtetit bazuar në ligjin specifik organik.**

◆. Në lidhje me shkresën nr.12002/1 prot DPD datë 23.05.2016 që lidhet me “**Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor**” me NR. 1408 nxjerrë më datë 18.05.2016 që lidhet më praktikën doganore nr R 5376 datë 03.05.2016 për mallin e deklaruar si “Këpuçë inkeliti për të rritur” në kodin tarifor *64029996* është konkluduar në përfundim në klasifikimin tarifor në kreun tarifor *64039116* “Veshje këmbë me shuallin e jashtëm prej gome ose plastike, suprina prej materiali lëkure”. Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shkelja doganore e konsumuar që lidhet me keqklasifikimn tarifor të kryer nga subjekti “PANAJOT RRJEPAJ” meNIPT L02718204J për sasinë prej 563 palë dhe 676 kg. Nga Autoriteti Doganor nuk është dalë me vendimarrje për këtë rast dhe detyrimisht duhet të vijohet me nxjerrjen nga Autoriteti Doganor Vlorë të Vendimit Administrativ dhe të informohet **Kontrolli i Lartë i Shtetit bazuar në ligjin specifik organik.**

◆. Në lidhje me shkresën nr.19220/1 prot DPD datë 14.09.2016 që lidhet me “**Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor**” me NR. 147 nxjerrë më datë 08.09.2016 që lidhet më praktikën doganore nr R 9610 datë 27.07.2016 për mallin e deklaruar si “Pandofla për Hoteleri” në kodin tarifor *64052099* është konkluduar në përfundim në klasifikimin tarifor në kreun tarifor *640419110* “Pandofla me shuallin e jashtëm prej gome ose plastike ose material tekstil, për brend në shtëpi”. Konstatohet se nga personeli



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë shkelja doganore e konsumuar që lidhet me keqklasifikimn tarifor të kryer nga subjekti “OGIGIS TORO AMENITIES” meNIPT L37224203G për sasinë prej 7600 palë dhe 580 kg. Nga Autoriteti Doganor nuk është dalë me vendimmarrje për këtë rast dhe detyrimisht duhet të vijohet me nxjerrjen nga Autoriteti Doganor Vlorë të Vendimit Administrativ dhe të informohet **Kontrolli i Lartë i Shtetit bazuar në ligjin specifik organik.**

Për sa më sipër është mbajtur Projekt Raporti i Auditimit nr.1148/8 Prot datë 07.02.2018 dhe protokolluar në Degën Doganore Vlorë me shkresën nr.640 prot D.D.Vlorë datë 09.02.2018dhe për këtë rast subjekti i audituar Dega Doganore Vlorë me shkresën nr.1138/32 prot datë 09.03.2018 dhe shkresën nr.1111 prot datë 08.03.2018 ka bërë komente dhe shpjegime nisur specifikisht edhe nga observacionet e subjekteve të prekura si palë e interesuar si më poshtë vijon,

Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH.

Konkretisht u shqyrtuan observacionet e Degës Doganore Vlorë të përmendur në këtë material për materializimin e akteve administrative për subjektin “Kem Kolor” i cili lidhet me “Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor” me nr. 2813 nxjerrë më datë 02.11.2016 që lidhet më praktikën doganore nr R 11043 datë 01.09.2016 për mallin e deklaruar si “Tretës Boje” në kodin tarifor *38140090* është konkluduar në përfundim në klasifikimin tarifor në kreun tarifor *27101221* “Karburantet e bardha” për të cilin është dalë me vendim administrativdhe u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit

Për subjektin “Sirol 2008” që i referohet shkresës nr.15062/2 prot DPD datë 14.10.2015 që lidhet me “Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor” me NR. 112 nxjerrë më datë 05.10.2015 që lidhet më praktikën doganore nr R 8225 datë 15.06.2015 për mallin e deklaruar si “Etanol Denatyred” në kodin tarifor *22072000* është konkluduar në përfundim në klasifikimin tarifor në kreun tarifor *22071000* “Alkol etilik jo i denatyrar i një forcë ndaj volumit prej 80% vol. apo më shumë” .Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë përcaktimi i dhënë ligjor i dhënë sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 61 “Për Akcizat në RSH” sipas shkallës së detyrimit të akcizës prej 45 000 lekë për HL alkool anhidër e llogaritur në detyrimin e akcizës prej 2580 litra alkool anhidër *45.000 lekë Hektoliter. të vijohet me nxjerrjen nga Autoriteti Doganor Vlorë me vendimarrje dhe të informohet Departamenti i Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit bazuar në ligjin organik.

Gjetje dhe rekomandime nga pika 8 e auditimit

Drejtimi nr.8 “Të tjera gjatë Auditimit”:

Titulli i Gjetjes 6

Zbatimin e legjislacionit doganor në përputhje me Udhëzimin nr.8909/1 prot datë 10.04.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi procedurat e Mostrimit, Transportit, Ruajtjes së Mostrave, Administrimit të rezultateve të analizave laboratorike Situata

Situata:

Nga auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Vlorë gjatë veprimtarisë së zyrës doganore të sektorit operacional në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr.8909/1 prot datë 10.04.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi procedurat e Mostrimit, Transportit , Ruajtjes së Mostrave, Administrimit të rezultateve të analizave laboratorike” rezultoi se nga personeli përpunues



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Kriteri :	doganor për raste praktikash doganore të përzgjedhura nga profile të ndryshme risku për dyshime të keqklasifikimevë tariforë nuk janë marrë mostra nga doganierët e kontrollit fizik në përmbushje të detyrave funksionale të ngarkuara nga legjislacioni doganor . Udhëzimi nr.8909/1 prot datë 10.04.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “ <i>Mbi procedurat e Mostrimit, Transportit, Ruajtjes së Mostrave, Administrimit të rezultateve të analizave laboratorike</i> ”
Ndikimi/Efekti	Konstatohen mosveprime doganore nga personeli përpunues doganor jo në përputhje me Udhëzimin nr.8909/1 prot datë 10.04.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “ <i>Mbi procedurat e Mostrimit, Transportit, Ruajtjes së Mostrave, Administrimit të rezultateve të analizave laboratorike</i> gjatë vitit ushtrimor 2015, 2016 dhe 2017.
Rëndësia	E lartë.
Rekomandimi	Dega Doganore Vlorë nëpërmjet personelit përpunues doganor të zbatojë në mënyrë korrekte dhe me përgjegësi të plotë rastet e marrjes së mostrimit të mallrave të dyshuara për klasifikime të gabuara tariforë dhe për dyshime të tjera doganore të mbuluara nga profile risku me mostrim të detyrueshëm malli, në përmbushje të plotë të kërkesave të Udhëzimit nr.8909/1 prot datë 10.04.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “ <i>Mbi procedurat e Mostrimit, Transportit , Ruajtjes së Mostrave, Administrimit të rezultateve të analizave laboratorike</i> ” si dhe në rastet e konstatimit të moskryerjes së kësaj procedure të detyrueshme doganore të nxirren përgjegjësitë konkrete të personelit përpunues doganor për mospërmbushje të detyrave funksionale të ngarkuara nga legjislacioni doganor në fuqi.

Menjëherë

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si *më poshtë*:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se rezultonin diferenca të pagesës së rentës minerare që lidhen me vlerën e mallit “naftë bruto” të deklaruar në kodin tarifor *27090090* në deklaratat e eksportit nga subjekti “*Bankers Petroleum*” dhe “*Transantlik Oil*” krahasuar kjo me çmimin e publikuar të Bursës së Reuters (*platts*) për artikullin “*Naftë Bruto*” sipas kushtit të lëvrimit FOB për periudhën nën auditim. Gjithashtu nga **Kryetari i Komisionit AD-HOC** pranë Ministrisë së Financave nuk është mbledhë ky komision dhe nuk janë nxjerrë të dhëna referuese ose krahasuese për artikullin “*Naftë Bruto*” të deklaruar për eksport me origjinë nga “*Prodhimi Vendas Shqipëri*” sipas kushtit të lëvrimit FOB në zbatim të pikës 3 të VKM nr. 201, datë 21.03.2012, e ndryshuar ku përcaktohet se lista me vlerat referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale, hartohet dhe miratohet nga një komision AD-HOC i ngritur me urdhër të Ministrisë së Financave nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Drejtorive të Përgjithshme të Doganave e Tatimeve, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), Fakultetit të Gjeologji-Minierave, dhe “*brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ua*



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

përcjell zyrtarisht listën e miratuar autoriteteve doganore e tatimore, për t’u përdorur si burim i të dhënave të disponueshme. Ky komision mblidhet dhe përditëson listën sa herë është e nevojshme”

Trajtuar në faqet nr. 35-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit:

1.1 Rekomandimi. Dega Doganore Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ti drejtohet menjëherë **Kryetarit të Komisionit AD-HOC** pranë Ministrisë së Financave, në cilësinë e përfaqësuesit të ngarkuar me ligj pranë këtij Komisioni, me qëllim mbledhjen e menjëhershme të këtij Komisioni për përcaktimin e saktë të vlerës referuese, të artikullit “naftë bruto” nxjerrë sipas prodhimit vendas sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale, bazuar në zbatim të pikës 3 të VKM nr. 201, datë 21.03.2012, e ndryshuar dhe “brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, t’ja përcjell zyrtarisht listën e miratuar autoriteteve doganore e tatimore, për t’u përdorur si burim i të dhënave të disponueshme dhe të kryejë përditësime të listës sa herë të gjykohet se është e nevojshme”

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se rezultonin diferenca të pagesës së rentës minerare që lidhen me vlerën e mallit “naftë brutto” në deklaratat e eksportit nga subjekti “Bankers Petroleum” dhe “Transantlik Oil” krahasuar kjo me çmimin e publikuar të Bursës së Reuters (platts) për artikullin “Naftë Bruto” sipas kushtit të lëvrimit FOB, në **shumën totale prej 2,240,931 mijë lekë**. Nga **Komisioni AD-HOC** pranë Ministrisë së Financave nuk rezultojnë të publikuara të dhëna referuese ose krahasuese për artikullin “Naftë Bruto” të deklaruar për eksport për mallra me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të lëvrimit FOB. Në vijim nga Autoriteti Doganor Vlorë është kërkuar verifikim doganor për 121 praktika doganore pranë selive të kompanive pritëse ose importuese për praktikat doganore nën juridiksion auditimi për periudhën 01.01.2015 deri në periudhën 01.09.2017 për eksportet e kryer nga subjekti “Bankers Petroleum” sipas shkresës nr. 718 prot D.D.Vlorë datë 14.02.2018, shkresës nr. 670 prot D.D.Vlorë datë 12.02.2018 dhe shkresës nr. 632 prot D.D.Vlorë datë 08.02.2018 të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Konstatohet se nuk kemi përgjigje të verifikimeve të kryera si dhe nuk është kryer garantimi për pjesën e detyrimit doganor të munguar që mund të rilindë në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe pas kryerjes së verifikimeve doganore nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi **trajtuar si problematikë edhe më parë me shkresën nr. 835/1 Prot të Kontrollit të Lartë të Shtetit**, datë 20.09.2016 me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës së Degës Doganore Vlorë”.

Trajtuar në faqet 35-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit:

2.1 Rekomandimi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Degën Doganore Vlorë në mungesë të publikimit të të dhënave referuese nga **Komisioni AD-HOC** pranë Ministrisë së Financave për artikullin “Naftë Bruto” me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të lëvrimit FOB, dhe mungesës së përgjigjes së verifikimeve doganore të dërguara për investigim pranë Autoriteteve Doganore Homologe të gjykojë dhe të kërkojë ndjekjen e procedurave për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pagesës së rentës minerare të konstatuar si diferenca pagese në shumën prej 2,240,931 mijë lekë, shoqëruar me garantimin e borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë procedurave dhe transaksioneve të kryera midis kompanisë “Bankers Petroleum”, dhe “Transantlik Oil” dhe kompanive pritëse ose importuese të mallrave të natyrës “naftë bruto” të eksportuara nga këto kompani nga territori doganor shqiptar, për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Autoritetet Doganore Homologe bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, në shumën prej 2,240,931 mijë lekë për deklarime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017 deri në përfundim të hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore ku rezultojnë të përfshira rekomandime të trajtuara sa më sipër që lidhen me këtë pikë “Masë Organizative” trajtuar në faqet 35-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga ana e Degës Doganore Vlorë të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke informuar njëkohësisht edhe KLSH-në, në lidhje me afatet dhe ecurinë e procesit gjyqësor në vijimësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk rezultojnë të zbatuara masa për shpërbllim dëmi të rekomanduara më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 222/19 prot datë 30.06.2014, protokolluar në Degën e Doganës Vlorë me nr. 1534/3 prot datë 03.07.2014 në shumën **72,479,395 lekë**. Gjithashtu nuk është zbatuar një masë administrative dhe një masë disiplinore si dhe nuk është njoftuar Kontrolli i Lartë i Shtetit brenda afatit 20 ditor sipas përcaktimeve të shkresës nr. 222/19 prot Klsh datë 30.06.2014. Gjithashtu u konstatua se rezultojnë të pazbatuara masa për shpërbllim dëmi të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1101/17 datë 06.05.2015 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për auditimin e kryer për Taksën e Rentës Minerare dhe përcjellë me shkresën nr. 11213/1 datë 11.05.2015 Degës Doganore Vlorë në shumën **3,312,447,182 lekë** për 3 subjekte me aktivitet në fushën e hidrokarbureve që operojnë me eksportin e artikullit “*naftë bruto*”. Nga 116 praktika doganore të dërguara për verifikim doganor nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për 3 kompani, rezultojnë përgjigje të verifikimeve doganore të ardhura nga Autoritetet Doganore Homologe me shkresat nr. 13062.7 prot DPD datë 24.07.2015, ardhur nga Autoritetet Doganore të Spanjës për një eksport të verifikuar, shkresa nr. 3552 prot DDVlorë datë 07.09.2017, dhe shkresa nr. 18055/1 prot DD Vlorë datë 13.08.2017, por pa specifikuar rezultatin konkret të përputhshmërisë së tyre me faturat e dërguara për verifikim doganor. Në përfundim nuk administrohet akoma një përgjigje zyrtare përfundimtare e konformitetit të deklarimeve të kryera në lidhje me pagesën e rentës minerare për 116 praktikat doganore të dërguara për verifikim për këtë kompani nga Dega Doganore Vlorë, për të cilat janë rekomanduar detyrime të pagesës së rentës minerare me shkresën nr. 1101/17, datë 06.05.2015 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që lidhet me auditimin e pagesës së rentës minerare.

Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-27 dhe aneksin nr. 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit :

3.1 Rekomandimi. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në cilësinë e organit epror dhe Dega Doganore Vlorë në cilësinë e organit administrativ juridiksional të analizojnë në bashkëpunim të plotë rekomandimet e lëna, deleguar për kompetencë për vendimmarrje Degës Doganore Vlorë duke marrë masa të menjëhershme për analizimin e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete ligjore për moszbatimin e tyre. Nga këto dy institucione të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme verifikuese dhe administrative ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit për kontabilizimin e shumës prej **72,479 mijë lekë** rekomanduar më parë në



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 222/19 prot DDVlorë datë 30.06.2014, me shkresën nr. 1534/3 prot DDVlorë datë 03.07.2014, si dhe të kërkojë në mënyrë të menjëhershme ndjekjen dhe analizimin e shkaqeve ligjore dhe proceduriale të procedurave verifikuese të nisura më parë në funksion të zgjidhjes së problematikës së pagesës, kontabilizimit dhe arkëtimit të shumës prej **3,312,447 mijë lekë** rekomanduar më parë në Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjellë me shkresën nr. 1101/17 datë 06.05.2015 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që lidhet me auditimin e pagesës së rentës minerare

Menjëherë dhe në vijimësi.

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i ushtruar mbi programimin dhe realizimin e të ardhurave doganore gjatë periudhës së audituar të viteve 2015, 2016 dhe 9-mujori i parë i vitit 2017, u konstatua se nga Dega e Doganës Vlorë nuk janë realizuar të ardhurat doganore në krahasim me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke krijuar një diferencë të përgjithshme mosrealizimi në vlerën **7,349,041 mijë lekë** të rezultuar kryesisht gjatë viteve 2015 dhe 2016 e cila përbën rreth 95,5% të diferencës totale të mosrealizuar.

Trajtuar në faqet 27-35 dhe aneksit nr. 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit:

4.1 Rekomandim. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë të marrë masa të plota ligjore e administrative me plane konkrete për të analizuar në mënyrë të përditësuar zbatimin e masave që janë marrë dhe që do të merren për realizimin e të ardhurave doganore sipas të gjithë zërave respektivë në përputhje të plotë me programimin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për përmbushjen e misionit që i është ngarkuar sipas ligjit nr. 8449, datë 20.01.1999 “Kodi Doganor në RSH” i ndryshuar, ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse të stafit doganor në përputhje me funksionet që ata kryejnë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi dhe analiza e borxhit doganor gjëndje deri më datë 01.10.2017, i krijuar gjatë viteve deri në periudhën 30.09.2017, u konstatua se nga autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Vlorë nuk janë arritur të zbatohen plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për rikuperimin e borxhit doganor, duke reflektuar një gjëndje borxhi doganor në fund të periudhës së audituar në vlerën 819,296 mijë lekë nga të cilat shuma prej 571,630 mijë lekë në proces gjyqësor falimentimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shuma prej 247,666 mijë e parikuperuar. Konstatohet një pakësim i dukshëm i borxhit doganor në periudhën gusht-tetor 2017 në vlerën 38,025 mijë lekë .

Trajtuar në faqet nr. 115-128 të Raportit Përfundimtarit të Auditimit :

5.1 Rekomandim. Autoriteti doganor kompetent, DDVlorë të kërkojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave mbështetje metodologjike për sistemin e vlerave të borxhit, i cili është në kushtet e pamundësise për tu arkëtuar dhe të përcaktohen afate konkrete për perfundimin e këtij procesi duke marrë masa të plota ligjore për rikuperimin ose shuarjen e borxhit doganor të krijuar gjatë viteve 2009 deri në periudhën 01.10.2017 në vlerën 819,296 mijë lekë, si dhe të hartojë një program konkret me persona përgjegjës me afate kohore konkrete duke bashkëpunuar intensivisht me të gjitha institucionet e ngarkuara sipas ligjit për rikuperimin e borxhit si mësipërm bazuar në ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 4, datë 07.04.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”



KONTROLLI I LARTE I SHTESTIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se gjatë procesit të vlerësimit doganor nga personeli përpunues doganor nuk janë marrë në konsideratë shpjegimet dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të Ministrit të Financave, "Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore", ku përcaktohet sipas pikës 5.2 të këtij Udhëzimi se "në rastet kur për mallin e deklaruar nuk është e mundur të gjendet në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme atëherë në degën doganore ngrihet Grup Pune për përcaktimin e vlerës së mallit dhe vihet në dijeni zyrtarisht me shkrim Zëvendës drejtori i Departamentit Teknik" kryesisht për mallrat të natyrës "stok, fidanë agrumesh dhe paleta të përdoruara" dhe mallra të tjerë të papërfshirë në përshkrimet e Dosjes së të Dhënave të Disponueshme në RSH trajtuar në faqet nr. 28-74 të Projektraportit të Auditimit dërguar pranë DDVlorë me shkresën nr. 1148/8 prot tonën KLSH datë 07.02.2018.

Trajtuar në faqet nr. 65-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

6.1 Rekomandim. Dega e Doganës Vlorë në vijim nëpërmjet personelit përpunues doganor të kontrollit dokumentar në rastet e deklarimit të mallrave të natyrës "stok, fidanë agrumesh dhe paleta të përdoruara" të ngrëjë grup pune për përcaktimin e vlerës së mallit dhe të vendosë në dijeni zyrtarisht me shkrim Zëvendës drejtorin e Departamentit Teknik bazuar në përcaktimet e pikës 5.2 të Udhëzimit nr. 25 datë 16.05.2006 të Ministrit të Financave "Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore",

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i veprimtarisë së subjekteve tregëtarë që operojnë në fushën e akcizës u konstatua se subjektet me NIPT K36616211M, me NIPT K76603205E, me NIPT K77419201U, me NIPT K96404204P, me NIPT K56915201L dhe me NIPT K47123204G zotërojnë së bashku një sasi stoku prej 146,652 litra ose 85 % të stokut total të artikullit verë të deklaruar pranë kësaj Dege Doganore. Konstatohet se nga zyra e sektorit të akcizës janë ushtruar vetëm 3 (tre) programe kontrolli gjatë vitit 2017 me qëllim verifikimin e situatës nga momenti i grumbullimit të lëndës së parë (rrushit) e deri tek prodhimi, shitja dhe administrimi i produkteve të gatshme në magazinat fiskale respektive. Nga zyra e sektorit të akcizës gjatë viteve 2015, 2016 nuk është kryer asnjë program kontrolli me iniciativë direkte nga personeli mbikëqyrës mbi depozituesit e miratuar duke kryer dhe konsumuar veprime në kundërshtim me nenet 45-47 "Kompetencat e Autoriteteve Doganore" sipas përcaktimeve të ligjit nr. 61 datë 25.09.2012 "Për Akcizat në RSH".

Trajtuar në faqet 144-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit ;

7.1 Rekomandimi. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Vlorë të marrë masa të menjëhershme ligjore për nxjerrjen e përgjegjësive për mosveprimet e kryera nga ana e personelit përpunues doganor të sektorit të akcizës, të cilët nuk kanë kryer kontrolle pranë operatorëve me status depozitues të miratuar gjatë periudhës 2015, 2016 duke kryer dhe konsumuar veprime në kundërshtim me nenet 45-47 "Kompetencat e Autoriteteve Doganore", si dhe të ndjekë në mënyrë të menjëhershme analizimin e faktorëve që kanë sjellë pasojë akumulimin e sasisë së stokut prej 146,652 litra verë nga operatorët e mësipërm në përmbushje të përcaktimeve të ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 "Për Akcizat në RSH" dhe VKM-nr.612 datë 25.09.2012 "Dispozitat Zbatuese të Ligjit të Akcizës".

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se gjatë veprimtarisë së rregjimeve doganore ekonomike të subjektit "T.Maró" me NIPT L364101201R për autorizimet nr. 7073/2 të datës 21.03.2014 dhe nr. 6658/2 datë 20.03.2015 të marra nga ky subjekt dhe me subjekt porositës kompaninë italiane "Imac Spa Via Menochia 27 63010 Montefiore Del Aso



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Askoli Piceno Itali” vlera e tarifës TTP pagesa e trajtimit tarifor preferencial rezultonte në nivele shumë të ulëta në shumën 1,550,433 lekë ndërkohë që u konstatua se vlera e mallrave të hyra në këto regjime doganore ekonomike jashtë kushtit preferencial MSABE rezultoi në shumën prej 97,082,022 lekë nga të cilat specifikisht në kodet tarifore *4107* lëkurë dhe *5903* pëlhurë të deklaruara në kode tarifore me tarifë minimale bazë 0%. Gjithashtu nuk janë kryer veprime verifikuese nga personeli përpunues doganor me qëllim provimin e vërtetësisë së origjinës së mallrave të lëvruara në praktikat doganore në procedurat e importit si dhe nuk janë kryer mostrime malli me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor të mallrave të hyra në këto regjime doganore ekonomike.

Trajtuar në faqet 96-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit :

8.1 Rekomandimi. Dega Doganore Vlorë nëpërmjet Sektorit të Kontrollit pas Zhdoganimit të kërkojë verifikimin e dëshmimeve të origjinës për deklarata faturë të lëshuara nga eksportuesi i miratuar “*Imac Spa Via Menochia 27 63010 Montefiore Del Aso Askoli Piceno Itali*” për mallrat e lëvruar në kodet tarifore *4107* lëkurë dhe *5903* pëlhurë të deklaruara në kode tarifore me tarifë bazë 0% gjatë veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike sipas autorizimeve nr. 7073/2 të datës 21.03.2014 dhe nr. 6658/2 datë 20.03.2015 të përfituara nga ky subjekt dhe të trajtuara me procedura në eksport me kushtin preferencial MSABE. Bazuar në përcaktimet e Udhëzimit nr. 2077 prot datë 06.08.2010 “*Mbi rregullat e Origjinës*”, dokumentit të Udhërfyësit sipas ligjit nr 9590 datë 27.07.2006, “*Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare*”, pjesa V, Titulli “*Vërtetimi i Origjinës*”, dhe nenit 33 “*Verifikimi i Dëshmimeve të Origjinës*” të kryhet verifikimi doganor për përmbushjen e kushtit preferencial MSABE dhe përputhshmërinë e klasifikimit tarifor të artikullit lëkurë deklaruar në kodin *4107* dhe artikullit pëlhurë në kreun *5903* të deklaruara në kode tarifore me tarifë bazë 0%

8.2 Rekomandimi. Dega Doganore Vlorë nëpërmjet sektorit të kontrollit pas zhdoganimit të dhe sektorit të regjimeve doganore ekonomike të kryejë mostrime të detyrueshme malli për mallrat e hyra në regjimet doganore ekonomike në kodet tarifore *4107* lëkurë dhe *5903* pëlhurë të deklaruara me tarifë bazë 0% dhe të trajtuara me procedura në eksport me kushtin preferencial MSABE, me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor të mallrave të hyra në këto regjime doganore ekonomike nga operatori ekonomik “*Tomaificio Maro*” me NIPT L364101201R

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore për periudhën nën auditim rezultuan vendime administrative të nxjerra jo në përputhje me përcaktimet e nenit 256 dhe 271 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, për 2 raste subjektsh për vendime të nxjerra gjatë vitit ushtrimor 2016 për të cilat Autoriteti Doganor Vlorë ka nxjerrë detyrime dhe penalitete më tepër sa sa duhet të kontabilizoheshin në Vendimet administrative të nxjerra nga DDVlorë në shumën 8,013,473 lekë.

Trajtuar në faqet nr. 128-144 dhe anekset nr. 6.1-6.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9.1 Rekomandimi. Dega Doganore Vlorë të kryejë ndryshimin ose revokimin në rrugë ligjore për vendime administrative në shumën totale **8,013,473 lekë** për 2 raste subjektsh duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative me qëllim korrigjimin material të shumës së kontabilizuar më parë duke marrë në konsideratë konstatimet e shprehura në Raportin Përfundimtar të Auditimit në përputhje me përcaktimet e nenit 256 dhe 271 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

10. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i procedurave administrative të ndjekura nga Autoriteti Doganor Vlorë gjatë veprimtarisë së zyrës doganore të sektorit operacional në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr. 8909/1 prot datë 10.04.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “*Mbi procedurat e Mostrimit, Transportit , Ruajtjes së Mostrave, Administrimit të rezultateve të analizave laboratorike*” rezultoi se nga personeli përpunues doganor për raste praktikash doganore të përzgjedhura nga profile të ndryshme risku për dyshime të keqklasifikimeve tarifore nuk janë marrë mostra nga doganierët e kontrollit fizik në përmbushje të detyrave funksionale të ngarkuara nga legjislacioni doganor në fuqi.

Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 153-158 dhe anekset nr. 8.1-8.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10.1 Rekomandimi. Dega Doganore Vlorë në vijim nëpërmjet personelit përpunues doganor të zbatohet në mënyrë korrekte dhe me përgjegjësi të plotë rastet e marrjes së mostrimit të mallrave të dyshuara për klasifikime të gabuara tarifore dhe për dyshime të tjera doganore të mbuluara nga profile risku me mostrim të detyrueshëm malli, në përmbushje të plotë të kërkesave të Udhëzimit nr. 8909/1 prot datë 10.04.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “*Mbi procedurat e Mostrimit, Transportit , Ruajtjes së Mostrave, Administrimit të rezultateve të analizave laboratorike*” si dhe për rastet e konstatimit të moskryerjes së kësaj procedure të detyrueshme doganore, të nxirren përgjegjësitë konkrete të personelit përpunues doganor përmospërmbushje të detyrave funksionale të ngarkuara nga legjislacioni doganor në fuqi.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se gjatë deklarimeve doganore në procedura doganore IMP 4 vlerat e shpenzimeve të transportit janë deklaruar nën kufijtë minimalë të çmimit të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave sipas kriterëve dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 “*Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore*”. Në disa raste nuk ka një kontratë lëvrimi malli të përcaktuar midis lëvruesit të mallit dhe shoqërive importuese. Konstatohet se këto transporte malli janë kryer kryesisht me destinacion Italinë, Greqinë, Maqedoninë dhe janë kryer nga kompani shqiptare me seli të regjistruara në territorin doganor shqiptar si dokument transporti kanë shërbyer fatura tatimore shqiptare për transport ndërkombëtar të lëshuar nga këto kompani. Nga personeli përpunues doganor është administruar vetëm dokumentacioni tregëtar që lidhet me **itinerarin mbërritës** dhe nuk është kërkuar dokumentacion shtesë për të justifikuar edhe pjesën e **itinerarit nisës** për qëllime të vlerësimit dhe gjykimit përfundimtar për shpenzimet totale të transportit për rastet e deklarimeve të identifikuar më parë në Projekt Raportin e Auditimit sipas aneksit nr. 3.3 në shumën 3,769 mijë lekë dhe të trajtuara në këtë Raport Auditimi për ndjekje dhe verifikim të saktë ligjor nga Dega Doganore Vlorë dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore respektive të shpenzimeve të transportit vajtje-ardhje sipas faturave tatimore të lëshuara.

Trajtuar në faqet nr. 37-96 dhe anekset nr. 3.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11.1 Rekomandimi. Dega Doganore Vlorë të analizojë deklaratimet doganore që lidhen me shpenzimet e transportit të trajtuara në aneksin nr. 3.3 duke marrë në konsideratë të plotë përcaktimet e nenit 67 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*” ku përcaktohet seçmimit realisht të paguari duhen shtuar pika (i) “*shpenzimet e transportit e të sigurimit*” dhe (ii) “*shpenzimet e ngarkimit e të trajtimit që lidhen me transportin e mallrave*” dhe pikës 2 të nenit 67 të Kodit Doganor ku përcaktohet se “*Shtesat në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar, sipas këtij neni, bëhen vetëm në bazë të të dhënave objektive e të llogaritshme*” dhe në vijim të nxjerrë dhe kontabilizojë detyrimet respektive doganore të papaguara. Për rastet kur vlera e këtyre shpenzimeve është nën kufijtë



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

e lejuar sipas të Dosjes së të Dhënave të Disponueshme në RSH, në rastet e praktikave doganore ku janë dokumentuar vetëm shpenzimet e **transportit të mbërritjes** nga vendet lëvruese, të kërkohet dokumentacion shtesë për shpenzimet e transportit të kryera **në itinerarin nisës** nga shoqëritë transportuese shqiptare dhe të huaja. Gjithashtu të kryhen verifikime periodike pranë Drejtorive Rajonale Tatimore dhe të kërkohet dokumentacion tregëtar shtesë në lidhje me vlerat dhe vërtetësitë e dokumenteve të transportit të shprehura si shërbime të kryera nga shoqëritë e transportit sipas faturave tatimore respektive dhe në përfundim të konkludohet për ndjekjen e dhe arkëtimin e detyrimeve doganore në shumën shumën 3,769 mijë lekë sipas referimeve të cituara në aneksin nr. 3.3 bashkëngjitur këtij raporti përfundimtar auditimi.

Menjëherë

Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, ku përcaktohet qartë që: “dërgesa” do të thotë produkte që janë dërguar në mënyrë të njëkohshme nga një eksportues te një marrësosetë shoqëruara me një dokument të vetëm transporti që mbulon transportimin e tyre nga një eksportues te një marrës .”, dhe kërkesat e Titullit V, neni 22 “Kushtet per berjen e nje Deklarate Fature”, pika 1, gërma “b” të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, në të përcaktohet qartë që: “Një deklaratë faturë, siç referohet ne Nenin 16(1)(b), mund te behet:... nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera totale e të cilave nuk i kalon 6000€”;

*- së dyti, pretendimet Tuaja lidhur me DAV me R-13, datë 05/10/2015, referuar notave shpjeguese të NKM por edhe deklarimeve në D.D.V si dhe në degët e tjera doganore, artikulli “Letër për depilim” është keqklasifikuar në kodin tarifor *48189090* me pasojë shmangien e detyrimeve doganore pasi duhej klasifikuar në kodin tarifor *33079000* me nivel të taksës doganore 6 %.*

Shkresën nr.1148/32 prot., datë 09.03.2018 (KLSH), nr.1116 prot., datë 08.03.2018 (D.D.V), me dokumentacionin bashkëlidhur, sa më poshtë:

1. Në lidhje me importet e kryera nga subjekti “Sirol-2008”, ku citohet se “...Duke analizuar në tërësinë e tyre të gjithë elementët për një vlerësim doganor sa më objektiv, u pranua transaksioni si metodë e parë e vlerësimit doganor...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi cmimi i artikullit të deklaruar paraqitet nën 50 % të cmimeve të miratuara nga komisioni add-hoc pranë MF si dhe krahasuar me subjektet e tjerë për të cilët nga ana Juaj është rivlerësuar artikulli si dhe referuar DAV me R-8133, datë 12.06.2015 nga ana Juaj është bërë ndërhyrje për rivlerësimin e artikullit sipas nenit 36 të KD sipas të dhënave të disponueshme.

2. Në lidhje me “Deklaratat faturë”, ku citohet se “...Subjektet nuk kanë patur qëllim për të shmangur apo për të fshehur dicka në këto fatura pasi pavarësisht ndarjes në dy fatura malli është tërësisht me origjinë italiane...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi mallrat janë trajtuar me origjinë preferenciale pa dokumentacionin e detyrueshëm të origjinës preferenciale, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Titullit I “Dispozita të përgjithshme”, neni 1 “Përkufizimet”, germa “l”, të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, ku përcaktohet qartë që: ““dërgesa” do të thotë produkte që janë dërguar në mënyrë të njëkohshme nga një eksportues te një marrësosetë shoqëruara me një dokument të vetëm transporti që mbulon transportimin e tyre nga një eksportues te një marrës ...”, dhe kërkesat e Titullit V, neni 22 “Kushtet per berjen e nje Deklarate Fature”, pika 1, gërma “b” të Udhërrëfyesit të MSABE “Mbi Rregullat e Origjinës Preferenciale të përdorura në tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Vendeve të tjera sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë”, në të përcaktohet qartë që: “Një deklaratë faturë, siç referohet ne Nenin 16(1)(b), mund te behet:...



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera totale e të cilave nuk i kalon 6000€”;

3. Në lidhje me importet e kryera nga subjekti “Afërdita/V”, ku citohet se “...Cmimet në sistemin e raporteve të ASYCUDA janë të ndryshme në varësi të sasisë dhe cilësisë së importuar nga subjekte të ndryshëm...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi cmimi i artikullit të deklaruar paraqitet shumë ulët, krahasuar me cmimet e miratuara nga komisioni add-hoc pranë MF si dhe krahasuar me subjektet e tjerë për të cilët nga ana Juaj është rivlerësuar artikulli si dhe referuar DAV me R-8133, datë 12.06.2015 nga ana Juaj është bërë ndërhyrje për rivlerësimin e artikullit sipas nenit 36 të KD sipas të dhënave të disponueshme.

4. Në lidhje me taksën e ambalazhit (TAM), ku citohet se “...për tu quajtur set këto produkte duhet të jenë së bashku, kafja, sheqeri, trazuesi etj, të përdoren specifikisht në shërbim të kafes...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi artikulli është importuar së bashku me kafën në bustina apo kapsula, sheqerin dhe trazuesit brenda një dite dhe shërben për ambalazhimin e saj, (pavarësisht se është ndarë në DAV tjetër), ndajnë kuadratin 31 të DAV duhej deklaruar kodi 74 për të gjeneruar taksën e ambalazhit, ashtu si dhe te praktikat e tjera doganore.

5. Në lidhje me artikullin “Ace kandexhina”,

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

6. Në lidhje me artikujt e klasifikuar në kodin tarifor *12119086*, ku citohet se “...kodet tarifore të këtij produkti i ka të përshkruara në faturë të certifikuar sipas përbërësve të tij dhe nuk është e drejtë që pa asnjë përgjigje të laboratorit si organi më i specializuar ..ne të ndërhyjmë për të ndërruar kodin tarifor...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet Tuaja lidhur me klasifikimin tarifor të artikullit “Caj kamomili në bustina”, deklaruar në kodin tarifor me kre *1211*, nuk qëndrojnë pasi:

I. - referuar notave shpjeguese të NKM në këtë kre futen “Bimët dhe pjesë të bimëve të një lloji të përdorur kryesisht në parfumeri, në farmaceutikë apo për qëllime insekticidale....”;

II. - artikulli i sipërcituar i deklaruar nga ky subjekt në degën Tuaj doganore nga ky subjekt (DAV me R-4022, datë 25.12.2015, artikulli 2, R-12143, datë 24.09.2016, artikulli 5), por edhe nga subjekte të tjerë në degën Tuaj doganore por edhe në degët e tjera doganore rezultoi i deklaruar në kodin tarifor me kre *0902* të NKM me nivel tarifor 15 %;

7. Në lidhje me rivlerësimin e artikujve të përdorur, ku citohet se “...është ngritur grup vlerë dhe artikujt janë vlerësuar sipas Udhëzimit 25, datë 30.11.2007, pika 5.4 jo më pak se 30 % e çmimit të ri...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë pasi:

I. – për DAV me R-9778, datë 30.07.2016 nga ana Juaj nuk është bërë rivlerësim i artikullit në masën e praktikave të tjera me të njëjtin artikull (mjaft të citojmë DAV me R-5850, datë 13.05.2016, por jo vetëm), ku artikulli “mullinj kafeje të përdorur” është vlerësuar me 50 euro/copë;

II. – për DAV me R-2120, datë 16.02.2015 dhe DAV me R-963, datë 25.01.2015, (ku nga një përlllogaritje e thjeshtë për DAV me R-2120, artikulli “Lavatrice të përdorura 400/600/800/1000/>1000 xhiro”, përkatësisht në sasi të 104/21/10/10/10 copë), nuk është rivlerësuar përkatësisht me 30 % të (120/160/170/200/220 €/copë);

III. – për DAV me R-12288, datë 16.10.2016 artikulli “Pirun”, nuk është rivlerësuar me 30 % të çmimit referues ashtu si në praktikën e tjera doganore të përpunuara në degën Tuaj apo në degët e tjera doganore;

IV. – edhe për praktikën e tjera me artikuj të përdorur, nuk janë rivlerësuar me 30 % të çmimit referues ashtu si në praktikën e tjera doganore të përpunuara në degën Tuaj apo në degët e tjera doganore;

V. – për DAV me R-2707, datë 05.03.2016 artikulli “Bidona plastik të përdorur”, është rivlerësuar dhe trajtuar nga ana Juaj nën çmimin e lëndës së parë;

8. Në lidhje me importet e kryera nga subjekti “Bernard 2002”, ku citohet se “...diferenca e çmimit të blerjes nga subjekti me të dhënat e disponueshme është 0.4 euro/kg mendojmë se është një cmim i cili pasqyron transaksionin real të kryer...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi artikujt e importuar nga subjekti paraqiten me cmime të ndryshme dhe deri në vitin 2016 nga i njëjti eksportues ato kanë qenë mbi vlerat referuese ndaj referuar metodës 2 të vlerësimit nga ana Juaj duhet të rivlerësoheshin artikujt sipas kërkesave të nenit 35 të KD..

9. Në lidhje me importet e kryera të artikujve prej plastike,

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Bedinaj, z. Ferati, z. Hoxha, z. Hysi dhe z. Bega, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë për ato subjekte që artikujt i kanë deklaruar me vlera nën çmimin e lëndës së parë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, (mjafton të citojmë DAV me R-6407/2016; R-9381/2016; 11460/2016; 3956/2016; 15750/2016 etj).

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.3, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, dhe konkretisht me shkresën nr.1148/9 prot., datë 20.02.2018 (KLSH), me dokumentacionin bashkëlidhur, ku citohet se:

“...Ne si firmë kemi kontrata të rregullta me të gjithë firmat nga të cilat furnizohemi ...për çdo praktikë doganore të kryer pranë kësaj dege doganore ...ka si dokumenta shoqëruese: Deklaratë eksporti Greke, Italiane ose Gjermane, faturë malli, Eur.1, packing list, CMR, kontratë me shitësin dhe TVSH transporti...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Durrolli, sqarojmë se pretendimet për vlerësimin doganor të artikujve plastik të importuar nga subjekti “Serma Shpk & “5aShpk”, qëndrojnë prandaj ky koment merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit .

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.3, datë 19.01.2018 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, ka bërë komente dhe shpjegime, dhe konkretisht me shkresën nr.1148/10 prot., datë 22.02.2018 (KLSH), me dokumentacionin bashkëlidhur, ku citohet se:

“...Në dosjet e praktikave doganore të lartpërmendura të shoqërisë ...janë kontrata, pagesa bankare, deklarata e eksportit apo verifikime nga ana e doganës të vendit eksportues për mallrat e importuara...”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Monçe, administrator i subjektit “Kem Color”,sqarojmë se pretendimet lidhur me artikullin “Bojë hidromat”, qëndrojnë prandaj ky koment merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Subjekti i audituar Dega Doganore Vlorë me shkresën nr.1138/32 prot datë 09.03.2018, ka bërë komente dhe shpjegime nisur specifikisht edhe nga observacionet e subjekteve të prekura si palë e interesuar si më poshtë vijon,

Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH

Në lidhje me ankesën e bërë nga subjekti Bankers Petroleum dhe Transatlantik OIL sipas shkresës nr.1069 prot datë 07.03.2018 dhe shkresës nr.1148/31 prot KLSH datë 08.03.2018 pranë Degës Doganore Vlorë grupi i auditimit në tërësinë e fakteve të analizuara konkludoi që në mungesë të veprimeve të kryera nga Komisioni Ad-Hoc pranë Ministrisë së Financave të ndiqet rikerkimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit i vjelja dhe arkëtimin e detyrimeve doganore të pagesës së rentës minerare në vazhdimësi si dhe garantimi i menjëhershëm të borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë “Bankers Petroleum”, dhe “Transatlantik Oil” dhe kompanive blerëse në zbatim të shpjegimeve dhe përcaktimeve të VKM nr.201 datë 21.03.2012 i ndryshuar dhe VKM nr.7 datë 04.01.2012 i ndryshuar deri në ardhjen e një përgjigjeje përfundimtare nga Dega Doganore Vlorë mbi rezultatet e verifikimeve doganore të kërkuara

Observacioni i sektorit doganor PIA Vlorë nënshkruar nga doganieri z. Renato Bega.. Konstatohet në observacion se nga Dega Doganore Vlorë me shkresat nr.718 prot D.D.Vlorë datë 14.02.2018, me nr.670 prot D.D.Vlorë datë 12.02.2018 dhe shkresa nr.632 prot D.D.Vlorë datë 08.02.2018 janë dërguar për konfirmim doganor 121 praktika doganore të njehsuara pranë Departamentit Operativ-Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me qëllim verifikimin e transaksioneve të kryera midis kompanisë Bankers Petroleum dhe kompanive pritëse ose blerëse të mallit të cituara në këtë shkresë që lidhen me juridiksionin e auditimit për vitet 2015-2017.Gjithashtu nëpërmjet këtij observacioni na janë vendosë në dispozicion edhe shkresat nr.3552 prot D.D.Vlorë datë 07.09.2017 me lende “Përgjigje për verifikimin e faturave” ardhur me shkresën nr.18505/1 prot DPD datë 23.08.2017 ku ka ardhë dokumentacioni shkresor për verifikimin e 2 faturave të mallit të cituara në shkresë përkatësisht me blerës malli kompaninë IPLOM sipas faturës nr.23/2013 datë 07.05.2013 dhe faturës nr.31/2013 datë 12.06.2013 dhe shkresa nr.3532 datë 07.09.2017 prot D.D.Vlorë dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr.18055/1prot datë 13.08.2017 kërkuar 27 fatura për verifikim ku janë dokumentuar edhe përgjigjet për këto fatura “por pa specifikuarrezultatit konkret të përputhshmërisë së tyre me faturat e dërguara për verifikim doganor” Gjithashtu në shënimet e Kryetarit të Degës Doganore



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Vlorë i është lënë detyrë juristit dhe specialistit të Degës Doganore Vlorë për të dyja shkresat “Përgatitja e një Informacioni të detajuar për këtë rast”. Në këto kushte në zbatim të shpjegimeve dhe përcaktimeve të Udhezimit nr.VKM nr.201 datë 21.03.2012 i ndryshuar dhe VKM nr.7 datë 04.01.2012 i ndryshuar deri në ardhjen e një përgjigjeje përfundimtare nga Dega Doganore Vlorë mbi rezultatet e verifikimeve doganore të kërkuara do të rikërkohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit vjelja dhe arkëtimin e detyrimeve doganore të pagesës së rentës minerare në vazhdimësi si dhe garantimi i menjëhershëm të borxhit doganor që mund të lindë deri në përfundim të plotë të hetimit dhe verifikimit të të gjithë transaksioneve të kryera midis kompanisë “Bankers Petroleum”, dhe “Transantlik Oil” dhe kompanive pritëse ose importuese të mallrave të natyrës “nafte brutto” të eksportuara nga këto kompani nga territori doganor shqiptar, për detyrime doganore që mund të rilindin në rast të ardhjes së përgjigjeve negative nga Autoritetet Doganore Homologe bazuar në përcaktimet e nenit 204 deri 214 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, sipas shpjegimeve të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor me detyrime të importit të pezulluara” dhe 77 pika 1/a dhe nenit 84-90 të ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi i Ri Doganor në RSH” i ndryshuar, në shumën prej 2,240,931,479 lekë për deklarime doganore të periudhës 01.01.2015-01.10.2017 deri në përfundim të Hetimit që do të kryhet nga Administrata Doganore Shqiptare pranë selive të kompanive pritëse të mallit të cilësuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. trajtuar si problematikë edhe më parë me shkresën nr.835/1 Prot të Kontrollit të Lartë të Shtetit, datë 20.09.2016 me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës së Degës Doganore Vlorë ”.

Në lidhje me observacionin e bërë nga z. Renato Bega në lidhje me rezultatet e lëna, sqarojmë se pretendimet e shprehura në këtë material nuk përbëjnë prova dhe fakte ligjore të provueshme dhe të dokumentuara me prova shkresore. Në lidhje me referimin ligjor të munguar të audituesve të KLSH-së për VKM nr.201 datë 21.03.2012 sqarojmë se ky akt normative nuk ka shfuqizuar VKM nr.7 datë 04.01.2012 por ka prekur disa ndryshime të VKM nr.7 dhe konkretisht në pikën 3, 4, 9 dhe është shtuar PIKA 7.1. Pra të gjitha përcaktimet ligjore të sanksionuara më parë në VKM nr.7 kanë fuqi ligjore

U shqyrtua observacioni i ardhur me shkresën nr.780 prot DPD datë 19.02.2017 i ardhur nga subjekti La Petrolifera Italo-Albanese në lidhje me sasinë prej 180 ton diesel dhe nuk dokumentohet qartë origjina e pronësisë së sasisë prej 180 ton diesel të gjetur në tepricë. Konstatohet se më datën 17.05.2017 subjekti "Netsaviale Franscini,306900 Lugano Zvicra Petrolifera It-Alb, Kod MI-04NIPT K71906007" ka kryer eksport malli në sasinë prej 3,847,060 kg në vlerën 3,847,060 USD për artikullin naftë në kodin tarifor 2710943 ku dokumentohet edhe sasia prej 180 Ton naftë e hyrë në magazinë sipas deklaratës IMP 7 me nr R 2403 datë 28.02.2017. Sipas faturës nr. 23639556 datë 07.03.2017 dokumentohet kalimi i një sasive prej 2,171,270 kg me një çmim prej 424 euro/toni në vlerën totale prej 1,109,916 Euro me shitës malli kompaninë ENI SPA dhe blerës NET SA (adresë Lugano) Zvicër. Nuk dokumentohet në akte ose proces-verbale sasia gjendje e mallit të magazinës doganore në zotërim nga ENI SPA për artikullin naftë në momentin e kryerjes së eksportit të kësaj sasive prej 3,847,060 kg naftë diesel. Merret në konsideratë observacioni i bërë nga sektori Pia me shkresën nr.780 prot datë 19.02.2017 në lidhje me destinacionin e lirë që mund të marrë malli joshqiptar i magazinuar në një zonë të lirë por nuk arrihet të provohet nga ana dokumentare gjendja e magazinës më datën e kryerjes së eksportimit të këtij malli me qëllim provimin e sasisë prej 180 ton të riekportur jashtë zonës së lirë PIA.

Gjithashtu nga Komisioni AD-HOC pranë Ministrisë së Financave nuk janë nxjerrë të dhëna referuese ose krahasuese për artikullin “Naftë Bruto” të deklaruar për eksport me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të lëvrimit FOB në zbatim të pikës 3 të VKM



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

nr.201, datë 21.03.2012, e ndryshuar përcaktohet se lista me vlerat referuese, sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale, hartohet dhe miratohet nga një komision AD-HOC i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Drejtorive të Përgjithshme të Doganave e Tatimeve, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), Fakultetit të Gjeologji-Minierave, dhe “brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ua përcjell zyrtarisht listën e miratuar autoriteteve doganore e tatimore, për t’u përdorur si burim i të dhënave të disponueshme. Ky komision mblidhet dhe përditëson listën sa herë është e nevojshme”

Subjekti i audituar Dega Doganore Vlorë me shkresën nr.1138/32 prot tonën KLSH datë 09.03.2018, dhe shkresës nr.1116 prot D.D.Vlorë datë 08.03.2018

Konkretisht u shqyrtuan obserbacionet e subjekteve :

Subjektit “Fabian 07” meNIPT K73022401E sipas shkresës nr.1090 prot D.D.Vlorë datë 07.03.2018 dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura janë të paqarta dhe nuk mund të merren në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit pasi të dhenat e paraqitura nuk lidhen me kodin autorizues të dhënë për këtë subjekt nga Dega Doganore Vlorë .

Subjektit “Edlo” meNIPT J93112235Ë sipas shkresës nr.1091 prot D.D.Vlorë datë 06.03.2018 dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura janë të paqarta dhe nuk mund të merren në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit pasi të dhenat e paraqitura nuk përbëjnë prova dhe fakte të reja dhe nuk lidhen me kodin autorizues të dhënë për këtë subjekt nga Dega Doganore Vlorë .

Subjektit “Gentian Fejzullahu” meNIPT K12623401T sipas shkresës nr.1076 prot D.D.Vlorë datë 07.03.2018 dhe shkresës nr. 1092 prot D.D.VLORË dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura të merren janë të paqarta dhe nuk mund të merren në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit pasi të dhenat e paraqitura nuk lidhen me kodin autorizues të dhënë për këtë subjekt nga Dega Doganore Vlorë .

Subjektit “Nord Italia Gom” shpk meNIPT K37327202P përfaqësuar nga z. Arsen Breshanaj sipas shkresës nr.1148/17 prot tonën KLSH datë 01.03.2018 dhe shkresës nr 1042 prot D.D.VLORË datë 27.02.2018 dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura janë tepër të sakta dhe provojnë rregullshmërinë dhe përputhshmërinë e procedurave doganore Import 5 (5300) dhe Export 3 (3153) të kryera nga ky subjekt në lidhje me autorizimet e tipit RLP me nr P20160520/2063/1, P20170210/557/1, P20170619/2426/1dhe P20170627/2494/1 dhe merren në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit.

Subjektit “Marlet 2012” meNIPT L23314403I sipas shkresës nr.1070 prot D.D.Vlorë datë 07.03.2018 dhe shkresës nr. 1148/41 prot tonën KLSH datë 15.03.2018 dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura të merren në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit

Subjektit “Lico” meNIPT J77207240T sipas shkresës nr.1148/11 prot KLSH datë 26.02.2018dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura të merren teresisht në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit.

Subjekti “Luiza Simoni” meNIPT L66706203B sipas shkresës nr.1012 prot Dega Doganore Vlorë datë 05.03.2018 dhe shkresa nr.1148/25 prot KLSH, datë 06.03.2018 dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura të merren tërësisht në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit.



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Subjektit “GB Fashion” meNIPT L44301401A sipas shkresës nr.1114 prot Dega Doganore Vlorë datë 08.03.2018 dhe u arrit në konkluzionin që argumentet dhe provat e paraqitura të merren tërësisht në konsideratë dhe të reflektohen në raportin përfundimtar të auditimit pasi gabimi material u riverifikua hollësisht dhe për këtë fakt Dega Doganore Vlorë ka rikërkuar nga Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit në DPD (HelpDesk) rishfaqjen e deklaratës doganore nr.Të tipit EXP 3 me NR. 13911 datë 27.10.2016 në ngarkim të subjektit GB FASHION me peshe neto 31 kg dhe vlerë 6172 Euro

Subjektit “Lolida Group”NIPT K87116202Fipajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me AutoriziminNr. 3032/1,datë 06/02/2015 për zhvillimin e aktivitetit të përpunimit aktiv me pezullim në rivlerësim të argumenteve të paraqitura nga personeli përpunues doganordhe argumenteve te paraqitura u rillogaritën detyrime doganore për mallin lëkurë të hedhur në qarkullim të lirë në shumën 1,484,594 lekë dukë marrë si çmimmesatar vlerën prej 19,29 euro/m2 dhe jo 25 euro/m2, pasi sasia zhdoganuar në dy deklaratat me procedurë 4051 është një sasi e mbartur nga zhdoganimet të mëparshme për të cilat u përdor një metode deduktive mesatare llogaritje të çmimit fillestar hyrës

Gjithashtu nga Dega Doganore Vlorë të ndiqet kontabilizimi i detyrimit doganor për subjektin “Manifaktura Rolega” meNIPT L3652503S sipas konstatimeve të nxjerra në ProjektRaportin Raportin e Auditimit dhe në këtë Raport Përfundimtar nisur edhe nga kërkesa e subjektit “Rolega” me shkresënr.948 prot datë 27.02.2017

Në lidhje me observacionin e ardhur nga subjekti “T.Maró”shpk pas shqyrtimit të obesrvacione mr nr, 1148/48 datë 20.03.2018 ardhur pranë Institucionit të KLSH-se u arrit në konkluzionin që të merret në konsideratë për sa i përket sasisë prej 601kg e cila ishte konstatuar si e paeksportuar nga territori doganor shqiptar dhe u riverifikua nëpërmjet dokumentacionit bashkangjitur rishqyrtimi i afatve autorizuese në lidhje me sasi të mallrave dhe afatin kohor të rieksporimit në lidhje me autorizimet nr. 4311 dhe 1304 të lëshuara nga Dega Doganore Vlorë në lidhje me aplikimin e sanksioneve respektive në zbatim të Kodit Doganor në RSH

Ka bërë komente dhe shpjegime nga personeli përpunues doganor i Degës Doganore Vlorë z. Festim Kapaj, znj Jeta Manaj, z. Andet Hoxhaj dhe z. Gjergji Brakanisur specifikisht edhe nga observacionet e subjekteve të prekura si palë e interesuar si më poshtë vijon,

Me shkresë nr.1148/12 prot., datë 27.02.2018 (KLSH), ku citohet se “...veprimet që kemi kryer për operacionet doganore, i janë përmbajtur VKM nr.205 datë 13.04.1999 Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor...në nenin nr. 300 pika 3 përcaktohet qartë se: Mbyllja e regjimit bëhet 30 ditë pas afatit të rieksporimit të përcaktuar te pika 8 e autorizimit...ne nuk e kemi parë të arsyeshme të bënim mbylljen e regjimit 30 ditë pas eksportit të fundit”

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Aliaj, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi pika 8 e autorizimit ka të bëjë me kufirin kohor për rieksporim të produkteve kompensuesendaj veprimet dhe pretendimet Tuaja bien ndesh me kërkesat e nenit 6, pika 3, të të Udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 të D.P.D “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, në të cilin përcaktohet qartëqë:“Pasi përfundon periudha e vlefshmërisë së autorizimit, përfshi këtu edhe kohën e përpunimit të cilësuar në piken 8 të autorizimit, shoqëria është e detyruar të dorëzojë pranë degës se doganës mbikëqyrëse materialin e mbylljes së autorizimit sipas modelit 3 të këtij udhëzimi. Megjithatë kjo kohë do të jetë më e shpejtë në rastet kur i jepet destinacion doganor produkteve kompensuese. Koha e dorëzimit nuk mund të kalojë 30 ditë



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

nga rastet e sipër përmendura, në të kundërt shoqëria penalizohet sipas nenit 272 të Kodit Doganor.”

Me shkresën nr.1148/16 prot., datë 01.03.2018 (KLSH), nr.926 prot., datë 26.02.2018; nr.1148/20 prot., datë 05.03.2018 (KLSH), nr.2 prot., datë 26.02.2018 (D.D.V); nr.1148/24 prot., datë 06.03.2018 (KLSH), nr.1148/32 prot., datë 09.03.2018 (KLSH), nr.1116 prot., datë 08.03.2018 (D.D.V), ku citohet se “...Veprimet tona janë mbështetur në VKM nr.205, dt. 13.04.1999 (i ndryshuar), neni 300 të cilin po e citojmë: Dokumenti i mbylljes së regjimit i dërgohet zyrës mbikqyrëse brenda 30 ditësh nga mbarimi i afatit të caktuar për riekspertimin...”

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjektet “2 Toci Group”, “Helios”, “Pierilia”, z. Hoxhaj, z. Vjero, zj. Manaj, z. Brakaj dhe z. Kapaj, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi afati i riekspertit i përcaktuar në pikën 8 të autorizimit përfundon së bashku me rieksperton e produkteve kompensuese e përcaktuar qartë kjo te kërkesat e nenit 6, pika 3, të të Udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 të D.P.D “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, në të cilin përcaktohet qartëqë: “Pasi përfundon periudha e vlefshmërisë së autorizimit, përfshi këtu edhe kohën e përpunimit të cilësuar në pikën 8 të autorizimit, shoqëria është e detyruar të dorëzojë pranë degës së doganës mbikëqyrëse materialin e mbylljes së autorizimit sipas modelit 3 të këtij udhëzimi. Megjithatë kjo kohë do të jetë më e shpejtë në rastet kur i jepet destinacion doganor produkteve kompensuese. Koha e dorëzimit nuk mund të kalojë 30 ditë nga rastet e sipër përmendura, në të kundërt shoqëria penalizohet sipas nenit 272 të Kodit Doganor.”

Subjekti i audituar Dega Doganore Vlorë me shkresën nr.1138/32 prot datë 09.03.2018, ka bërë komente dhe shpjegime nisur specifikisht edhe nga observacionet e subjekteve të prekura si palë e interesuar si më poshtë vijon,

Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH

Konkretisht u shqyrtuan observacionet e subjekteve :

Subjekti “Teknoplastik” meNIPT K47201207P sipas shkresave nr.938 prot D.D.Vlorë datë 26.02.2018, shkresa nr.992 prot datë 01.03.2016 D.D.Vlorë dhe shkresa nr.1148/21 prot datë 05.03.2018 tonën KLSH grupi i auditimit arriti në konkuzionin që të merret në konsideratë dhe u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit.

Në lidhje me shkresën nr.1148/15 prot tonën KLSH datë 28.02.2018 dërguar nga z. E. Mustafaraj merret në konsideratë mospërgjegjësia funksionale e z. Mustafaraj për rastin e vendimit administrative në ngarkim të subjektit “Irene Lisette Cop” pasi çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë sipas vendimit unifikues të kolegjit administrative të Gjykatës së Lartë me nr. 3 datë 06.12.2013 dhe problematika e ngritur nga grupi auditues do të reflektohet përsëri në raportin përfundimtar të auditimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor ku Dega Doganore Vlorë do të jetë palë e interesuar dhe e paditur në gjykim.

Në lidhje me shkresën nr.1148/15 prot tonën KLSH datë 28.02.2018 dërguar nga z. E. Mustafaraj merret në konsideratë mospërgjegjësia funksionale e z. Mustafaraj për rastin e vendimeve administrative në ngarkim të subjektit “Maurizio Colombo” dhe subjektit “Fatmir Krasniqi” pasi çështja është për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe problematika e ngritur nga grupi auditues do të reflektohet përsëri në raportin përfundimtar të auditimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Tiranë për borxhin e mbuluar me urdhër ekzekutimi ku Dega Doganore Vlorë do të jetë palë e interesuar dhe e paditur në gjykim.

Në lidhje me shkresën nr.1148/32 prot tonën KLSH datë 09.03.2018 dërguar nga z. E. Callmori Kryetar i Degës Doganore Vlorë me lëndë “Observacione mbi ProjektRaportin e Auditimit” dhe shkresës nr. 1112 prot D.D.Vlorë datë 08.03.2018 nga shqyrtimi i dokumentacionit u arrit në konkluzionin se observacioni i bërë nga juristi i Degës Doganore Vlorë z. E. Mustafaraj për vendimet administrative të nxjerra në ngrakim të subjekteve “Altin Haniaj” “Nevzat Shenaj” “Elona Spahiu” dhe “Mario&Adi” nuk u pranua dhe nuk u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit.

Në lidhje me shkresën nr.1104 prot D.D.Vlorë datë 08.03.2018 dërguar në lidhje me observacionin e ardhura nga Dega Doganore Vlorë pretendohet që më shkresën nr.1277 prot datë 25.03.2016 të Degës Doganore Vlorë është dërguar pranë Departamentit të Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë por nuk provohet konkretisht shkresa specifike dërguar Organeve Tatimore përfshirë Drejtorinë Rajonale Vlorë , Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për konstatimin e referuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë shqyrtimit të Vendimit administrative nr.97 datë 10.03.2015 i mbajtur për subjektin “Transatlantic Albania LTD-Dega Shqipëri me NIPT K72205016P. ku është konstatuar se gjatë kontrollit të kryer sipas materialit shkresor nr.4482 prot datë 09.01.2014 me tematikë kontrolli “Verifikimin e gjendjes së stokut të produkteve me akcizë të përjashtuar” të pasqyruar edhe në proces-verbalin e verifikimit të kundërvajtjes administrative me nr.serial 000528 datë 17.11.2014 si dhe materialin me nr.398/1 prot datë 10.03.2015 është konstatuar se subjekti ka një sasi prej 210,834 kg naftë brutto në mungesë për të cilën është llogaritur një detyrim doganor prej 5,270,850 lekë gjatë kontrollit në magazinën fiskale me nr.AL03411202900 dhe për këtë fakt është rekomanduar Njoftimi i Organeve Tatimore për rezultatet e kontrollit në ngarkim të subjektit “Transatlantic Albania LTD-Dega Shqipëri me NIPT K72205016P me NIPT L02010020K ku është kërkuar marrja në konsideratë e pagesës së detyrimit tatimor të përlllogaritur në shumën 3,801,180 lekë për vlerën e TVSH mbi vlerën e mallit dhe vlerën e akcizës së lindur dhe të papaguar në zbatim të Ligjit 92 datë datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën” pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë . Ky observacion nuk u mor në konsideratë dhe nuk u reflektua në Raportin Përfundimtar të Auditimit

Gjithashtu

1. Në lidhje me Vendimin Administrativ nr.57, datë 30.06.2016 ku citohet se: “në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje doganore, por kemi të bëjmë me mosmbylljen në afat të skemes së TVSH së përfituar në doganë”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Mustafallari, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi nga ana e subjektit është vepruar jo në përputhje me afatet e përcaktuara në autorizimin për shtyrjen e TVSH, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.2 dhe 275.1 të KD.

2. Në lidhje me Vendimin Administrativ nr.46, datë 26.05.2016 ku citohet se: “...Subjekti...është paraqitur në DDV dhe me deklaratën doganore IM4 me R-6445, datë 26.05.2016 i ka dhënë destinacion doganor mallit..”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Mustafallari, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi konstatimet janë bërë me hedhjen e mallit për qarkullim të lirë dhe jo në tranzit.

3. Në lidhje me Vendimin Administrativ nr.28, datë 13.04.2017 ku citohet se: “...Kodi i Ri Doganor një penalitet të tillë e ka parashikuar me dënim një fish..”;

Qëndrimet e Audituesit Shtetëror të të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:

Në lidhje me komentet e bëra nga z. Mustafallari, sqarojmë se pretendimet e mësipërme nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit, pasi Kodi i Ri Doganor lidhur me kapitullin e shkeljeve në fushën doganore ka hyrë në fuqi pas Qershorit 2017

Subjekti i audituar Dega Doganore Vlorë me shkresën nr.1138/32 prot datë 09.03.2018 dhe shkresën nr.1111 prot datë 08.03.2018 ka bërë komente dhe shpjegime nisur specifikisht edhe nga observacionet e subjekteve të prekura si palë e interesuar si më poshtë vijon,

.Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH-së, referuar përcaktimit të nenit 29 të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH.

*Konkretisht u shqyrtuan observacionet e Degës Doganore Vlorë të përmendur në këtë material për materializimin e akteve administrative për subjektin “Kem Kolor” i cili lidhet me “Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor” me nr.2813 nxjerrë më datë 02.11.2016 që lidhet me praktikën doganore nr R 11043 datë 01.09.2016 për mallin e deklaruar si “Tretës Boje” në kodin tarifor *38140090* është konkluduar në përfundim në klasifikimin tarifor në kreun tarifor *27101221* “Karburantet e bardha” për të cilin është dalë me vendim administrativ dhe u reflektua në raportin përfundimtar të auditimit*

*Për subjektin “Sirol 2008” që i referohet shkresës nr.15062/2 prot DPD datë 14.10.2015 që lidhet me “Certifikatën e Verifikimit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor” me NR. 112 nxjerrë më datë 05.10.2015 që lidhet me praktikën doganore nr R 8225 datë 15.06.2015 për mallin e deklaruar si “Etanol Denatyred” në kodin tarifor *22072000* është konkluduar në përfundim në klasifikimin tarifor në kreun tarifor *22071000* “Alkol etilik jo i denatruar i një forcë ndaj volumit prej 80% vol. apo më shumë” .Konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë përcaktimi i dhënë ligjor i dhënë sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 61 “Për Akcizat në RSH” sipas shkallës së detyrimit të akcizës prej 45 000 lekë për HL alkool anhidër e llogaritur në detyrimin e akcizës prej 2580 litra alkool anhidër *45.000 lekë Hektoliter. të vijohet me nxjerrjen nga Autoriteti Doganor Vlorë me vendimarrje dhe të informohet Departamenti i Akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit bazuar në ligjin organik.*

VI. DOKUMENTACIONI SHOQERUES

Pjesë përbërëse e Raport Përfundimtarit të Auditimit është edhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë :

1-Akt Konstatime nr. 1 datë 19.01.2018 ” Për pikën nr.8 të ndryshme gjatë auditimit”(mbajtur nga auditues Agron Opari)

2-Akt Konstatime nr. 2 datë 19.01.2018 ” Për pikën nr.4 auditimi i procedurave doganore gjate veprimtarisë së regjimeve doganore ekonomike” (mbajtur nga auditues Livan Hoxha)

3-Akt Konstatime nr.3 datë 19.01.2018 ”Për pikën nr.3auditimin e sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor” (mbajtur nga auditues Agron Opari)

4-Akt Konstatime nr. 4 datë 19.01.2018 ” Për pikën nr.6për auditimin e procedurave gjatë marrjes së vendimeve administrative” (mbajtur nga auditues Agron Opari)



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “DEGEN DOGANORE VLORE”

- 5-Akt Konstatime nr. 5 datë 16.01.2018 ” Për pikën nr. 3 për auditimin e sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor” (mbajtur nga auditues Aqif Klosi)
- 6-Akt Konstatime nr. 6 datë 16.01.2017 ”Për pikën nr. 1 auditimi i zbatimit të rekomandimeve të mëparshme“(mbajtur nga auditues Aqif Klosi)
- 7-Akt Konstatime nr. 7 datë 17.01.2017 ”Për pikën nr.4 për auditimin e procedurave të ndjekura nga sektori rregjim doganore ekonomike” (mbajtur nga auditues Aqif Klosi)
- 8-Akt Konstatime nr. 8 datë 18.01.2017 ”Për pikën nr.3për auditimin e sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor” (mbajtur nga auditues Aqif Klosi)
- 9-Akt Konstatime nr.9 datë 19.01.2018 ”Për pikën nr. 2 për auditimin e procedurave të ndjekura gjatë mbledhjes së të ardhurave doganore” (mbajtur nga auditues Livan Hoxha)
- 10-Akt Konstatime nr. 10 datë 19.01.20178 ”Për pikën nr.5 për auditimin e procedurave të ndjekura nga sektori i mbledhjes së borxhit doganor” (mbajtur nga auditues Livan Hoxha)
- 11-Akt Konstatiminr. 11 datë 19.01.2018 ”Për pikën nr.6 për auditimin e procedurave doganore gjatë marrjes së vendimeve administrative” (mbajtur nga auditues Altin Dinaj)
- 12-Akt Konstatimi nr. 12 datë 20.10.2017 ”Për pikën nr.3 për auditimin e procedurave të ndjekura gjatë sistemit të vlerësimit doganor” (mbajtur nga auditues Altin Dinaj)
- 13-Akt Konstatime nr. 13 datë 20.10.2017 ”Për pikën nr.4 për auditimin e procedurave të ndjekura nga sektori rregjimive doganore” (mbajtur nga auditues Altin Dinaj)
- 14-Akt Konstatime nr.14 datë 20.10.2017 ”Për pikën nr.5 për auditimin e procedurave të ndjekura për arkëtimin e borxhit doganor” (mbajtur nga auditues Livan Hoxha)
- 15-Akt Verifikimi nr. 1 datë 20.10.2017 ”Për pikën nr.3 për auditimin për auditimin e sistemit të vlerësimit doganor dhe klasifikimit tarifor” (mbajtur nga auditues Altin Dinaj)
- 16-Akt Verifikimi nr 2 datë 20.10.2017 ”Për pikën nr.8 të Tjera(mbajtur nga auditues Altin Dinaj)

GRUPI I AUDITIMIT

- 1.Altin DINAJ (Përgj/grupi)
2. Livan HOXHA
- 3.Agron OPARI
- 4.Aqif KLOSI

DREJTORI DEPARTAMENTIT

Azmi STRINGA